



# **Raiffeisen Invest Albania**

## **Raport Vjetor 2017**

**Raiffeisen Invest sh.a.**  
**Fondi i Investimit Raiffeisen Prestigj**  
**Fondi i Investimit Raiffeisen Invest Euro**  
**Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen**

Ky raport nuk është një ofertë ose reklamë për shitjen e kuotave të fondeve të Raiffeisen INVEST. Raporti vjetor përmban pasqyrat financiare të shoqërisë administruese dhe secilit prej fondeve për vitin 2017, të audituara nga shoqëria DELOITTE AUDIT ALBANIA sh.p.k.

# Përmbajtja

<b>Mesazh nga Këshilli i Administrimit</b>	<b>4</b>
<b>Mesazh nga Administratori i Përgjithshëm</b>	<b>5</b>
<b>Raiffeisen Invest sh.a</b>	<b>8</b>
Misioni dhe Vlerat	8
Qeverisja e Korporatës	9
Stafi Ynë	10
Kodi i Etikës	12
Procesi i Investimit	12
Konflikti i Interesit	12
<b>Përgjegjësia Sociale</b>	<b>13</b>
<b>Edukimi financiar dhe transparenca ndaj publikut</b>	<b>16</b>
<b>Raport i Menaxherëve të Fondeve</b>	<b>18</b>
<b>Performanca e Fondeve – 31 Dhjetor 2017</b>	<b>18</b>
<b>Zhvillimet Ekonomike</b>	<b>19</b>
<b>Fondi Raiffeisen Prestigj</b>	<b>21</b>
Performanca	21
Portofoli i Investimeve	22
Strategjia e investimit gjatë vitit 2018	23
Top 10 (Investimet Kryesore si % e asetëve)	23
<b>Fondi Raiffeisen Invest Euro</b>	<b>24</b>
Performanca	24
Portofoli i Investimeve	25
Strategjia e investimit gjatë vitit 2018	26
Top 10 (Investimet Kryesore si % e asetëve)	26
<b>Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen</b>	<b>27</b>
Performanca	27
Portofoli i Investimeve	28
Strategjia e zhvillimit të fondit gjatë vitit 2018	28
Top 10 (Investimet Kryesore si % e asetëve)	28
<b>Raport i Menaxherit të Rrezikut</b>	<b>29</b>
<b>Pasqyrat Financiare &amp; Raporti i Audituesit të Pavarur</b>	<b>30</b>
<b>Raiffeisen Invest sh.a – Shoqëria administruese</b>	<b>30</b>
<b>Fondi Raiffeisen Prestigj</b>	<b>64</b>
<b>Fondi Raiffeisen Invest Euro</b>	<b>96</b>
<b>Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen</b>	<b>128</b>

# Mesazh nga Këshilli i Administrimit

Të nderuar investitorë!

Raiffeisen Invest sh. a, shoqëria administruese e fondit të pensionit vullnetar dhe fondeve të investimit, ka vazhduar të tregojë rritje të qëndrueshme në tregun vendas përgjatë vitit 2017. Ajo ka ndjekur vizionin e saj e të qenit lider në tregun shqiptar nëpërmjet produkteve financiare që ofron, të cilat vazhdojnë të shihen me shumë interes nga investitorët vendas.

Ekonomia shqiptare ka vijuar të ketë një trend pozitiv zhvillimi duke ndihmuar në zgjerimin e aktivitetit ekonomik vendas. Kjo sigurisht ka dhënë efektet e veta edhe në sektorin financiar ku Fondet e Investimeve zenë tashmë një peshë shumë të rëndësishme.

Tregjet financiare kanë ndjekur një trend të lehtë rritës të normave të interesit në monedhën vendase duke ndikuar në uljen e kthyeshmërisë së fondit në Lekë krahasuar me vitin e kaluar ku normat e interesit prekën nivele shumë të ulta. Megjithatë fondi i investimeve në LEKË arriti të ofrojë një kthim të kënaqshëm, duke qenë kështu një alternativë tërheqëse investimi në monedhën vendase dhe duke vazhduar të zërë një peshë të rëndësishme të tregut financiar shqiptar.

Gjithashtu, Fondi në Euro vazhdon të shihet me shumë interes nga investitorët individualë vendas duke qenë një ndër alternativat më të mira të investimeve në monedhën Euro, krahasuar me ato që ofron tregu financiar shqiptar.

Vlen të theksohet bashkëpunimi i ngushtë i Raiffeisen Invest me Autoritetin rregullator lokal për zhvillimin dhe zbatimin e kuadrit ligjor në frymën e direktivave të Bashkimit Evropian për tregjet financiare jobankare, të cilat do të japin një zhvillim pozitiv tregut lokal. Falë këtij bashkëpunimi dhe falë kërkesave në rritje të menaxhimit të brendshëm është arritur që t'u sigurohet klientëve transparencë në produktete e ofruara dhe dedikim në rritjen e edukimit financiar të investitorëve vendas.

Raiffeisen Invest sh.a. përveç kontributit të dhënë në tregun financiar vendas njihet edhe për kontributin e dhënë në financimin e projekteve të ndryshme për komunitetin shqiptar.

Gjatë vitit në vazhdim, shoqëria Raiffeisen Invest sh.a duke vlerësuar oportunitetet e tregut vendas, kërkesat në rritje të investitorëve për kthyeshmëri më të lartë si dhe eksperiencat e ngjashme në fushën e investimeve do të vijë pranë investitorit me mundësi të reja investimi duke synuar të zhvillojë më tej linjën e produkteve të ofruara. Kjo sigurisht do të shoqërohet me një strategji të qartë e cila do të forcojë pozitën lider të Raiffeisen Invest në tregun vendas duke u bërë një pjesë integrale e rëndësishme e tij.

Në emër të Këshillit të Administrimit dua të falënderoj të gjithë investitorët tanë për besimin e treguar dhe bashkëpunimin disa vjeçar duke i siguruar se stafi i Raiffeisen Invest do të jetë gjithmonë në shërbim të tyre me eksperiencën shumëvjeçare në fushën e investimeve.

Çdo arritje në rezultatet financiare të fondeve nën administrim është rrjedhojë e punës së përkushtuar të një stafi profesional dhe me integritet të lartë.



Në emër të Këshillit të Administrimit

**Donalda Gjorga**

**Kryetare e Këshillit të Administrimit**

# Mesazh nga Administratori i Përgjithshëm

Të nderuar investitorë!

Raiffeisen Invest sh.a., shoqëria më e madhe në vend për administrimin e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive (fonde investimi) dhe Fondeve të Pensionit Vullnetar e zgjeroi aktivitetin e saj të suksesshëm edhe gjatë vitit 2017.

Fondet e investimit i ofruan publikut mundësi komode për të investuar kursimet e tyre në Lekë dhe në Euro, dhe njëkohësisht të diversifikojnë portofolin jashtë spektrit të produkteve bankare. Po kaq i rëndësishëm ka qenë edhe roli i Fondit të Pensionit Vullnetar, si një mekanizëm efikas për të plotësuar të ardhurat e moshës së pensionit.

Gjatë 2017-ës, ekonomia shqiptare regjistroi një përmirësim të ritmit të rritjes dhe politika monetare e Bankës së Shqipërisë ruajti prirjen e saj lehtësuese, në kushtet e presioneve të ulëta inflacioniste. Norma bazë e interesit ka mbetur e pandryshuar, në nivelin më të ulët historik prej 1.25 përqind. Yield-et e titujve të borxhit të qeverisë shqiptare - bonove dhe obligacioneve të thesarit, kanë shfaqur ecuri më të qëndrueshme në tregun primar, pas luhatjeve të ndjeshme që pësuan në fund të vitit 2015 dhe gjatë vitit 2016. Pasi ranë në muajt e parë të vitit, ato filluan të rriten në mënyrë të përmbajtur dhe pothuajse uniforme në të gjitha maturitetet, ndërsa pjerrësia e kurbës së yield-eve ka mbetur e pandryshuar kundrejt një viti më parë.



Gjithashtu tregjet ndërkombëtare të obligacioneve shënuan kthime të qëndrueshme pavarësisht luhatshmërive si pasojë e zhvillimeve ekonomiko-politike në Europë dhe Shtetet e Bashkuara. Rritja ekonomike përgjithësisht ka qenë më e shpejtë, jo vetëm për vendet me ekonomi të zhvilluar, por edhe për ato në zhvillim. Presionet inflacioniste mbeten përgjithësisht të dobëta, ndonëse në vendet e zhvilluara ato treguan shenja rigjallërimi.

Ekipi i Raiffeisen Invest menaxhoi me përkushtim dhe profesionalizëm asetet e investitorëve duke ulur duration të portofoleve të fondeve të investimit përballë rrezikut të rritjes së normave të interesit dhe duke siguruar kapitalin e investitorit dhe një performancë tejet të kënaqshme dhe konkurruese, respektivisht 3.87 përqind për fondin e investimit në lekë, 2.72 përqind për fondin e investimit në euro dhe 5.86 përqind për fondin e pensionit vullnetar.

Në dy fondet në monedhë vendase (Prestigj dhe Pension) ku mungon mundësia për diversifikim mbi bazë emetuesi, investimi i aseteve u fokusua në menaxhimin e duration, për të siguruar balancën e drejtë midis kthimit dhe likuiditetit. Fondi në monedhën Euro, pavarësisht natyrës si fond obligacionesh ofroi mundësi diversifikimi sipas emetuesve (obligacione të qeverive, korporatave apo fonde të tjera investimi) dhe sektorëve (financiar, telekomunikacion, shëndetësi, transport etj). Në të tre fondet, vëmendje e veçantë është treguar për mbajtjen e niveleve të duhura të likuiditetit për të mundësuar shlyerjen në kohë të investitorëve.

Për sa i përket ecurisë së aktivitetit, gjatë vitit 2017 vlera neto e aseteve të fondeve të investimit u rrit me 10 përqind respektivisht për secilin prej tyre, ndërsa fondi i pensionit shënoi një rritje të konsiderueshme prej 23 përqind. Viti 2017 u mbyll me një nivel asetesh nën administrim prej 543.8 milion eurosh (429.4 milionë për fondin e investimit në lekë, 110.7 milionë për fondin e investimit në euro dhe 3.8 milionë për fondin e pensionit).

Përveç administrimit sa më të mirë të aseteve të investitorëve, një nga objektivat kryesorë gjatë vitit që lamë pas ishte rritja e nivelit të transparencës ndaj investitorit. Forca shitëse është trajnuar dhe orientuar në mënyrë të vazhdueshme

mbi produktet e investimit dhe komunikimin me investitorët dhe rezultatet e këtij bashkëpunimi janë vlerësuar pozitivisht nga autoritetet mbikëqyrëse në vend. Për më tepër, nëpërmjet informacionit të ndarë përmes faqes zyrtare, Raiffeisen Invest u përkujdes për një informim sa më të gjerë të publikut.

## **Pritshmëritë për vitin 2018**

Objektivat kryesore për vitin 2018 vazhdojnë të kenë në fokus klientin. Ato lidhen me njohjen e mirë të tij, menaxhimin cilësor të aseteve që na ka besuar si dhe futjen e opsioneve të reja të investimit paralelisht me rritjen e ndërgjegjësimit dhe njohurisë mbi fondet e investimeve në Shqipëri.

Menaxhimi i kujdesshëm i likuiditetit dhe performanca e mirë e fondeve në kontekstin e zhvillimeve ekonomike dhe eurisë së normave të interesit, do të jenë prioritetet kryesore për vitin e ardhshëm.

Viti 2018 pritet të jetë një vit sfidash, i karakterizuar nga një mjedis normash interesi relativisht të ulëta, ku sigurisht do të ketë hapësirë për luhatshmëri në funksion të rritjes ekonomike dhe zhvillimeve politike si brenda vendit, ashtu edhe në tregjet ndërkombëtare. Ne jemi të angazhuar që të përshtasim në mënyrë proaktive politikat e investimit dhe manaxhimit të rrezikut me sinjalet e dhëna nga tregjet, me qëllim që investitorët në terma afatmesëm të përfitojnë sigurinë dhe përfitueshmërinë e pritur. Transparenca ndaj tyre, si në procesin e shitjes së fondeve, ashtu edhe në atë të mirëmbajtjes së marrëdhënies ekzistuese investitor-shoqëri administruese, mbetet detyrim dhe angazhim i padiskutueshëm.

Gjithashtu, në funksion të tipologjisë së klientit të fondeve, i cili është kryesisht një klient me horizont investimi afatmesëm, si dhe me qëllimin për të pasur një gamë më të gjerë e më të diversifikuar produktesh, Raiffeisen Invest do të fokusohet në dizajnimin dhe lançimin e fondeve të reja të investimit, fillimisht në lekë e më pas në monedhën euro, me profil rreziku të ndryshëm nga fondet ekzistuese.

Një objektiv tjetër shumë i rëndësishëm gjatë 2018-s do të jetë edhe gjetja e mënyrave të reja për të aplikuar qasje inovative për përmirësimin e produkteve dhe shërbimit. Strategjia e Raiffeisen Bank për dixhitalizimin e platformës dhe produkteve të saj do të shtrihet edhe në aktivitetet e Raiffeisen Invest duke e bërë më të lehtë procesin e investimit.

Viti 2018 e gjen Raiffeisen Invest të mirëpozicionuar për të udhëhequr tregun drejt rritjes dhe sofistikimit të mëtejshëm. Projekti i ndërmarrë nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për të përmirësuar legjislacionin që rregullon aktivitetin e fondeve të investimit me qëllimin për ta përafuar atë me legjislacionin e tregjeve të zhvilluara, do t'i hapë rrugë krijimit të alternativave të reja të investimit për publikun shqiptar. Rezultati do të jetë rritja e hapësirës për të diversifikuar më tej portofolin e investimeve, duke kërkuar mundësi të reja investimi.

Në përfundim, Ju falënderoj edhe njëherë për besimin tuaj tek Raiffeisen Invest dhe ju garantoj që edhe gjatë këtij viti që vjen ne do të vijojmë të menaxhojmë fondet tuaja me përkushtim, integritet dhe transparencë.

**Edlira Konini**  
**Administratore e Përgjithshme**



**Alketa Emini (Gjoçaj)**  
Zv/Administratore e Përgjithshme

**Lizander Saraçi**  
Drejtor i Departamentit të Riskut

**Edlira Konini**  
Administratore e Përgjithshme

# Raiffeisen Invest Sh.a

Raiffeisen Invest sh.a është shoqëria e parë e licensuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për administrimin e fondeve të pensionit vullnetar & sipërmarrjeve të investimeve kolektive.

Raiffeisen Invest sh.a ushtron aktivitetin e saj në përputhje të plotë me Ligjin nr. 10 197, datë 10.12.2009 "Per fondet e pensionit vullnetar" dhe Ligjin nr. 10 198, datë 10.12.2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive ", Direktivat e Grupit Raiffeisen dhe praktikatat më të mira.

Raiffeisen Invest sh.a është subjekt i mbikëqyrjes nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Administrimi i fondeve kryhet tërësisht nga stafi i Raiffeisen Invest sh.a.

Banka e Parë e Investimeve sh.a. (First Investment Bank Albania), me seli në Bulevardin "Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla 2, kati 14, Tiranë, është banka depozitare e fondeve të administruara nga shoqëria Raiffeisen Invest sh.a. gjatë vitit 2017.

Raiffeisen Invest sh.a, gjatë vitit 2017, ofroi për publikun dy fonde investimi, perkatësisht Fondin Raiffeisen Prestigj në lekë, dhe Fondin Raiffeisen Invest Euro në monedhën euro, si dhe Fondin e Pensionit Vullnetar Raiffeisen;

Edhe gjatë vitit 2017, Raiffeisen Invest sh.a vazhdoi të ruante pozicionin e shoqërisë lider në tregun financiar shqiptar në fushën e administrimit të asetëve, me një fokus të qartë në kujdesin ndaj investitorëve, transparencën ndaj tyre dhe zbatimin e praktikave më të mira.

Numri i klientëve deri në fund të vitit 2017 ishte 33,722 me një total asetesh nën administrim rreth 543.8 milionë Euro.

## Misioni dhe Vlerat

### Misioni:

T'u ofrojmë investitorëve alternativa të reja dhe të përshtatshme investimi, bazuar në parime dhe profesionalizëm, duke mundësuar zhvillimin e tregut të kapitalit në vend, nëpërmjet fokusimit dhe jo vetëm në:

- Njohjen e klientëve dhe orientimin e tyre drejt vendimarrjes së duhur të investimit;
- Menaxhimin cilësor të asetëve me qëllim kthime të kënaqshme nga investimi;
- Mirëqeverisjen e korporatës;
- Krijimin e opsioneve të reja për investim, paralelisht me rritjen e edukimit financiar të publikut mbi fondet e investimit & pensionit vullnetar.

### Vlerat:

Jemi pjesë e Grupit Raiffeisen, një emër i madh bazuar në standarte;

- Shoqëri lider në menaxhimin e asetëve në tregun shqiptar;
- profesionalizëm i lartë, duke aplikuar praktikatat më të mira të menaxhimit të asetëve;
- Procesi i investimit bazohet në integritet, transparencë dhe standarte të larta;



# Qeverisja e Korporatës

Raiffeisen INVEST sh.a. është shoqëri aksionare, e organizuar sipas sistemit me një nivel drejtimi, në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë " Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Selia e shoqërisë është në Blv. "Bajram Curri", ETC, Kati i 9-të, Tiranë, Shqipëri.

Aksionari i vetëm i shoqërisë është Raiffeisen Bank sh.a.

Organet drejtuese të shoqërisë janë : Asambleja e aksionarëve, Këshilli i Administrimit dhe Administratorët Ekzekutivë.

## 1. Asambleja e aksionarëve:

Asambleja e aksionerëve përbëhet nga përfaqësuesit ligjorë të aksionarit të vetëm të shoqërisë Raiffeisen Bank sh.a.

## 2. Këshilli i Administrimit:

Këshilli i Administrimit është organi qendror i Shoqërisë Raiffeisen Invest sh. a i cili kontrollon dhe mbikëqyr zbatimin e politikave tregtare dhe zhvillimin e biznesit.

<b>Kryetare</b>	<b>Donalda Gjorga</b> Chief Dealer - Departamenti i Thesarit - Raiffeisen Bank Albania, Tiranë
<b>Nën kryetar</b>	<b>Peter Zilinek</b> Drejtor i Departamentit Group Steering, në Qendrën e Kompetencës -Raiffeisen Capital Management, Austri
<b>Anëtare</b>	<b>Vilma Baçe</b> Drejtoreshë e Divizionit të Rrjetit të Shitjes dhe Shpërndarjes - Raiffeisen Bank Albania, Tiranë
<b>Anëtare</b>	<b>Alda Shehu</b> Drejtoreshë e Divizionit të Financës - Raiffeisen Bank Albania, Tiranë
<b>Anëtar</b>	<b>Joan Canaj</b> Drejtor i Divizionit të Riskut të Integruar - Raiffeisen Bank Albania, Tiranë
<b>Anëtare</b>	<b>Edlira Konini</b> Administratore e Përgjithshme - Raiffeisen Invest, sha.
<b>Anëtare</b>	<b>Alketa Emini (Gjoçaj)</b> Zv/Administratore e Përgjithshme - Raiffeisen Invest, sh. a

## 3. Stafi menaxherial i Shoqërisë

**Edlira Konini**  
Administratore e Përgjithshme

**Alketa Emini (Gjoçaj)**  
Zv/Administratore e Përgjithshme

**Lizander Saraçi**  
Drejtor i Departamentit të Riskut

**Rezarta Arapi**  
Drejtoreshë e Menaxhimit të Fondeve

**Brunilda Haxhimihali (Emini)**  
Drejtoreshë e Departamentit Ligjor, Përputhshmërisë & PPP

# Stafi ynë

Stafi i Raiffeisen Invest sh.a. është i talentuar dhe i përkushtuar për t'u siguruar investitorëve një menaxhim profesional të aseteve të tyre.

Edhe gjatë vitit 2017, shoqëria tregoi angazhim maksimal në zhvillimin e stafit të saj përmes trajnimeve dhe edukimit të vazhdueshëm.

Tematikat kryesore të trainimeve ishin të lidhura me "Manaxhimin e portofolit", "Manaxhimin e riskut të tregut nëpërmjet VAR dhe Kontrollit të Volatilitetit", "Qeverisja e Korporatës", "Masat lidhur me parandalimin e pastrimit të parave" etj.



**Rezarta Arapi**  
Drejtoresh e Menaxhimit të Fondeve

**Alketa Emini (Gjoçaj)**  
Zv/Administratore e Përgjithshme

**Lizander Saraçi**  
Drejtor i Departamentit të Riskut

**Edlira Konini**  
Administratore e Përgjithshme

**Brunilda Haxhimihali (Emini)**  
Drejtoresh e Departamentit Ligjor, Përputhshmërisë & PPP

## Kodi i Etikës

Në ushtrimin e aktivitetit të administrimit të aseteve, Raiffeisen Invest sh. a bazohet në legjislacionin shqiptar, si dhe udhëhiqet nga Kodi i Etikës së Grupit Raiffeisen.

Kodi i Etikës së Grupit Raiffeisen përshkruan vlerat e përbashkëta dhe standardet bazë të sjelljes etike në biznes që duhet të ndiqen nga të gjithë shoqëritë e Grupit. Ai udhëheq veprimtarinë e përditshme me të gjitha palët, brenda dhe jashtë shoqërisë.

Kryerja e veprimtarisë tregtare në mënyrë etike, të ligjshme dhe me përgjegjshmëri të lartë është thelbi i kulturës së shoqërisë Raiffeisen Invest sh.a.

Kodi i Etikës Raiffeisen është i detyrueshëm për çdo punonjës, dhe ka si qëllim të sigurojë që sjellja në marrëveshjet e biznesit dhe çëshjet e etikës të jetë në përputhje me standardet tona të larta.

Standartet bazohen në vlerat në vijim :

- **Fokusi tek Klienti ;**
- **Profesionalizmi ;**
- **Cilësia ;**
- **Respekti reciprok ;**
- **Iniciativa ;**
- **Puna në grup ;**
- **Integriteti ;**
- **Qeverisja e mirë e korporatës**

## Procesi i Investimit

Menaxhimi i portofolit kryhet në përputhje me "Rregullin e personit të kujdesshëm". Ky rregull detyron menaxherët e fondeve që të veprojnë dhe të investojnë me të njëjtin gjykim, kujdes e mençuri, me të cilin do të vepronte një person i kujdesshëm që po menaxhon asetet e tij ; jo për motive spekulimi, por për një motiv të pastër investimi, duke konsideruar mundësitë e ruajtjes së kapitalit dhe mundësinë e të ardhurave që do të fitonte si rezultat i këtij investimi.

Fondet e administruara nga Raiffeisen Invest sh. a manaxhohen nga profesionistët më të mirë në treg, me profesionalizëm dhe "kujdesin e duhur", të denjë për besimin e publikut.

## Konflikti i Interesit

Çdo punonjës i Raiffeisen Invest është i përkushtuar për të identifikuar dhe shmangur konfliktin potencial të interesit gjatë ushtrimit të detyrave.

Punonjësit sigurojnë që interesat e tyre nuk bien në konflikt me detyrimet e tyre ndaj shoqërisë apo me detyrimet e shoqërisë ndaj investitorëve.

Në veçanti, punonjësit e përfshirë në procesin e investimit të aseteve nuk duhet të kenë paralelisht një aktivitet apo biznes personal, i cili mund të jetë në konflikt me manaxhimin e investimeve në mënyrën e duhur, apo që mund të kufizojë aftësinë e tyre për të marrë vendime të paanshme.

Raiffeisen Invest sh. a ka në organizimin e saj Njësinë e Përputhshmërisë, një nga detyrat e veçanta të së cilës është parandalimi, identifikimi dhe zgjidhja e konflikteve të interesit midis shoqërisë dhe fondeve të saj si dhe ndërmjet fondeve me qëllimin që investitori të mos disavantazohet nga konflikte të mundshme interesi.

# Përgjegjësia Sociale

Në botëkuptimin e Grupit Raiffeisen, biznesi ynë mund të ketë një efekt të rëndësishëm në shtyllat e qëndrueshmërisë: në sferën ekonomike, në shoqëri dhe në mjedis.

Sikurse për vite me radhë, edhe gjatë vitit 2017 Raiffeisen Invest sh.a, ka vazhduar të kontribuojë në zhvillimin ekonomik , social –kulturore dhe mjedisor në Shqipëri.

Të rëndësishme kanë qenë kontributet e saj në sektorin shëndetësor, arsimor si dhe ato artistiko –kulturore.

Në sektorin e arsimit, vlen të përmenden projektet e mbështetura nga Drejtoritë Rajonale Arsimore: Vlorë, Krujë, Sarandë, Berat, Korçë, Përmet, dhe Gjirokastrë, të cilat lidhen me blerjen e pajisjeve të nevojshme për institucionet e arsimit, rikonstrukcionin e tyre si dhe organizimin e aktiviteteve të ndryshme kulturore në funksion të procesit të edukimit. Më konkretisht, mund të përmendim, projektet si vijon: “Rikonstrukcioni i Kopshtit të Fëmijëve në Berat”, “Blerja e pajisjeve për shkollën e fëmijëve me nevoja të veçanta në Vlorë”, “Përmirësimi i klasave për fëmijë me aftësi të kufizuara të Shkollës 9 Tetori, Sarandë”, “Pajisja me kamera sigurie të Shkolles Fan Noli”, “Rritja dhe përmirësimi i zonave të gjelbra” etj. Në veçanti, është mbështetur pajisja me libra e bibliotekave të qyteteve të ndryshme të vendit nëpërmjet projektit “Qyteti i Lexuesve”.

Në sektorin e shëndetësisë, janë mbështetur projektet e zbatuara nga Drejtoritë Rajonale të Shëndetit Publik si dhe Qendrat shëndetësore nëpër rrethe, të cilat lidhen me rikonstrukcionin dhe blerjen e pajisjeve të nevojshme për Qendrat shëndetësore dhe Spitalet , ku mund të përmendim: “Blerjen e pajisjeve për Qendrën Shëndetësore Nr.1 Fier”, “Rikonstrukcionin e dhomave të emergjencës për Qendrën Shëndetësore Mamurras”, “Rikonstrukcionin e Qendrës Shëndetësore në Fratar-Mallakastër”etj.

Për të qenë sa më pranë fëmijëve në nevojë është bërë i mundur ndërtimi i dy zonave për “Vlerësimin dhe Rikuperimin e fëmijëve me Autizëm”zbatuar nga Qendra TISS.

Në fushën e kulturës, janë mbështetur një sërë aktiviteteve artistiko-kulturore siç janë “Koncerti i violinistit të suksesshëm Olen Çezar”, “Reja Festival” e zhvilluar nga Bashkia Tiranë, “Pianodrom-Festivali Ndërkombëtar i Pianos”, “Jazz Festival”, si dhe shumë aktivitete të tjera kulturore të zhvilluara në qytete të ndryshme të vendit.

Raiffeisen Invest sha. në bashkëpunim me Raiffeisen Bank Sh.a, mbeten të angazhuara të japin kontributin e tyre të rëndësishëm në zhvillimin e mëtejshëm ekonomik dhe social –kulturore të vendit.



Projekti i zbatuar nga Qendra TISS për "Vlerësimin dhe Rikuperimin e fëmijëve me Autizëm"



"Të mblidhemi së bashku" aktivitetet për të rinjtë, i zhvilluar nga Shoqata Gjymnastike e Aerobisë



"Konferenca e 3-të Kombëtare për Financën", e zhvilluar nga Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës



Koncerti i violinistit Olen Çesar në Tiranë

# Edukimi financiar dhe transparenca ndaj publikut

Në funksion të objektivit për edukimin e vazhdueshëm të publikut dhe rritjen e nivelit të transparencës lidhur me fondet e pensionit vullnetar dhe fondet e investimit, Raiffeisen Invest sh.a. gjatë vitit 2017 publikoi dy broshura informuese në faqen zyrtare të kompanisë, për secilin tip fondi nën administrim.



Broshura informuese për fondet e investimit përmban informacion të përgjithshëm dhe të thjeshtë për publikun në lidhje me karakteristikat e produktit dhe avantazhet/rreziqet e investimit në një fond investimi.

Kjo broshurë i vjen në ndihmë investitorëve për të kuptuar natyrën e fondeve të investimit, përpara se të marrin vendimin për të investuar në fond.



Broshura informuese për fondin e pensionit vullnetar përmban informacion të përgjithshëm dhe të thjeshtë për publikun me fokus kryesor në karakteristikat e fondit, planet pensionale të ofruara nga Raiffeisen Invest sh.a, arsyet pse është e nevojshme për të patur një fond pensioni vullnetar si dhe lehtësitë fiskale.



Edhe gjatë vitit 2018, Raiffeisen Invest sh.a do të vijojë të ketë në fokus edukimin e publikut të gjerë në lidhje me produktet e investimit. Për të përmbushur këtë objektivi, Raiffeisen Invest sh.a do të publikojë në faqen zyrtare broshura të shkurtëra edukuese dhe informuese, me qëllimin për të pasuruar nivelin e njohurive të investitorëve të rinj dhe ekzistues dhe për të qënë sa më transparent në lidhje me produktet që ofron.

# Raport i Menaxherëve të Fondeve

## Performanca e Fondeve në 31 Dhjetor 2017

### Kthimi neto nga investimi

Fondi	1 vit (kthimi në bazë vjetore 31.12.2016-31.12.2017)	3 vjet (kthimi në bazë vjetore 31.12.2014-31.12.2017)	Që nga krijimi i fondit (kthim me bazë vjetore)
Raiffeisen Prestigj	3.87%	5.92%	6.38%
Raiffeisen Invest Euro	2.72%	2.94%	3.11%
Raiffeisen Pension	5.86%	6.72%	7.27%

\*Tarifa e administrimit zbritet përpara llogaritjes së kthimit nga investimi

### Çmimi i Kuotës së Fondeve për 3 vitet e fundit

Fondi	Më 31.12.2017	Më 31.12.2016	Më 31.12.2015
Raiffeisen Prestigj	1,434.8851	1,381.4541	1,289.5286
Raiffeisen Invest Euro	116.9382	113.8404	109.5685
Raiffeisen Pension	1,634.9663	1,544.4451	1,443.8130

### Tarifat e Fondeve

Fondi	Tarifa e Menaxhimit (në bazë vjetore si % e asetëve)
Raiffeisen Prestigj	1.25%
Raiffeisen Invest Euro	1.50%
Raiffeisen Pension	1.50%

# Zhvillimet Ekonomike

## Tregu financiar shqiptar dhe të dhënat makroekonomike

Gjatë vitit 2017 aktiviteti i fondeve të Raiffeisen Invest u zhvillua në një mjedis ekonomik relativisht sfidues në tregun e brendshëm dhe të jashtëm financiar, ku normat e interesit kanë ndjekur një trend të lehtë rritës në monedhën vendase LEKË dhe kanë vazhduar të jenë të ulëta në monedhën Euro.

Sistemi bankar u karakterizua nga norma të ulëta të interesit për depozitat në LEKË dhe Euro. Sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë, në fund të vitit, norma mesatare e interesit për depozitat 1 vjeçare në lekë ishte 0.61 përqind, ndërsa norma e interesit mesatar për depozitat me afat në euro ishte 0.16 përqind. Një rënie e tillë i atribuohet dy faktorëve kryesorë: tepricës së likuiditetit të sistemit bankar, dhe politikës monetare lehtësuese të ndjekur nga Banka Qendrore.

Në pjesën e parë të vitit, yield-et në ankandet e tregut primar të titujve të borxhit të Qeverisë Shqiptare treguan rënie të lehtë për të gjitha maturitetet, ndërsa në pjesën e dytë të vitit treguan një rritje të përmbajtur për të gjitha maturitetet. Normat e interesit të titujve të borxhit të Qeverisë Shqiptare mbeten ende në nivele të ulëta, duke favorizuar kështu edhe rritjen e kreditimit. Qeveria Shqiptare organizoi dy ankande në tregun lokal në monedhën Euro gjatë vitit 2017, përkatësisht në muajin Janar dhe Gusht. Defiçiti buxhetor qëndron në 2 përqind të GDP; ndërsa borxhi publik vlerësohet të jetë afro 70 përqind e GDP në vitin 2017.

Monedha vendase është vlerësuar kundrejt monedhave të vendeve kryesore partnere tregtare. Kështu, gjatë 2017, një Euro është këmbyer mesatarisht me 134.20 lekë – rreth 2.3 përqind më lirë se vitin e kaluar.

Vlerësimi i agjencive të rating për borxhin e Qeverisë Shqiptare qëndroi i pandryshuar në nivelin B1 nga Moody's dhe B+ nga "Standard & Poors".

Hap pozitiv drejt një tregu financiar më të zhvilluar në Shqipëri ishte liçensimi nga ana e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF), në korrik 2017 të bursës së parë private në Shqipëri, "Albanian Securities Exchange - ALSE sh. a".

## Tregu vendas i Fondeve të Investimit

Gjatë vitit 2017, në tregun e fondeve të investimeve ushtruan aktivitetin e tyre 3 fonde investimi, nga të cilat dy nën administrimin e Raiffeisen Invest sh.a.

Të dhënat e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare tregojnë se gjatë vitit 2017, tregu i fondeve të investimit u rrit me 11.14 për qind. Për këtë periudhë, vlera neto e asetëve të Fondeve, arriti rreth 72.72 miliardë lekë, me një rritje prej 7.29 miliardë lekë ose 11.14 për qind, krahasuar me vitin 2016. E shprehur në euro, totali i asetëve neto është 539 milionë euro.

Ky treg dominohet kryesisht nga investimet në Obligacione Qeveritare, të cilat përbëjnë 61.30 përqind të asetëve të fondeve, me një rritje prej 5.84 përqind krahasuar me vitin 2016. Krahas vlerës së asetëve, rritje ka pësuar edhe numri i individëve që kanë zgjedhur këtë formë investimi. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare konstaton se gjatë vitit 2017, numri i anëtarëve që kanë investuar në Fondet e Investimit arriti në 31.320, duke u rritur me 7.01 përqind krahasuar me një vit më parë.

Gjatë vitit 2017, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare menaxhoi një projekt të rëndësishëm me bashkëpunim të ekspertëve të huaj, me qëllim përmirësimin e kuadrit mbikëqyrës dhe rishikimin e kuadrit ligjor dhe rregullator të fondeve të investimeve në përputhje me parimet e BE-së dhe standardet ndërkombëtare. Finalizimi i projektit gjatë vitit 2018 do të hapë opsione për lloje të tjera të fondeve dhe zgjerim potencial të tregut.

## Tregjet financiare ndërkombëtare

Tregjet financiare ndërkombëtare u karakterizuan nga rritja ekonomike dhe vlera modeste inflacioni gjatë vitit 2017, të cilat nxitën rritje të fitimeve të korporatave dhe kthime që tejkalojnë pritshmëritë e vendosura në fillim të vitit. Vlerat e aksioneve në nivel global pësuan rritje mes rigjenerimit ekonomik, rritjes së të ardhurave të korporatave dhe masave stimuluese të ndërmarra nga Bankat Qendrore.

Rezultatet e zgjedhjeve në Francë, Holandë, Gjermani e Japoni ndihmuan në rivendosjen e stabilitetit në ekonominë që më parë ishin vënë në vështirësi. Kështu në Europë, fitorja e Emmanuel Macron në Francë dhe Angela Merkel në Gjermani rivendosën stabilitetin e munguar brenda Bashkimit European si dhe ndihmuan monedhën e përbashkët Euro.

Viti 2017 nisi me entuziazëm rreth axhendës së administratës së presidentit Trump, e cila parashikonte masa nxitëse për bizneset, kyesisht nëpërmjete paketës së re fiskale. Kjo paketë ka për qëllim të transformojë sistemin fiskal të SHBA dhe parashikon ulje taksash duke synuar të rigjenerojë ekonominë amerikane. Ulja e taksave në SHBA do të nxisë rritjen ekonomike dhe inflacionin duke rritur kështu për rrjedhojë probabilitetin për rritje më agresive të normave bazë të interesit. Përsa u përket tregjeve të obligacioneve, Rezerva Federale Amerikane rriti normën bazë të interesit 3 herë gjatë vitit, duke e çuar këtë të fundit në intervalin e 1.25 - 1.50 përqind.

Masat ekspansioniste të ndërmarra nga Banka Qëndrore Europiane (BQE) përbënë një tjetër stimul për ekonominë dhe tregjet financiare Europiane. Kështu, BQE zgjati programin e blerjes së obligacioneve përtej 2018 – pavarësisht shenjave të përmirësimit ekonomik – dhe mbajti normat afatshkurtra bazë të interesit në nivele negative në një përpjekje për të nxitur kredidhënien e fuqizuar ekonominë.

Ritmi i rritjes së GDP të Eurozonës u rrit përgjatë të tërë vitit, duke arritur vlerën e 2.6 përqind në bazë vjetore në 3-mujorin e tretë të vitit. Norma e papunësisë ra në kuotën e 8.8 përqind – niveli më i ulët që nga 2009.


Në periudhën që tregjet u dominuan nga një pritshmëri për rritje ekonomike të ngadalësuar dhe nivel i paarrtur i inflacionit të synuar -- kryesisht në periudhën Qershor - Gusht 2017 -- normat e interesit të obligacioneve ranë, duke rritur kështu botërisht çmimet e tyre. Më pas, pavarësisht zgjatjes së programit stimules të BQE, pritshmëritë në rritje për fundin e këtij programi gjatë vitit 2018, bënë që normat e interesit të obligacioneve qeveritare të rriten në të gjitha maturimet gjatë pjesës së fundit të vitit 2017.



Gjithsesi, gjatë vitit 2017 çmimi i kuotës së Fondit Prestigj ka ndjekur një trend rritës dhe performanca e realizuar është e kënaqshme dhe konkurruese me alternativat e tjera të investimit në treg.

Çmimi i kuotës është rritur me 3.87 përqind për periudhën 31 Dhjetor 2016 – 31 Dhjetor 2017.

### Performanca historike e çmimit të kuotës të Fondit Raiffeisen Prestigj



## Portofoli i Investimeve

Gjatë vitit 2017, fondi Prestigj regjistroi rritje të asetëve me 10.49 përqind dhe gjeneroi një performancë të kënaqshme. Në përgjithësi rritja e asetëve të Fondit Prestigj ka qenë e kontrolluar në përputhje me objektivat tona strategjike. Vlera neto e asetëve të fondit arriti në 57 miliardë Lekë / 430 milionë Euro në Dhjetor të 2017.

Numri i anëtarëve në fond u rrit me 6.65 përqind gjatë vitit 2017, me 1656 anëtarë më shumë krahasuar me vitin paraardhës.

Rritja e normave të interesit të titujve të Qeverisë shqiptare gjatë pjesës së dytë të vitit ndikoi negativisht në performancën e investimeve të mëparshme. Megjithatë, investitorët vendas vazhduan t'ja besojnë kursimet e tyre në LEKË Fondit Prestigj, i cili gjeneroi një performancë pozitive dhe konkurruese në treg.

Gjatë vitit 2017, fondi investoi në bono dhe obligacione të emetuara nga qeveria shqiptare në tregun vendas, në monedhën LEKË. Shpërndarja e asetëve të fondit kishte për qëllim prodhimin e një marzhi fitimi sa më të lartë në krahasim me normën mesatare të interesit të ofruar në sistemin bankar për depozitat me afat 12 mujor, por në të njëjtën kohë edhe menaxhimin sa më efikas të rrezikut të likuiditetit dhe respektimin e raporteve të likuiditetit. Për këtë të fundit, është rritur pesha e asetëve me maturim afatshkurtër, kryesisht bono thesari dhe depozita afatshkurtëra dhe është ulur ndjeshëm kohëzgjatja mesatare e portofolit të investimit (duration) në nivelin 1.82.

Ulja e kohëzgjatjes mesatare të portofolit të investimit (duration) kufizoi impaktin negativ të vlerësimit të portofolit si pasojë e rritjes së normave të interesit të letrave me vlerë gjatë pjesës së dytë të vitit 2017. Të gjitha investimet e kryera gjatë 2017 janë regjistruar në portofolin e "Titujve për tregtim".

Likuiditeti i tepërt është investuar si depozitë afatshkurtër ose duke përdorur marrëveshjet e riblerjes me bankat lokale. Në 31 Dhjetor 2017, struktura e portofolit të investimeve paraqitet si në tabelën e mëposhtme:

Instrumenti	% e Aseteve
Bono Thesari	22.21
Obligacione Thesari	66.96
Depozita afatshkurtëra / Llogari rrjedhese	8.55
Marrëveshje të Riblerjes - Repo	2.28

## Strategjia e investimit gjatë vitit 2018

Fondi synon të ruajë një shpërndarje efikase të aseteve në instrumente të tilla si bono, obligacione, cash, depozita dhe marrëveshje riblerjeje (transaksione Repo). Pritshmeritë janë që normat e interesit të titujve të Qeverisë Shqiptare të kenë një trend të lehtë rritës gjatë gjysmës së dytë të vitit 2018.

Strategjia e investimit të fondit do të jetë kryesisht e përqëndruar në investime afatshkurtëra për të siguruar uljen e maturimit mesatar të portofolit (duration) dhe kufizimin e efektit të pritshëm negativ nga rritja e normave të interesit. Gjithashtu do të synohet zbatimi i politikave të brendshme për një menaxhim sa më efikas të likuiditetit. Ndërkohë do të vijojë aplikimi i shkallëzimit të maturimeve me qëllim për të siguruar një përfaqësim optimal të të gjithë kurbës së interesit të instrumenteve.

Portofoli i investimit do të vazhdojë të jetë i ekspozuar ndaj luhatshmërisë së normave të interesit të titujve të borxhit të emetuara nga Qeveria Shqiptare.

## Top 10 (Investimet Kryesore si % e aseteve)

Fondi Raiffeisen Prestigj	
Instrumenti	% e Aseteve
Obligacion Thesari 10 vjet – Mat 29.10.2023	6.88%
Obligacion Thesari 7 vjet – Mat 17.03.2021	4.23%
Obligacion Thesari 7 vjet – Mat 20.09.2020	3.30%
Obligacion Thesari 5 vjet – Mat 11.11.2018	3.17%
Obligacion Thesari 7 vjet – Mat 18.03.2020	2.70%
Obligacion Thesari 5 vjet – Mat 10.02.2019	2.48%
Obligacion Thesari 7 vjet – Mat 09.12.2021	2.21%
Obligacion Thesari 7 vjet – Mat 20.09.2020	2.20%
Obligacion Thesari 7 vjet – Mat 16.12.2020	2.19%
Obligacion Thesari 5 vjet – Mat 08.02.2018	2.02%

# Fondi Raiffeisen Invest Euro

Fondi Raiffeisen Invest Euro është i denominuar në monedhën Euro. Objektivi i fondit është t'i japë investitorit një kthim konkurrues, në përputhje me një menaxhim të kujdesshëm të asetëve duke mbrojtur kapitalin dhe ruajtur nivelin e likuiditetit të nevojshëm


Asetet e fondit janë të investuara kryesisht në obligacione të emetuara nga Qeveria Shqiptare, qeveri të vendeve të BE-së dhe korporata ndërkombëtare, depozita bankare afatshkurtëra dhe fonde investimi.

## Performanca e Fondit

Në bazë vjetore, kthimi për vitin 2017 ishte 2.72 përqind.

Në një mjedis financiar të ndikuar nga pasiguritë politike dhe paqartësia rreth politikave monetare të Bankave qendrore, performanca e Fondit Euro rezultoi relativisht e luhatshme gjatë vitit 2017.

### Ecuria e çmimit të kuotës Fondi Raiffeisen Euro gjatë vitit 2017



Në fillim të vitit, tregjet financiare të obligacioneve u stabilizuan pas humbjeve dhe luhatshmërisë së lartë gjatë fundit të vitit 2016 dhe portofoli i investimit të fondit u vlerësua pozitivisht.


Më tej tregjet financiare ndërkombëtare u karakterizuan nga një volatilitet i lartë si rrjedhojë e rrezikut politik që i parapriu raundeve të zgjedhjeve presidenciale në Francë gjatë Prill/Maj dhe zgjedhjeve federale në Gjermani në Shtator. Problematikat ekonomike u sheshuan disi me fitoren e zgjedhjeve në Francë nga Emmanuel Macron. Sidoqoftë, në pjesën e dytë të muajit Qershor, çmimi i kuotës së Fondit në Euro pësoi rënie. Shkak kryesor ishin pritshmëritë e rritura në tregjet ndërkombëtare për reduktim të stimujve monetarë nga ana e Bankës Qendrore Europiane dhe për rritje të normës bazë të interesit gjatë vitit 2018. Rritja e përgjithshme e normave të interesit bëri që portofoli i investimeve i fondit Euro të vlerësohej negativisht.

Më tej, gjatë muajve Gusht - Tetor, çmimi i kuotës së fondit Euro ndoqi një trend rritës teksa fondi performoi më mirë së në muajt e mëparshëm. Një gjë e tillë u ndihmua nga vendimi i Bankës Qendrore Europiane për të vijuar me programin e blerjes së obligacioneve deri në Shtator 2018. Kjo e fundit bëri që normat e obligacioneve qeveritare e të korporatave të qëndronin të ulta duke rritur çmimet e tyre. Gjithsesi, BQE shpalli se do të përgjysmojë blerjet mujore të obligacioneve, duke arritur në vlerën e EUR 30 miliardë.

Luhatshmëria u rikthye në tregjet financiare në fundin e vitit teksa u rritën paqartësitë mbi miratimin apo jo të reformës fiskale amerikane e mbi pasojat që kjo e fundit do të kishte mbi tregjet e korporatave e huaja. Gjithashtu, ndonëse Banka Qendrore Europiane, në mbledhjen e saj të fundit për 2017 nuk u shpreh për politikën monetare, fakti që presidenti i saj rinëvizoi nivelin e lartë të dinamizmit ekonomik dhe sentimentin e mirë ekonomik, bëri që të rriteshin gjasat për një




rritje të normave të interesit para pritshmërive. Kjo solli rritjen e yield-eve, duke u përkthyer kështu në rënien e lehtë të çmimit të kuotës.



Pavaresisht luhatshmërisë, kthimi vjetor neto i Fondit Raiffeisen Invest Euro është shumë i kënaqshëm për vitin 2017 dhe mjaft konkurrues në raport me alternativat e tjera të investimit në tregun shqiptar.

Çmimi i kuotës është rritur me 2.72 përqind për periudhën 31 Dhjetor 2016 – 31 Dhjetor 2017. Kthimi i Fondit Euro ishte dukshëm më i lartë krahasuar me normën mesatare të depozitave me afat 12 muaj në monedhën Euro ofruar nga bankat në vend, e cila për të njëjtën periudhë rezultoi 0.16 përqind.

### Performanca historike e çmimit të kuotës të Fondit Raiffeisen Invest Euro



## Portofoli i Investimeve

Fondi Euro regjistroi rritje të vlerës neto të asetëve me 10 përqind gjatë vitit 2017, ndërsa numri i anëtarëve në fond në fund të 2017 shënoi rritje të lehtë prej 1.53 përqind krahasuar me vitin paraardhës ose 66 anëtarë më shumë.

Gjatë vitit 2017 është zbatuar një politikë investimi e kujdesshme duke ndërthurur një manaxhim efikas të rreziqeve me shpërndarjen efektive të asetëve, me synimin për një kthim sa më të kënaqshëm për investitorët e Fondit. Portofoli i investimeve është përshtatur në përputhje me këtë objektiv, si dhe në përputhje me zhvillimet e tregut, bazuar në një përzgjedhje të kujdesshme të instrumenteve financiare.

Fondi Euro investoi në obligacione të emetuara në monedhën euro, si nga qeveria shqiptare ( Eurobondi Shqiptar dhe obligacion në Euro emetuar në tregun lokal) dhe qeveri të tjera europiane, ashtu edhe në ato të emetuara nga kompani të njohura ndërkombëtare me nivel të lartë të rating, dhe kuota fondesh të huaja investimi me fokus investimin në obligacione. Shpërndarja e asetëve të fondit kishte për qëllim diversifikimin e portofolit, me qëllim reduktimin e rrezikut të tregut, dhe sigurimin e likuiditetit të nevojshëm.

Në gjysmën e parë të vitit, investimet kryesore synuan

sigurimin e një yield-i më të lartë, ndërsa drejt fundit të vitit fokusi ishte kryesisht në uljen e kohëzgjatjes mesatare të portofolit të investimeve, duke qenë se titujt e borxhit afatgjatë janë të parët që ndikohen nga rritja e normave të interesit, çka u vu re në muajt e fundit të 2017.

Qeveria shqiptare organizoi 2 herë gjatë vitit ankandin e obligacionit 2-vjeçar në Euro në tregun e brendshëm – në Janar e në Gusht. Të dyja herët norma e kuponit rezultoi relativisht e ulët në nivelin 0.80 përqind. Ndërkohë, në tregjet

ndërkombëtare Eurobondi shqiptar vazhdoi të performojë shumë mirë veçanërisht pas afirmimit të vlerësimit të mirë për ekonominë shqiptare dhe opinionit të qëndrueshëm nga ana e kompanive të klasifikimit S&P dhe Moody's.

Vlera neto e aseteve të fondit ishte 110.7 milionë Euro në dhjetor të 2017. Në 31 Dhjetor 2017 struktura e Portofolit të investimeve paraqitet si në tabelën e mëposhtme :

<b>Instrumenti</b>	<b>% e Aseteve</b>
Obligacione të Qeverisë Shqiptare	35.78
Obligacione të Qeverive të huaja	8.15
Obligacione të Korporatave	26.52
Fonde të investimeve	24.54
Depozita / Llogari rrjedhëse	5.02

## Strategjia e investimit gjatë vitit 2018

Strategjia e Fondit edhe gjatë 2018-ës do të synojë një shpërndarje sa më efektive të aseteve midis klasave të ndryshme, duke diversifikuar portofolin mbi bazë emetuesi dhe sektori të ekonomisë.

Viti 2017 u mbyll me norma interesi relativisht të ulëta në tregun e obligacioneve dhe pritshmëritë për gjallërimin e ekonomisë për zonën Euro dhe për rritje të normës së inflacionit do të sjellin dhe rritje të normave të interesit në tregun e obligacioneve.

Rritja e normave të interesit mund të ndikojë negativisht në portofolin ekzistues të fondit në Euro dhe në këto kushte 2018-a do të jetë vit tepër sfidues për të gjeneruar kthime të kënaqshme.

Tregjet financiare pritet të karakterizohen nga paqëndrueshmeri dhe të dominohen nga ndikimet e mundshme të zbatimit të politikave monetare nga ana e Bankave Qendrore në Europë dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Kështu, nga njëra anë dominojnë prirjet e politikës monetare shtrënguese të Rezervës Federale në SHBA me pritshmëri të larta për të rritur vazhdimisht normat e interesit gjatë vitit 2018 dhe nga ana tjetër prirjet e politikës monetare nga ana e Bankës Qendrore Evropiane për tu orientuar drejt shtrëngimit dhe dhënies fund të programit të blerjes së obligacioneve në treg. Pritshmëritë janë që shumata e programit të blerjes së obligacioneve në treg të zerohen në fund të 2018.

Reziqet politike pritet të jenë të pranishme gjithashtu, sidomos me zgjedhjet elektorale të ardhshme në Itali, me pritshmëritë e politikës proteksioniste amerikane, pritshmëritë për rritje të çmimit të naftës, konfliktet e mundshme midis SHBA dhe Koresë së Veriut, apo Rusisë dhe Iranit dhe me shumë mundësi do të kenë ndikimin e tyre në tregjet financiare në përgjithësi.

Bazuar në këto pritshmëri, portofoli i fondit do të menaxhohet me kujdes dhe në raport me lëvizjet e tregjeve financiare për të ruajtur një performancë pozitive. Strategjia e investimit mbi bazën e "duration" do të jetë mjaft e rëndësishme në këtë mjedis, jo vetëm për sigurimin e performancës por edhe për menaxhimin e rrezikut të normave të interesit.

Në tregun vendas pritet aktiviteti i kufizuar emetues në monedhën euro nga ana e qeverisë shqiptare, por Fondi do të jetë aktiv në këto ankande, duke synuar të kryejë investime me norma interesi të pranueshme për nivelin e rrezikut të ndërmarrë dhe natyrën e një tregu joaktiv për emetimet në Euro në tregun vendas.

## Top 10 (Investimet Kryesore si % e aseteve)

<b>Fondi Raiffeisen Inveset Euro</b>	
<b>Instrumenti</b>	<b>% e Aseteve</b>
Eurobond 5 vjet i Qeverisë Shqiptare - ALBANI 5 ¾ 11/12/20	28.11%
Obligacion 2 vjet i Qeverisë Shqiptare - ALBANB 0.8 08/21/19	7.25%
Fondi Investimi - Raiffeisen – Euro - ShortTerm	4.46%
Fondi Investimi – Raiffeisen – Europa - HighYield	2.79%
Fondi Investimi – Raiffeisen 304 - Euro Corporates	2.67%
Obligacion Korporatë RBI – RBLAV 6 10/16/23	2.63%
Eurobond i Republikës së Malit të Zi – MONTEN 3 7/8 03/18/20	2.41%
Obligacion Korporatë RBI – RBLAV 6 5/8 05/18/21	2.34%
Eurobond i Republikës së Malit të Zi – MONTEN 5 ¾ 03/10/21	2.28%
Obligacion Korporatë ALLIANZ – ALVGR 3 ½ 02/14/22	2.11%

# Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen

Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen është i denominuar në monedhën lokale LEKË.

Objekti i fondit është investimi i asetëve sipas parimit të sigurisë afatgjatë dhe të një kthimi të përshtatshëm nga investimi, duke ruajtur një raport optimal mes rritjes së kursimeve për pension dhe rrezikut të marrë përsipër.

Gjatë vitit 2017, asetet e Fondit të Pensionit Vullnetar u rritën me 23 përqind dhe shoqëria stoi përpjekjet për të promovuar fondin e Pensionit në formën e planeve individuale dhe profesionale të pensionit.


Në kuadër të zgjerimit të sistemit të pensioneve vullnetare, u zhvilluan seanca informuese me kompani të ndryshme vendase, me qëllimin për të shtuar pjesëmarrjen në një fond pensioni privat të punonjësve të këtyre kompanive, çka do të shërbejë si një mekanizëm efikas për të rritur të ardhurat e pensionit nëpërmjet rritjes së kursimeve gjatë viteve të kontributit.

Vlera neto e asetëve të fondit arriti në 3.80 milionë Euro në dhjetor të 2017. Numri i anëtarëve në fond në fund të 2017 shënoi rritje prej 5.54 përqind krahasuar me vitin paraardhës ose 147 anëtarë më shumë.


## Performanca e Fondit

Në bazë vjetore, kthimi për vitin 2017 ishte 5.86 përqind.

Performanca e fondit të Pensionit ka rezultuar më e ulët krahasimisht me të njëjtën periudhë vitin e kaluar si rrjedhojë e nivelit të ulët të normave të interesit të obligacioneve afatgjata të Qeverisë Shqiptare.



## Ecuria e çmimit të kuotës Fondi të Pensionit Vullnetar Raiffeisen



Çmimi i kuotës së Fondit të Pensionit ka ndjekur një trend rritës gjatë vitit. Megjithëse së fundmi rritja ka qenë më e ulët ajo mbetet gjithsesi shumë e kënaqshme.

## Portofoli i Investimit

Gjatë vitit 2017 fondi investoi kryesisht në obligacione afatgjatë të emtuara nga qeveria shqiptare në tregun vendas, në monedhen LEKË. Rënia e normave të interesit për letrat me vlerë në pjesën e parë të vitit ndikoi pozitivisht në performancën e investimeve të mëparshme të realizuara nga Fondi i Pensionit.

Ndërsa në pjesën e dytë të vitit rritja e çmimit të kuotës së fondit është ngadalësuar si pasojë e efektit negativ që pati rritja e normave të interesit të letrave me vlerë në tregun vendas.

Shpërndarja e asetëve të fondit kishte për qëllim prodhimin e një marzhi fitimi sa më të lartë, objektiv i cili u arrit me sukses. Në 31 Dhjetor 2017 struktura e Portofolit të investimeve paraqitet si në tabelën e mëposhtme :

Instrumenti	% e Aseteve
Bono Thesari	-
Obligacione Thesari	98.22
Depozita / Llogari rrjedhëse	1.78

## Strategjia e zhvillimit të fondit gjatë vitit 2018

Per sa i perket investimeve, Fondi synon të ruajë balancën e duhur midis obligacioneve dhe cash / depozitave. Në fokus do të vazhdojnë të jenë investimet në obligacione afatgjatë duke patur parasysh edhe horizontin afatgjatë të investitorëve të fondit të pensionit.

Pritshmëritë janë që Fondi i pensionit të ketë rritje gjatë 2018, si rezultat i kontributeve të qëndrueshme nga programet profesionale dhe një interesi të shtuar nga ana e publikut për fondet e pensionit.

Raiffeisen Invest do të shtojë përpjekjet dhe iniciativat e veta për zgjerimin e tregut të pensioneve private, tashmë i mbështetur nga lehtësirat e duhura fiskale. Për këtë qëllim do të vijohet me zhvillimin e sesioneve informuese pranë kompanive të ndryshme në vend, për të siguruar rritjen e anëtarëve dhe asetëve në Fondin e Pensionit.

Aplikimi i lehtësive fiskale mbi anëtarët e fondit të pensionit vullnetar do të shërbejë si një nxitje për investitorët për të kursyer më shumë përmes fondit të pensionit vullnetar.

## Top 10 (Investimet Kryesore si % e asetëve)

Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen	
Instrumenti	% e Aseteve
Obligacion Thesari 10 vjet – Mat 18.01.2026	9.11%
Obligacion Thesari 10 vjet – Mat 23.01.2025	6.98%
Obligacion Thesari 7 vjet – Mat 09.12.2021	6.74%
Obligacion Thesari 10 vjet – Mat 24.07.2025	2.87%
Obligacion Thesari 7 vjet – Mat 03.03.2024	2.79%
Obligacion Thesari 5 vjet – Mat 08.11.2022	2.78%
Obligacion Thesari 7 vjet – Mat 16.03.2022	2.52%
Obligacion Thesari 7 vjet – Mat 16.09.2022	2.52%
Obligacion Thesari 7 vjet – Mat 16.09.2023	2.08%
Obligacion Thesari 5 vjet – Mat 09.08.2018	2.03%

# Raport i Menaxherit të Rrezikut

## Tregues të Rrezikut

Fondi	Kohëzgjatja mesatare	Kohëzgjatja mesatare e modifikuar	Devijimi standard	*Treguesi sintetik i Rrezikut
Raiffeisen Prestigj	2.13	2.07	1.44%	Niveli 2
Raiffeisen Invest Euro	3.14	3.04	0.98%	Niveli 2
Raiffeisen Pension	4.46	4.31	1.06%	Niveli 2

\* Treguesi i rrezikut sintetik dhe përfitimit jep informacion mbi nivelin e rrezikut të fondit (nga niveli 1 deri në nivelin 7) duke u bazuar mbi luhatshmërinë historike të performancës së fondit.

Administrimi i Rrezikut kryhet nga një njësi e pavarur e cila mat, monitoron, dhe raporton në AMF, Këshillin e Administrimit dhe Komitetin e Investimit treguesit e ndryshëm të rrezikut. Gjatë vitit 2017, janë respektuar të gjitha limitet ligjore apo të brendshme.

Shumë nga treguesit kanë qenë stabël dhe fondet e investimit kanë patur rritje të nivelit të likuiditetit, në përputhje me politikat e brendshme dhe kërkesat rregullatore për manaxhimin e likuiditetit.

Në kuadër të rritjes së transparencës dhe njohjes së investitorit është vërejtur një përmirësim i kategorizimit të profilit të rrezikut të investitorëve. Kjo na ndihmon për të kryer një manaxhim më të drejtë të fondeve ekzistuese, por edhe për të zhvilluar në të ardhmen fonde të përshtatshme për secilën kategori.

Për fondin Prestigj, gjatë vitit 2017, falë vendimit për të rritur pjesën e investimeve afatshkurtra, është vërejtur një ulje e duration të portofolit të investimit. Luhatshmëria e rëndësishme e disa normave të titujve të qeverisë shqiptare, veçanërisht atyre afatshkurtra në tremujorin e parë, ka sjellë një rritje të devijimit standart dhe luhatshmërisë së kthimit.

Megjithatë treguesi sintetik i rrezikut nuk ka ndryshuar dhe mbetet në nivelin 2. Kjo tregon që fondi Prestigj vazhdon të jete një fond me profil të ulët rreziku.

Për fondin Euro, treguesit e rrezikut kanë qenë stabël. Falë diversifikimit të tij dhe një administrimi më dinamik, është arritur që luhatshmëria e tij të jetë më e ulët se ajo e tregjeve ndërkombëtare të obligacioneve.

Për fondin e Pensioneve Vullnetare, duke qenë se pjesa më e madhe e portofolit do të mbahet deri në maturim dhe vlerësohet me amortizim linear, luhatshmëria e kthimit është tepër e ulët. Si rezultat, treguesi sintetik i rrezikut ka rënë në nivelin 1. Gjithashtu është ulur pak edhe duration si rezultat i uljes të afateve të mbetura deri në maturim.

**RAIFFEISEN INVEST – SHOQËRI ADMINISTRUESE  
E FONDEVE TË PENSIONIT DHE SIPËRMARRJEVE  
TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE SH.A.**

Raporti i Audituesit të Pavarur  
dhe Pasqyrat Financiare  
për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017

# Përmbajtja

<b>Raporti i audituesit të pavarur</b>	<b>32</b>
<b>Pasqyra e pozicionit financiar</b>	<b>34</b>
<b>Pasqyra e fitim humbjes dhe e te ardhurave te tjera gjithperfshirese</b>	<b>35</b>
<b>Pasqyra e ndryshimeve ne kapital</b>	<b>36</b>
<b>Pasqyra e flukseve te mjeteve monetare</b>	<b>37</b>
1. Hyrje	38
2. Përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël	38
3. Vlerësime dhe gjykime kontabël	42
4. Adoptimi i standardet dhe interpretimeve të reja ose të rishikuara	42
5. Standardet e reja dhe ndryshimet në standardet ekzistuese në çështje që nuk janë adoptuar ende	43
6. Paraja dhe ekuivalentët e saj	50
7. Llogari të arkëtueshme nga Fondet	50
8. Aktive financiare të mbajtura deri në maturim	50
9. Aktive afatgjata materiale, neto	51
10. Aktive afatgjata jomateriale, neto	52
11. Detyrime të tjera	53
12. Kapitali aksioner	53
13. Rezerva Ligjore	53
14. Tarifa të administrimit të Fondeve	53
15. Të ardhura nga interesi	54
16. Shpenzime personeli	54
17. Shpenzime të përgjithshme dhe administrative	54
18. Tatim fitimi	55
19. Administrimi i rrezikut financiar	55
20. Vlerat e drejta të aktiveve dhe detyrimeve financiare	59
21. Angazhime dhe detyrime e të drejta të kushtëzuara	60
22. Transaksionet me palët e lidhura	60
23. Ngjarjet pas datës së raportimit	61

# Raporti i Audituesit të Pavarur

**Deloitte.**

Deloitte Audit Albania sh.p.k.  
Rr. Elbasanit,  
Pallati poshtë Fakulteti Gjeologji-  
Miniera  
Tirana, Albania  
Tef: +355 4 45 17 920  
[www.deloitte.al](http://www.deloitte.al)

VAT (NUIS) No: L41709002H

**Drejtuar Aksionarëve dhe Drejtimit të Shoqërisë Raiffeisen INVEST – Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a.**

## Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Raiffeisen INVEST – Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a. ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2017, pasqyra e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datë 31 dhjetor 2017 si edhe të performancës së saj financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

## Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në paragrafin emërtuar "Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare" të këtij raporti. Ne shprehim pavarsinë tonë nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës së Kontabilistëve Profesionistë i vendosur nga Bordi i Kontabilistëve për Standardet Ndërkombëtare të Etikës ("BKSNE") dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si edhe, kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe të përshtatshme për të mbështetur bazën për opinionin tonë të auditimit.

## Përgjegjësitë e drejtimit dhe palëve të ngarkuara me qeverisjen për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, si edhe për sistemin e kontrollit të brendshme, i cili, në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënime shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Shoqërisë, dhe të përdorë parimet kontabël vijimësisë, përveç rasteve kur drejtimi ka ose për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveçse sa më lart. Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

## Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.



Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë procesit së auditimit. Gjithashtu, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, hartojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie material, si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të sistemeve të kontrolleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të përshtatshme me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e sistemeve të kontrolleve të brendshme të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vemendjen në raportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidences së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërpreje të aftësisë së Shoqërisë për vazhduar në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare prezantojnë transakcionet dhe ngjarjet thelbësore në një mënyrë që arrin prezantimin e drejtë.

*Deloitte Audit Albania sh.p.k.*  
 Deloitte Audit Albania sh.p.k.  
 Rr. Elbasanit, Pallati poshte Fakultetit Gjeologji  
 - Miniera,  
 Tiranë, Shqipëri  
 Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS):  
 1.41709002H



Enida Cara  
 Auditues ligjor  
 Partner Angazhimi

Tiranë, Shqipëri  
 30 Mars 2018

## Pasqyra e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2017

(Shumat në Lek)

	Shënime	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
<b>AKTIVET</b>			
Paraja dhe ekuivalentët e saj	6	398,953,641	204,856,768
Llogari të arkëtueshme nga Fondet	7	81,509,299	74,058,218
Invetime të mbajtura deri në maturim	8	20,152,000	20,152,000
Aktive afatgjata material,net	9	11,996,259	17,888,701
Aktive afatgjata jomateriale,net	10	6,377,629	8,483,199
Parapagime dhe llogari të arkëtueshme		400,609	135,370
<b>TOTALI I AKTIVEVE</b>		<b>519,389,437</b>	<b>325,574,257</b>
<b>DETYRIMET</b>			
Tatim fitimi i pagueshëm		5,391,342	6,069,356
Detyrime të tjera	11	15,962,073	25,744,638
<b>TOTALI I DETYRIMEVE</b>		<b>21,353,415</b>	<b>31,813,994</b>
<b>KAPITALI</b>			
Kapitali aksionar	12	90,000,000	90,000,000
Rezerva logjore	13	9,000,000	9,000,000
Fitim/(Humbje) të mbartura		194,760,263	4,089,637
Fitim/(Humbje) i vitit		204,275,759	190,670,626
<b>TOTALI I KAPITALIT</b>		<b>498,036,022</b>	<b>293,760,263</b>
<b>TOTALI I KAPITALIT DHE DETYRIMEVE</b>		<b>519,389,437</b>	<b>325,574,257</b>

Këto pasqyra financiare u miratuan nga Këshilli i Administrimit të Raiffesien INVEST- Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a. më 15 Mars 2018 dhe u firmosën nga:

Administrator i Përgjithshëm  
Edlira KONINI



Zv. Administratore e Përgjithshme  
Alketa EMINI

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 38 deri në 61, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

## Pasqyra e fitim humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017

(Shumat në Lek)

	Shënime	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
<b>Të ardhurat</b>			
Tarifa të administrimit të Fondeve	14	929,812,522.98	908,082,828
Të ardhura interesi	15	1,631,863.02	1,868,329
Tarifa të largimit nga fondi		1,151,424.13	883,313
Të ardhura të tjera		1,722,556.00	75,327
<b>Totali i të ardhurave</b>		<b>934,318,366.13</b>	<b>910,909,797</b>
<b>Shpenzimet</b>			
Shpenzime për personelin	16	(42,138,402.45)	(40,909,399.05)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	9.1	(5,761,904.00)	(7,207,656.00)
Shpenzime të përgjithshme administrative	17	(568,840,168.43)	(563,142,214.00)
Shpenzime të tjera		(228,464.00)	
<b>Totali i shpenzimeve</b>		<b>(616,968,938.88)</b>	<b>(611,259,269.05)</b>
<b>(Humbje)/fitimi nga kursi i këmbimit</b>		<b>(716,888.62)</b>	<b>(959,801.00)</b>
		<b>(716,888.62)</b>	<b>(959,801.00)</b>
<b>Fitimi neto para tatimit</b>		<b>316,632,538.63</b>	<b>298,690,727</b>
Tatim fitimi	18	(112,356,779.29)	((108,020,109.68
<b>Fitimi neto pas tatimit</b>		<b>204,275,759.34</b>	<b>190,670,617</b>
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse		-	-
<b>Totali i të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin</b>		<b>204,275,759.34</b>	<b>190,670,617</b>

Pasqyra e fitim humbjes dhe të ardhurave të tjera përmblendhëse duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 38 deri në 61, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

## Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017

(Shumat në Lek)

	Kapitali aksionar	Rezerva ligjore	Fitime të mbartura	Totali
<b>Gjendja më 1 janar 2016</b>	<b>90,000,000</b>	<b>9,000,000</b>	<b>224,236,923</b>	<b>323,236,923</b>
Pagesë dividendi			(220,147,286)	<b>(220,147,286)</b>
Fitimi i vitit	-	-	190,670,626	<b>190,670,626</b>
Të ardhura gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2016</b>	<b>90,000,000</b>	<b>9,000,000</b>	<b>194,760,263</b>	<b>293,760,263</b>
Pagese dividendi				-
Fitimi i vitit	-	-	204,275,759	204,275,759
Të ardhura gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2017</b>	<b>90,000,000</b>	<b>9,000,000</b>	<b>399,036,022</b>	<b>498,036,022</b>

Pasqyra e ndryshimeve të kapitalit duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 38 deri në 61, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare,

## Pasqyra e mjeteve monetare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017

(Shumat në Lek)

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
<b>Fluksi monetar nga aktiviteti operativ</b>		
<b>Fitimi neto para tatimit</b>	<b>316,632,539</b>	<b>298,690,727</b>
<b>Rregulluar me:</b>		
Zhvlerësimi dhe amortizimi	5,761,904	7,207,656
Tarifa nga administrimi i fondeve	(929,812,523)	(908,082,828)
Të ardhura nga interesi	(1,631,863)	(1,868,329)
Humbje nga Kursi i këmbimit	0	0
	<b>(609,049,943)</b>	<b>(604,052,774)</b>
<b>Ndryshime në kapitalin punues</b>		
Ndryshime në aktive të tjera	(265,239)	324,770
Ndryshime në detyrime të tjera	(9,782,565)	10,694,018
<b>Fluksi monetar nga aktiviteti operativ pas ndryshimeve në kapitalin punues</b>	<b>(619,097,748)</b>	<b>(593,033,986)</b>
Arkëtime të të ardhurave nga Fondet e administruara	920,873,867	908,095,008
Interesa të marra	1,625,356	2,092,699
Komisione bankare	118,550	
Të tjera	1,604,006	
Tatim fitimi i paguar	(113,034,793)	(123,021,828)
<b>Mjete monetare neto gjeneruar nga aktiviteti operativ</b>	<b>192,089,239</b>	<b>194,131,893</b>
<b>Flukset monetare nga aktiviteti investues</b>		
Blerja e aktiveve afatgjata	(2,577,143)	(1,696,116)
Shitje e aktiveve afatgjata	4,746,830	1,052,068
Blerja e aktiveve jomateriale	(162,042)	(1,047,600)
<b>Mjetet monetare neto gjeneruar nga/(të përdorura) në aktivitetin investues</b>	<b>2,007,645</b>	<b>(1,691,648)</b>
<b>Flukset monetare nga aktiviteti investues</b>		
Dividenti i paguar		(220,147,286)
<b>Mjetet monetare neto të përdorura në aktivitetin investues</b>		<b>(220,147,286)</b>
<b>Mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre në fillim të vitit</b>	<b>204,856,758</b>	<b>232,563,799</b>
Rritje neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre gjatë vitit	194,096,833	(27,707,040)
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fund të vitit (Shenimi 6)</b>	<b>398,953,641</b>	<b>204,856,758</b>

Pasqyra e fluksit të parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 38 deri në 61, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

# 1. HYRJE

Raiffeisen INVEST- Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive" sh.a. ("Shoqëria") është një shoqëri aksionere shqiptare me qendër në Tiranë. Shoqëria është regjistruar në Regjistrin Tregtar të Shqipërisë nga Gjykata e Tiranës me vendimin nr. 33825, i dates 18 korrik 2005. Zyrat qëndrore ndodhen në Bulevardin "Bajram Curri", ETC, Kati i 10-të, Tiranë.

Shoqëria është licencuar nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare më 7 korrik 2005 (License Nr. 2) për të vepruar si shoqëri administruese e Fondeve të Pensionit Vullnetar në mbledhjen dhe investimin e fondeve të pensionit vullnetar dhe kryerjen e pagesave të pensionit. Gjithashtu, shoqëria është licencuar nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare më 13 dhjetor 2011 (License Nr. 1) për të vepruar si shoqëri administruese e asetëve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive.

Raiffeisen Invest sh.a mbikqyret nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9572, datë 03 korrik 2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", ligjit nr.10197, datë 10 dhjetor 2009 "Për fondet e pensionit vullnetar" dhe ligjit nr.10198, datë 10 dhjetor 2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive".

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është:

- Menaxhimi i fondit të pensionit vullnetar nëpërmjet mbledhjes dhe investimit të fondeve bazuar në Ligjin nr. 10197, të datës 10 dhjetor 2009 "Mbi fondet e pensionit vullnetar", si dhe në përputhje me parimin e shpërndarjes së rrezikut (diversifikimit), si qëllim për të siguruar përfitime pensioni për personat që janë anëtarë të fondit. Shoqëria mund të sigurojë gjithashtu kryerjen e pagesave të pensionit.
- Të themeloje dhe/ose të menaxhojë Sipërmarrje të Investimeve Kolektive bazuar në Ligjin nr. 10198, të dates 10 dhjetor 2009 "Mbi sipërmarrjet e investimeve kolektive".
- Të përformojë aktivitete të tjera siç përshkruhet në Ligjin nr. 10198, të dates 10 dhjetor 2009 "Mbi sipërmarrje të investimeve kolektive".

Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017 janë autorizuar për tu publikuar nga Bordi Drejtues më 28 mars 2018. Aprovimi i këtyre pasqyrave nga Aksionari, do të merret në Mbledhjen Vjetore të Zakonshme.

Këshilli i Administrimit si organi qëndror i Shoqërisë përbëhet nga 7 anëtarë si më poshtë:

Znj. Donalda GJORGA	Kryetare e Këshillit të Administrimit
Znj. Peter ZILINEK	Anetar i Këshillit të Administrimit
Znj. Vilma BAÇE	Anëtare e Këshillit të Administrimit
Znj. Alda SHEHU	Anëtare e Këshillit të Administrimit
Z. Joan CANAJ	Anetar i Këshillit të Administrimit
Znj. Edlira KONINI	Anëtare e Këshillit të Administrimit
Znj. Alketa EMINI	Anëtare e Këshillit të Administrimit

Administratorët janë:

Znj. Edlira Konini	Administrator i Përgjithshëm
Znj Alketa Gjocaj	Zv/Administratore e Përgjithshme

## 2. PËRMBLEDHJE TË POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

### a) Bazat e përgatitjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") me metoden e kostos historike, siç modifikohet nga njohja fillestare e instrumenteve financiare bazuar në vlerën e drejtë dhe në matjen e instrumentave financiare të kategorizuara si me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Politikat kontabël kryesore të aplikuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë përcaktuara më poshtë. Këto politika janë aplikuar në mënyrë vazhdueshme në të gjitha periudhat e treguara, përveçse kur përcaktohet ndryshe:

## 2. PËRMBLEDHJE TË POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### b) Monedha funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në LEK shqipëtar ("LEK"), e cila është monedha e përdorur dhe prezantuese e Shoqërisë.

### c) Fondet nën administrim

Shoqëria vepron si Shoqëri Administruese për fondet e mëposhtme:

- Fondi me Kontribute të Përcaktuara "Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen" i aprovuar nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare më 18 tetor 2010;
  - "Raiffeisen Prestigj"- fond investimi i cili u aprovua nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare më 13 dhjetor 2011;
  - "Raiffeisen Invest Euro"- fond investimi i cili u aprovua nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare më 26 shtator 2012.
- Politikat kontabël të treguara më poshtë janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme në këto pasqyra financiare.

### d) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Aktivitet monetare dhe detyrimet të nominuara në monedhë të huaj në datën e raportimit rikonvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të asaj date.

Fitimi ose humbja nga monedhat e huaja mbi zërat monetarë është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar për interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të konvertuar me kursin e këmbimit në fund të periudhës. Aktivitet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj të cilat maten me vlerën e drejtë rikonvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së përcaktimit të vlerës së drejtë. Ndryshimet nga monedhat e huaja të cilat lindin nga rikonvertimi njihen në fitim ose humbje.

Kurset zyrtare të aplikueshme të Shoqërisë (LEK në njësi të monedhës së huaj) për monedhat kryesore më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017		31 Dhjetor 2016	
	Fund viti	Mesatare	Fund viti	Mesatare
Dollar i Shteteve të Bashkuara (USD)	111.10	119.05	128.17	124.12
Monedha e Bashkimit Evropian (EUR)	<b>132.95</b>	<b>134.13</b>	<b>135.23</b>	<b>139.74</b>

### e) Të ardhura nga administrimi i fondeve

Të ardhurat përfshijnë vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arketueshme nga shitja e produkteve dhe shërbimeve gjatë kursit normal të aktivitetit të Shoqërisë. Shoqëria i njëh të ardhurat kur shumat e të ardhurave mund të maten me besueshmëri, është e mundshme që benefite ekonomike nga e ardhura do të rrjedhin tek klienti dhe kriteret specifike janë arritur për secilën nga aktivitetet e Shoqërisë siç përshkruhet më poshtë.

Të ardhurat nga administrimi i fondeve njihen në bazë ditore si një përqindje e përcaktuar e Vlerës Neto të Aktivit për secilin nga Fondet. Përqindjet e aplikuar për secilin nga Fondet janë përcaktuar siç vijon: Fondi Prestigj — 1.25 % (vjetor) të vlerës neto të aktivitetit, Fondi pension — 1.5 % (vjetor) të vlerës neto të aktivitetit, Fondi i Investimit Euro — 1.5 % (vjetor) të vlerës neto të aktivitetit.

### f) Të ardhurat nga investimet

Të ardhurat dhe shpenzimet nga investimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse duke përdorur metodën e interesit efektiv. Norma e interesit efektive është norma që zbritet saktësisht pagesat dhe arkëtimet të përlogaritura të së ardhmes gjatë jetëgjatësisë së pritur të aktivitetit ose detyrimit financiar (ose, nëse e përshtatshme, një periudhë më e shkurtër) në vlerën aktuale të aktivitetit ose detyrimit. Norma e interesit efektiv është përcaktuar në njohjen fillestare të aktivitetit dhe detyrimit financiar dhe nuk rishikohet më pas.

Përlogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha tarifatat e paguara ose të marra, kosto e transaksionit, dhe zbritjet ose çmimet që janë një pjesë integrale e normës së interesit. Kostot e transaksionit janë kosto shtese të cilat i atribuohen në mënyrë direkte blerjes, emetimit ose shitjes së aktivitetit ose detyrimit financiar.

### g) Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen në momentin që shkaktohen.

## 2. PËRMBLEDHJE TË POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### h) Përfitimet e punonjësve

- *Planet e kontributeve të përcaktuara*

Shoqëria jep kontribute sigurie shoqërore të detyrueshme të cilat sigurojnë përfitime pensioni për punonjësit e saj mbas daljes në pension. Detyrimi për këto kontribute në planet e pensionit të kontributeve të përcaktuara njihen si një shpenzim në momentin kur ato ndodhin. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për sigurimin e pragut ligjor minimal për pensionet në Shqipëri sipas një plani pensioni kontributësh të përcaktuar.

- *Pagesa e lejeve vjetore*

Shoqëria njih si një detyrim shumën e pazbritur të kostos së përllogaritur në lidhje me lejet vjetore të cilat priten të paguhen në këmbim të shërbimit të punonjësit për periudhën e plotësuar.

- *Përfitimet afat-shkurtra*

Detyrimet për përfitimet afat-shkurtra të punonjësve maten në një bazë të pa-zbritshme dhe ngarkohen si shpenzime gjatë sigurimit të shërbimit.

### i) Shpenzimi i tatim fitimit

Shpenzimi i tatim fitimit përfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë. Shpenzimi i tatim fitimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse përveç se në rastet kur lidhet me zëra të cilët njihen direkt në kapital, pasi në një rast të tillë njihet në kapital. Tatimi aktual është tatimi i pagueshëm i parashikuar mbi fitimin e tatueshëm për vitin, duke përdorur norma tatimi në fuqi ose konsiderohen në fuqi në periudhën e raportimit, dhe çdo ndryshim në tatimin e pagueshëm në respekt të viteve të mëparshme.

Tatimi i fitimit të shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, si pasojë e ekzistencës së diferencave të perkohshme midis vlerës së mbartur të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore. Tatimet e shtyra maten me normat e tatimit të cilat priten ti aplikohen diferencave të perkohshme kur ato ndryshojnë, bazuar në ligjet në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në periudhën e raportimit. Një aktiv tatimor i shtyrë njihet vetëm nëse është e mundur që fitime të tatueshme të së ardhmes do të jenë të disponueshme kundrejt të cilit zbritjet mund të shfrytëzohen. Aktivet tatimore të shtyra të rishikohen gjatë çdo periudhe raportimi dhe zbriten deri sa nuk është me e mundur që përfitimet tatimore të realizohen. Tatime fitimi shtesë që lindin nga shpërndarja e dividendit njihen në të njëjtën kohë që njihet detyrimi për të paguar dividendin.

### j) Aktive dhe detyrimet financiare

#### i Njohja

Aktivitetet financiare njihen në pasqyrën e pozicionit financiar në ditën kur entiteti bëhet pale kontraktuale në lidhje me një instrument në perputhje me blerjen e rregullt të tij. Një mënyrë e rregullt blerjeje ose shitjeje e një instrumenti financiar njih si datë kontabilizimi të aktivitetit, datën e shlyerjes. Dita e shlyerjes është dita kur aktivi i lëvrohet entitetit. Dita e shlyerjes i referohet a) njohjes së aktivitetit në ditën kur ai merrret nga entiteti b) ç'regjistrimit të aktivitetit dhe njohjes së fitimit/humbjes neto nga shitja në ditën kur ai lëvrohet/dërgohet nga entiteti. Kur aplikohet dita e shlyerjes, entiteti kontabilizon çdo ndryshim në vlerën e drejtë të aktivitetit gjatë periudhës midis datës së tregtimit dhe datës së shlyerjes. Me fjalë të tjera, ndryshimi në vlerë nuk njihet për aktivitetin e mbajtura me kosto ose kosto të amortizuar; njihet si fitim ose humbje për aktivitetin e klasifikuar si aktive financiare të njohura me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes; njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse për aktivitetin e vlefshme për shitje.

Detyrimet njihen fillimisht në datën kur entiteti bëhet pale e kontratës.

#### ii Çregjistrimi

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur mbarojnë të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga aktivi financiar, ose kur të drejtat për të arkëtuar flukse monetare kontraktuale të aktivitetit financiar janë transferuar në një transaksion me të cilin transferohen kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivitetit financiar. Fondi nuk njih një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale janë përmblusur, ndërprerë apo kanë përfunduar.

Shoqëria merr pjesë në transaksione me anë të të cilave transferon aktive të njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por mban të gjitha ose kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivitetit të transferuar, ose një pjesë të tyre. Nëse të gjitha ose kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet mbahen, atëherë aktivitetin e transferuar nuk çregjistrohen nga pasqyra e pozicionit financiar.

Në transaksionet në të cilat Shoqëria as nuk mban dhe as nuk transferon rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivitetin financiar, aktivi çregjistrohet nëse kontrolli mbi to humbet.

#### iii Matja e vlerës së drejtë

Pas njohjes fillestare të gjitha aktivitetet financiare (përveç atyre të mbajtura deri në maturitet) maten me vlerën e drejtë. Përkufizimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare është përcaktuar duke përdorur teknika të vlerësimit.



## 2. PËRMBLEDHJE TË POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### j) Aktive dhe detyrimet financiare (vazhdim)

Metodat e vlerësimit përfshijnë teknikën e vlerës aktuale neto, metodën e flukseve monetare të skontuara dhe krahasimin me instrumente të tjerë të ngjashëm, për të cilat ekzistojnë çmime tregu dhe metoda vlerësimi. Ndryshimet në vlerën e drejtë janë njohur menjëherë në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave.

#### iv. Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit

Në çdo datë raportimi Shoqëria vlerëson, nëse ka një evidence objektive që aktivet financiare, të cilat nuk mbahen me vlerën e drejtë përmes fitim - humbjes, janë zhvlerësuar. Aktivet financiare zhvlerësohen kur evidenca objektive paraqet që një ngjarje që sjell humbje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit dhe që ngjarja që sjell humbje ka ndikim në flukset e ardhshme të parasë së aktivitetit, të cilat mund të maten me besueshmëri.

#### v. Investime të mbajtura deri në maturim

Investimet e mbajtura deri në maturim janë aktive financiare me pagesa fikse ose të përcaktuara dhe maturitet të fiksuar që Shoqëria ka synimin e qartë dhe aftësinë për të mbajtur deri në maturim, dhe të cilat nuk janë përcaktuar me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes ose në dispozicion për shitje. Investimet e mbajtura deri në maturim mbahen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Çdo shitje ose riklasifikim i shumave të konsiderueshme të investimeve të mbajtura deri në maturim që nuk janë afër maturimit të tyre do të rezultonte në riklasifikimin e të gjitha investimeve të mbajtura deri në maturim si të disponueshme për shitje, dhe do të parandalonte Shoqërinë të klasifikonte letrat me vlerë për qëllime investimi si instrumenta të mbajtura deri në maturim për periudhën aktuale dhe gjatë dy viteve financiare pasuese.

#### vi. Investimeve të mbajtura me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes

Shoqëria mban disa instrumenta me vlerën e drejtë, me ndryshimet e vlerës së drejtë të njohura menjëherë në fitim ose humbje. Një prezantim të detajuar të matjeve të vlerës së drejtë mund ta gjeni në shënimin 8 dhe 9.

### k) Mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre përfshijnë aktive financiare shumë likuide me maturitet më të vogël se tre muaj, të cilat janë subjekt i rrezikut të parëndësishëm në ndryshimet e vlerës së tyre të drejtë, dhe përdoren nga Shoqëria në menaxhimin e angazhimeve të saj afat-shkurtra. Mjetet monetare dhe ekuivalentet e saj mbahen në pasqyrën e pozicionit financiar me koston e amortizuar.

### l) Aktive afatgjata materiale

- Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë. Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të ngarkueshme për blerjen e aktivitetit, kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë Shoqëria që përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore, si dhe ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me vënien e aktivitetit në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar nga Drejtimi dhe kostot e çmontimit dhe kthimit të vendndodhjes në kushtet e duhura.

Kur pjesë të një elementi të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elementë të veçanta të aktiveve afatgjata materiale.

- Kosto vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundshme që përfitime ekonomike, në të ardhmen që i atribuohen atij elementi, do të rrjedhin në Shoqëri, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën e veçantë përmbledhëse të të ardhurave në momentin kur ndodhin.

- Amortizimi

Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve duke përdorur metodën e vlerës së mbetur. Normat vjetore të amortizimit janë si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	2017	2016
Pajisje zyre	20%	20%
Pajisje informatike	25%	25%
Automjete	20%	20%

## 2. PËRMBLEDHJE TË POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### m) Aktivet afatgjata jomateriale

Aktivt afatgjata jomateriale të blera nga Shoqëria paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë.

Shpenzimet e mëvonshme mbi aktivet afatgjata jomateriale kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime lidhen me rritjen e përfitimit të ardhshëm ekonomik prej aktivit. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën që ndodhin në pasqyrën e veçantë përmbledhëse të të ardhurave.

Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve duke përdorur metodën e vlerës së mbetur. Norma vjetore e amortizimit është 25%.

### n) Aktive dhe detyrime të tregtueshme

Aktivt dhe detyrimet e tregtueshme janë ato aktive dhe detyrime që Shoqëria i blen ose i mban kryesisht për qëllimin e shitjes ose riblerjes në periudhën afatshkurtër, ose i mban si pjesë e portofolit, i cili përdoret për ruajtjen e pozicionit, ose për përfitime afatshkurtra. Aktivt dhe detyrimet e tregtueshme, fillimisht njihen me kosto dhe më vonë maten me vlerën e drejtë në pasqyrën e veçantë të pozicionit financiar, duke i kaluar kostot direkte të transaksionit si fitim ose humbje në pasqyrën e të ardhurave të tjera përmbledhëse, çdo fitim ose humbje si pasojë e ndryshimit në vlerën e drejtë.

## 3. VLERËSIME DHE GJYKIME KONTABËL

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse kanë ndikim. Në veçanti, informacioni mbi elementët e rëndësishëm të vlerësimit të pasigurive dhe gjykimeve kritike për aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt material në vlerat kontabël të pasqyrave financiare jepet në shënimet 21 and 22.

## 4. ADOPTIMI I STANDARDEVE DHE INTERPRETIMEVE TË REJA OSE TË RISHIKUARA

Zbatimi fillestar i ndryshimeve të reja në standardet ekzistuese në fuqi për periudhën raportuese aktuale. Ndryshimet e mëposhtme në standardet ekzistuese dhe interpretimi i ri i lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të kontabilitetit (BSNK), janë në fuqi për periudhën raportuese:

- **Ndryshime në SNK 7 " Pasqyra e Levizjes së Parasë"-** Iniciativa e informacioneve shpjeguese (efektive për periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 Janar 2017),
- **Ndryshime në SNK 12 "Tatimi mbi të Ardhurat" -** Njohja e aktiveve tatimore të shtyra për humbjet e parealizuara ( efektive për periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 Janar 2017),
- **Ndryshime në SNRF 12 si pasojë e "Përmirësimeve të SNRF-ve (cikli 2014-2016)"** rezultuar nga projekti i përmirësimit vjetor të SNRF (SNRF 1, SNRF 2, dhe SNK 28) kryesisht me një pikëpamje për të eliminuar mospërputhjet dhe për të qartësuar formulimin mbi SNRF 12 do të jenë të aplikueshme për periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 Janar 2017).

Adaptimi i këtyre ndryshimeve tek standartet ekzistuese nuk ka çuar në ndryshime për sa i përket politikave kontabël të Shoqërisë.

## 5. STANDARDET E REJA DHE NDRYSHIMET NË STANDARDET EKZISTUESE NË ÇËSHTJE QË NUK JANË ADOPTUAR ENDE

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet e reja të mëposhtme, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimi i ri ishin publikuar, por ende jo efektive: Asnjë prej tyre nuk pritet të ketë efekt material t'në pasqyrat e Shoqërisë.

- **SNRF 9 “Instrumentat Financiare”** (efektive për raportime vjetore duke filluar nga 1 Janari 2018)

Shoqëria menaxhuese parashikon se zbatimi i SNRF 9 në të ardhmen mund të ketë një ndikim në shumat e njohura në aktivet dhe detyrimet financiare. Pritet që SNRF 9 të rrisë nivelin e përgjithshëm të provigjoneve për aktivet dhe detyrime. Parashikimi është i bazuar në një kërkesë për të njohur provigjonet në shumën e parashikuar të kredive të pashlyera.

Më 27 dhjetor 2017, Parlamenti Europian publikoi rregulloren (EU) 2017/2395 mbi kërkesat në tranzicion drejt SNRF 9. Rregullorja mundëson zgjedhjen midis dy metodave të ndryshme përsa i përket njohjes së efektit të implementimit të standartit në kapitalin rregullator:

1. Njohja e efektit të plotë në mënyrë lineare, e shpërndarë në një periudhë 5 vjecare, ose
2. Njohja e impaktit të plotë në ditën e përshtatjes.

Shoqëria menaxhuese ka vendosur të aplikojë metodën e dytë.

### Klasifikimi dhe Matja e Përgjithshme

SNRF 9 përmban një përjasje të re për klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare, që reflekton modelin e biznesit sipas të cilit menaxhohen aktivet dhe karakteristikat e fluksit të parasë së tyre.

Shoqëria menaxhuese do të aplikojë katër kategori për klasifikimin e Aktiveve Financiare:

- Aktivet financiare të matura me kosto të amortizuara (KA)
- Aktivet financiare të matura me vlerë së drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDNATGJ)
- Aktivet Financiare të detyrueshme për tu matur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim-humbjes (VDNFH) dhe
- Aktive Financiare të matura me vlerë të drejtë nëpërmjet pasqyrave të fitim-humbjes (VDNFH)

Kategoritë ekzistuese të SNK 39 si: të mbajtura deri në maturim, kredi dhe llogari të arkëtueshme, të vlefshme për shitje do të eliminohen.

Aktivitet Financiare do të maten me koston e amortizuar nëse plotësohen të dy kushtet e mëposhtme:

- Aktivitet mbahet sipas një modeli biznesi, objektivi i të cilit është të mbajë aktive financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale
- Kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar shprehin qartë termat kohorë të flukseve monetare, të cilat janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit mbi principalin e mbetur.

Objektivi i një modeli biznesi mund të jetë mbajtja e aktiveve financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale, edhe në rastin kur shitje të aktiveve financiare kanë ndodhur ose priten që të ndodhin.

Një aktiv financiar klasifikohet si i matur me VDNATGJ nëse ai mbahet nëpërmjet një modeli biznesi, objektivi i të cilit është të mbledhë flukse monetare kontraktuale dhe të shesë aktive financiare, kur kushtet kontraktuale të aktiveve financiare specifikojnë datat e caktuara të flukseve monetare, të cilat janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit mbi principalin e mbetur.

Për njohjen fillestare të një instrumenti kapitali neto që nuk mbahet për shitje, Shoqëria menaxhuese mund të zgjedhë të paraqesë në mënyrë të pakthyeshme ndryshimet e mëvonshme në vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. Kjo përzgjedhje bëhet për çdo investim individualisht dhe mbulon interesa strategjike që nuk paraqiten plotësisht në mënyrë të konsoliduar. Të gjithë aktivet e tjerë financiare, që nuk plotësojnë kriteret për tu klasifikuar si të matura me koston e amortizuar ose VDNATP, klasifikohen si të matura me vlerën e drejtë, ndryshimet e të cilës njihen në fitim-humbje. Si rrjedhojë, Shoqëria menaxhuese ka mundësinë që në njohjen fillestare të përcaktojë në mënyrë të pakthyeshme një aktiv financiar, matja e të cilit bëhet me VDNFH, nëse të vepruarit në këtë mënyrë eliminon ose redukon ndjeshëm një mospërputhje matjeje ose njohjeje, për shembull një mospërputhje kontabël që do të lindte nga matja e aktiveve ose detyrimeve, ose njohja e fitimeve dhe humbjeve në to, në baza të ndryshme. Një aktiv financiar klasifikohet në një nga këto kategori në njohjen e tij fillestare.

## 5. STANDARDET E REJA DHE NDRYSHIMET NË STANDARDET EKZISTUESE NË ÇËSHITJE QË NUK JANË ADOPTUAR ENDE (VAZHDIM)

### Vlerësimi i modelit të biznesit

Shoqëria menaxhuese ka vlerësuar objektivin e modelit të biznesit në të cilin një aktiv financiar mbahet në nivel portofoli, dhe kjo reflekton më së miri mënyrën se si menaxhohet biznesi dhe se si informacioni i përcillet drejtimit.

Në vlerësimin se cili model biznesi është i përshtatshëm, janë shqyrtuar kriteret e mëposhtme:

- Si performanca e modelit të biznesit (dhe aktiveve financiare të këtij modeli) janë vlerësuar dhe raportuar drejt personelit drejtues të njësisë ekonomike;
- Si ndikojnë rreziqet në performancën e modelit të biznesit (dhe aktiveve financiare të mbajtura brenda atij modeli) dhe mënyra e menaxhimit të këtyre rreziqeve;
- Si kompensohen drejtuesit e biznesit, p.sh. nëse kompensimi bazohet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare ose në flukset monetare kontraktuale të mbledhura;
- Frekuenca, vlera dhe koha e realizimit të shitjeve në periudhat e mëparshme, arsyet për shitjet dhe pritshmëria për aktivitetin e ardhshëm të shitjeve; dhe
- Nëse aktiviteti i shitjeve dhe mbledhja e flukseve monetare kontraktuale janë pjesë integrale e modelit të biznesit apo ndodhin në mënyrë të rastësishme (modelet mbajtur deri në maturim dhe mbajtur për shitje)

Aktivitetet financiare që mbahen për tregtim dhe ato që vlerësohen me vlerë të drejtë do të maten me VDNFH.

### Analizë e Karakteristikave të Flukseve Monetare Kontraktuale

Pasi Shoqëria menaxhuese përcakton se modeli i biznesit të një portofoli specifik është mbajta e asetëve financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale (ose njëkohësisht mbledhja e flukseve monetare kontraktuale dhe shitja e aktiveve financiare), duhet të vlerësojë nëse kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar specifikojnë datat e caktuara të flukseve monetare, të cilat janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit mbi principalin e mbetur. Për këtë qëllim, interesi përcakton vlerën në kohë të parasë, rrezikun e kredisë që lidhet me shumën e principalit të papaguar gjatë një periudhe të caktuar kohore. Rreziqet dhe kosto të tjera themelore të huadhënies, si dhe një marzhin e fitimit. Ky vlerësim do të kryhet për çdo instrument në datën e njohjes fillestare të aktivitetit financiar.

Kur vlerëson nëse flukset monetare kontraktuale janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit, Shoqëria menaxhuese do të marrë parasysh kushtet kontraktuale të instrumentit. Kjo do të përfshijë vlerësimin nëse aktiviteti financiar përmban një kusht kontraktual që mund të ndryshojë kohën ose shumën e flukseve të mjeteve monetare kontraktuale në mënyrë që të mos plotësojë këtë kusht. Shoqëria menaxhuese do të marrë në konsideratë:

- Parapagimin, kushtet e zgjatjes së kontratës
- Veçoritë e levës financiare
- Nëse një kusht i kontratës është i limituar në aktive ose flukse monetare specifike
- Instrumentet e lidhura me kontratë

Në vitin 2018, BSNK publikoi një amendament për SNRF 9 në lidhje me tiparet e parapagimit me kompensim negativ. Kompensimi negativ lind kur kushtet kontraktuale lejojnë huamarrësin të parapagujë instrumentin para maturimit kontraktual, por shuma e parapagimit mund të jetë më e vogël se shumata e papaguara të principalit dhe interesit. Megjithatë, për t'u kualifikuar për matjen me anë të Kostos së Amortizuar, kompensimi negativ duhet të jetë kompensim i arsyeshëm për përfundimin e parakohshëm të kontratës. Shoqëria menaxhuese nuk pret një volum të lartë të parapagimeve me kompensim negativ, i cili duhet të matet detyrimisht me VDNFH.

### Modifikimi i vlerës kohore të parasë dhe testit të vlerësimit

Vlera në kohë e parasë është elementi i interesit që merr në konsideratë kalimin e kohës (SNRF 9. B4. 1.9A). Nuk merr parasysh rreziqet e tjera (kredisë, likuiditetit etj) ose kostot (administrative, etj.) të lidhura me mbajtjen e një aktiviteti financiar.

Në disa raste, elementi i vlerës në kohë të parasë mund të mos jetë plotësisht i saktë. Një rast i tillë ndodh kur norma e interesit e një aktiviteti financiar rivendoset periodikisht, por frekuenca e kësaj rivendosjeje nuk përputhet me maturitetin e normës së interesit. Në këtë rast njësitë duhet të vlerësojnë modifikimin, në mënyrë që të përcaktojnë nëse flukset monetare kontraktuale përfaqësojnë akoma pagesa vetëm të interesit dhe principalit, që do të thotë maturiteti i rivendosjes nuk ndryshon ndjeshëm flukset e mjeteve monetare nga një instrument standard i përsosur.

### Vlerësimi i ndikimit në klasifikim dhe matje

SNRF 9 do të ndikojë në klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare të mbajtura të Bankës më 1 Janar 2018 si më poshtë:

## 5. STANDARDET E REJA DHE NDRYSHIMET NË STANDARDET EKZISTUESE NË ÇËSHTJE QË NUK JANË ADOPTUAR ENDE (VAZHDIM)

Kreditë dhe paradhëniet për Kompanine menaxhuese dhe klientët, të klasifikuar si hua dhe llogari të arkëtueshme të matura me koston e amortizuar sipas SNK 39, do të maten me koston e amortizuar në përputhje me SNRF 9.

Aktivet financiare të mbajtura deri në maturim, të matura me koston e amortizuar sipas SNK 39, si rregull gjithashtu do të maten me koston e amortizuar në përputhje me SNRF 9.

Instrumentet e borxhit të vlefshëm për shitje, të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet kapitalit sipas SNK 39, si rregull gjithashtu do të maten në VDNATGJ në përputhje me SNRF 9.

### Kontabiliteti mbrojtës

SNRF 9 lejon opsionet e kontabilitetit mbrojtës. Shoqëria menaxhuese planifikon të vazhdojë të zbatojë dispozitat për kontabilitetin mbrojtës në përputhje me SNK 39, duke marrë parasysh ndryshimet të paraqitura në shënimet shpjeguese sipas SNRF 7.

### Zhvlërësimi i përgjithshëm

Llogaritja e humbjeve të pritura të kredisë kërkon përdorimin e parashikimeve kontabël të cilat, sipas përkufizimit, rrallëherë do të jenë të barabarta me rezultatet aktuale. Drejtimi ushtron gjykim në zbatimin e politikave kontabël të Grupit.

Shoqëria menaxhuese vlerëson në bazë të parashikimit humbjet e pritura të kredisë të lidhura me aktivet e saj të borxhit të mbartura me koston e amortizuar dhe VDNATGJ, dhe me ekspozimin që rrjedh nga angazhimet e huasë, kontratat e qirasë dhe kontratat e garancisë financiare. Shoqëria menaxhuese njuh provigjon për humbje të tilla në çdo datë raportimi.

### Matja e humbjeve të pritshme të kredisë

Matja e humbjeve të pritura të kredisë pasqyron një vlerë të paanshme dhe me probabilitet të ponderuar që përcaktohet duke vlerësuar një sërë re zultatesh të mundshme, vlerën në kohë të parasë dhe informacionin e arsyeshëm dhe të mbështetur që është në dispozicion pa kosto ose përpjekje të panevojshme në datën e raportimit për ngjarjet e kaluara, aktuale dhe parashikimet e kushteve të ardhshme ekonomike.

Matja e lejesës për humbjet e pritshme të kredisë për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar dhe vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, është një zonë që kërkon përdorimin e modeleve komplekse dhe supozimeve të rëndësishme në lidhje me kushtet e ardhshme ekonomike dhe sjelljen e kredisë. Vlerësime të rëndësishme:

- Përcaktimi i kritereve për rritje të ndjeshme të rrezikut të kredisë
- Zgjedhja e modeleve dhe supozimeve të përshtatshme për matjen e humbjeve të pritura të kredisë
- Vendosja e numrit dhe peshave relative të skenarëve të ardhshëm për secilin lloj produkti/tregu dhe humbjet e pritura të kredisë të lidhura
- Krijimi i grupeve të aktiveve financiare të ngjashme me qëllim matjen e humbjeve të pritshme të kredisë.

Vlerësimi i ekspozimit të kredisë për qëllime të menaxhimit të rrezikut është kompleks dhe kërkon përdorimin e modeleve. Vlerësimi i rrezikut të kredisë për një portofol të aktiveve përfshin vlerësime të mëtejshme në lidhje me mundësitë e mosshlyerjeve të ndodhura, të raporteve të lidhura me humbjen dhe korrelacioneve të mosshlyerjeve ndërmjet palëve.

Shoqëria menaxhuese mat rrezikun e kredisë duke përdorur probabilitetin e mosshlyerjes së kredive, ekspozimin në mosshlyerje të kredisë dhe humbjet nga mosshlyerja. Kjo është një metodë mbizotëruese e përdorur për qëllimet e matjes së humbjeve të pritshme të kredisë sipas SNRF 9.

SNRF 9 përshkruan një model me tre hapa për zhvlërësimin bazuar në ndryshimet në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare. Ky model kërkon që një instrument financiar, i cili nuk është i zhvlërësuar nga kreditë në njohjen fillestare, klasifikohet në Fazën 1 dhe rreziku i tij i kreditit monitorohet vazhdimisht. Nëse është identifikuar një rritje e ndjeshme e rrezikut të kredisë që nga njohja fillestare, instrumenti financiar kalon në Fazën 2, por nuk konsiderohet të jetë i zhvlërësuar nga kredia. Nëse instrumenti financiar është i zhvlërësuar nga kreditimi, instrumenti financiar më pas zhvendoset në Fazën 3.

Për instrumentet financiare në Fazën 1, humbja e pritshme e kredisë matet me një shumë të barabartë me pjesën e humbjeve të pritshme të kredisë që rezultojnë nga ngjarjet e mundshme gjatë 12 muajve të ardhshëm. Instrumentet në Fazat 2 ose 3 kanë humbjet e pritshme të kredive të matura në bazë të humbjeve të pritura të kredisë gjatë gjithë jetëgjatësisë. Sipas SNRF 9, kur matet humbja e pritshme e kredisë është e nevojshme të merret në konsideratë informacioni për të ardhmen. Aktivet financiare të blera ose me origjinë nga kreditë e zhvlërësuar janë aktive financiare

## 5. STANDARDET E REJA DHE NDRYSHIMET NË STANDARDET EKZISTUESE NË ÇËSHITJE QË NUK JANË ADOPTUAR ENDE (VAZHDIM)

të cilat janë të zhvlerësuara nga kredia në njohjen fillestare. Humbja e pritshme e kreditit matet në vazhdimësi të jetës (Faza 3).

### **Rritja e ndjeshme e rrezikut të kredisë**

Shoqëria menaxhuese konsideron që një instrument financiar ka përjetuar një rritje të ndjeshme të rrezikut të kredisë kur një ose më shumë nga kriteret e mëposhtme sasiore, cilësore ose ndaluese të mëposhtme janë plotësuar:

#### **Kriteret sasiore**

Shoqëria menaxhuese përdor kriteret sasiore si tregues parësor të rritjes së konsiderueshme të rrezikut të kredisë për të gjitha portfolet materiale.

Për vlerësimin sasiore, Shoqëria menaxhuese krahason kurbën e probabilitetit të mospagimit për të gjithë jetëgjatësinë me të dhënat e matura, me kurbën e ardhshme të probabilitetit të mos pagimit në datën e njohjes fillestare. Për vlerësimin e kurbës së probabilitetit të mospagimit për të gjithë jetëgjatësinë në datën e njohjes fillestare, bëhen supozime rreth strukturës së saj. Për instrumentet financiare me vlerësim të lartë, supozohet se kurba do të përkeqësohet me kalimin e kohës. Për instrumentet financiare me vlerësim të ulët, supozohet se kurba do të përmirësohet me kalimin e kohës. Shkalla e përmirësimit ose përkeqësimit do të varet nga niveli i vlerësimit fillestar.

Shoqëria menaxhuese nuk është në dijeni të ndonjë praktike tregu të pranuar përgjithësisht, e cila specifikon një nivel për të cilin një instrument financiar duhet të transferohet në Fazën 2. Nga kjo perspektivë, pritet që rritja e probabilitetit të mospagimit në datën e raportimit, e cila konsiderohet e rëndësishme, do të zhvillohet gjatë një periudhe kohore si rezultat i një procesi përsëritës ndërmjet pjesëmarrësve të tregut dhe mbikëqyrësve.

#### **Kriteret cilësore**

Shoqëria menaxhuese përdor kriteret cilësore si një tregues dytësor për rritje të rëndësishme të rrezikut të kredisë për të gjitha portfolet materiale. Transferimi në Fazën 2 zhvillohet kur plotësohen kriteret e mëposhtme.

Për portfolet qeveritare, bankare, të korporatave dhe të financave të projektit, nëse huamarrësi plotëson një ose më shumë nga kriteret e mëposhtme:

- Treguesit e jashtëm të tregut
- Ndryshime në kushtet e kontratës
- Ndryshime në qasjen e drejtimit

### **Gjykimi i ekspertëve**

Vlerësimi i një rritjeje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë përfshin informacione të ardhshme dhe kryhet në baza tremujore në një nivel marrëveshjeje për të gjithë portfolet jo të tregtueshme të mbajtur nga Shoqëria menaxhuese.

Për portfolet e tregëtueshme, nëse huamarrësi plotëson një ose më shumë nga kriteret e mëposhtme:

- Lëshime përsa i përket marrëveshjes së kredisë, kur huamarrësi po kalon vështirësi
- Gjykimi i ekspertëve

Vlerësimi i një rritjeje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë përfshin informacion për të ardhmen dhe kryhet në baza mujore në një nivel marrëveshjeje për të gjitha portfolet retail të mbajtura nga Shoqëria menaxhuese.

### **Ndalesa**

Nëse një huamarrës vonohet më shumë se 30 ditë për pagesat e tij kontraktuale, instrumenti financiar mendohet të ketë patur një rritje të ndjeshme në rrezikun e kredisë dhe në këtë rast, aplikohet një ndalesë. Në disa raste të kufizuara, supozimi se aktivet financiare të cilat janë më shumë se 30 dite vonesa duhet të kalojnë në Fazën 2, hidhet poshtë.

Shoqëria menaxhuese nuk ka përdorur përjashtimin që vjen nga rreziku i ulët i kredisë për klientët huamarrës; megjithatë, përdor në mënyrë selective përjashtimin që vjen nga rreziku i ulët i kredisë për instrumentat e borxhit.

### **Përcaktimi i mospagimit dhe aktiveve të zhvlerësuara nga kreditimi**

Shoqëria menaxhuese përcakton që një instrument financiar është në mospagim, i cili është plotësisht i linjësuar me

## 5. STANDARDET E REJA DHE NDRYSHIMET NË STANDARDET EKZISTUESE NË ÇËSHITJE QË NUK JANË ADOPTUAR ENDE (VAZHDIM)

përkufizimin e zhvlerësimit nga kreditimi, kur plotëson një ose më shumë nga kriteret e mëposhtme:

- Huamarrësi është më shumë se 90 ditë me vonese për pagesat e tij kontraktuale;
- Nuk është bërë asnjë përpjekje për të hedhur poshtë supozimin se asetet financiare të cilat janë më shumë se 90 ditë me vonese duhet të jenë në Fazën 3.

Huamarrësi ka gjasa për të mos paguar, që tregon se është në vështirësi të konsiderueshme financiare. Këto janë raste kur:

- Huamarrësit i janë mundësuar lëshime për një afat të gjatë për shkak të vështirësive që është duke kaluar ose mund të kalojë
- Huamarrësi është i vdekur
- Huamarrësi është i paaftë të paguajë
- Huamarrësi është në kundërshtim me kushtet financiare të kontratës
- Nuk ka një treg aktiv për aktivin financiar për shkak të vështirësive financiare
- Është e mundshme që huamarrësi të hyjë në falimentim
- Aktivet financiare janë blerë ose origjinojnë me një zbritje të thellë nga cmimi, që pasqyron humbjet e shkaktuara te kredisë.

Kriteret e mësipërme janë zbatuar mbi të gjitha instrumentet financiare të mbajtura nga Shoqëria menaxhuese dhe janë në përputhje me përkufizimin e mospagimit të përdorur për qëllime të menaxhimit të brëndshëm të rrezikut të kredisë.

### Shpjegimi i të dhënave, supozimeve dhe teknikave të vlerësimit

Humbja e pritshme e kredisë matet në bazë të një periudhe 12-mujore ose jetëgjatësisë, në varësi të faktit nëse ka ndodhur një rritje e konsiderueshme në rrezikun e kredisë që nga njohja fillestare ose nëse një aktiv konsiderohet si i dëmtuar nga kredia.

Informacioni ekonomik për të ardhmen gjithashtu përfshihet në përcaktimin e probabilitetit të mospagimit 12-mujor dhe të probabilitetit të mospagimit për të gjithë jetëgjatësinë e aktivitetit, ekspozimit në mospagim dhe humbja nga mospagimi. Këto supozime ndryshojnë sipas llojit të produktit. Humbjet e pritshme të kredisë janë prodhimi i probabilitetit të mospagimit, humbja nga mospagimi, ekspozimi në mospagim dhe faktorit skontues (FS).

### Probabiliteti i mosshlyerjes

Probabiliteti i mosshlyerjes paraqet mundësinë që një huamarrës nuk përmbush detyrimet financiare gjatë 12 muajve të ardhshëm ose gjatë jetës së mbetur të detyrimit. Si rregull, probabiliteti i mosshlyerjes është llogaritur duke përdorur probabilitetin rregullor 12 mujor të mosshlyerjes, pa asnjë marzh konservativizmi. Më pas përdoren metoda të ndryshme statistikore për të gjeneruar një vlerësim se si do të llogaritet profili i mosshlyerjes nga pika e njohjes fillestare e përgjatë gjithë jetës së kredisë ose portofolit të huave.

Në rastet e kufizuara kur disa të dhëna nuk janë në dispozicion, për llogaritjen përdoret grupimi, mesatarja ose krahasimi i të dhënave.

### Humbja nga mosshlyerja

Humbja nga mosshlyerja, paraqet pritshmërinë që ka Shoqëria menaxhuese për shkallën e humbjes lidhur me ekspozim që nuk është paguar në kohë. Kjo humbje varion sipas produktit apo palës së tretë nga e cila rrjedh. Humbja nga mospagimi shprehet si përqindje për njësi ekspozimi në kohën e mospagimit.

Ajo llogaritet në bazë 12 mujore ose për të gjithë jetëgjatësinë, ku humbja nga mospagimi 12-mujor është përqindja e humbjes që pritet të pësohet nëse ndodh mospagimi në 12 muajt e ardhshëm dhe humbja nga mospagimi gjatë jetës është përqindja e humbjes që pritet të pësohet nëse mospagimi ndodh gjatë jetës së mbetur.

### Ekspozimi i mosshlyerjes

Ekspozimi në mospagim bazohet në shumën që Shoqëria menaxhuese pret që klientët t'i kenë borxh në kohën e mospagimit, gjatë 12 muajve të ardhshëm ose gjatë jetës së mbetur. Ekspozimi në Mospagim 12-mujor dhe gjatë jetëgjatësisë përcaktohen në bazë të profilit të pagesës së pritshme, e cila ndryshon sipas llojit të produktit. Për produktet e amortizueshme dhe huatë që mundësojnë shlyerjen e njëhershme të principalit në maturim (bullet), llogaritja e ekspozimit në mospagim është bazuar në shlyerjet kontraktuale të huamarrësit gjatë një periudhe 12 mujore ose për

## 5. STANDARDET E REJA DHE NDRYSHIMET NË STANDARDET EKZISTUESE NË ÇËSHITJE QË NUK JANË ADOPTUAR ENDE (VAZHDIM)

të gjithë jetëgjatësinë. Aty ku është e përshtatshme, në llogaritje merren parasysh supozimet e ripagimit/rifinancimit të parakohshëm.

Për produktet rrotulluese (revolving), ekspozimi në mospagim llogaritet duke l shtuar shumës së tërhequr një faktor konvertimi të kedisë , i cili lejon tërheqjen e pritshme të kufirit të mbetur deri në kohën e mospagimit. Marzhet rregullatorë të kujdesshme hiqen nga faktori i konvertimit të kredisë. Në rastet e kufizuara kur disa të dhëna nuk janë plotësisht të disponueshme, për llogaritjen përdoret krahasimi i inputeve.

### Faktori skontues

Si rregull, për ekspozime në pasqyrën e pozicionit financiar që nuk janë qera financiare ose instrumenta të blerë ose të origjinuar nga zhvlerësimi i kredisë, norma skontuese e përdorur në llogaritjen e humbjes së pritshme të kredisë është norma efektive e interesit ose një përafrim i saj.

Humbja e pritshme e kredisë është një produkt i Probabilitetit të mosshlyerjes, humbja nga mosshlyerja dhe Ekspozimi i mosshlyerjes, shumëzuar me probabilitetin e mungesës së mospagimit (probabilitetin e pagimit) të një periudhe më para periudhës kohore të konsideruar. Kjo e fundit shprehet nga funksioni i mbijetesës S. Kjo llogarit vlerat e ardhshme të humbjeve të pritura të kredisë, të cilat pastaj skontohen në datën e raportimit dhe më pas mblidhen. Vlerat e llogaritura të humbjeve të pritshme të kredisë peshohen me një skenar të ardhshëm.

Modele të ndryshme janë përdorur për të vlerësuar dispozitat e Fazës 3 të shumave të papaguara të kredisë dhe këto mund të grupohen në kategoritë e mëposhtme:

- Qeveritë, klientët korporata, financimet e projektit, institucionet financiare, qeveritë lokale dhe rajonale, kompanitë e sigurimeve dhe ndërmarrjet e investimeve kolektive - Provigjonet e Fazës 3 llogariten nga menaxherët e ristrukturimit që skontojnë flukset e pritshme të parasë sipas normës së përshtatshme efektive të interesit.
- Kredi me hipotekë për individë – Provigjonet e Fazës 3 krijohen duke llogaritur vlerën e zbritur të realizimit të kolateralit.
- Kreditë e tjera të shitjes me pakicë - Provigjonet e Fazës 3 gjenerohen duke llogaritur vlerësimin më të mirë statistikor të humbjes së pritshme, duke marrë parasysh kostot indirekte.

Nuk është bërë asnjë përpjekje për të hedhur poshtë supozimin se aktivet financiare që janë me më shumë se 90 ditë vonesë duhet të jenë në Fazën 3.

### Informacion për të ardhmen

Vlerësimi i një rritjeje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë dhe llogaritja e humbjeve të pritura të kredisë përfshijnë informacion që shihet nga e ardhmja. Shoqëria menaxhuese ka kryer analiza historike dhe ka identifikuar variabla kryesorë ekonomike që ndikojnë në rrezikun e kredisë dhe humbjet e pritshme të kredisë për çdo portofol.

Gjykim i ekspertëve zbatohet në këtë proces. Parashikimet e variablave ekonomike (skenari ekonomik bazë) sigurohen nga Raiffeisen Research në baza tremujore dhe japin parashikimin më të mirë për ekonominë gjatë tre viteve të ardhshme. Pas tre vjetësh, për të projektuar variablat ekonomike për jetëgjatësinë e plotë të secilit instrument, përdoret një metodë e kthimit në mesatare, që do të thotë se variablat ekonomike kanë tendencë ose të jenë një normë mesatare afatgjatë ose të kenë një normë mesatare të rritjes afatgjatë deri në maturim. Ndikimi i variablave ekonomike mbi probabilitetin e mospagimit, humbja në mospagim dhe ekspozimi në mospagim përcaktohet duke përdorur regresionin statistikor për të kuptuar ndikimin që ndryshimet në këto variabla kanë pasur historikisht në normat e mospagimit dhe mbi përbërësit e humbjes në mospagim dhe ekspozimit në mospagim.

Përveç skenarit ekonomik bazë, Raiffeisen Research gjithashtu ofron një skenar me rastin më të mirë dhe një skenar me rastin më të keq, të ponderuara për të siguruar kapërcimin e jo-linearitetit. Shoqëria menaxhuese ka arritur në konkluzionin se tre skenare ose më pak kapin në mënyrë të përshtatshme jo-linearitetin. Peshat e skenarit përcaktohen nga një kombinim i analizës statistikore dhe gjykitimit të ekspertizës së kredisë, duke marrë parasysh gamën e rezultateve të mundshme që secili skenar i zgjedhur përfaqëson.

Shoqëria menaxhuese konsideron që këto parashikime përfaqësojnë vlerësimin më të mirë të rezultateve të mundshme dhe mbulojnë çdo jo-linearitet dhe asimetri të mundshme në portofolet e ndryshme të Bankës.

### Analiza e ndjeshmërisë

Supozimet më të rëndësishme që ndikojnë në lejesën e humbjes së pritshme së kredisë janë si më poshtë:

- Portofolet e korporatave
  - o Prodhimi i Brendshëm Bruto



## 5. STANDARDET E REJA DHE NDRYSHIMET NË STANDARDET EKZISTUESE NË ÇËSHITJE QË NUK JANË ADOPTUAR ENDE (VAZHDIM)

- o Shkalla e papunësisë
- o Norma afatgjatë e obligacioneve qeveritare
- o Norma e inflacionit
- Portofole e tregtueshme
  - o Prodhimi i Brendshëm Bruto
  - o Shkalla e papunësisë
  - o Çmimet e pasurive të paluajtshme

### Tranzicioni

Ndryshimet në politikat kontabël që rrjedhin nga miratimi i SNRF 9 në përgjithësi do të zbatohen në mënyrë retrospektive, përveç siç përshkruhet më poshtë:

- Shoqëria menaxhuese do të përfitojë nga përjashtimi duke e lejuar atë të mos rishikojë informacionin krahasues për periudhat e mëparshme në lidhje me ndryshimet në klasifikimin dhe matjen (duke përfshirë zhvlerësim). Diferencat në vlerën kontabël të aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare që rezultojnë nga zbatimi i SNRF 9 njihen në fitimet e pashpërndara që nga 1 janari 2018.

Vlerësimet e mëposhtme duhet të bëhen në bazë të fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë në datën e aplikimit fillestar:

- Përcaktimi i modelit të biznesit në të cilin mbahet një aktiv financiar.
- Emërtimi dhe revokimi i emërtimeve të mëparshme të aktiveve dhe detyrimeve të caktuara financiare të matura në VDNFH
- Caktimi i disa investimeve strategjike që nuk mbahen për tregtim si në VDNATGJ.

**SNRF 15 "Të ardhurat nga kontratat me klientët"** dhe ndryshime të mëtejshme (efektiv më ose pas datës 1 Janar 2018),

**SNRF 16 "Qiratë"** (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 Janar 2019),

Ndryshimet në SNRF 2 "Pagesat bazuar në Aksione", - Klasifikimi dhe Matja e transaksioneve të pagesave me bazë aksionet (efektiv më ose pas datës 1 Janar 2018),

**Ndryshimet në SNRF 4 "Kontratat e sigurimit"** - Aplikimi i SNRF 9 "Instrumentat financiarë" me SNRF 4 "Kontratat e sigurimit" (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018, ose kur SNRF 9 "Instrumentat financiarë", është aplikuar për herë të parë),

**Ndryshimet në SNRF 9 "Instrumentat Financiarë"** – Veçoritë e Parapagimit me Kompensim Negativ (efektiv më ose pas datës 1 Janar 2019),

**Ndryshimet në SNRF 10 "Pasqyrat Financiare të Konsoliduara" dhe SNK 28 "Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta"** - Shitja apo Kontributi i asetëve mes një Investitori dhe bashkëpunëtorëve të tij, ose sipërmarrje të përbashkëta dhe ndryshimeve të mëtejshme (data efektive e shtyrë për kohë të pacaktuar derisa projekti kërkimor mbi metodën e kapitalit neto të jetë përfunduar),

**Ndryshimet në SNK 28 "Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta"**- interesa afatgjatë në Pjesëmarrje dhe Ndërmarrje të Përbashkëta (efektiv më ose pas datës 1 Janar 2019),

**Ndryshimet në SNK 40 "Aktivet Materiale Afatgjata të Investuara"** - Transferimet e aktiveve materiale afatgjata të investuara (efektive më ose pas 1 janarit 2018),

**Ndryshime në SNRF 1 dhe SNK 28 si pasojë e "Përmirësimeve të SNRF-ve ( cikli 2014-2016)"** rezultuar nga projekti i përmirësimit vjetor të SNRF ( SNRF 1, SNRF 12, dhe SNK 28) kryesisht me një pikëpamje për të eliminuar mospërputhjet dhe për të qartësuar formulimin (ndryshimet mbi SNRF 1 dhe SNK 28 do të jenë të aplikueshme për periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 Janar 2018).

**Ndryshimet në standardet e ndryshme "Përmirësimet në SNRF-të (cikli 2015-2017)"** që rezultojnë nga përmirësimi i përvitshëm të projektit të SNRF (SNRF 3, SNRF 11, SNK 12 dhe SNK 28) kryesisht me qëllimin që të shmangin mospërputhjet dhe të qartësojnë formulimin (efektiv në periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2019),

**KIRFN 22 "Transaksionet valutë dhe Konsiderata për avancat"** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).

**KIRFN 23 "Pasiguria mbi Trajtimin e Tatimit mbi të Ardhurat"** efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).

## 6. PARAJA DHE EKVIVALENTËT E SAJ

Paraja dhe ekuivalentët e saj janë mbajtur me kosto të amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar dhe përbëhen nga:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Llogari në banka në lek	18,953,641	29,856,768
Depozita në lek	380,000,000	175,000,000
<b>Totali</b>	<b>398,953,641</b>	<b>204,856,768</b>

Në datë 31 Dhjetor 2017 depozitat janë si më poshtë:

	Vlera Nominale	Data e vendosjes	Data e maturimit	Norma e interesit
	380,000,000	07 Dhjetor 2017	05 Janar 2018	0.10%
<b>Totali</b>	<b>380,000,000</b>			

Në datë 31 Dhjetor 2016 depozitat janë si më poshtë:

	Vlera Nominale	Data e vendosjes	Data e maturimit	Norma e interesit
	25,000,000	08 Korrik 2016	6 Janar 2017	0.10%
	150,000,000	14 Dhjetor 2016	6 Janar 2017	0.10%
<b>Totali</b>	<b>175,000,000</b>			

## 7. LLOGARI TË ARKËTUESHME NGA FONDET

Shumat e arkëtueshme nga fondet i përkasin komisioneve të administrimit për muajin të dhjetor të pagueshme nga të tre Fondet në Administrimin të Shoqërisë, si dhe penaliteteve për tërheqje të parakohshme nga Fondi i Pensionit Vullnetar (të tjera) dhe janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Të arkëtueshme nga fondi i Investimit Prestigj	60,963,932	55,391,852
Të arkëtueshme nga fondi i Investimit EURO	18,754,659	17,262,167
Të arkëtueshme nga fondi i Pensionit	639,285	520,886
Të tjera	1,151,424	883,313
<b>Totali</b>	<b>81,509,299</b>	<b>74,058,218</b>

## 8. AKTIVE FINANCIARE TË MBAJTURA DERI NË MATURIM

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
<b>Afat-shkurtra</b>	-	-
Vlera nominale	-	-
Zbritje e pa-amortizuar		

## 8. AKTIVE FINANCIARE TË MBAJTURA DERI NË MATURIM (VAZHDIM)

	31 December 2017	31 December 2016
<b>Afat-gjata</b>		
Vlera nominale	20,000,000	20,000,000
Interesi i përlogaritur	152,000	152,000
<b>Totali</b>	<b>20,152,000</b>	<b>20,152,000</b>

Obligacionet e Qeverisë me 31 dhjetor 2017 përbëhen nga obligacione 5-vjeçare të nominuar në Lek të emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë me normë kuponi 6,6% dhe bonde 7-vjeçare të nominuar në Lek të emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë me normë kuponi 7,38%. Kuponi paguhet çdo 6-muaj.

	Vlera nominale	(Skonto) / Prim i paamortizuar	Interesa të përlogaritura	Vlera kontabël
Bono thesari				
Obligacione qeveritare	20,000,000	-	152,000	20,152,000
<b>Më 31 Dhjetor 2017</b>	<b>20,000,000</b>	<b>-</b>	<b>152,000</b>	<b>20,152,000</b>

	Vlera nominale	(Skonto) / Prim i paamortizuar	Interesa të përlogaritura	Vlera kontabël
Bono thesari				
Obligacione qeveritare	20,000,000	-	152,000	20,152,000
<b>Më 31 Dhjetor 2016</b>	<b>20,000,000</b>	<b>-</b>	<b>152,000</b>	<b>20,152,000</b>

Lëvizjet në vlerat nominale të aktiveve të mbajtura deri në maturim paraqiten si me poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Më 1 janar	20,000,000	20,000,000
Blerje gjatë vitit	-	-
Të maturuara gjatë vitit	-	-
<b>Më 31 dhjetor</b>	<b>20,000,000</b>	<b>20,000,000</b>

## 9. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE, NETO

	Automjete	Pajisje zyre dhe informatike	Totali
<b>Kosto</b>			
Gjendja më 1 Janar 2016	18,483,849	12,267,089	<b>30,750,938</b>
Shtesa		1,696,116	<b>1,696,116</b>
Pakësime	(1,541,980)		<b>(1,541,980)</b>
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2016</b>	<b>16,941,869</b>	<b>13,963,204</b>	<b>30,905,073</b>
Shtesa	2,504,583	72,560	<b>2,577,143</b>

## 9. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE, NETO (VAZHDIM)

Pakesime	(7,404,359)		<b>(7,404,359)</b>
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2017</b>	<b>12,042,093</b>	<b>14,035,764</b>	<b>26,077,858</b>
<b>Zhvlërësimi i akumuluar</b>			
Gjendja më 1 Janar 2016	(3,698,571)	(5,330,586)	<b>(9,029,157)</b>
Shpenzimi i vitit	(2,786,257)	(1,766,198)	<b>(4,552,455)</b>
Pakësime	565,239		<b>565,239</b>
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2016</b>	<b>(5,919,589)</b>	<b>(7,096,784)</b>	<b>(13,016,373)</b>
Shpenzimi i viti	(1,820,045)	(1,674,848)	<b>(3,494,887)</b>
Pakesime	(3,494,887)		<b>(3,494,887)</b>
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2017</b>	<b>(5,310,570)</b>	<b>8,771,632</b>	<b>(14,081,891)</b>
<b>Vlera e mbetur</b>			
<b>Më 31 Dhjetor 2016</b>	<b>11,022,280</b>	<b>6,866,420</b>	<b>17,888,701</b>
<b>Më 31 Dhjetor 2017</b>	<b>6,732,125</b>	<b>5,264,133</b>	<b>11,996,259</b>

## 10. AKTIVE AFATGJATA JOMATERIALE, NETO

Aktivët afatgjatë jomateriale përfshijnë software të përdorura nga Shoqëria:

	Programe Kompjuterike	Totali
<b>Kosto</b>		
Gjendja më 1 Janar 2016	22,026,722	22,026,722
Shtesa	1,047,600	1,047,600
Pakësime	(235,152)	(235,152)
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2016</b>	<b>22,839,170</b>	<b>22,839,170</b>
Shtesa	162,042	162,042
Pakesime	(375,329)	(375,329)
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2017</b>	<b>22,625,883</b>	<b>22,625,883</b>
<b>Zhvlërësimi i akumuluar</b>		
Gjendja më 1 Janar 2016	11,935,923	11,935,923
Shpenzimi i vitit	(2,655,201)	(2,655,201)
Pakësime	235,152	235,152
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2016</b>	<b>14,355,972</b>	<b>14,355,972</b>
Shpenzimi i viti	(2,267,612)	(2,267,612)
Pakesime	375,329	375,329
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2017</b>	<b>(16,248,255)</b>	<b>(16,248,255)</b>

## 10. AKTIVE AFATGJATA JOMATERIALE, NETO (VAZHDIM)

<b>Vlera e mbetur</b>		
<b>Më 31 Dhjetor 2016</b>	<b>8,483,198</b>	<b>8,483,198</b>
<b>Më 31 Dhjetor 2017</b>	<b>6,377,628</b>	<b>6,377,628</b>

## 11. DETYRIME TË TJERA

Detyrimet e tjera dhe provigjonet për detyrime dhe pagesa përbëhen si më poshtë:

	<b>31 Dhjetor 2017</b>	<b>31 Dhjetor 2016</b>
Detyrime për Banken Kujdestare	5,230,134	4,929,792
Detyrime për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare	3,063,839	2,772,239
Shpenzime të përlogaritura auditimi	1,703,194	1,548,420
Detyrime për sigurimet shoqërore	430,317	364,234
Tatim mbi të ardhurat nga punësimi	394,642	306,429
Furnitorë	528,900	1,659,277
Të tjera	4,611,048	14,164,247
<b>Totali</b>	<b>15,962,073</b>	<b>25,744,638</b>

## 12. KAPITALI AKSIONAR

Me 31 Dhjetor 2017 dhe 2016, kapitali aksionar i regjistruar është 90,000,000 Lek i përbërë nga 12,857 aksione me vlerë nominale prej 7,000.08 Lek secili. Aksioneri i vetëm i Shoqërisë është Raiffeisen Bank sh.a.

## 13. REZERVA LIGJORE

Bazuar në ligjin nr. 9901 datë 14 prill 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë e tregtare" si dhe statutin e Shoqërisë, Shoqëria mban një rezervë ligjore dhe transferon çdo vit 5% te fitimit neto të realizuar në vitin financiar paraardhës derisa shuma të arrije 10% të vlerës së kapitalit, Duke qënë se rezerva ligjore e ka arritur nivelin 10% të vlerës së kapitalit, nuk ka patur ndryshim në rezervën ligjore gjatë vitit 2017.

## 14. TARIFA TË ADMINISTRIMIT TË FONDEVE

	<b>31 Dhjetor 2017</b>	<b>31 Dhjetor 2016</b>
Raiffeisen Prestigj	708,565,742	705,392,908
Raiffeisen Invest Euro	214,404,428	197,145,210
Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen	6,842,354	5,544,710
<b>Totali</b>	<b>929,812,523</b>	<b>908,082,828</b>

Të ardhurat e administrimit të Fondëve llogariten mbi Vlerën Neto të Aktiveve ditore për secilin fond, bazuar në tarifën e përcaktuara, të detajuara si më poshtë:

- Fondi Pretigj – 1.25% (vjetore) e vlerës neto të aktiveve;
- Fondi Pensionit – 1.5% (vjetore) e vlerës neto të aktiveve;
- Fondi Raiffeisen Invest Euro – 1.5% (vjetore) e vlerës neto të aktiveve,

Shpenzimi llogaritet në bazë ditore.

## 15. TË ARDHURA NGA INTERESI

Të ardhurat nga interesi sipas kategorive përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Obligacione të qeverisë	1,359,000	1,359,000
Depozita me afat dhe llogari rrjedhese	272,863	509,329
	<b>1,631,863</b>	<b>1,868,329</b>

## 16. SHPENZIME PERSONELI

Kosto e personelit përbëhet nga si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Paga, shpërblime	(37,665,072)	(36,654,134)
Sigurime shoqërore	(2,927,896)	(2,541,183)
Kosto të tjera të personelit	(1,545,434)	(1,714,082)
<b>Totali</b>	<b>(42,138,402 )</b>	<b>(40,909,399)</b>

## 17. SHPENZIME TË PËRGJITHSHME DHE ADMINISTRATIVE

Shpenzimet e përgjithshme administrative përbëhen nga si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Shpenzime të tjera të administrimit të fondeve të pensionit dhe investimeve	(340,533,200)	(333,077,450)
Sponsorizime	(89,504,146)	(89,356,460)
Shpenzime për bankën depozitare	(60,897,089)	(59,836,648)
Tarifë për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare	(25,149,371)	(31,666,574)
Shpenzime të shitjes me agjent	(16,081,500)	(16,456,500)
Shpenzime mirëmbajtje Invest 2/Bloomberg/Reuters	(10,163,981)	(7,437,976)
Komisione	(7,017,459)	(4,925,908)
Shpenzime për trajnim personeli	(4,355,900)	(4,460,521)
Qera	(3,422,481)	(2,148,014)
Udhëtime dhe dieta	(2,312,340)	(4,839,976)
Siguracion	(2,297,405)	(1,229,842)
Shpenzime telefonike dhe internet	(366,871)	(258,815)
Taksa dhe TVSH	(270,425)	(245,576)
Noter dhe shpenzime ligjore	(25,220)	(177,948)
Të tjera	(6,442,782)	(7,024,007)
<b>Totali</b>	<b>(568,840,169)</b>	<b>(563,142,214)</b>

Shpenzimet e tjera të administrimit të fondeve të investimit lidhen me marrëveshjen e bashkëpunimit midis Raiffeisen Bank sh.a dhe Raiffeisen Invest sh.a datë 03 Janar 2013 në bazë të së cilës Raiffeisen Invest sh.a angazhohet të pajisë të gjithë investitorët me një paketë shërbimesh bankare të ofruara nga Raiffeisen Bank sh.a dhe të mbulojë nëpërmjet pagesave mujore të gjitha kostot e shërbimeve të përfshira në paketë. Për vitin 2017 kostoja e shërbimeve të paketës

## 17. SHPENZIME TË PËRGJITHSHME DHE ADMINISTRATIVE (VAZHDIM)

është 950 Lek/për investitor.

(2016 : 850 Lek/për investitor deri më 30 prill 2016 dhe 950 Lek/për investitor për gjithë periudhën tjetër)

Bazuar në rregulloren nr. 18/1, datë 15 Shkurt 2010 të Bordit të Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare (të rishikuar në 6 tetor 2011), shoqëritë e administrimit të fondeve të pensioneve dhe të investimeve duhet të paguajnë kundrejt Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare një tarifë vjetore prej 0,05% të vlerës së aktiveve në fund të muajit për fondet e investimeve dhe 0,05% të vlerës së aktiveve në fund të tremujorit për fondet e pensioneve). (2016: 0,05% të vlerës së aktiveve në fund të muajit për fondet e investimeve dhe 0,05% të vlerës së aktiveve në fund të tremujorit për fondet e pensioneve).

## 18. TATIM FITIMI

Shoqëria ka përcaktuar tatimin në fund të vitit në përputhje me legjisllacionin shqiptar. Në vitin 2017, për shoqëritë shqiptare norma e tatimit është e barabartë me 15% (2016: 15%) e fitimit të tatueshëm. Më poshtë paraqitet rakordimi i tatimit mbi fitimin i përlogaritur me normën e aplikueshme të tatimit me fitimin kontabël:

	Përqindja efektive e tatimit	31 Dhjetor 2017	Përqindja efektive e tatimit	31 Dhjetor 2016
<b>Fitimi përpara tatimit</b>		316,632,539		298,690,736
Tatim fitimi i përlogaritur me 15% viti 2017 dhe 2016		(47,494,88)		(44,803,610)
Shpenzimet e pazbritshme		(64,831,899)		(63,216,500)
<b>Tatim fitimi</b>	<b>35.48%</b>	<b>(112,326,779)</b>	<b>36.16%</b>	<b>(108,020,110)</b>

Te perfshire ne shpenzimet e pazbritshme , ka nje shume prej Lek 51,079,980 ( ne 2016 Lek 49,960,418) qe i referohen shpenzimeve per sherbimet e marra nga RBAL).

Tatim fitimi i Shoqërisë rivlerësohet nga menaxhimi në fund të çdo periudhe raportimi. Detyrimet regjistrohen për pozicionet e tatim fitimit që përcaktohen nga menaxhimi si më të mundshmet që të mos rezultojë në tatime shtesë, nëse pozicioni tatimor do të kontestohet nga autoritetet tatimore. Vlerësimi bazohet në interpretimin e ligjeve tatimore në fuqi ose që konsideroheshin në fuqi në fund të periudhës raportuese dhe në çdo gjykim ose rregullore tjetër për të tilla çështje. Detyrimet për gjoba, interesa dhe tatime të tjera nga tatim fitimi njihen duke u bazuar në vlerësimin më të mirë të menaxhimit për shpenzimin e nevojshëm për të mbyllur detyrimin në fund të periudhës raportuese.

## 19. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR

### a) Të përgjithshme

Shoqëria ka ekspozim në rreziqet e mëposhtme në përdorimin e instrumentave financiare

- Rreziku i kreditimit
- Rreziku i likuiditetit
- Rreziku i tregut
- Rreziku operacional

Ky shenim prezanton informacionin për ekspozimin e Shoqërisë ndaj çdo rreziku të përmendur me sipër, objektivat, politikat dhe procedurat për matjen dhe administrimin e rrezikut si dhe për administrimin e kapitalit të shoqërisë.

### **Struktura e Administrimit të rrezikut**

Bordi administrues ka përgjegjësinë e gjithanshme për themelimin dhe mbikqyrjen e kuadrit të drejtimit të rrezikut të shoqërisë. Bordi është përgjegjës për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të administrimit të rrezikut të shoqërisë. Politikat e administrimit të rrezikut janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet e hasura nga institucioni financiar për të vendosur kufizime dhe kontrole dhe për të monitoruar zbatimin e këtyre kontrolleve. Politikat e administrimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet produktet dhe sherbimet e tregut. Shoqëria përmes standardeve dhe procedurave administrative synon të zhvillojë një mjedis kontrolli të disiplinuar dhe konstruktiv në të cilin çdo punonjës të kuptojë rolin dhe detyrat e tij.

## 19. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

### b) Rreziku i kreditimit

Risku i kreditimit është risku i humbjeve financiare nëse një klient ose palë e tretë për një instrument financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet kontraktuale. Për qëllime të raportimit të manaxhimit të rrezikut, Shoqëria konsideron këta elementë të ekspozimi të rrezikut (siç është rreziku i individit dhe rreziku i sektorit).

Këshilli i Administrimit të Shoqërisë e ka deleguar këtë përgjegjësi për manaxhimin të rrezikut të kreditimit tek Manaxhimi, i cili është përgjegjës për gabimet e rrezikut të kreditimit të Shoqërisë. Investimet e Shoqërisë janë në letra me vlerë të qeverisë shqiptare, ndaj Shoqëria është e ekspozuar vetëm ndaj rrezikut të kreditimit të qeverisë Shqiptare.

Ekspozimi maksimal kundrejt rrezikut të kreditimit është detajuar më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Paraja dhe ekuivalentët e saj	398,953,641	204,856,768
Llogari të arkëtueshme nga Fondet	81,509,299	81,509,299
Aktive Financiare të mbajtura deri në maturim	20,152,000	20,152,000
Llogari të tjera të arkëtueshme	400,609	135,370
<b>Totali</b>	<b>501,015,549</b>	<b>306,653,437</b>

Cilësia e kredisë së aktiveve financiare është si më poshtë:

	Aktive Financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes		Aktive Financiare të mbajtura deri në maturim	
	2017	2016	2017	2016
As me vonesë as të zhvlerësuar, cilësia B +	-	-	20,152,000	20,152,000
<b>Vlera neto</b>	-	-	<b>20,152,000</b>	<b>20,152,000</b>

### c) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të shlyejë detyrimet financiare në kohën e duhur.

#### **Administrimi i rrezikut të likuiditetit**

Qëndrimi i Shoqërisë në administrimin e likuiditetit është të sigurojë vazhdimisht likuiditet të mjaftueshëm për të shlyer detyrimet, si në kushtet normale, ashtu edhe në kushte të pafavorshme, pa pasur humbje të papranueshme, apo të dëmtoje emrin e saj. Tabela e mëposhtme paraqet flukset zbritëse të detyrimeve financiare në bazë të maturitit më të hershëm kontraktual ose flukseve të pritshme.



## 19. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

## c) Rreziku i likuiditetit

31 Dhjetor 2017						
	Deri në 1 muaj	1 deri 3 muaj	3 deri 6 muaj	6 deri 12 muaj	Mbi 1 vit	Totali
<b>Akriver</b>						
Paraja dhe ekuivalentët e saj	398,953,641	-	-	-	-	398,953,641
Llogari të arkëtueshme nga fondet	81,509,299	-	-	-	-	81,509,299
Llogari të arkëtueshme të tjera	101,826	66,396	99,595	132,793	-	400,609
Investime të mbajtura deri në maturim	-	-	-	-	20,152,000	20,152,000
<b>Totali</b>	<b>480,564,766</b>	<b>66,396</b>	<b>99,595</b>	<b>15,182,293</b>	<b>5,102,500</b>	<b>501,015,549</b>
<b>Detyrimet</b>						
Detyrime të tjera	15,962,073	-	-	-	-	15,962,073
<b>Totali</b>	<b>15,962,073</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>15,962,073</b>
<b>Rreziku i likuiditetit</b>	<b>464,602,693</b>	<b>66,396</b>	<b>99,595</b>	<b>15,182,293</b>	<b>5,102,500</b>	<b>485,053,476</b>
<b>Kumulative</b>	<b>464,602,693</b>	<b>464,669,089</b>	<b>464,768,684</b>	<b>479,950,976</b>	<b>485,053,476</b>	<b>485,053,476</b>
31 Dhjetor 2016						
	Deri në 1 muaj	1 deri 3 muaj	3 deri 6 muaj	6 deri 12 muaj	Mbi 1 vit	Totali
<b>Akriver</b>						
Paraja dhe ekuivalentët e saj	204,856,768	-	-	-	-	204,856,768
Llogari të arkëtueshme nga fondet	74,100,992	30,865	30,865	30,865	-	74,193,589
Investime të mbajtura deri në maturim	-	-	-	-	20,152,000	20,152,000
<b>Totali</b>	<b>278,957,760</b>	<b>30,865</b>	<b>30,865</b>	<b>30,865</b>	<b>20,152,000</b>	<b>299,202,357</b>
<b>Detyrimet</b>						
Detyrime të tjera	25,744,638	-	-	-	-	25,744,638
<b>Totali</b>	<b>25,744,638</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>25,744,638</b>
<b>Rreziku i likuiditetit</b>	<b>253,213,122</b>	<b>30,865</b>	<b>30,865</b>	<b>30,865</b>	<b>20,152,000</b>	<b>273,457,718</b>
<b>Kumulative</b>	<b>253,213,122</b>	<b>253,243,987</b>	<b>253,274,853</b>	<b>253,305,718</b>	<b>273,457,718</b>	<b>273,457,718</b>

## 19. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

### d) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku ku ndryshimet në çmimet e tregut, si norma e interesit, rreziku i kursit të këmbimit dhe marzhi i kredisë do të ndikojnë të ardhurat e Shoqërisë ose vlerën e mjeteve financiare që ajo disponon, Qëllimi i administrimit të rrezikut të tregut është të menaxhojë dhe të kontrollojë ekspozimet e rrezikut financiar brenda parametrave të pranueshëm, duke optimizuar fitimet e këtij rreziku.

### Ekspozimi kundrejt rrezikut të normës së interesit

Rreziku kryesor kundrejt të cilit portofolet e tregëtimit janë të ekspozuara është rreziku i humbjes nga luhatjet e fluksese të mjeteve monetare ose vlera e drejtë e instrumentave financiarë si rrjedhojë e një ndryshimi në normat e interesit të tregut (Vlera Neto Aktuale e hendekut midis Aktiveve dhe Detyrimeve). Rreziku i normës së interesit menaxhohet kryesisht nëpërmjet monitorimit të hendekut të normave të interesit.

Aktivitetet financiare që mbartin interes më 31 Dhjetor 2017 dhe 31 Dhjetor 2016 janë paraqitur më poshtë:

31 Dhjetor 2017						
	Deri në 1 muaj	1 deri në 3 muaj	3 deri në 6 muaj	6 deri në 12 muaj	Mbi 1 vit	Totali
<b>Aktivitetet</b>						
Aktivitetet financiare të mbajtura deri në maturitet	-	-	-	15,049,500	5,102,500	- 20,152,000
<b>Totali</b>	-	-	-	<b>15,049,500</b>	<b>5,102,500</b>	- <b>20,152,000</b>

31 Dhjetor 2016						
	Deri në 1 muaj	1 deri në 3 muaj	3 deri në 6 muaj	6 deri në 12 muaj	Mbi 1 vit	Totali
<b>Aktivitetet</b>						
Aktivitetet financiare të mbajtura deri në maturitet	-	-	-	-	20,152,000	- 20,152,000
<b>Totali</b>	-	-	-	-	<b>20,152,000</b>	- <b>20,152,000</b>

Menaxhimi i rrezikut të normave të interesit kundrejt limiteve të hendekut të normës së interesit plotësohet nëpërmjet monitorimit të ndjeshmërisë të Aktiveve dhe Detyrimeve financiare kundrejt disa situatave të normave të interesit standarde dhe jo-standarde. Situatat standarde që konsiderohen në mënyrë të rregullt përfshijnë rënien apo ngritjen paralele me 100 pike bazë (pb) në të gjitha kurbat e normës së interesit. Një analizë e ndjeshmërisë së Shoqërisë kundrejt një rritje ose zbritje në normat e interesit të tregut (duke supozuar lëvizje jo asimetrike përgjatë kurbës së normës së interesit dhe një pozicion financiar konstant) është si më poshtë:

2017		
Normat e interesit	Rritje 100 pb	Rënie 100 pb
Fitimi/(humbja) e vlerësuar në Lekë	139	(139)
2016		
Normat e interesit	Rritje 100 pb	Rënie 100 pb
Fitimi/(humbja) e vlerësuar në Lekë	137	(137)

### Ekspozimi kundrejt rrezikut të kursit të këmbimit

Shoqëria nuk është e ekspozuar në mënyrë të konsiderueshme kundrejt rrezikut të kursit të këmbimit duke qenë se transaksionet në monedhë të huaj nuk janë të shpeshta. Rreziku i kursit të këmbimit menaxhohet duke përdorur parimin e krahasimit të aktiveve me detyrimet. Pothuajse të gjitha asetet financiare të kompanisë si në 31 Dhjetor 2017 dhe 2016 janë nominuar në kursin vendor.

## 19. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

### e) Rreziku operacional

Rreziku operacional është rreziku i humbjeve direkte ose indirekte të ardhur nga një sërë shkaqesh të lidhura me proceset e Shoqërisë, personelit, teknologjisë dhe infrastrukturës, dhe faktorë të jashtëm përveç rrezikut të kredisë, tregut dhe likuiditetit si dhe ato të ardhura nga kërkesat ligjore dhe rregullatore dhe standarde të sjelljes profesionale të pranuarra gjerësisht duke përfshirë rrezikun e reputacionit dhe atë strategjik. Qëllimi i Shoqërisë është të menaxhojë rrezikun operacional për të balancuar shmangjen e humbjeve financiare nëpërmjet kontrollit të procedurave që kufizojnë iniciativën dhe kreativitetin. Përgjegjësia kryesore për zhvillimin dhe implementimin e kontrolleve për të adresuar rrezikun operacional i është caktuar Këshillit të Administrimit. Kjo përgjegjësi mbështetet nga zhvillimi i standardeve të përgjithshme të Shoqërisë për menaxhimin e rrezikut operacional në fushat e mëposhtme:

- ndarja e duhur e detyrave, përfshirë këtu autorizimin e pavarur të transaksioneve
- rakordimi dhe monitorimi i transaksioneve
- pajtueshmëria me kërkesat rregullatore dhe kërkesa të tjera ligjore
- dokumentimi i kontrolleve dhe procedurave
- vlerësim periodik i rreziqeve operationale me të cilat përballet Shoqëria, përshtatshmëria e kontrolleve dhe procedurave të lidhura me to
- raportimi i humbjeve operationale dhe veprimet korrigjuese të propozuara
- zhvillimi i planeve eventuale
- trajnime dhe zhvillime profesionale
- standardet etike dhe ato të biznesit
- zvogëlimi i riskut, përfshirë këtu siguracionet në rast se kjo është e aplikueshme

## 20. VLERAT E DREJTA TË AKTIVEVE DHE DETYRIMEVE FINANCIARE

### ***Përcaktimi i vlerës së drejtë***

Përcaktimi i vlerës së drejtë i aktiveve dhe detyrimeve financiare është e bazuar në çmimet e kuotuarat të tregut ose të agjentëve për instrumentat financiare të tregtuara në tregjet aktive. Për gjithë instrumentat e tjerë financiarë, vlera e drejtë përcaktohet duke përdorur teknika vlerësimi. Këto teknika përfshijnë teknikat e vlerës aktuale neto, metodën e flukseve monetare të zbritshme, krahasimin me instrumentat e ngjashme për të cilat ekzistojnë çmime tregu të verifikueshme, dhe modele vlerësimi.

Shoqëria mat vlerat e drejta duke përdorur hierarkinë e vlerës së drejtë të Nivelit 2, e cila reflekton rëndësinë e inputeve të përdorura gjatë matjeve, e shpjeguar si më poshtë:

Niveli 2: Teknikat e vlerësimit të bazuara në inpute të verifikueshme, direkt (psh çmimet) ose indirekt (psh bazuar në çmime). Kjo kategori përfshin instrumentat e vlerësuar duke përdorur: çmimet e kuotuarat në tregjet aktive për instrumentat e ngjashme; çmimet e kuotuarat për instrumenta identikë ose të ngjashëm në tregjet e konsideruara më pak se aktive; ose teknika të tjera vlerësimi ku të gjitha inputet e rëndësishme janë direkt ose indirekt të verifikueshme nga të dhënat e tregjeve.

Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare të cilat tregtohen në tregjet aktive është e bazuar në çmimet e kuotuarat të tregjeve ose agjentëve. Për instrumentat financiarë që tregëtohen rrallë dhe për të cilat ka transparencë të ulët të çmimeve, vlera e drejtë është më pak objektive dhe kërkon shkallë të ndryshme vlerësimi të bazuara në likuiditetin, përqëndrimin, pasigurinë e faktorëve të tregjeve, supozimet për çmimet, dhe rreziqe të tjera që ndikojnë në një instrument specific.

### ***Mjetet monetare***

Mjetet monetare përfshijnë arkën dhe llogaritë rrjedhëse me bankat rezidente. Duke qënë se këto balanca janë afatshkrutra, vlera e tyre e drejtë konsiderohet e njëjtë me vlerën kontabël neto.

## 20. VLERAT E DREJTA TË AKTIVEVE DHE DETYRIMEVE FINANCIARE (VAZHDIM)

### **Aktive financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes**

Aktivet financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes përfshijnë bonot e thesarit ose obligacionet qeveritare. Vlera e drejtë e këtyre investimeve është vlerësuar duke përdorur modelin e flukseve të mjeteve monetare të skontuar bazuar në një kurbë aktuale të normës së interesit të përshtatshme për periudhën e mbetur deri në maturitet. Investimet mbahen në vlerën e drejtë.

## 21. ANGAZHIME DHE DETYRIME E TË DREJTA TË KUSHTËZUARA

Kohë pas kohe dhe në rrjedhën normale të biznesit, kundrejt Shoqërisë mund të ngrihen ankesa. Mbi bazë të vlerësimeve vetjake dhe eksperiences profesionale, menaxhimi mendon që nuk do ketë humbje materiale nga këto ankesa, dhe si rrjedhim nuk janë bërë provigjone në këto pasqyra financiare.


## 22. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA


Palët përgjithësisht konsiderohen të lidhura nëse ato janë nën kontroll të përbashkët, ose një pale ka aftësinë të kontrollojë palën tjetër ose mund të ushtrojë influence të konsiderueshme kundrejt palës tjetër për të marrë vendime financiare apo operationale. Duke konsideruar çdo marrëdhënie të mundshme me palët e lidhura, vëmendja drejtohet kundrejt thelbit të marrëdhënies, dhe jo thjesht formës ligjore të saj. Një transaksion me palët e lidhura është një transfertë rezervash, shërbimesh apo detyrimesh midis palëve të lidhura, pavarësisht nëse një çmim është paguar. Shoqëria ka një marrëdhënie palësh të lidhura me kompaninë mëmë, Raiffeisen Bank sh.a. Më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 Shoqëria ka hyrë në transaksionet dhe balancat e mëposhtme me palët e lidhura:

<b>Ndaj Raiffeisen Bank sh.a.</b>	<b>31 Dhjetor 2017</b>	<b>31 Dhjetor 2016</b>
<b>Pasqyra e pozicionit financiar</b>		
Paraja dhe ekuivalentet e saj	396,155,922	202,007,846
<b>Totali</b>	<b>396,155,922</b>	<b>202,007,846</b>
<b>Pasqyra përmbledhëse e të ardhurave</b>		
<b>Të ardhura</b>		
Të ardhura/shpenzime neto nga komisionet	(176,935)	(160,518)
<b>Totali</b>	<b>(176,935)</b>	<b>(160,518)</b>
<b>Shpenzime</b>		
Pagesa për paketën e shërbimeve	(340,533,200)	(333,077,450)
Pagesa për shërbimin e shitjes	(16,081,500)	(16,456,500)
<b>Totali</b>	<b>(356,614,700)</b>	<b>(356,614,700)</b>
<b>Ndaj Fondeve</b>		
<b>Pasqyra përmbledhëse e të asdhurave</b>		
<b>Të ardhura</b>		
Të ardhura nga transaksionet	929,812,523	908,082,828
<b>Totali</b>	<b>929,812,523</b>	<b>908,082,828</b>
<b>Shpenzime</b>		
Pagesa për drejtimin	(15,752,941)	(11,776,445)
<b>Totali</b>	<b>(15,752,941)</b>	<b>(11,776,445)</b>

## **23. NGJARJET PAS DATËS SË RAPORTIMIT**

Nuk ka ngjarje pas datës së raportimit, të cilat mund të kërkojnë rregullim ose prezantim në pasqyrat financiare.





FONDI RAFFEISEN PRESTIGJ

**RAIFFEISEN PRESTIGJ**

Raporti i Audituesit të Pavarur  
dhe Pasqyrat Financiare  
për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017



# Përmbajtja

<b>Raporti i audituesit të pavarur</b>	<b>66</b>
<b>Pasqyra e fitim humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse</b>	<b>68</b>
<b>Pasqyra e pozicionit financiar</b>	<b>68</b>
<b>Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave</b>	<b>69</b>
<b>Pasqyra e mjeteve monetare më 31 dhjetor 2017</b>	<b>70</b>
1. Hyrje	71
2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël	71
3. Manaxhimi i rrezikut financiar	82
4. Manaxhimi i rrezikut të kapitalit	85
5. Strategjia e investimit	85
6. Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare	87
7. Vlerësimet dhe gjykimet kritike kontabël	88
8. Të ardhurat nga interesi	89
9. Ndryshime të tjera neto në vlerën e drejtë	89
10. Aktive financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes	89
11. Aktive financiare të mbajtura deri në maturim	90
12. Aktive financiare të vlefshme për shitje	91
13. Paraja dhe ekuivalentë të saj	92
14. Detyrime të tjera	92
15. Aktivitet neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave	92
16. Palët e lidhura	92
17. Ngjarje pas datës së bilancit	93

# Raporti i Audituesit të Pavarur

**Deloitte.**

Deloitte Audit Albania sh.p.k.  
Rr. Elbasanit,  
Pallati poshte Fakulteti Gjeologji-  
Miniera  
Tirana, Albania  
Tel: +355 4 45 17 920  
[www.deloitte.al](http://www.deloitte.al)

VAT (NUIS) No: L41709002H

Drejtuar Aksionarëve dhe Drejtimit të Shoqërisë Raiffeisen INVEST – Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a.

## Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Raiffeisen Prestige sh.a ("Fondi"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2017 dhe pasqyrën e fitim humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve të aktiveve neto që i atribuohen mbajtësve të njësive dhe pasqyrën e mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe nga një përmbledhje e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Fondit më datë 31 dhjetor 2017 si edhe të performancës së saj financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

## Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në paragrafin e emërtuar "Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare" të këtij raporti. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Fondit në përputhje me Kodin e Etikës së Kontabilistëve Profesionistë i vendosur nga Bordi i Kontabilistëve për Standardet Ndërkombëtare të Etikës ("BKSNE") dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si edhe, kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur bazën për opinionin tonë të auditimit.

## Përgjegjësitë e drejtimit dhe palëve të ngarkuara me qeverisjen për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, si edhe për sistemin e kontrollit të brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Fondit për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënime shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Fondit, dhe të përdorë parimin kontabël të vijimësisë, përveç rasteve kur drejtimi ka ose për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveçse sa më lart. Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Fondit.

## Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve

do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Gjithashtu, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, hartojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale, si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësim të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të sistemeve të kontrolleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të përshtatshme me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e sistemeve të kontrolleve të brendshme të Fondit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Fondit për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërpreje të aftësisë së Fondit për vazhduar në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare prezantojnë transaksionet dhe ngjarjet thelbësore në një mënyrë që arrin prezantimin e drejtë.

Ne komunikojmë me palët e ngarkuara me qeverisjen e Fondit, ku përveçse çështjeve të tjera, komunikojmë edhe qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në sistemin e kontrollit të brendshëm që është identifikur gjatë auditimit tonë.

*Deloitte Audit Albania sh.p.k*  
 Deloitte Audit Albania sh.p.k  
 Rr. Elbasanit, Pallati poshte Fakultetit  
 Gjeologji - Miniera,  
 Tirana, Albania  
 Numri i identifikimit i personit të tatueshëm (NUIS):  
 L41709002H

**DELOITTE AUDIT ALBANIA**  
 M.S. Elbasit, P.L. nr.1, K.L. poshte Fakultetit Gjeologji Miniera  
 Tel: 044517920  
 NIPT: L 41709002 H TIRANA - ALBANIA

Enilda Cara  
 Auditues ligjor  
 Partner Angazhimi



Tiranë, Shqipëri  
 3 prill 2018

## Pasqyra e fitim humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në mijë Lek)

Të ardhura	Shënime	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2016
Të ardhura nga interesi	8	2,613,067	2,686,301
Ndryshime të tjera neto në vlerën e drejtë	9	(1,283,202)	288,359
Të ardhura të tjera		78	-
<b>Totali i të ardhurave neto</b>		<b>1,329,943</b>	<b>2,974,660</b>
<b>Shpenzime</b>			
Tarifa e Shoqërisë së Administrimit		(708,566)	(705,393)
<b>Totali i shpenzimeve</b>		<b>(708,566)</b>	<b>(705,393)</b>
<b>Të ardhura të tjera përmbledhëse</b>			
Ndryshimi i vlerës së drejtë të instrumenteve të vlefshme për shitje	12	1,514,936	1,660,507
<b>Rritja në aktivet neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave nga aktiviteti i investimit</b>		<b>2,136,313</b>	<b>3,929,774</b>


Shënimet nga faqja 160 në 182 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

## Pasqyra e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2017


(shumat në mijë Lek)

AKTIVET	Shënime	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Aktive financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes	10	30,025,849	25,303,286
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim	11	-	6,115,236
Aktive financiare të vlefshme për shitje	12	21,033,231	14,942,857
Mjete monetare dhe ekuivalentë të saj	13	6,200,104	5,461,623
<b>TOTALI I AKTIVEVE</b>		<b>57,259,184</b>	<b>51,823,002</b>
<b>DETYRIMET</b>			
Detyrime ndaj Shoqërisë së Administrimit		60,964	55,392
Detyrime për kërkesa tërheqje nga fondit		88,351	52,265
Detyrime të tjera	14	21,628	48,035
<b>TOTALI I DETYRIMEVE</b>		<b>170,943</b>	<b>155,692</b>
<b>AKTIVET NETO QË I ATRIBUOHEN MBAJTËSVE TË KUOTAVE</b>	<b>15</b>	<b>57,088,241</b>	<b>51,667,310</b>
<b>Numri i kuotave të emetuara të Fondit</b>		<b>39,786</b>	<b>37,401</b>
<b>AKTIVET NETO PËR NJËSI</b>		<b>1,435</b>	<b>1,381</b>

Këto pasqyra financiare janë miratuar më 28 mars 2018 në emër të Fondit nga Këshilli i Administrimit të Raiffeisen INVEST – Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a. dhe u firmosën nga:

  
 Administrator i Përgjithshëm  
 Edlira KONINI



  
 Zv. Administratore e Përgjithshme  
 Alketa EMINI

Shënimet nga faqja 71 në 93 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

## Pasqyra e ndryshimeve të aktiveve neto që i atribuohen mbajtësve të njëjësive për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në mijë Lek)

Shënime	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2016
Aktive neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave më 1 janar	<b>51,667,310</b>	<b>56,633,644</b>
Kontribute	14,160,057	9,055,908
Tërheqje për pagesat e përfitimeve të pensionit dhe tërheqje të parakohshme	<b>(10,875,439)</b>	<b>(17,952,017)</b>
<b>Rritja neto nga transaksionet e shitblerjes së kuotave</b>	<b>3,284,618</b>	<b>(8,896,105)</b>
Rritja në aktivet neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave nga aktiviteti i investimit	621,377	2,269,268
Të ardhura të tjera përmbledhëse	1,514,936	1,660,507
<b>Totali i rritjes</b>	<b>2,136,313</b>	<b>3,929,775</b>
<b>Aktive neto (të detyrueshme nga)/ të atribuueshme ndaj mbajtësve të kuotave</b>	<b>14</b>	<b>57,088,241</b>
<b>NUMRI I KUOTAVE TË INVESTIMIT</b>		
Kuota të emetuara mbi bazën e kontributeve	10,063	6,732.53
Kuota të tërhequra/ shlyerje	(7,678)	(13,249.96)
<b>RRITJE NË NUMRIN E KUOTAVE TË FONDIT TË INVESTIMIT</b>	<b>2,385</b>	<b>(6,517)</b>

Shënimet nga faqja 71 në 93 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

## Pasqyra e e mjeteve monetare më 31 dhjetor 2017

(shumat në mijë Lek)

Shënime	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2016
<b>Flukset e mjeteve monetare nga aktiviteti operacional</b>		
<b>Rritja në shumën që i atribuohet kontribuesve</b>	<b>2,136,313</b>	<b>3,929,774</b>
<b>Rregullime për:</b>		
Fitime të perealizuara nga rivlerësimi i aktiveve financiare të mbajtura në vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes	733,723	1,809,428
Të ardhura nga interesi	(2,613,067)	(2,686,301)
Tarifa e Shoqërisë Administruese	708,566	705,393
<b>Flukset e mjeteve monetare të gjeneruara në aktivitetet operacionale</b>	<b>965,535</b>	<b>3,758,294</b>
Rritja në aktivet financiare me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes	(4,932,940)	(2,933,650)
Zvogëlimi në aktivet financiare të mbajtura deri në maturim	6,032,683	14,366,167
Rritja në aktivet financiare të vlefshme për shitje	(6,297,498)	(5,858,733)
Rritja neto / (Zvogëlimi) në detyrimet e tjera	15,251	(27,154)
<b>Flukset e mjeteve monetare nga / (të përdorura) në aktivitetet operacionale</b>	<b>(4,216,969)</b>	<b>5,538,249</b>
Interesi i arkëtuar	2,373,826	2,925,665
Tarifa e paguar e Shoqërisë Administruese	(702,994)	(709,995)
<b>Flukset e mjeteve monetare neto nga / (të përdorura) në aktivitetet operacionale</b>	<b>(2,546,137)</b>	<b>11,512,213</b>
<b>Flukset e mjeteve monetare nga aktivitetet financuese</b>		
Kontribute marrë nga mbajtësit e njëjësive	14,160,057	9,055,909
Kontributet të paguara mbajtësive të njëjësive	(10,875,439)	(17,952,017)
Flukset e mjeteve monetare neto (të përdorura) / nga aktivitetet financuese	3,284,618	(8,896,108)
<b>Rritje neto në e flukset e mjeteve monetare</b>	<b>738,481</b>	<b>2,616,105</b>
Paraja dhe ekuivalentë të saj në fillim të vitit	5,461,623	2,845,519
<b>Paraja dhe ekuivalentë të saj në fund të vitit</b>	<b>6,200,104</b>	<b>5,461,623</b>

Shënimet nga faqja 71 në 93 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

# 1. HYRJE

Fondi i investimit Raiffeisen Prestigj ("Fondi") është një fond investimi me ofertë publike i licensuar nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare ("AMF") bazuar në ligjin nr. 10198, datë 10 dhjetor 2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive" dhe bazuar në vendimin nr. 180, datë 13 dhjetor 2011.

Aktivitetet investuese të fondit manaxhohen nga Raiffeisen INVEST – Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a. ("Shoqëria Administruese").

Objektivi i Fondit është që të maksimizojë kthimin nga investimi, duke synuar në të njëjtën kohë ruajtjen e kapitalit të investitorit dhe sigurimin e likuiditetit të nevojshëm në shërbim të arritjes së objektivit . Ky qëllim synohet të arrihet nëpërmjet një portofoli të përbërë kryesisht nga instrumenta financiarë të emetuar dhe garantuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

Të ardhurat nga investimi në Fond janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat personale dhe lidhen me të ardhurat kapitale të kontribuesve të cilat taten në normën 15%. Shoqëria e Administrimit vepron si një agjent mbledhës në emër të Fondit. Fondi i ofron investimin në kuota një grupi të gjerë investitorësh të cilët janë kryesisht individë.

Mbështetur në Ligjin nr. 10197, datë 10.12.2009, Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare miratoi gjithashtu First Investment Bank Albania sh.a. si bankë depozitare e Fondit të Investimit Raiffeisen Prestigj ("Depozitari"). Shoqëria Administruese dhe Depozitari mbajnë aktivet, veprimet dhe regjistrimet e veta të ndara nga aktivet, veprimet dhe regjistrimet kontabël të Fondit të Investimit Raiffeisen Prestigj.

Këto pasqyra financiare janë autorizuar për publikim nga Bordi i Drejtorëve më 28 mars 2018.

## 2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

Politikat kryesore kontabël të zbatuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë të paraqitura më poshtë. Këto politika janë aplikuar në vazhdimësi në të gjitha vitet e paraqitur, nëse nuk shprehet ndryshe.

### a) Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare të Fondit Raiffeisen Prestigj janë përgatitur mbi një bazë vijimesie dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Pasqyrat financiare janë përgatitur nën parimin e kostos historike, siç modifikohen nga rivlerësimi i aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare me vlerë të drejtë dhe sipas rivlerësimit të aktiveve financiare të mbajtura për shitje dhe instrumentat financiar të vlerësuar me vlerën e drejtë nëpërmjet fitim - humbjes.

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek Shqiptar ("Lek"), nëse nuk është shprehur ndryshe. Nëse nuk është shënuar, informacioni financiar i raportuar në Lek është rrumbullakosur në mijëshen më të afërt.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon përdorimin e vlerësimeve kontabël kritike. Ajo gjithashtu kërkon që Shoqëria Administruese të ushtrojnë gjykimin e saj në procesin e zbatimit të politikave kontabël për Fondin. Ndryshimet në supozime mund të ketë një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare në periudhën që supozimet kanë ndryshuar. Manaxhimi beson se supozimet e aplikuar janë të përshtatshme dhe se për këtë arsye pasqyrat financiare të Fondit paraqesin gjendjen financiare dhe rezultatet në mënyrë të drejtë. Zonat që përfshijnë një shkallë më të lartë të gjykimit ose kompleksitetit, apo fushat ku supozimet dhe vlerësimet janë të rëndësishme për pasqyrat financiare janë shpalosur në Shënimin 7.

### b) Zbatimi i Standarde dhe Interpretime të reja dhe atyre në fuqi për periudhën raportuese

Ndryshimet e mëposhtme të standardeve ekzistuese të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe interpretimet e publikuara nga Komiteti i Interpretimeve të Raportimeve Financiare Ndërkombëtare janë në fuqi për periudhën raportuese:

**Ndryshimet e mëposhtme në standardet ekzistuese dhe interpretimi i ri i lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK), janë në fuqi për periudhën raportuese:**

- **Ndryshime në SNK 7 " Pasqyra e Levizjes së Parasë"-** Iniciativa e informacioneve shpjeguese (efektive për periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 Janar 2017),

## 2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### b) Zbatimi i Standarde dhe Interpretime të reja dhe atyre në fuqi për periudhën raportuese

- **Ndryshime në SNK 12 “Tatimi mbi të Ardhurat”** – Njohja e aktiveve tatimore të shtyra për humbjet e parealizuar ( efektive për periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 Janar 2017),
- **Ndryshime në SNRF 12 si pasojë e “Përmirësimeve të SNRF-ve ( cikli 2014-2016)” rezultuar nga projekti i përmirësimit vjetor të SNRF ( SNRF 1, SNRF 2, dhe SNK 28)** kryesisht me një pikëpamje për të eliminuar mospërputhjet dhe për të qartësuar formulimin (ndryshimet mbi SNRF 12 do të jenë të aplikueshme për periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 Janar 2017).

Këto ndryshime në standardet dhe interpretimet ekzistuese nuk kanë ndikuar në politikat kontabël, pozicionin financiar dhe performancën e Fondit.

### c) Standarde dhe Interpretime të reja dhe ndryshime në standardet e publikuara por jo në fuqi për periudhën raportuese

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet, përmirësimet në standardet në fuqi dhe interpretimet e mëposhtme ishin publikuar por akoma nuk ishin në fuqi:

- **SNRF 9 “Instrumentat Financiare”** (efektive për raportime vjetore duke filluar nga 1 Janari 2018)

Fondi parashikon se zbatimi i SNRF 9 në të ardhmen mund të ketë një ndikim në shumën e njohura në aktivet dhe detyrimet financiare të Fondit. Pritet që SNRF 9 të rrisë nivelin e përgjithshëm të provigjoneve për aktivet dhe detyrimet. Parashikimi është i bazuar në një kërkesë për të njohur provigjonet në shumën e parashikuar të kredive të pashlyera.

Fondi do të aplikojë SNRF 9 në 1 Janar 2018, sipas versionit të publikuar në Korrik 2014 dhe do të përshtasë ndryshimet e SNRF 9 në të njëjtën datë. Si rrjedhojë nuk pritet ndonjë diferencë në zhvlerësimin e provigjoneve të krijuara sipas SNK 39 mbi humbjet e mbartura dhe provigjonet e krijuara sipas SNK 9 mbi humbjet nga kreditimi.

Më 27 dhjetor 2017, Parlamenti Europian publikoi rregulloren (EU) 2017/2395 mbi kërkesat në tranzicion drejt SNRF 9. Rregullorja mundëson zgjedhjen midis dy metodave të ndryshme përsa i përket njohjes së efektit të implementimit të standartit në kapitalin rregullator:

1. Njohja e efektit të plotë në mënyrë lineare, e shpërndarë në një periudhë 5 vjetore, ose
2. Njohja e impaktit të plotë në ditën e përshtatjes.

Fondi ka vendosur të aplikojë metodën e dytë.

#### Klasifikimi dhe Matja e Përgjithshme

SNRF 9 përmban një përfaqëse të re për klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare, që reflekton modelin e biznesit sipas të cilit menaxhohen aktivet dhe karakteristikat e fluksit të parasë së tyre.

Fondi do të aplikojë katër kategori për klasifikimin e Aktiveve Financiare:

- Aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar (KA)
- Aktivet financiare të matura me vlerë së drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDNATGJ)
- Aktivet Financiare të detyrueshme për tu matur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim-humbjes (VDNFH) dhe
- Aktive Financiare të matura me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim-humbjes (VDNFH)

Kategoritë ekzistuese të SNK 39 si: të mbajtura deri në maturim, kredi dhe llogari të arkëtueshme, të vlefshme për shitje do të eliminohen.

Aktivitet Financiare do të maten me koston e amortizuar nëse plotësohen të dy kushtet e mëposhtme:

- Aktivit mbahet sipas një modeli biznesi, objektivi i të cilit është të mbajë aktive financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale
- Kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar shprehin qartë termat kohorë të flukseve monetare, të cilat janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit mbi principalin e mbetur.

Objektivi i një modeli biznesi mund të jetë mbajtja e aktiveve financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale, edhe në rastin kur shitje të aktiveve financiare kanë ndodhur ose priten që të ndodhin.

Një aktiv financiar klasifikohet si i matur me VDNATGJ nëse ai mbahet nëpërmjet një modeli biznesi, objektivi i të cilit është të mbledhë flukse monetare kontraktuale dhe të shesë aktive financiare, kur kushtet kontraktuale të aktiveve



## 2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### c) Standarde dhe Interpretime të reja dhe ndryshime në standardet e publikuara por jo në fuqi për periudhën raportuese (vazhdim)

financiare specifikojnë datat e caktuara të flukseve monetare, të cilat janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit mbi principalin e mbetur.

Për njohjen fillestare të një instrumenti kapitali neto që nuk mbahet për shitje, Fondi mund të zgjedhë të paraqesë në mënyrë të pakthyeshme ndryshimet e mëvonshme në vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. Kjo përzgjedhje bëhet për çdo investim individualisht dhe mbulon interesa strategjike që nuk paraqiten plotësisht në mënyrë të konsoliduar. Të gjithë aktivet e tjerë financiarë, që nuk plotësojnë kriteret për tu klasifikuar si të matura me koston e amortizuar ose VDNATP, klasifikohen si të matura me vlerën e drejtë, ndryshimet e të cilës njohen në fitim-humbje. Si rrjedhojë, Fondi ka mundësinë që në njohjen fillestare të përcaktojë në mënyrë të pakthyeshme një aktiv financiar, matja e të cilit bëhet me VDNFH, nëse të vepruarit në këtë mënyrë eliminon ose redukton ndjeshëm një mospërputhje matjeje ose njohjeje, për shembull një mospërputhje kontabël që do të lindte nga matja e aktiveve ose detyrimeve, ose njohja e fitimeve dhe humbjeve në to, në baza të ndryshme. Një aktiv financiar klasifikohet në një nga këto kategori në njohjen e tij fillestare.

#### Analizë e Karakteristikave të Flukseve Monetare Kontraktuale

Pasi Fondi përcakton se modeli i biznesit të një portofoli specifik është mbajtja e aktiveve financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale (ose njëkohësisht mbledhja e flukseve monetare kontraktuale dhe shitja e aktiveve financiare), duhet të vlerësojë nëse kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar specifikojnë datat e caktuara të flukseve monetare, të cilat janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit mbi principalin e mbetur. Për këtë qëllim, interesi përcakton vlerën në kohë të parasë, rrezikun e kredisë që lidhet me shumën e principalit të papaguar gjatë një periudhe të caktuar kohore. Rreziqe dhe kosto të tjera themelore të huadhënies, si dhe një marzhin e fitimit. Ky vlerësim do të kryhet për çdo instrument në datën e njohjes fillestare të aktivitetit financiar.

Kur vlerëson nëse flukset monetare kontraktuale janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit, Fondi do të marrë parasysh kushtet kontraktuale të instrumentit. Kjo do të përfshijë vlerësimin nëse aktiviteti financiar përmban një kusht kontraktual që mund të ndryshojë kohën ose shumën e flukseve të mjeteve monetare kontraktuale në mënyrë që të mos plotësojë këtë kusht. Fondi do të marrë në konsideratë:

- Parapagimin, kushtet e zgjatjes së kontratës
- Veçoritë e levës financiare
- Nëse një kusht i kontratës është i limituar në aktive ose flukse monetare specifike
- Instrumentet e lidhura me kontratë

Në vitin 2018, BSNK publikoi një amendament për SNRF 9 në lidhje me tiparet e parapagimit me kompensim negativ. Kompensimi negativ lind kur kushtet kontraktuale lejojnë huamarrësin të parapaguajë instrumentin para maturimit kontraktual, por shuma e parapagimit mund të jetë më e vogël se shumata e paguara të principalit dhe interesit. Megjithatë, për t'u kualifikuar për matjen me anë të Kostos së Amortizuar, kompensimi negativ duhet të jetë kompensim i arsyeshëm për përfundimin e parakohshëm të kontratës. Fondi nuk pret një volum të lartë të parapagimeve me kompensim negativ, i cili duhet të matet detyrimit me VDNFH.

#### Modifikimi i vlerës kohore të parasë dhe testit të vlerësimit

Vlera në kohë e parasë është elementi i interesit që merr në konsideratë kalimin e kohës (SNRF 9. B4. 1.9A). Nuk merr parasysh rreziqet e tjera (kredisë, likuiditetit etj) ose kostot (administrative, etj.) të lidhura me mbajtjen e një aktiviteti financiar.

Në disa raste, elementi i vlerës në kohë të parasë mund të mos jetë plotësisht i saktë. Një rast i tillë ndodh kur norma e interesit e një aktiviteti financiar rivendoset periodikisht, por frekuenca e kësaj rivendosjeje nuk përputhet me maturitetin e normës së interesit. Në këtë rast njësitë duhet të vlerësojnë modifikimin, në mënyrë që të përcaktojnë nëse flukset monetare kontraktuale përfaqësojnë akoma pagesa vetëm të interesit dhe principalit, që do të thotë maturiteti i rivendosjes nuk ndryshon ndjeshëm flukset e mjeteve monetare nga një instrument standard i përsosur.

#### Vlerësimi i ndikimit në klasifikim dhe matje

SNRF 9 do të ndikojë në klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare të mbajtura të Fondit më 1 janar 2018 si më poshtë:

Kreditë dhe paradhëniet për Fondin dhe klientët, të klasifikuar si hua dhe llogari të arkëtueshme të matura me koston e amortizuar sipas SNK 39, do të maten me koston e amortizuar në përputhje me SNRF 9.

Aktivitetet financiare të mbajtura deri në maturim, të matura me koston e amortizuar sipas SNK 39, si rregull gjithashtu do të maten me koston e amortizuar në përputhje me SNRF 9.

Instrumentet e borxhit të vlefshëm për shitje, të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet kapitalit sipas SNK 39, si rregull

## 2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### c) Standarde dhe Interpretime të reja dhe ndryshime në standardet e publikuara por jo në fuqi për periudhën raportuese (vazhdim)

gjithashtu do të maten në VDNATGJ në përputhje me SNRF 9.

#### Kontabiliteti mbrojtës

SNRF 9 lejon opsionet e kontabilitetit mbrojtës. Fondi planifikon të vazhdojë të zbatojë dispozitat për kontabilitetin mbrojtës në përputhje me SNK 39, duke marrë parasysh ndryshimet të paraqitura në shënimet shpjeguese sipas SNRF 7.

#### Zhvlerësimi i përgjithshëm

Llogaritja e humbjeve të pritura të kredisë kërkon përdorimin e parashikimeve kontabël të cilat, sipas përkufizimit, rrallëherë do të jenë të barabarta me rezultatet aktuale. Drejtimi ushtron gjykim në zbatimin e politikave kontabël të Grupit.

Fondi vlerëson në bazë të parashikimit humbjet e pritura të kredisë të lidhura me aktivet e saj të borxhit të mbartura me koston e amortizuar dhe VDNATGJ, dhe me ekspozimin që rrjedh nga angazhimet e huasë, kontratat e qirasë dhe kontratat e garancisë financiare. Fondi njih provigjon për humbje të tilla në çdo datë raportimi.

#### Matja e humbjeve të pritshme të kredisë

Matja e humbjeve të pritura të kredisë pasqyron një vlerë të paanshme dhe me probabilitet të ponderuar që përcaktohet duke vlerësuar një sërë re zultatesh të mundshme, vlerën në kohë të parasë dhe informacionin e arsyeshëm dhe të mbështetur që është në dispozicion pa kosto ose përpjekje të panevojshme në datën e raportimit për ngjarjet e kaluara, aktuale dhe parashikimet e kushteve të ardhshme ekonomike.

Matja e lejesës për humbjet e pritshme të kredisë për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar dhe vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, është një zonë që kërkon përdorimin e modeleve komplekse dhe supozimeve të rëndësishme në lidhje me kushtet e ardhshme ekonomike dhe sjelljen e kredisë. Vlerësime të rëndësishme:

- Përcaktimi i kritereve për rritje të ndjeshme të rrezikut të kredisë
- Zgjedhja e modeleve dhe supozimeve të përshtatshme për matjen e humbjeve të pritura të kredisë
- Vendosja e numrit dhe peshave relative të skenarëve të ardhshëm për secilin lloj produkti/tregu dhe humbjet e pritura të kredisë të lidhura
- Krijimi i grupeve të aktiveve financiare të ngjashme me qëllim matjen e humbjeve të pritshme të kredisë.

Vlerësimi i ekspozimit të kredisë për qëllime të menaxhimit të rrezikut është kompleks dhe kërkon përdorimin e modeleve. Vlerësimi i rrezikut të kredisë për një portofol të aktiveve përfshin vlerësime të mëtejshme në lidhje me mundësitë e mosshlyerjeve të ndodhura, të raporteve të lidhura me humbjen dhe korrelacioneve të mosshlyerjeve ndërmjet palëve. Fondi mat rrezikun e kredisë duke përdorur probabilitetin e mosshlyerjes së kredive, ekspozimin në mosshlyerje të kredisë dhe humbjet nga mosshlyerja. Kjo është një metodë mbizotëruese e përdorur për qëllimet e matjes së humbjeve të pritshme të kredisë sipas SNRF 9.

SNRF 9 përshkruan një model me tre hapa për zhvlerësimin bazuar në ndryshimet në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare. Ky model kërkon që një instrument financiar, i cili nuk është i zhvlerësuar nga kreditë në njohjen fillestare, klasifikohet në Fazën 1 dhe rreziku i tij i kreditit monitorohet vazhdimisht. Nëse është identifikuar një rritje e ndjeshme e rrezikut të kredisë që nga njohja fillestare, instrumenti financiar kalon në Fazën 2, por nuk konsiderohet të jetë i zhvlerësuar nga kredia. Nëse instrumenti financiar është i zhvlerësuar nga kreditimi, instrumenti financiar më pas zhvendoset në Fazën 3.

Për instrumentet financiare në Fazën 1, humbja e pritshme e kredisë matet me një shumë të barabartë me pjesën e humbjeve të pritshme të kredisë që rezultojnë nga ngjarjet e mundshme gjatë 12 muajve të ardhshëm. Instrumentet në Fazat 2 ose 3 kanë humbjet e pritshme të kredive të matura në bazë të humbjeve të pritura të kredisë gjatë gjithë jetëgjatësisë. Sipas SNRF 9, kur matet humbja e pritshme e kredisë është e nevojshme të merret në konsideratë informacioni për të ardhmen. Aktivet financiare të blera ose me origjinë nga kreditë e zhvlerësuar janë aktive financiare të cilat janë të zhvlerësuar nga kredia në njohjen fillestare. Humbja e pritshme e kreditit matet në vazhdimësi të jetës (Faza 3).

#### Rritja e ndjeshme e rrezikut të kredisë

Fondi konsideron që një instrument financiar ka përjetuar një rritje të ndjeshme të rrezikut të kredisë kur një ose më shumë nga kriteret e mëposhtme sasiore, cilësore ose ndaluese të mëposhtme janë plotësuar:

## 2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### c) Standarde dhe Interpretime të reja dhe ndryshime në standardet e publikuara por jo në fuqi për periudhën raportuese (vazhdim)

#### **Kriteret sasiore**

Fondi përdor kriteret sasiore si tregues parësor të rritjes së konsiderueshme të rrezikut të kredisë për të gjitha portofolet materiale.

Për vlerësimin sasiore, Fondi krahason kurbën e probabilitetit të mospagimit për të gjithë jetëgjatësinë me të dhënat e matura, me kurbën e ardhshme të probabilitetit të mos pagimit në datën e njohjes fillestare. Për vlerësimin e kurbës së probabilitetit të mospagimit për të gjithë jetëgjatësinë në datën e njohjes fillestare, bëhen supozime rreth strukturës së saj. Për instrumentet financiare me vlerësim të lartë, supozohet se kurba do të përkeqësohet me kalimin e kohës. Për instrumentet financiare me vlerësim të ulët, supozohet se kurba do të përmirësohet me kalimin e kohës. Shkalla e përmirësimit ose përkeqësimit do të varet nga niveli i vlerësimit fillestar.

Fondi nuk është në dijeni të ndonjë praktike tregu të pranuar përgjithësisht, e cila specifikon një nivel për të cilin një instrument financiar duhet të transferohet në Fazën 2. Nga kjo perspektivë, pritet që rritja e probabilitetit të mospagimit në datën e raportimit, e cila konsiderohet e rëndësishme, do të zhvillohet gjatë një periudhe kohore si rezultat i një procesi përsëritës ndërmjet pjesëmarrësve të tregut dhe mbikëqyrësve.

#### **Kriteret cilësore**

Fondi përdor kriteret cilësore si një tregues dytësor për rritje të rëndësishme të rrezikut të kredisë për të gjitha portofolet materiale. Transferimi në Fazën 2 zhvillohet kur plotësohen kriteret e mëposhtme.

Për portofolet qeveritare, të bankave, të korporatave dhe të financave të projektit, nëse huamarrësi plotëson një ose më shumë nga kriteret e mëposhtme:

- Treguesit e jashtëm të tregut
- Ndryshime në kushtet e kontratës
- Ndryshime në qasjen e drejtimit
- Gjykimi i ekspertëve

Vlerësimi i një rritjeje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë përfshin informacione të ardhshme dhe kryhet në baza tremujore në një nivel marrëveshjeje për të gjithë portofolet jo të tregtueshme të mbajtura nga Fondi.

Për portofolet e tregëtueshme, nëse huamarrësi plotëson një ose më shumë nga kriteret e mëposhtme:

- Lëshime përsa i përket marrëveshjes së kredisë, kur huamarrësi po kalon vështirësi
- Gjykimi i ekspertëve

Vlerësimi i një rritjeje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë përfshin informacion për të ardhmen dhe kryhet në baza mujore në një nivel marrëveshjeje për të gjitha portofolet retail të mbajtura nga Fondi.

#### **Ndalesa**

Nëse një huamarrës vonohet më shumë se 30 ditë për pagesat e tij kontraktuale, instrumenti financiar mendohet të ketë patur një rritje të ndjeshme në rrezikun e kredisë dhe në këtë rast, aplikohet një ndalesë. Në disa raste të kufizuara, supozimi se aktivet financiare të cilat janë me më shumë se 30 dite vonesa duhet të kalojnë në Fazën 2, hidhet poshtë.

Fondi nuk ka përdorur përjashtimin që vjen nga rreziku i ulët i kredisë për klientët huamarrës; megjithatë, përdor në mënyrë selektive përjashtimin që vjen nga rreziku i ulët i kredisë për instrumentat e borxhit.

#### **Përcaktimi i mospagimit dhe aktiveve të zhvlerësuara nga kreditimi**

Fondi përcakton që një instrument financiar është në mospagim, i cili është plotësisht i linjësuar me përkufizimin e zhvlerësimit nga kreditimi, kur plotëson një ose më shumë nga kriteret e mëposhtme:

- Huamarrësi është më shumë se 90 ditë me vonese për pagesat e tij kontraktuale;
- Nuk është bërë asnjë përpjekje për të hedhur poshtë supozimin se aktivet financiare të cilat janë më shumë se 90 ditë me vonese duhet të jenë në Fazën 3.

Huamarrësi ka gjasa për të mos paguar, që tregon se është në vështirësi të konsiderueshme financiare. Këto janë raste kur:

- Huamarrësit i janë mundësuar lëshime për një afat të gjatë për shkak të vështirësive që është duke kaluar ose

## 2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### c) Standarde dhe Interpretime të reja dhe ndryshime në standardet e publikuara por jo në fuqi për periudhën raportuese (vazhdim)

mund të kalojë

- Huamarrësi është i vdekur
- Huamarrësi është i paftë të paguajë
- Huamarrësi është në kundërshtim me kushtet financiare të kontratës
- Nuk ka një treg aktiv për aktivin financiar për shkak të vështirësive financiare
- Është e mundshme që huamarrësi të hyjë në falimentim
- Aktivet financiare janë blerë ose origjinojnë me një zbritje të madhe nga çmimi, që pasqyron humbjet e shkaktuara te kredisë.

Kriteret e mësipërme janë zbatuar mbi të gjitha instrumentet financiare të mbajtura nga Fondi dhe janë në përputhje me përkufizimin e mospagimit të përdorur për qëllime të menaxhimit të brëndshëm të rrezikut të kredisë.

#### Shpjegimi i të dhënave, supozimeve dhe teknikave të vlerësimit

Humbja e pritshme e kredisë matet në bazë të një periudhe 12-mujore ose jetëgjatësisë, në varësi të faktit nëse ka ndodhur një rritje e konsiderueshme në rrezikun e kredisë që nga njohja fillestare ose nëse një aktiv konsiderohet si i dëmtuar nga kredia.

Informacioni ekonomik për të ardhmen gjithashtu përfshihet në përcaktimin e probabilitetit të mospagimit 12-mujor dhe të probabilitetit të mospagimit për të gjithë jetëgjatësinë e aktivitetit, ekspozimit në mospagim dhe humbja nga mospagimi. Këto supozime ndryshojnë sipas llojit të produktit. Humbjet e pritshme të kredisë janë prodhimi i probabilitetit të mospagimit, humbjes nga mospagimi, ekspozimit në mospagim dhe faktorit skontues (FS).

#### Probabiliteti i mosshlyerjes

Probabiliteti i mosshlyerjes paraqet mundësinë që një huamarrës nuk përmbush detyrimet financiare gjatë 12 muajve të ardhshëm ose gjatë jetës së mbetur të detyrimit. Si rregull, probabiliteti i mosshlyerjes është llogaritur duke përdorur probabilitetin rregullator 12 mujor të mosshlyerjes, pa asnjë marzh konservatizmi. Më pas përdoren metoda të ndryshme statistikore për të gjeneruar një vlerësim se si do të llogaritet profili i mosshlyerjes nga momenti i njohjes fillestare e përgjatë gjithë jetës së kredisë ose portofolit të huave.

Në rastet e kufizuara kur disa të dhëna nuk janë në dispozicion, për llogaritjen përdoret grupimi, mesatarja ose krahasimi i të dhënave.

#### Humbja nga mosshlyerja

Humbja nga mosshlyerja, paraqet pritshmërinë që ka Fondi për shkallën e humbjes lidhur me ekspozim që nuk është paguar në kohë. Kjo humbje varion sipas produktit apo palës së tretë nga e cila rrjedh. Humbja nga mospagimi shprehet si përqindje për njësi ekspozimi në kohën e mospagimit. Ajo llogaritet në bazë 12 mujore ose për të gjithë jetëgjatësinë, ku humbja nga mospagimi 12-mujor është përqindja e humbjes që pritet të pësohet nëse ndodh mospagimi në 12 muajt e ardhshëm dhe humbja nga mospagimi gjatë jetës është përqindja e humbjes që pritet të pësohet nëse mospagimi ndodh gjatë jetës së mbetur.

#### Ekspozimi i mosshlyerjes

Ekspozimi në mospagim bazohet në shumën që Fondi pret që klientët t'i kenë borxh në kohën e mospagimit, gjatë 12 muajve të ardhshëm ose gjatë jetës së mbetur. Ekspozimi në Mospagim 12-mujor dhe gjatë jetëgjatësisë përcaktohen në bazë të profilit të pagesës së pritshme, e cila ndryshon sipas llojit të produktit. Për produktet e amortizueshme dhe huatë që mundësojnë shlyerjen e njëhershme të principalit në maturim (bullet), llogaritja e ekspozimit në mospagim është bazuar në shlyerjet kontraktuale të huamarrësit gjatë një periudhe 12 mujore ose për të gjithë jetëgjatësinë. Ajo ku është e përshtatshme, në llogaritje merren parasysh supozimet e ripagimit/rifinancimit të parakohshëm.

Për produktet rrotulluese (revolving), ekspozimi në mospagim llogaritet duke i shtuar shumës së tërhequr një faktor konvertimi të kedisë, i cili lejon tërheqjen e pritshme të kufirit të mbetur deri në kohën e mospagimit. Marzhet rregullatorë të kujdesshme hiqen nga faktori i konvertimit të kredisë. Në rastet e kufizuara kur disa të dhëna nuk janë plotësisht të disponueshme, për llogaritjen përdoret krahasimi i inputeve.

## 2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### c) Standarde dhe Interpretime të reja dhe ndryshime në standardet e publikuara por jo në fuqi për periudhën raportuese (vazhdim)

#### Faktori aktualizues

Si rregull, për ekspozime në pasqyrën e pozicionit financiar që nuk janë qira financiare ose instrumenta të blerë ose të origjinuar nga zhvlerësimi i kredisë, norma skontuese e përdorur në llogaritjen e humbjes së pritshme të kredisë është norma efektive e interesit ose një përafrim i saj.

Humbja e pritshme e kredisë është një produkt i Probabilitetit të Mosshlyerjes, Humbja nga Mosshlyerja dhe Ekspozimi i Mosshlyerjes, shumëzuar me probabilitetin e mungesës së mospagimit (probabilitetin e pagimit) të një periudhe më para periudhës kohore të konsideruar. Kjo e fundit shprehet nga funksioni i mbijetesës S. Kjo llogarit vlerat e ardhshme të humbjeve të pritura të kredisë, të cilat pastaj skontohen në datën e raportimit dhe më pas mbliidhen. Vlerat e llogaritura të humbjeve të pritshme të kredisë peshohen me një skenar të ardhshëm.

Modele të ndryshme janë përdorur për të vlerësuar dispozitat e Fazës 3 të shumave të papaguara të kredisë dhe këto mund të grupohen në kategoritë e mëposhtme:

- Qeveritë, klientët korporata, financimet e projektit, institucionet financiare, qeveritë lokale dhe rajonale, kompanitë e sigurimeve dhe ndërmarrjet e investimeve kolektive - Provigjonet e Fazës 3 llogariten nga menaxherët e ristrukturimit që skontojnë flukset e pritshme të parasë sipas normës së përshtatshme efektive të interesit.
- Kredi me hipotekë për individë – Provigjonet e Fazës 3 krijohen duke llogaritur vlerën e zbritur të realizimit të kolateralit.
- Kreditë e tjera të shitjes me pakicë - Provigjonet e Fazës 3 gjenerohen duke llogaritur vlerësimin më të mirë statistikor të humbjes së pritshme, duke marrë parasysh kostot indirekte.

Nuk është bërë asnjë përpjekje për të hedhur poshtë supozimin se aktivet financiare që janë me më shumë se 90 ditë vonesë duhet të jenë në Fazën 3.

#### Informacion për të ardhmen

Vlerësimi i një rritjeje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë dhe llogaritja e humbjeve të pritura të kredisë përfshijnë informacion që sheh nga e ardhmja. Fondi ka kryer analiza historike dhe ka identifikuar variabla kryesorë ekonomike që ndikojnë në rrezikun e kredisë dhe humbjet e pritshme të kredisë për çdo portofol.

Gjykim i ekspertëve zbatohet në këtë proces. Parashikimet e variablave ekonomike (skenari ekonomik bazë) sigurohen nga Raiffeisen Research në baza tremujore dhe japin parashikimin më të mirë për ekonominë gjatë tre viteve të ardhshme. Pas tre vjetësh, për të projektuar variablat ekonomike për jetëgjatësinë e plotë të secilit instrument, përdoret një metodë e kthimit në mesatare, që do të thotë se variablat ekonomike kanë tendencë ose të jenë një normë mesatare afatgjatë ose të kenë një normë mesatare të rritjes afatgjatë deri në maturim. Ndikimi i variablave ekonomike mbi probabilitetin e mospagimit, humbja në mospagim dhe ekspozimi në mospagim përcaktohet duke përdorur regresionin statistikor për të kuptuar ndikimin që ndryshimet në këto variabla kanë pasur historikisht në normat e mospagimit dhe mbi përbërësit e humbjes në mospagim dhe ekspozimit në mospagim.

Përveç skenarit ekonomik bazë, Raiffeisen Research gjithashtu ofron një skenar me rastin më të mirë dhe një skenar me rastin më të keq, të ponderuara për të siguruar kapërcimin e jo-linearitetit. Fondi ka arritur në konkluzionin se tre skenare ose më pak kapin në mënyrë të përshtatshme jo-linearitetin. Peshat e skenarit përcaktohen nga një kombinim i analizës statistikore dhe gjykit të ekspertizës së kredisë, duke marrë parasysh gamën e rezultateve të mundshme që secili skenar i zgjedhur përfaqëson.

Fondi konsideron që këto parashikime përfaqësojnë vlerësimin më të mirë të rezultateve të mundshme dhe mbulojnë çdo jo-linearitet dhe asimetri të mundshme në portofolet e ndryshme të Fondit.

#### Analiza e ndjeshmërisë

Supozimet më të rëndësishme që ndikojnë në lejesën e humbjes së pritshme së kredisë janë si më poshtë:

Portofolet e korporatave

- Prodhimi i Brendshëm Bruto
- Shkalla e papunësisë
- Norma afatgjatë e obligacioneve qeveritare
- Norma e inflacionit

Portofole e tregtueshme

- Prodhimi i Brendshëm Bruto

## 2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### c) Standarde dhe Interpretime të reja dhe ndryshime në standardet e publikuara por jo në fuqi për periudhën raportuese (vazhdim)

- Shkalla e papunësisë
- Çmimet e pasurive të paluajtshme

#### Tranzicioni

Ndryshimet në politikat kontabël që rrjedhin nga miratimi i SNRF 9 në përgjithësi do të zbatohen në mënyrë retrospektive, përveç siç përshkruhet më poshtë:

- Fondi do të përfitojë nga përjashtimi duke e lejuar atë të mos rishikojë informacionin krahasues për periudhat e mëparshme në lidhje me ndryshimet në klasifikimin dhe matjen (duke përfshirë zhvlerësim). Diferencat në vlerën kontabël të aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare që rezultojnë nga zbatimi i SNRF 9 njihen në fitimet e pashpërndara që nga 1 janari 2018.
  - Vlerësimet e mëposhtme duhet të bëhen në bazë të fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë në datën e aplikimit fillestar:
  - Përcaktimi i modelit të biznesit në të cilin mbahet një aktiv financiar.
  - Emërtimi dhe revokimi i emërtimeve të mëparshme të aktiveve dhe detyrimeve të caktuara financiare të matura në VDNFH
  - Caktimi i disa investimeve strategjike që nuk mbahen për tregtim si në VDNATGJ.
- **SNRF 15 "Të ardhura nga Kontratat me Klientët"** dhe ndryshime të mëtejshme (efektive duke filluar 1 Janar 2018 e në vazhdim),
  - **SNRF 16 "Qiratë"** (efektive duke filluar 1 Janar 2019 e në vazhdim),
  - **SNRF 17 "Kontratat e Sigurimi"** (efektive duke filluar nga 1 Janar 2021 e në vazhdim)
  - **Ndryshime në SNRF 2 "Pagesat e bazuara në aksione"** - Klasifikimi dhe Matja e transaksioneve të pagesave të bazuara në aksione (efektive duke filluar nga 1 Janar 2018 e në vazhdim)
  - **Ndryshime në SNRF 4 "Kontratat e Sigurimit"** - konsistojnë në aplikimin e SNRF 9 "Instrumentat Financiarë" me SNRF 4 "Kontratat e Sigurimit" (efektive duke filluar nga 1 Janar 2018 e në vazhdim ose në momentin që SNRF 9 "Instrumentat Financiarë" vihet në zbatim për herë të parë.
  - **Ndryshime në SNRF 10 "Pasqyrat financiare të konsoliduara" dhe SNK 28 "Investime në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta"**- Shitja apo kontributi i pasurive ndërmjet një investitori dhe bashkëpunatori të tij ose sipërmarrje të përbashkët (data efektive e hyrjes nw fuqi shtyhet për një afat të pacaktuar deri nw pwrmbushjen projektit të kërkimit bazuar nw metodat e kapitalit ),
  - **Ndryshimet në SNK 28 "Investime në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta "** – Interesa afat-gjatë në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janar 2019),
  - **Ndryshimet në Aktivet Afatgjatë Materiale të Investuara** – transferimet e aktiveve afatgjatë materiale të investuara (efektive duke filluar nga 1 Janar 2018)
  - **Ndryshimet në SNRF 1 dhe SNK 28 për shkak të ndryshimeve në disa standarde "Përmirësimet e SNRF-ve (2014 -2016)"** që rezultojnë nga projekti i përmirësimit vjetor të SNRF-ve (SNRF 1, SNRF 12, SNK 28) kryesisht me qëllim heqjen e mospërputhjeve dhe sqarimin e fjalëve (ndryshimet për SNRF 1 dhe ndryshimet për SNK 28 duhet të aplikohen për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 Janar 2018).
  - **Ndryshime në disa standarde "Përmirësimet e SNRF-ve (2015 -2017)"** që rezultojnë nga projekti i përmirësimit vjetor të SNRF-ve (SNRF 3, SNRF 11, SNK 12 SNK 23) kryesisht me qëllim heqjen e mospërputhjeve dhe sqarimin e fjalëve (duhet të aplikohen për periudhat për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 Janar 2019).
  - **IFRIC 22 "Transaksionet në monedhë të huaj dhe shqyrtimi i parapagesave"** (efektive për vjetore periudhat që fillojnë më ose pas datës 1 Janar 2018)
  - **IFRIC 23 Pasiguritë mbi trajtimin e tatimit mbi fitimin** ( duhet të aplikohet për periudhat që fillojnë më apo pas datës 1 Janar 2019)

Fondi ka zgjedhur të mos adoptojë këto standarde, rishqyrtime dhe interpretime përpara datës së tyre efektive. Drejtimi parashikon se adoptimi i këtyre standardeve nuk do të ketë impakt material në pasqyrat financiare të Fondit në periudhën fillestare të zbatimit nga Fondi.

## 2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### d) Entiteti i investimit dhe konsolidimi

Fondi ka investitorë të shumtë jo të lidhur dhe mban investimeve të shumta. Fondi është caktuar që të plotësojë përkufizimin e një entiteti investimesh sipas SNRF 10, ndërsa kushtet e mëposhtme ekzistojnë:

1. Fondi mbledh aktivet me qëllim që t'ju sigurojë investitorëve shërbime profesionale të menaxhimit të investimeve.
2. Qëllimi i biznesit të Fondit, i cili u është komunikuar direkt investitoreve, është të investojë aktivet e tyre me qëllim përfitimin e të ardhurave nga kapitali dhe të ardhurave nga investimet.
3. Investimet janë të matura dhe vlerësuara mbi bazën e vlerës së drejtë.

### e) Aktivet dhe detyrimet financiare

#### i Njohja

Aktivët financiarë njihen në pasqyrën e pozicionit financiar në ditën kur entiteti behet pale kontraktuale në lidhje me një instrument në perputhje me blerjen e rregullt të tij. Një menyre e rregullt blerjeje ose shitjeje e një instrumenti financiar njihet si datë kontabilizimi të aktivitetit, datën e shlyerjes. Dita e shlyerjes është dita kur aktivi i livrohët entitetit. Dita e shlyerjes i referohët a) njohjes së aktivitetit në ditën kur ai merret nga entiteti b) c'regjistrimit të aktivitetit dhe njohjes së fitimit/humbjes neto nga shitja në ditën kur ai livrohët/dergohët nga entiteti. Kur aplikohët dita e shlyerjes, entiteti kontabilizon çdo ndryshim në vlerën e drejtë të aktivitetit gjatë periudhës midis datës së tregtimit dhe datës së shlyerjes. Me fjalë të tjera, ndryshimi në vlerë nuk njihët për aktivet të mbajtura me kosto ose kosto të amortizuara; njihët si fitim ose humbje për aktivet e klasifikuar si aktive financiare të njohura me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes; njihët në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse për aktivet e vlefshme për shitje.

Detyrimet njihen fillimisht në datën kur entiteti bëhët palë e kontratës.

#### ii Ç'regjistrimi

Fondi c'regjistron një aktiv financiar kur mbarojnë të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga aktivi financiar, ose kur të drejtat për të arkëtuar flukse monetare kontraktuale të aktivitetit financiar janë transferuar në një transaksion me të cilin transferohen kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktiv financiar. Fondi nuk njihët një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale janë përmblushur, ndërprerë apo kanë përfunduar.

Fondi merr pjesë në transaksione me anë të të cilave transferon aktive të njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por mban në të gjitha ose kryesisht në të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivitetit të transferuar, ose një pjesë të tyre. Nëse të gjitha ose kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet mbahen, atëherë aktivet e transferuara nuk çregjistrohen nga pasqyra e pozicionit financiar.

Në transaksionet në të cilat Fondi as nuk mban dhe as nuk transferon rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivet financiare, aktivi c'regjistrohët nëse kontrolli mbi to humbët.

#### iii Matja e vlerës së drejtë

Pas njohjes fillestare të gjitha aktivet financiare (përveç atyre të mbajtura deri në maturitet) maten me vlerën e drejtë. Përkufizimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare është përcaktuar duke përdorur teknika të vlerësimit. Metodot e vlerësimit përfshijnë teknikën e vlerës aktuale neto, metodën e flukseve monetare të skontuara dhe krahasimin me instrumente të tjerë të ngjashëm, për të cilat ekzistojnë çmime tregu dhe metoda vlerësimi. Ndryshimet në vlerën e drejtë janë njohur menjëherë në pasqyrën përmblëdhëse të të ardhurave.

#### iv Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit

Në çdo datë raportimi Fondi vlerëson, nëse ka një evidencë objektive që aktivet financiare, të cilat nuk mbahen me vlerën e drejtë përmes fitim - humbjes, janë zhvlerësuar. Aktivet financiare zhvlerësohen kur evidenca objektive paraqët që një ngjarje që sjell humbje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit dhe që ngjarja që sjell humbje ka ndikim në flukset e ardhshme të parasë së aktivitetit, të cilat mund të maten me besueshmëri.

#### v Investime të mbajtura deri në maturim

Investimet e mbajtura deri në maturim janë aktive financiare me pagesa fikse ose të përcaktuara dhe maturitet të fiksuara që Fondi ka synimin e qartë dhe aftësinë për të mbajtur deri në maturim, dhe të cilat nuk janë përcaktuar me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes ose në dispozicion për shitje. Investimet e mbajtura deri në maturim mbahen me

## 2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### e) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Çdo shitje ose riklasifikim i shumave të konsiderueshme të investimeve të mbajtura deri në maturim që nuk janë afër maturimit të tyre do të rezultonte në riklasifikimin e të gjithë investimeve të mbajtura deri në maturim si të disponueshme për shitje, dhe do të parandalonte Shoqërinë të klasifikonte letrat me vlerë për qëllime investimi si instrumenta të mbajtura deri në maturim për periudhën aktuale dhe gjatë dy viteve financiare pasuese.

#### vi *Investimeve të mbajtura me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes*

Fondi mban disa instrumenta me vlerën e drejtë, me ndryshimet e vlerës së drejtë të njohura menjëherë në fitim ose humbje, siç përshkruhet në politikën kontabël 2 (c) (iii). Një prezantim të detajuar të matjeve të vlerës së drejtë mund ta gjeni në shënimin 6 dhe 7.

#### vii *Letra me vlerë të vlefshme për shitje*

Investimet e vlefshme për shitje janë investime jo-derivative, të cilat nuk klasifikohen në ndonjë kategori tjetër të aktiveve financiare. Investimet në kapital, të cilat nuk janë të kuotuar dhe vlera e drejtë nuk mund të matet në mënyrë të besueshme, maten me kosto. Mjetet e tjera të disponueshme për shitje mbahen me vlerën e tyre të drejtë. Të ardhurat nga interesi regjistrohen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave sipas metodës së interesit efektiv. Fitimet ose humbjet nga kursi i këmbimit që lidhen me investimet e disponueshme për shitje njihen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave.

Ndryshimet në vlerën e drejtë njihen në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse deri në momentin që letra me vlerë shitet ose zhvlerësohet, dhe balanca në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse njihet në fitim ose humbje.

### f) Paraja dhe ekuivalentë të saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë aktive financiare me shkallë likuiditeti të lartë, me maturitet më të vogël se tre muaj, të cilat nuk ndikohen shumë nga ndryshimet në vlerën e drejtë dhe përdoren nga Fondi për administrimin e angazhimeve afatshkurtra. Paraja dhe ekuivalentët e saj mbahen në pasqyrën e pozicionit financiar me kosto të amortizuar.

### g) Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen në fillim në pasqyrën e pozicionit financiar me vlerën e drejtë dhe maten në vazhdim me kosto të amortizuar, duke i zbritur zhvlerësimin.

### h) Shitja dhe riblerja e marrëveshjeve dhe huadhënia e letrave me vlerë

Marrëveshjet e shitjes dhe riblerjes ("marrëveshjet repo"), të cilat në fakt ofrojnë kthimin e huadhënësit ndaj palës tjetër, trajtohen si transaksione financiare të siguruara. Letrat me vlerë të shitura sipas marrëveshjeve të tilla të shitjes dhe të riblerjes nuk rregjistrohen. Letrat me vlerë nuk riklasifikohen në bilanc, përveçëse i transferuari ka të drejtën sipas kontratës ose të zakonit të shitjes ose të rivendosjes së letrave me vlerë, në të cilin rast ato janë të riklasifikuara si të arkëtueshme të riblerjes. Detyrimi korrespondues është paraqitur brenda shumave për shkak të bankave të tjera ose fonde të tjera të mara hua.

Letrat me vlerë të blera sipas marrëveshjeve për t'u rishitur ("marrëveshjet repo të investuara"), e cila në mënyrë efektive kërkon të sigurojë kthimin e huadhënësit për Fondin, rregjistrohen si shkak nga bankat e tjera ose huave dhe paradhënieve për klientët, sipas rastit. Dallimi midis shitjes dhe riblerjes me çmimin e rregulluar nga interesi dhe dividendët, të ardhurat nga pala tjetër, trajtohen si të ardhur nga interesi dhe të përlllogaritura mbi jetën e marrëveshjeve repo duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Letrat me vlerë të huazuara për palë të treta për një tarifë fikse janë mbajtur në pasqyrat financiare të konsoliduara në kategorinë e tyre origjinale në pasqyrën e pozicionit financiar përveç nëse pala tjetër ka të drejtën sipas kontratës ose të zakonit të shitjes ose të rivendosjes letrat me vlerë, në të cilin rast ato janë riklasifikuar dhe paraqitur veç e veç. Letrat me vlerë të huazuara për një tarifë fikse nuk janë të rregjistruara në pasqyrat financiare të konsoliduara, nëse këto janë u shiten palëve të tjera, në të cilin rast blerje dhe shitje rregjistrohen në pasqyrën e të ardhurave për vitin brenda fitimit me pak humbjet e krijuara nga letrat me vlerë të tregtueshme. Detyrimi për kthimin e letrave me vlerë është rregjistruar me vlerën e drejtë në fonde të tjera të marra hua.

### i) Llogari të pagueshme dhe të tjera

Llogaritë e pagueshme dhe të tjera janë paraqitur me kosto të amortizuar.



## 2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### j) Rënia në vlerë e aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Fondit rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për zhvlerësim. Nëse ka evidenca të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Një humbje nga rënia në vlerë njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Një njësi gjeneruese e parasë është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse monetare që janë të pavarura nga aktivitetet dhe grupet e tjera. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në fitim ose humbje.

Shuma e rikuperueshme e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të parasë është më e madhe se vlera e tij në përdorim dhe se vlera e drejtë minus kostot e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e ardhshme të parasë janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivitetin. Humbjet nga zhvlerësimi të njohura në periudhat e mëparshme vlerësohen në çdo datë raportimi për të parë nëse humbja është zvogëluar apo nuk ekziston. Humbja nga rënia në vlerë rimerret nëse ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga rënia në vlerë anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivitetit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin, në qoftë humbje nga rënia nuk ishte njohur.

### k) Kuotat e shlyeshme

Fondi emeton kuota të shlyeshme, me kërkesë të investitorit. Kuotat klasifikohen si detyrime financiare. Çdo investitor që ka bërë shlyerje të kuotave të tij, mund të ri-investojë në Fond nëpërmjet depozitimit të mjeteve monetare ekuivalente me vlerën e kuotave të kërkuara. Kuotat janë të shlyeshme çdo ditë. Në momentin e kërkesës për shlyerje, kuotat që do të shlyhen mbarten në vlerën e shlyerjes si detyrim i pagueshëm në pasqyrën e pozicionit financiar të Fondit.

### l) Vlera neto e aktiveve

Vlera neto e aktiveve është e barabartë me vlerën totale të aktiveve neto minus detyrimet e Fondit.

### m) Vlera e kuotes së fondit

Vlera e një kuote të Fondit është e barabartë me vlerën neto të aktiveve të pjesëtuar me numrin e kuotave në datën e raportimit. Bazuar në politikën e Fondit, vlera e një kuote në nisjen e Fondit ishte e barabartë me 1,000 Lek.

### n) Të ardhurat nga interesi

Të ardhurat nga interesi përfshijnë hyrjet nga kuponat e obligacioneve dhe interesat nga depozitat maturuara gjatë vitit dhe nga interesat e llogarise rrjedhese. Të ardhurat nga interesi njihen në bazë përllogaritjeje.

### o) Tarifa e Shoqërisë Administruese

Fondi duhet t'i paguajë Shoqërisë së Administrimit një tarifë prej 1.25% në vit (2016: 1.25%) të vlerës së aktiveve neto, si shpenzim i cili llogaritet në baza ditore.

### p) Fitimi / humbje të realizuara

Fitim / humbja e realizuar njihet nga shitja e letrave me vlerë dhe është llogaritur si diferencë midis çmimit të ofruar dhe vlerës së principalit dhe interesit të maturuar të letrave me vlerë të blera me premium ose zbritje. Këto dallime njihen në fitim ose humbje kur ndodhin.

### q) Fitimi / humbje të porealizuara

Fitimi / humbja e porealizuar njihet si diferencë midis kostos dhe vlerës së drejtë. Kur letrat me vlerë shiten fitim / humbja e porealizuar transferohet në fitim/ humbjen për periudhën.

### r) Krahasueshmeria

Të gjitha shumat janë raportuar ose paraqitur me informacione krahasuese.

## 3. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR

### a) Përmbledhje

Aktivitetet e Fondit e ekspozojnë atë ndaj një shumëllojshmërie rreziqesh financiare: rrezikut të tregut (duke përfshirë rrezikun e këmbimit valutor, rrezikun e normës së interesit dhe rreziqe të tjera të çmimeve), rrezikut të kredisë dhe rrezikut të likuiditetit.

Fondi është i ekspozuar edhe ndaj rreziqeve operationale të tilla si rreziku i kujdestarisë. Rreziku i kujdestarisë është rreziku i humbjes së letrave me vlerë të mbajtura në kujdestari të shkaktuar nga neglizhenca e kujdestarit. Edhe pse është vendosur një kuadër i përshtatshëm ligjor që eliminon rrezikun e humbjes së vlerës së letrave me vlerë të mbajtura nga kujdestari, në rast të dështimit të saj, aftësia e Fondit për të transferuar letrat me vlerë mund të dëmtohet përkohësisht. Programi i përgjithshëm i menaxhimit të rrezikut të Fondit kërkon të maksimizojë kthimin që vjen nga niveli i rrezikut për të cilat Fondi është i ekspozuar dhe kërkon për të minimizuar efektet e mundshme negative mbi performancën financiare të Fondit.

### Struktura e administrimit të rrezikut

Në bazë të ligjit nr. 10198, datë 10 dhjetor 2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive" Shoqëria e Administrimit ka përfshirë në strukturën e saj, Njësinë e Menaxhimit të Rrezikut, përgjegjës për administrimin e rrezikut dhe për raportimin në Këshillin e Administrimit. Politikat e menaxhimit të rrezikut të Fondit janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet e hasura nga institucioni financiar, për të vendosur kufizime dhe kontrolle, dhe për të monitoruar zbatimin e këtyre kontrolleve. Politikat e administrimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut, produktet dhe shërbimet e ofruara. Fondi, përmes standardeve dhe procedurave të menaxhimit, synon të zhvillojë një mjedis kontrolli konstruktiv dhe të disiplinuar, në të cilin çdo punonjës do kuptojë rolin dhe detyrimet përkatëse.

### b) Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë lidhet me mundësinë që emetuesi i një instrumenti financiar, pjesë e aktiveve të Fondit, të mos jetë në gjendje të shlyejë pjesërisht ose plotësisht të gjitha detyrimet e tij, cka do të kishte një impakt negative mbi vlerën e aktiveve të Fondit. Këshilli i Administrimit i Fondit ka deleguar përgjegjësinë për administrimin e rrezikut të kredisë Menaxhimit, i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e rrezikut të kredisë të Fondit. Investimet e Fondit janë në bono thesari dhe obligacione të Qeverisë së Shqipërisë dhe për këtë arsye Fondi është i ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë së Qeverisë së Shqipërisë. Fondi nuk përfshin asnjë kolateral apo përforcues të tjerë të rrezikut të kredisë, e cila mund të reduktojë ekspozimin e Fondit. Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut kreditor më 31 dhjetor është vlera kontabël e aktiveve financiare të përcaktuara më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Aktivitetet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes	30,025,849	25,303,286
Aktivitetet financiare të mbajtura deri në maturim	-	6,115,236
Aktivitetet financiare të vlefshme për shitje	21,033,231	14,942,857
Paraja dhe ekuivalentë të saj	6,200,104	5,461,623
<b>Totali</b>	<b>57,259,184</b>	<b>51,823,002</b>

Cilësia e kredisë së letrave me vlerë të investimeve sipas klasifikimit të Standard and Poor janë të detajuara si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Vlerësimi i tanishëm: B + (Shqipëria)	51,059,080	46,361,379
<b>31 Dhjetor</b>	<b>51,059,080</b>	<b>46,361,379</b>

Më 31 dhjetor 2017, aktivet e mbajtura nga Fondi nuk janë as me vonesë as të zhvlerësuar (2016:nil)

### 3. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

#### c) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Fondi mund të mos jetë në gjendje të gjenerojë burime të mjaftueshme të parasë për të shlyer detyrimet e tij në mënyrë të plotë në kohën e duhur ose mund të veprojë kështu vetëm në kushte që janë materialisht të pafavorshme. Fondi mund të investojë në mënyrë periodike në instrumenta financiarë të tregtueshme. Si rezultat, Fondi mund të mos jetë në gjendje të likuidojë shpejt investimet në këto instrumenta në një shumë të afërt me vlerën e tyre të drejtë për të përmbushur kërkesat për likuiditet, ose të jetë në gjendje tu pergjigjet ngjarjeve të veçanta si përkeqësimi i aftësisë kredimarrëse të një emetuesi të vecantë. Fondi ka aftësinë të marrë hua afat-shkurtër për të mundësuar shlyerjen, pas miratimit nga AMF dhe deri në limitin e përcaktuar nga Ligji. Nuk ka pasur hua të këtij lloji gjatë vitit.

Në mënyrë që të menaxhojë likuiditetin e përgjithshëm të Fondit, Shoqëria Administruese ka aftësinë të pezullojë tërheqjet nëse kjo konsiderohet të jetë në interesin më të mirë të të gjithë kontribuesve.

Në mungesë të detyrimeve të rëndësishme financiare Shoqëria Administruese e monitoron rrezikun e likuiditetit në bazë flukseve monetare të aktualizuara kontraktuale. Tabela e mëposhtme analizon aktivet financiare dhe detyrimet e Fondit në grupimet përkatëse të maturimit bazuar në periudhën e mbetur në pasqyrën e pozicionit financiar deri në datën kontraktuale të maturimit. Shumat në tabelë janë flukset e parasë të aktualizuara kontraktuale më 31 dhjetor 2017 dhe 2016:

31 Dhjetor 2017	Deri 1 muaj	1 deri në 3 muaj	3 deri 6 muaj	6 deri 12 muaj	Mbi 1 vit	Totali
<b>Aktivët</b>						
Aktivët financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes	1,028,365	2,451,970	4,392,877	7,178,226	14,974,411	30,025,849
Aktivët financiare të mbajtura deri në maturim		1,251,820	725,458	2,691,598	16,364,354	21,033,231
Aktivët financiare të vlefshme për shitje						-
Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre	6,200,104	-	-	-	-	6,200,104
<b>Totali</b>	<b>7,228,469</b>	<b>3,703,790</b>	<b>5,118,335</b>	<b>9,869,824</b>	<b>31,338,766</b>	<b>57,259,184</b>
<b>Detyrimët</b>						
Detyrime ndaj Shoqërisë së Administrimit	60,964	-	-	-	-	60,964
Detyrime për kërkesa tërheqjeje nga fondi	88,351	-	-	-	-	88,351
Detyrime të tjera	21,628	-	-	-	-	21,628
<b>Totali</b>	<b>170,943</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>170,943</b>
<b>Rreziku i likuiditetit</b>	<b>7,057,526</b>	<b>3,703,790</b>	<b>5,118,335</b>	<b>9,869,824</b>	<b>31,338,766</b>	<b>57,088,241</b>
<b>Akumulimi</b>	<b>7,057,526</b>	<b>10,761,316</b>	<b>15,879,651</b>	<b>25,749,475</b>	<b>57,088,241</b>	

31 Dhjetor 2016	Deri 1 muaj	1 deri në 3 muaj	3 deri 6 muaj	6 deri 12 muaj	Mbi 1 vit	Totali
<b>Aktivët</b>						
Aktivët financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes	1,550,757	2,652,270	4,778,310	3,498,612	12,823,337	<b>25,303,286</b>

### 3. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM) c) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Aktivitet financiare të mbajtura deri në maturim	-	249,103	-	-	5,873,581	<b>6,155,236</b>
Aktivitet financiare të vlefshme për shitje	-	-	-	-	14,935,409	<b>14,942,857</b>
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	4,457,622	-	1,004,001	-	-	<b>5,461,623</b>
<b>Totali</b>	<b>6,008,379</b>	<b>2,901,373</b>	<b>5,782,311</b>	<b>3,498,612</b>	<b>33,632,327</b>	<b>51,823,002</b>
<b>Detyrimet</b>						
Detyrime ndaj Shoqërisë së Administrimit	55,392	-	-	-	-	<b>55,392</b>
Detyrime për kërkesa terheqjeje nga fondi	52,265	-	-	-	-	<b>52,265</b>
Detyrime të tjera	48,035	-	-	-	-	48,035
<b>Totali</b>	<b>155,692</b>	-	-	-	-	<b>155,692</b>
<b>Rreziku i likuiditetit</b>	<b>5,852,687</b>	<b>2,901,373</b>	<b>5,782,311</b>	<b>3,498,612</b>	<b>33,632,327</b>	<b>51,667,310</b>
<b>Akumulimi</b>	<b>5,852,687</b>	<b>8,754,060</b>	<b>14,536,371</b>	<b>18,034,983</b>	<b>51,667,310</b>	

#### d) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimi në çmimet e tregut do të ndikojnë në të ardhurat e Fondit ose në vlerën e instrumenteve financiare. Objektivi i administrimit të rrezikut të tregut është të menaxhojë dhe kontrollojë ekspozimet ndaj riskut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, ndërkohë që optimizon kthimin nga rreziku.

#### **Ekspozimi ndaj rrezikut të monedhës së huaj**

Fondi nuk është i ekspozuar ndaj rrezikut të valutës nëse transaksionet në monedhë të huaj mungojnë. Fondi nuk ka hyrë në ndonjë shkëmbim ose transaksion derivativ më 31 dhjetor 2017. Më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 nuk ka aktive ose pasive financiare të cilat janë të shprehura në monedhë të huaj.

#### **Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit**

Rreziku kryesor ndaj të cilit portofolet tregtare janë ekspozuar është rreziku i humbjes nga luhatja e flukseve të ardhshme të parasë ose vlerës së drejtë të instrumenteve financiare për shkak të një ndryshimi në normat e interesit të tregut (diferencat mes vlerës aktuale të aktiveve dhe detyrimeve neto). Rreziku i normës së interesit menaxhohet kryesisht nëpërmjet monitorimit të diferencave të normave të interesit. Administrimi i rrezikut të normave të interesit kundrejt hendekut të limitit të normave të interesit, kompletohet duke monitoruar ndjeshmërinë e aktiveve dhe detyrimeve financiare të Fondit për skenarë të ndryshëm standard dhe jo-standard të normave të interesit. Skenarët standardë të cilët vlerësohen në mënyrë periodike, përfshijnë 100 pikë bazë (pb) rënie ose ngritje paralele në të gjitha kurbat e kthimit. Një analizë e ndjeshmërisë të Fondit në një rritje ose rënie të normave të interesit të tregut (duke supozuar që nuk ka lëvizje asimetrike të kurbave të kthimit si dhe një gjendje të pandryshueshme financiare) është si vijon:

<b>2017</b>		
Normat e interesit	Rënie 100 pbs	Rritje 100 pbs
Efekti i fitim/ humbjes së vlerësuar (në 000/Lek)	1,018,719	(1,018,719)
<b>2016</b>		
Normat e interesit	Rënie 100 pbs	Rritje 100 pbs
Efekti i fitim/ humbjes së vlerësuar (në 000/Lek)	901,234	(901,234)

## 4. MANAXHIMI I RREZIKUT TE KAPITALIT

Kapitali i Fondit përfaqësohet nga aktivet neto që i atribuohen mbajtësit të kuotave. Shuma e aktivitet neto që i atribuohet mbajtësit të kuotave mund të ndryshojë në mënyrë të konsiderueshme në baza ditore, pasi Fondi i nënshtrohet investimeve dhe tërheqjeve ditore sipas gjykimit të mbajtësit të kuotes. Objektivi i Fondit për sa i përket menaxhimit të kapitalit është të ruajë vazhdimësinë e tij me qëllim sigurimin e kthimit për mbajtësin e kuotes, sigurimin e përfitimeve për palët e tjera dhe ruajtjen e një bazë të fortë kapitali për të mbështetur zhvillimin e aktiviteteve të investimeve të Fondit. Për të ruajtur strukturën e kapitalit, politika e Fondit do të performojë si më poshtë:

- Monitorimi i nivelit të hyrjeve dhe tërheqjeve ditore në raport me situatën e cash-it duhet të mundësojë likuidimin e kërkesave për brenda 7 ditëve nga dita e kërkesës së vlefshme.
- Shlyerja dhe emetimi i kuotave të reja duhet kryer në përputhje me ligjin dhe prospektin e Fondit. Kjo përfshin aftësinë për të kufizuar shlyerjet dhe për të kërkuar një minimum investimi në Fond.

Administratoret e Shoqërisë Administruese monitorojnë kapitalin në bazë të vlerës së aktiveve neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave.

## 5. STRATEGJIA E INVESTIMIT

Strategjia e investimeve të aktiveve të Fondit Raiffeisen Prestigj mbështetet në ligjin nr. 10198 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive” dhe rregulloret e dala në zbatim të tij, si dhe në politikën e brendshme të investimit të Shoqërisë administruese, propozuar nga Komiteti i Investimit dhe miratuar nga Keshilli i Administrimit i Shoqërisë Administruese.

### a) Kuadri ligjor

Në lidhje me investimet e aktiveve të Fondit, Shoqëria Administruese Raiffeisen INVEST – Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a. i përmbahet ligjit nr.10198, datë 10 dhjetor 2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive” dhe perspektivës së Fondit.

### (i) Investimet e lejuara

Sipas rregullores, aktivet e Fondit mund të investohen vetëm në instrumentet e mëposhtëm:

- tituj të transferueshëm dhe instrumente të tregut të parasë, që tregtohen në tregje të rregulluara ose në një bursë titujsh në Republikën e Shqipërisë, në një shtet të Bashkimit Europian apo në çdo shtet tjetër të lejuar nga AMF-ja;
- kuota të fondeve të investimit apo aksione të shoqërive të investimit, të liçencuara sipas ligjit nr.10198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, si dhe nga kuota ose aksione të sipërmarrjeve kolektive të investimit, të liçencuara në përputhje me standardet e Bashkimit Europian;
- depozita në institucione kreditimi, të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, në një nga shtetet anëtare të BE-së ose në çdo shtet të lejuar nga AMF-ja, të cilat mund të tërhiqen menjëherë ose që kanë afat maturimi jo më shumë se 12 muaj;
- instrumente financiare derivative ;
- instrumente të tjera të tregut të parasë.

Për secilin prej keyre instrumenteve, shoqëria administruese duhet të respektojë kufizimet e investimit të parashikuara në Ligjin nr.10198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, si dhe ato të parashikuara në politikën e brendshme për manaxhimin e rrezikut.

### (ii) Kufizimet e investimit dhe kufiri i lejuar

Fondi nuk mund të investojë më shumë se 20 % të aktiveve të saj në depozita në të njëjtin institucion depozitues. Fondi nuk mund të investojë më shumë se 5 % të aktiveve të saj në tituj dhe instrumente të tregut të parasë të një emetuesi të vetëm. Kufiri 5 %, mund të rritet deri në:

- 10 %. Në këtë rast, vlera totale e titujve ose instrumenteve të tregut të parasë, që mban Fondi të disa emetues, ku për secilin ka investuar mbi 5 për qind të aktiveve, nuk duhet të tejkalojë 40 për qind të vlerës totale të aktiveve të fondit;
- 35 % në rastin e titujve dhe të instrumenteve të tregut të parasë, të emetuara ose të garantuara nga qeveria dhe autoritetet vendore të Republikës së Shqipërisë, shteteve të Bashkimit Europian, shteteve të tjera të lejuara nga AMF-ja, ose nga organizma publikë ndërkombëtarë, në të cilët bëjnë pjesë një ose më shumë shtete të Bashkimit Europian;
- 100 % me miratimin e AMF-së, sipas disa kushteve të percaktuara në Ligj.
- 25 % në rastin e disa obligacioneve të veçanta, të emetuara nga institucionet kredituese të liçencuara, të cilat e kanë

## 5. STRATEGJIA E INVESTIMIT (VAZHDIM)

### a) Kuadri ligjor (vazhdim)

selinë e regjistruar në Republikën e Shqipërisë, apo në një shtet të Bashkimit Europian apo të lejuara nga AMF-ja. Kur Fondi investon më shumë se 5 % të aktiveve në këto lloj obligacionesh të emetuara nga një emetues i vetëm, atëherë vlera totale e këtij investimi nuk tejkalon 80 % të vlerës totale të aktiveve të sipërmarrjes kolektive me ofertë publike;

Ekspozimi ndaj rreziqeve të palës tjetër i Fondit në një transaksion me instrumente derivativ në një treg të rregulluar nuk duhet te tejkalojë 10 % të aktiveve të tij, kur pala tjetër është një institucion i licencuar kreditimi ose 5 % të aktiveve, në rastet e tjera.

Fondi mund të investojë deri në 30 % të aktiveve të tij në kuota apo aksione të një forme tjetër të sipërmarrjeve të investimeve kolektive. Aktivët e Fondit mund të investohen deri në 100% në letra me vlerë të emetuara ose garantuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

Shoqëria Administruese i manaxhon aktivet e Fondit sipas parimit të sigurisë afatgjatë dhe të një kthimi të përshtatshëm nga investimi, duke ruajtur një raport optimal mes rritjes së kursimeve për investime dhe riskut të marrë përsipër. Objektivat afatgjatë për shpërndarjen e aktiveve të Fondit janë si më poshtë:

Klasa	Objektivi
Tituj të emtuar dhe garantuar nga qeveria e Republikës së Shqipërisë	90%
Tituj të emtuar dhe garantuar nga shtete të BE-së	0%
Depozita bankare ekuivalente të tjerë	6%
Tituj të emtuar dhe garantuar nga autoritetet vendore dhe shoqëri tregtare të Republikës së Shqipërisë	2%
Kuotat e fondit të investimit	2%
Derivate financiare	0%
Tituj të transferueshëm dhe instrumenta të tjerë financiar të borxhit që tregtohen në tregje të rregulluara, në një shtet të BE-së apo në çdo shtet tjetër të lejuar	0%

Më 31 dhjetor 2016, për të mbrojtur anëtarët e Fondit nga rrezikut të kursit të këmbimit dhe duke pasur parasysh se tregu i letrave me vlerë shqiptare është ende në zhvillim dhe mungon një bursë e përshtatshme, portofoli përbëhet nga bono thesari dhe obligacione qeveritare të lëshuara nga Qeveria Shqiptare.

### b) Politika e brendshme e investimeve të Shoqërisë së Administrimit

Rreziku në investime ndërmerret vetëm nga anëtarët e Fondit dhe jo nga Shoqëria Administruese. Për të minimizuar këtë rrezik, Shoqëria Administruese ka përfshirë në strukturën e saj organizative, Komitetin e Investimeve, i cili propozon politikat për alokimin e pasurive dhe investimeve dhe një Njësi për Menaxhimin e rrezikut i cili kryen kontrollin sasior dhe cilësor të të gjitha rreziqeve të lidhura me Fondin.

Pasqyra e strukturës së investimeve më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 paraqitet si më poshtë:

	Vlera në datën e raportimit 31 Dhjetor 2017	Pjesa ndaj totalit të aktiveve të fondit %
Obligacione	38,340,592	67%
Bono Thesari	12,718,488	22%
Mjete monetare dhe ekuivalentë	4,894,943	9%
Repo	1,305,161	2%
<b>Më 31 Dhjetor 2017</b>	<b>57,259,184</b>	<b>100%</b>

## 5. STRATEGJIA E INVESTIMIT (VAZHDIM)

### b) Politika e brendshme e investimeve të Shoqërisë së Administrimit (vazhdim)

	Vlera në datën e raportimit 31 Dhjetor 2016	Pjesa ndaj totalit të aktiveve të fondit %
Obligacione Qeveritare	36,973,817	71%
Bono thesari	9,387,562	18%
Mjete monetare dhe ekuivalentë	4,792,727	9%
Repo	668,896	1%
<b>Më 31 Dhjetor 2016</b>	<b>51,823,002</b>	<b>100%</b>

## 6. VLERA E DREJTË E AKTIVEVE DHE DETYRIMEVE FINANCIARE

Duke filluar nga 1 janar 2014 Fondi ka adoptuar SNRF 13 në lidhje me dhënien e informacioneve shpjeguese rreth shkallës së besueshmërisë së matjeve të vlerës së drejtë. Kjo kërkon që Fondi të klasifikojë, për qëllime të shpalosjes, matjet e vlerës së drejtë duke përdorur një hierarki të vlerës së drejtë e cila reflekton rëndësinë e të dhënave të përdorura në kryerjen e matjeve.

### *Përcaktimi i vlerës së drejtë*

Përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare të tregtuara në tregje aktive bazohet tek çmimet e kuotuar të tregut ose në çmimet e shitësit. Vlera e drejtë e instrumenteve të tjera financiare përcaktohet përmes teknikave të vlerësimit. Teknikat e vlerësimit përfshijnë teknikën e vlerës aktuale neto, metodën e skontimit të flukseve monetare, krahasimin me instrumente të ngjashme për të cilat ka çmime tregu dhe modelet e vlerësimit.

Fondi e mat vlerën e drejtë duke përdorur Nivelin 2 të hierarkisë së vlerës së drejtë, i cili reflekton rëndësinë e elementeve të përdorur në realizimin e vlerësimit, që shpjegohet si më poshtë:

- Niveli 2: Teknikat e vlerësimit të bazuara në elementet e vëzhgueshëm, në mënyrë direkte ose jo direkte (p.sh. që rrjedhin nga çmimet). Kjo kategori përfshin instrumente të vlerësuar nëpërmjet çmimeve të instrumenteve të ngjashëm të kuotuar në tregje aktive; çmimet e kuotuar të instrumenteve të njëjta ose të ngjashme në tregje jo shumë aktive; ose teknika të tjera vlerësimi, ku të gjithë elementet e rëndësishme vëzhgohen në mënyrë direkte ose jo direkte nga të dhënat e tregut.

Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare që tregtohen në tregje aktive bazohet në çmimet e kuotuar të tregut ose në çmimet e kuotuar të shitësit. Për instrumentet financiare që nuk tregtohen në mënyrë të vazhdueshme dhe që nuk kanë transparencë në çmime, vlera e drejtë është më pak objektive dhe kërkon nivele të ndryshme të gjykimit, në varësi të likuiditetit, përqendrimit, pasigurisë së faktorëve të tregut, supozimeve mbi çmimet dhe rreziqeve të tjera që ndikojnë në instrument.

### *Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre*

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë në arkë, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat me bankat rezidente. Sikurse këto gjendje janë afatshkurtra, vlera e drejtë e tyre është pothuajse e barabartë me vlerën e mbetur.

### *Investimet në letra me vlerë*

Investimet në letra me vlerë përfshijnë bono thesari dhe obligacione të qeverisë. Vlera e drejtë e tyre llogaritet duke përdorur modelin e flukseve të skontuara të parave bazuar në normën e brendshme aktuale të kthimit e përshtatshme për maturitetin e mbetur. Investimet në letrat me vlerë janë mbajtur me vlerën e drejtë.

Tabela e mëposhtme analizon në kuadër të hierarkisë së vlerës së drejtë aktivet financiare të Fondit (në bazë të klasës) i matur me vlerën e drejtë më 31 dhjetor 2017.

Të gjitha matjet e vlerës së drejtë të publikuara janë matje të vlerës së drejtë periodike.

## 6. VLERA E DREJTË E AKTIVEVE DHE DETYRIMEVE FINANCIARE (VAZHDIM)

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Aktivt financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes	30,025,849	25,303,286
Aktivt financiare të mbajtura deri në maturim	-	6,115,236
Aktivt financiare të vlefshme për shitje	21,033,231	14,942,857
Mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre	6,200,104	5,461,623
<b>Totali</b>	<b>57,259,184</b>	<b>51,823,002</b>

Vlerësimet janë përgatitur dhe shqyrtuar në baza mujore nga Menaxheri i rrezikut që raporton dhe i jep rekomandime shoqërisë administruese në bazë mujore, në përputhje me vlerësimet mujore që janë dhënë për investitorët. Menaxheri i rrezikut konsideron përshtatshmërinë e modelit të vlerësimit, të dhënat hyrëse kryesore si dhe rezultatit e vlerësimit duke përdorur metoda të ndryshme të vlerësimit dhe teknika përgjithësisht të njohura si standarde në kuadër të industrisë. Menaxheri i rrezikut mund të kryejë testimin përsëri duke marrë në konsideratë rezultatet aktuale të modeleve të ndryshme dhe se si ata historikisht janë në një linjë me transaksionet aktuale të tregut. Gjithashtu banka kujdestare është përgjegjëse për shqyrtimin e rivlerësimeve përmes një procedure të përditshme konfirmimi.

## 7. VLERËSIMET DHE GJYKIMET KRITIKE KONTABËL

Fondi bën vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën dhe faktorët e tjerë, duke përfshirë pritjet e ngjarjeve të ardhshme të cilat besohet të jenë të arsyeshme duke marrë në konsideratë rrethanat.

### Vlera e drejtë e investimeve e pakuotuar në një treg aktiv

Vlerat e drejta të letrave me vlerë që nuk janë të kuotuar në një treg aktiv përcaktohen duke përdorur teknika vlerësimi, kryesisht të ardhurat shumëfisha, flukset e parasë të skontuara dhe transaksioneve të kohëve të fundit të krahasueshme. Modelet e përdorura për të përcaktuar vlerat e drejta janë të vlefshme dhe të rishikohen periodikisht nga Shoqëria Administruese. Inputet në modele me të ardhurat e shumëfishta përfshijnë të dhëna të vëzhgueshme, siç janë shumëfisha të të ardhurave të kompanive të krahasueshme me kompaninë përkatëse të portofolit, dhe të dhëna të pavëzhgueshme, të tilla si të ardhurat e parashikuara për kompaninë portofolit. Në modelet e skontuara të flukseve monetare, inputet jo të vëzhgueshme janë flukset e parasë të projektuara të kompanisë përkatëse portofolit dhe primit të rrezikut për likuiditet dhe rrezikun e kreditit që janë të përfshira në normën e skontimit. Menaxheri përdor modele për të rregulluar kthimin e kapitalit neto të vëzhguar për të reflektuar strukturën aktuale të financimit të borxhit / kapitalit neto të investimeve të vlerësuar të kapitalit. Modelet janë të kalibruar nga mbropa- testimit për rezultatet aktuale/ çmimet e daljes të arritura për të siguruar që rezultatet janë të besueshme.

### Statusi i entitetit të investimeve

Në përcaktimin e statusit të Fondit si një entitet të investimit në përputhje me SNRF 10, Shoqëria Administruese konsideron faktet e mëposhtme:

- Fondi ka grumbulluar aktive monetare nga investitorët e tij në mënyrë që të rrisë investimet financiare dhe për të ofruar shërbime të menaxhimit në lidhje me këto investime;
- Fondi ka për qëllim të gjenerojë kapitale dhe kthime në të ardhura nga investimet të cilat do të shpërndahen në përputhje me kërkesat e kontribuesit; dhe
- Fondi vlerëson performancën e investimeve mbi bazën e vlerës së drejtë (përveç atyre të mbajtura deri në maturim), në përputhje me politikat e përcaktuara në këto pasqyra financiare. Edhe pse Fondi plotëson të tre kriteret përcaktuese, Shoqëria Administruese e ka vlerësuar gjithashtu qëllimin e biznesit të Fondit, strategjitë e investimit për investimet financiare, natyrën e çdo të ardhure nga investimet dhe modelet e vlerës së drejtë. Shoqëria Administruese bëri këtë vlerësim për të përcaktuar nëse fusha të tjera të gjykitimit do të ekzistojnë në lidhje me karakteristikat tipike të një njësie ekonomike të investimit kundrejt atyre të Fondit.



## 8. TË ARDHURAT NGA INTERESI

Të ardhurat nga interesi përbehen si më poshtë:

*(shumat në mijë Lek, përveç rasteve kur tregohet ndryshe)*

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2016
Obligacione të Qeverisë dhe Korporatave	2,568,700	2,652,837
Të ardhurat nga interesi i depozitave	31,844	26,322
Të ardhura nga interesi i Repos	12,523	7,142
Të ardhurat nga interesi i llogarive rrjedhëse dhe të ardhura të tjera		
<b>Totali</b>	<b>2,613,067</b>	<b>2,686,301</b>

## 9. NDRYSHIME TË TJERA NETO NË VLERËN E DREJTË

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2016
Fitime të realizuara nga investimet	108,443	168,310
Humbje të realizuara nga investimet	(73,105)	(28,872)
Fitime të përealizuara nga investimet	1,540,092	2,007,888
Humbje të përealizuara nga investimet	(2,858,632)	(1,858,968)
<b>Ndryshimi total në vlerën e drejtë të aktiveve financiare</b>	<b>(1,283,202)</b>	<b>288,359</b>

## 10. AKTIVE FINANCIARE TË MBAJTURA ME VLERË TË DREJTË NËPËRMJET FITIMIT OSE HUMBJES

Aktivët financiarë me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes janë paraqitur si më poshtë:

Afatgjata	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Obligacione Qeveritare	17,307,361	15,915,724
	<b>17,307,361</b>	<b>15,915,724</b>
<b>Afatshkurtra</b>		
Bono Thesari	12,718,488	9,387,562
	<b>12,718,488</b>	<b>9,387,562</b>
<b>Totali</b>	<b>30,025,849</b>	<b>25,303,286</b>

## 10. AKTIVE FINANCIARE TË MBAJTURA ME VLERË TË DREJTË NËPËRMJET FITIMIT OSE HUMBJES (VAZHDIM)

Aktivët financiarë me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes mund të detajohen përsa i përket kategorive si në vijim:

	Vlera Nominale	Primi /(zbritja) e paamortizuar	Interesi i përlogaritur	Vlera e drejtë fitim	Vlera e tregut
Bono thesari	12,862,000	(284,018)		140,506	12,718,488
Obligacione Qeveritare	15,997,971	1,207,150	270,412	(168,173)	17,307,361
Obligacione Qeveritare – të vlefshme për shitje	18,737,806	122	337,205	2,468,054	21,033,231
<b>31 dhjetor 2017</b>	<b>47,597,777</b>	<b>923,254</b>	<b>607,617</b>	<b>2,440,387</b>	<b>50,059,080</b>

	Vlera Nominale	Primi /(zbritja) e paamortizuar	Interesi i përlogaritur	Vlera e drejtë fitim	Vlera e tregut
Bono thesari	9,452,460	(131,024)		66,126	9,387,562
Obligacione Qeveritare	14,474,571	621,203	218,815	601,135	15,915,724
Obligacione Qeveritare – të vlefshme për shitje	12,950,123	2,169	251,109	1,723,345	14,942,857
<b>31 dhjetor 2016</b>	<b>36,877,154</b>	<b>492,348</b>	<b>469,924</b>	<b>2,390,606</b>	<b>40,246,143</b>

Lëvizjet në vlerë nominale të aktiveve financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 janë paraqitur më poshtë:

Bono Thesari	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Më 1 janar	9,452,460	10,605,610
Blerje gjatë vitit	12,862,000	13,029,780
Të maturuara gjatë vitit	(9,452,460)	(14,182,930)
<b>Më 31 dhjetor</b>	<b>12,862,000</b>	<b>9,452,460</b>

Obligacione Qeveritare	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Më 1 janar	14,474,571	16,255,071
Blerje gjatë vitit	7,642,300	1,350,000
Të maturuara gjatë vitit	(6,118,900)	(3,130,500)
<b>Më 31 dhjetor</b>	<b>15,997,971</b>	<b>14,474,571</b>

## 11. AKTIVE FINANCIARE TË MBAJTURA DERI NË MATURIM

Aktivët financiarë të mbajtura deri në maturim mund të detajohen përsa i përket maturimit si më poshtë:

Afatgjata	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Obligacione Qeveritare	-	6,115,236
<b>Totali</b>	<b>-</b>	<b>6,115,236</b>

Aktivët financiarë të mbajtura deri në maturim mund të detajohen përsa i përket maturimit si më poshtë:

Vlera Nominale	Primi/(zbritja) e paamortizuar	Interesi i përlogaritur	Vlera neto
----------------	--------------------------------	-------------------------	------------

## 11. AKTIVE FINANCIARE TË MBAJTURA DERI NË MATURIM (VAZHDIM)

Obligacione Qeveritare	-	-	-	-
<b>31 Dhjetor 2017</b>	-	-	-	-
	<b>Vlera Nominale</b>	<b>Primi/(zbritja) e paamortizuar</b>	<b>Interesi i përlogaritur</b>	<b>Vlera neto</b>
Obligacione Qeveritare	6,032,683	(7,432)	89,985	6,115,236
<b>31 Dhjetor 2016</b>	<b>6,032,683</b>	<b>(7,432)</b>	<b>89,985</b>	<b>6,115,236</b>

Lëvizjet në vlerë nominale të aktiveve financiare të mbajtura deri në maturim më 31 dhjetor 2017 janë paraqitur më poshtë:

<b>Obligacione qeveritare</b>	<b>31 Dhjetor 2017</b>	<b>31 Dhjetor 2016</b>
Më 1 janar	6,032,683	19,903,850
Blerje gjatë vitit		
Të maturuara gjatë vitit	(6,032,683)	(13,871,167)
<b>Më 31 dhjetor</b>	<b>-</b>	<b>6,032,683</b>

## 12. AKTIVË FINANCIARË TË VLEFSHME PËR SHITJE

Aktivët financiarë të vlefshme për shitje mind të detajohen përsa i përket maturimit si më poshtë:

<b>Afatgjata</b>	<b>31 Dhjetor 2017</b>	<b>31 Dhjetor 2016</b>
Obligacione Qeveritare	21,033,231	14,942,857
<b>Totali</b>	<b>21,033,231</b>	<b>14,942,857</b>

Aktivët financiarë të vlefshme për shitje mund të detajohen përsa i përket maturimit si më poshtë:

	<b>Vlera Nominale</b>	<b>Vlera e drejtë fitim/humbje</b>	<b>Interesi i përlogaritur</b>	<b>Vlera neto</b>
Obligacione Qeveritare	18,737,806	1,958,220	337,205	21,033,231
<b>31 Dhjetor 2017</b>	<b>18,737,806</b>	<b>1,958,220</b>	<b>337,205</b>	<b>21,033,231</b>

	<b>Vlera Nominale</b>	<b>Vlera e drejtë fitim/humbje</b>	<b>Interesi i përlogaritur</b>	<b>Vlera neto</b>
Obligacione Qeveritare	12,440,308	2,251,439	251,109	14,942,857
<b>31 Dhjetor 2016</b>	<b>12,440,308</b>	<b>2,251,439</b>	<b>251,109</b>	<b>14,942,857</b>

Lëvizjet në vlerë nominale të aktiveve financiare të të vlefshme për shitje më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 janë paraqitur më poshtë:

<b>Obligacione qeveritare</b>	<b>31 Dhjetor 2017</b>	<b>31 Dhjetor 2016</b>
Më 1 janar	12,950,123	5,277,599
Blerje gjatë vitit	6,032,683	7,695,014
Të maturuara gjatë vitit	(245,000)	(22,490)
<b>Më 31 dhjetor</b>	<b>18,737,806</b>	<b>12,950,123</b>

## 13. MJETE MONETARE DHE EKVIVALENTË TË TYRE

Për qëllime të pasqyrës së flukseve parasë, paraja dhe ekuivalentet e saj përfshijnë tepricat e mëposhtme me maturim original prej më pak se 90 ditë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Llogaritë rrjedhëse me banken kujdestare	27,142	18,566
<b>Total i llogarive rrjedhëse</b>	<b>27,142</b>	<b>18,566</b>
Depozita	4,867,000	4,770,000
Repo	1,304,395	668,710
Interesi i përlogaritur	1,567	4,347
<b>Totali i depozitave</b>	<b>6,172,962</b>	<b>5,443,057</b>
<b>Totali i parasë dhe ekuivalentë të saj</b>	<b>6,200,104</b>	<b>5,461,623</b>

## 14. DETYRIME TË TJERA

Detyrimet e tjera përfshijnë tatimin në burim mbi të ardhurat personale të mbajtur nga Shoqëria Administruese në lidhje me përfitimet kapitale nga tërëqjet e kontributoreve gjatë muajit Dhjetor. Shoqëria administruese vepron si agjent mbledhës për Fondin, sipas ligjit nr. 8438 "Tatimi mbi të ardhurat" i datës 28.12.1998.

## 15. AKTIVET NETO QË I ATRIBUOHEN MBAJTËSVE TË KUOTAVE

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Kapitali i përkushtuar	51,667,310	56,633,644
Kontributet kapitale kumulative	14,160,056	9,055,909
Pagesa të kapitalit kumulative	(10,875,439)	(17,952,017)
<b>Kontributet kumulative të kapitalit neto</b>	<b>54,951,927</b>	<b>47,737,536</b>
Fitimet e përealizuara neto kumulative	231,734	1,948,866
Fitimet e realizuara neto kumulative	2,613,067	2,686,301
Shpenzime të tjera neto kumulative	(708,488)	(705,393)
<b>Rritja në aktivet neto që i atribuohet kontribuesve</b>	<b>2,136,313</b>	<b>3,929,774</b>
<b>Totali i aktiveve neto që i atribuohet kontribuesve</b>	<b>57,088,240</b>	<b>51,667,310</b>
<b>Numri i njërive të fondit</b>	<b>39,786</b>	<b>37,401</b>
<b>Aktivitet për njësi</b>	<b>1,435</b>	<b>1,381</b>

## 16. PALËT E LIDHURA

Palët konsiderohen si të lidhura në qoftë se njëra palë ka aftësinë për të kontrolluar palën tjetër ose të ushtrrojë ndikim të rëndësishëm mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare ose operacionale.

Palët e lidhura të Fondit janë Raiffeisen INVEST - Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të

## 16. PALËT E LIDHURA (VAZHDIM)

Investimeve Kolektive sh.a, e cila menaxhon Fondin, banka kujdestare e Fondit dhe Raiffeisen Bank sh.a. si aksionar i vetëm i shoqërisë administruese.

Që nga dhe për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 Fondi ka hyrë në transaksionet dhe balancat e mëposhtme me palët e lidhura me të:

<b>Paraja dhe ekuivalentë të parasë</b>	<b>31 Dhjetor 2017</b>	<b>31 Dhjetor 2016</b>
Llogari rrjedhëse ne Bankën Kujdestare	27,142	18,566
<b>Totali</b>	<b>27,142</b>	<b>18,566</b>

<b>Depozita</b>	<b>31 Dhjetor 2017</b>	<b>31 Dhjetor 2016</b>
Depozita me Raiffeisen Bank sha	2,750,000	3,160,000
Interesi i përlogaritur	523	4,035
<b>Totali</b>	<b>2,750,523</b>	<b>3,164,035</b>

<b>Detyrime ndaj Shoqërisë administruese</b>	<b>31 Dhjetor 2017</b>	<b>31 Dhjetor 2016</b>
Tarifë e pagueshme ndaj Shoqërisë administruese	(60,964)	(55,392)
<b>Totali</b>	<b>(60,964)</b>	<b>(55,392)</b>

<b>Të ardhura</b>	<b>Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2017</b>	<b>Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2016</b>
Të ardhura nga interesat nga depozitat me të maturuara brenda vitit dhe llogaritë rrjedhëse	15,287	9,874
<b>Totali</b>	<b>15,287</b>	<b>9,874</b>

<b>Shpenzime</b>	<b>Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2017</b>	<b>Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2016</b>
Tarifa e Shoqërisë administruese	(702,994)	(705,393)
<b>Totali</b>	<b>(702,994)</b>	<b>(705,393)</b>

## 17. NGJARJE PAS DATËS SË BILANCIT

Nuk ka ngjarje pasuese pas datës së raportimit që mund të kërkojnë ose rregullim ose prezantim shtesë në pasqyrat financiare.





FONDI RAFFEISEN INVEST EURO

**FONDI RAIFFEISEN INVEST EURO**

Raporti i Audituesit të Pavarur  
dhe Pasqyrat Financiare  
për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017



# Përmbajtja

<b>Raporti i audituesit të pavarur</b>	98
<b>Pasqyra e fitim humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse</b>	100
<b>Pasqyra e pozicionit financiar</b>	101
<b>Pasqyra e ndryshimeve të aktiveve neto që i atribuohen mbajtësve të njëjësive</b>	101
<b>Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare</b>	102
1. Hyrje	103
2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël	103
3. Manaxhimi i rrezikut financiar	113
4. Manaxhimi i rrezikut të kapitalit	116
5. Strategjia e investimit	117
6. Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare	119
7. Vlerësimet dhe gjykimet kritike kontabël	120
8. Të ardhurat nga interesi	120
9. Ndryshime të tjera në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura në vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes	121
10. Humbje nga kursi i kembimit	121
11. Aktive financiare të mbajtura me vlerëtë drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes	122
12. Investime në kuota të fondeve të tjera	123
13. Paraja dhe ekuivalentë të saj	123
14. Detyrime të tjera	123
15. Aktivitet neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave	124
16. Palët e lidhura	124
17. Ngjarje pas datës së bilancit	125

# Raporti i Audituesit të Pavarur

**Deloitte.**

Deloitte Audit Albania sh.p.k.  
Rr. Elbasanit,  
Pallati poshtë Fakulteti Gjeologji-  
Miniera  
Tirana, Albania  
Tel: +355 4 45 17 920  
[www.deloitte.al](http://www.deloitte.al)

VAT (NUIS) No: L41709002H

Drejtuar Aksionarëve dhe Drejtimit të Shoqërisë Raiffeisen INVEST – Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a.

## Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të veçanta të Raiffeisen Euro ("Fondi"), të cilat përfshijnë pasqyrën e veçantë të pozicionit financiar më 31 dhjetor 2017 dhe pasqyrën e fitim humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyra e ndryshimeve të aktiveve neto që i atribuohen mbajtësve të njësisve dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe nga një përmbledhje e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Fondit më datë 31 dhjetor 2017 si edhe të performancës së saj financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

## Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në paragrafin e emërtuar "Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare" të këtij raporti. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Fondi në përputhje me Kodin e Etikës së Kontabilistëve Profesionistë i vendosur nga Bordi i Kontabilistëve për Standardet Ndërkombëtare të Etikës ("BKSNE") dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si edhe, kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur bazën për opinionin tonë të auditimit.

## Përgjegjësitë e drejtimit dhe palëve të ngarkuara me qeverisjen për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me IFRS-të, si edhe për sistemin e kontrollit të brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Fondit për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënime shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Fondit, dhe të përdorë parimin kontabël të vijimësisë, përveç rasteve kur drejtimi ka ose për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveçse sa më lart. Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Fondit.

## Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve

do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Gjithashtu, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, hartojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale, si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të sistemeve të kontrolleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të përshtatshme me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e sistemeve të kontrolleve të brendshme të Fondit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimisë së të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Fondit për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vemendjen në raportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërpreje të aftësisë së Fondit për vazhduar në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare prezantojnë transaksionet dhe ngjarjet thelbësore në një mënyrë që arrin prezantimin e drejtë.

Ne komunikojmë me palët e ngarkuara me qeverisjen e fondit, ku përveç çështjeve të tjera, komunikojmë edhe qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në sistemin e kontrollit të brendshëm që është identifikuar gjatë auditimit tonë.

*Deloitte Audit Albania sh.p.k*  
 Deloitte Audit Albania sh.p.k  
 Rr. Elbasanit, Pallati poshtë Fakultetit  
 Gjeologji - Miniera,  
 Tirana, Shqipëri  
 Numër identifikimi unik i subjektit  
 (NUIS): L41709002H

**DELOITTE AUDIT ALBANIA**  
 Adr: Elbasanit, Pll. nr. 1, H. 2, poshtë Fakultetit Gjeologji Miniera  
 Tel: 0445 17920  
 NPT: L 41709002 H TIRANA - ALBANIA

Enida Cara  
 Auditues ligjor  
 Partner Angazhimi



Tiranë, Shqipëri  
 3 prill 2018

## Pasqyra e fitim ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017

(shumat në mijë Lek)

<b>Të ardhura</b>	<b>Shënime</b>	<b>31 Dhjetor 2017</b>	<b>31 Dhjetor 2016</b>
Të ardhura nga interesi	8	375,332	340,485
Të ardhura/humbje neto të realizuara nga investimet në letra me vlerë	9	174,863	308,640
Të ardhura të tjera		44,858	21,533
<b>Totali i të ardhurave neto</b>		<b>595,053</b>	<b>670,658</b>
<b>Shpenzime</b>			
Tarifa e Shoqërisë së Administrimit		<b>(214,407)</b>	<b>(197,089)</b>
Shpenzime të tjera operacionale		210	(164)
Humbje neto nga kursit i këmbimit	10	(151,558)	(202,465)
<b>Totali i shpenzimeve</b>		<b>(365,755)</b>	<b>(399,718)</b>
<b>Rritja në aktivet neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave nga aktiviteti i investimit</b>		<b>229,298</b>	<b>270,940</b>
<b>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse</b>			
Instrumente të vlefshme për shitje: <i>Ndyshimi i vlerës së drejtë të instrumenteve të vlefshme për shitje</i>		-	-
<b>Të ardhura të tjera përmbledhëse për vitin</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse</b>		<b>229,298</b>	<b>270,940</b>


Shënimet nga faqja 103 në 125 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

## Pasqyra e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2017


(shumat në mijë Lek)

<b>AKTIVET</b>	<b>Shënime</b>	<b>31 Dhjetor 2017</b>	<b>31 Dhjetor 2016</b>
Aktive financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes	11	10,387,789	8,651,237
Kuota ne fonde investimi	13	3,618,106	2,172,958
Paraja dhe ekuivalentë të saj	14	623	241
Llogari të arkëtueshme të tjera		738,862	2,810,559
<b>TOTALI</b>		<b>14,745,380</b>	<b>13,634,995</b>
<b>DETYRIMET</b>			
Detyrime ndaj Shoqërisë së Administrimit		18,755	17,262
Detyrime për kërkesa tërheqje nga fondit		11,746	8,860
Detyrime të tjera	15	1,437	2,438
<b>TOTALI I DETYRIMEVE</b>		<b>31,938</b>	<b>28,560</b>
<b>AKTIVET NETO QË I ATRIBUOHEN MBAJTËSVE TË KUOTAVE</b>	<b>16</b>	<b>14,713,442</b>	<b>13,606,435</b>
<b>Numri i kuotave të emetuara të fondit</b>		<b>946,389</b>	<b>883,843</b>
<b>AKTIVET NETO PËR NJËSI</b>		<b>15,547</b>	<b>15,395</b>

Këto pasqyra financiare janë miratuar më 28 Mars 2018 në emër të Fondit nga Këshilli i Administrimit të Raiffeisen INVEST – Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a. dhe u firmosën nga:

  
Administratore e Përgjithshme  
Edlira KONINI



  
Zv.Administratore e Përgjithshme  
Alketa EMINI

Shënimet nga faqja 103 në 125 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

## Pasqyra e ndryshimeve të aktiveve neto që i atribuohen mbajtësve të njësisve për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në mijë Lek)

	<b>Shënime</b>	<b>Viti i mbyllur në 31 Dhjetor 2017</b>	<b>Viti i mbyllur në 31 Dhjetor 2016</b>
Aktive neto që i atribuohen kontribuesve më 1 janar		<b>13,606,435</b>	<b>10,355,508</b>
Kontribute		3,516,704	7,132,028
Rritja neto nga transkasionet e shitjes se kuotave		(2,638,994)	(4,152,041)
<b>Rritja neto nga transaksionet</b>		<b>14,484,145</b>	<b>2,979,987</b>
Rritja në aktivet neto që i atribuohen kontribuesve nga aktiviteti i investimit		229,298	270,940
<b>Aktive neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave</b>	<b>15</b>	<b>14,713,442</b>	<b>13,606,435</b>
<b>NUMRI I KUOTAVE TË INVESTIMIT</b>			
Njësi të emetuara mbi bazën e kontributeve		227,514	462,184
Njësi të tërhequra për shkak të pagesave të përfitimeve		(164,968)	(266,801)
<b>RRITJE NË NUMRIN E KUOTAVE TË FONDIT</b>		<b>62,546</b>	<b>195,383</b>

Shënimet nga faqja 103 në 125 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

## Pasqyra e flukseve te mjeteve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në mijë mijë Lek)

Shënime	Viti i mbyllur në 31 Dhjetor 2017	Viti i mbyllur në 31 Dhjetor 2016
<b>Flukset e parasë nga aktiviteti operacional</b>		
<b>Rritja në shumën që i atribuohet kontribuesve</b>	<b>229,298</b>	<b>270,940</b>
<b>Rregullime për:</b>		
Fitime të perealizuara nga rivlerësimi i aktiveve financiare të mbajtura në vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes	(201,627)	(333,552)
Të ardhura nga interesi 8	(382,394)	(340,485)
Tarifa e Shoqërisë Administruese	214,407	197,089
<b>Flukset e parasë të përdorura në aktivitetet operacionale</b>	<b>(140,316)</b>	<b>(206,008)</b>
Rritja në aktivet financiare me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes	(1,131,268)	(1,250,908)
Rritja në aktivet financiare të mbajtura deri në maturim	-	336,413
Rritja në Investimet në kuota	(1,442,465)	(1,469,478)
Zvogëlimi në detyrimet ndaj Shoqërisë Administruese	-	3,993
Zvogëlimi në detyrimet e tjera	(1,001)	(329)
<b>Flukset e parasë të përdorura në aktivitetet operacionale</b>	<b>(2,715,050)</b>	<b>(2,586,317)</b>
Interesi i arkëtuar	(24,328)	423,026
Tarifa e paguar e Shoqërisë Administruese	(212,914)	(161,986)
<b>Flukset e parasë neto nga të përdorura në aktivitetet operacionale</b>	<b>(2,952,292)</b>	<b>(2,457,203)</b>
Kontribute marrë nga mbajtësit e njësisë	3,516,704	7,132,028
Kontributet të paguara mbajtësive të njësisë	(2,636,109)	(4,152,041)
<b>Flukset e parasë neto (të përdorura) / nga aktivitetet financuese</b>	<b>880,595</b>	<b>2,979,987</b>
<b>Rritje neto në e flukset e mjeteve monetare</b>	<b>(2,071,697)</b>	<b>522,717</b>
Mjete monetare në fillim të vitit 13	2,810,559	2,287,775
<b>Mjete monetare në fund të vitit 13</b>	<b>738,862</b>	<b>2,810,559</b>

Shënimet nga faqja 103 në 125 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

# 1. HYRJE

Fondi i investimit Raiffeisen Invest Euro ("Fondi") është një fond investimi me ofertë publike i licensuar nga Autoriteti i Mbykqyrjes Financiare ("AMF") bazuar në ligjin nr. 10198 më datë 10 Dhjetor 2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive" dhe bazuar në vendimin nr. 180 më datë 13 Dhjetor 2011.

Aktivitetet investuese të fondit manaxhohen nga Raiffeisen INVEST sh.a – Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive ("Shoqëria Administruese").

Objekti i Fondit është që ti japë investitorit një kthim nga investimi në përputhje me një menaxhim të kujdesshëm të portofolit, duke ruajtur nivelin e kapitalit dhe të likuiditetit të nevojshëm.

Te ardhurat nga investimi në Fond janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat personale dhe lidhen me të ardhurat kapitale të kontribuesve të cilat taten në normën 15%. Shoqëria e Administrimit vepron si një agjent mbledhës në emër të Fondeve.

Fondi i ofron investimin në kuota një grupi të gjerë investitorësh të cilët janë kryesisht individë.

Mbështetur në Ligjin nr. 10197, datë 10.12.2009, Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare ka miratuar First Investment Bank Albania sh.a. si bankë depozitare e Fondit të Investimit Raiffeisen Invest Euro ("Depozitari"). Shoqëria Administruese dhe Depozitari do të mbajnë aktivet, veprimet dhe regjistrimet e veta të ndara nga aktivet, veprimet dhe regjistrimet kontabël të Fondit të Investimit Raiffeisen Invest Euro.

Këto pasqyra financiare janë autorizuar për publikim nga Bordi i Drejtorëve më 28 mars 2018.

## 2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

Politikat kryesore kontabël të zbatuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë të paraqitura më poshtë. Këto politika janë aplikuar në vazhdimësi në të gjitha vitet e paraqitur, nëse nuk shprehet ndryshe.

### a) Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare të Fondit Raiffeisen Invest Euro janë përgatitur mbi një bazë vijimësie dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Pasqyrat financiare janë përgatitur nën parimin e kostos historike, siç modifikohen nga rivlerësimi i aktiveve financiare dhe pasiveve financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek Shqiptar ("Lek"), nëse nuk është shprehur ndryshe. Nëse nuk është shënuar, informacioni financiar i raportuar në Lek është rrumbullakosur në mijëshen më të afërt.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon përdorimin e vlerësimeve kontabël kritike. Ajo gjithashtu kërkon që Shoqëria Administruese të ushtrojë gjykimin e saj në procesin e zbatimit të politikave kontabël për Fondin. Ndryshimet në supozime mund të ketë një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare në periudhën që supozimet kanë ndryshuar. Manaxhimi beson se supozimet e aplikuar janë të përshtatshme dhe se për këtë arsye pasqyrat financiare të Fondit paraqesin gjendjen financiare dhe rezultatet në mënyrë të drejtë. Zonat që përfshijnë një shkallë më të lartë të gjykitimit ose kompleksitetit, apo fushat ku supozimet dhe vlerësimet janë të rëndësishme për pasqyrat financiare janë paraqitur në Shënimin 7.

### b) Standarde dhe Interpretime në fuqi për periudhën raportuese

Ndryshimet e mëposhtme të standardeve ekzistuese të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe interpretimet e publikuara nga Komiteti i Interpretimeve të Raportimeve Financiare Ndërkombëtare janë në fuqi për periudhën raportuese:

- **Ndryshime në SNK 7 " Pasqyra e Levizjes së Parasë"**- Iniciativa e informacioneve shpjeguese (efektive për periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 Janar 2017),
- **Ndryshime në SNK 12 "Tatimi mbi të Ardhurat"** – Njohja e aktiveve tatimore të shtyra për humbjet e parealizuar ( efektive për periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 Janar 2017),

## 2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### b) Standarde dhe Interpretime në fuqi për periudhën raportuese (vazhdim)

- **Ndryshime në SNRF 12 si pasojë e “Përmirësimeve të SNRF-ve ( cikli 2014-2016)”** rezultuar nga projekti i përmirësimit vjetor të SNRF ( SNRF 1, SNRF 2, dhe SNK 28) kryesisht me një pikëpamje për të eliminuar mospërputhjet dhe për të qartësuar formulimin (ndryshimet mbi SNRF 12 do të jenë të aplikueshme për periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 Janar 2017).

Këto ndryshime në standardet dhe interpretimet ekzistuese nuk kanë ndikuar në politikat kontabël, pozicionin financiar dhe performancën e Fondit.

### c) Standarde dhe interpretime në publikim akoma jo në fuqi

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet, përmirësimet dhe interpretimet e mëposhtme ishin ish-in në fuqi që prej 1 Janar 2015 dhe nuk janë aplikuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare. Asnjë prej tyre nuk pritet të ketë efekt të ndjeshëm në pasqyrat e Fondit.

- **SNRF 9 “Instrumentat financiare”** (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2018)

Fondi parashikon se zbatimi i SNRF 9 në të ardhmen mund të ketë një ndikim në shumat e njohura në aktivet dhe detyrimet financiare. Pritet që SNRF 9 të rrisë nivelin e përgjithshëm të provigjoneve për aktivet dhe detyrime. Parashikimi është i bazuar në një kërkesë për të njohur provigjionet në shumën e parashikuar të kredive të pashlyera.

Fondi do të aplikojë SNRF 9 në 1 Janar 2018, sipas versionit të publikuar në Korrik 2014 dhe do të përshtasë ndryshimet e SNRF 9 në të njëjtën datë. Si rezulta, asnjë diferencë në përputhje me SNK 39 në modelin e provigjoneve të humbjeve të shkaktuara dhe në përputhje me SNRF 9 modeli i provigjoneve të humbjeve të kredituara është i pritshëm.

Më 27 dhjetor 2017, Parlamenti Europian publikoi rregulloren (EU) 2017/2395 mbi kërkesat në tranzicion drejt SNRF 9. Rregullorja mundëson zgjedhjen midis dy metodave të ndryshme për të përcaktuar efektin e implementimit të standartit në kapitalin rregullator:

- Njohja e efektit të plotë në mënyrë lineare, e shpërndarë në një periudhë 5 vjeçare, ose
- Njohja e impaktit të plotë në ditën e përshtatjes.

Fondi ka vendosur të aplikojë metodën e dytë.

#### Klasifikimi dhe Matja e Përgjithshme

SNRF 9 përmban një përjasje të re për klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare, që reflekton modelin e biznesit sipas të cilit menaxhohen aktivet dhe karakteristikat e fluksit të parasë së tyre.

Fondi do të aplikojë katër kategori për klasifikimin e Aktiveve Financiare:

- Aktivet financiare të matura me kosto të amortizuara (KA)
- Aktivet financiare të matura me vlerë së drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDNATGJ)
- Aktivet Financiare të detyrueshme për tu matur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim-humbjes (VDNFH) dhe
- Aktive Financiare të matura me vlerë të drejtë nëpërmjet pasqyrave të fitim-humbjes (VDNFH)

Kategoritë ekzistuese të SNK 39 si: të mbajtura deri në maturim, kredi dhe llogari të arkëtueshme, të vlefshme për shitje do të eliminohen.

Aktivitet Financiare do të maten me koston e amortizuar nëse plotësohen të dy kushtet e mëposhtme:

- Aktivi mbahet sipas një modeli biznesi, objektivi i të cilit është të mbajë aktive financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale
- Kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar shprehin qartë termat kohorë të flukseve monetare, të cilat janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit mbi principalin e mbetur.

Objektivi i një modeli biznesi mund të jetë mbajtja e aktiveve financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale, edhe në rastin kur shitje të aktiveve financiare kanë ndodhur ose priten që të ndodhin.

Një aktiv financiar klasifikohet si i matur me VDNATGJ nëse ai mbahet nëpërmjet një modeli biznesi, objektivi i të cilit është të mbledhë flukse monetare kontraktuale dhe të shesë aktive financiare, kur kushtet kontraktuale të aktiveve financiare specifikojnë datat e caktuara të flukseve monetare, të cilat janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit



## 2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### c) Standarde dhe interpretime në publikim akoma jo në fuqi (vazhdim)

mbi principalin e mbetur.

Për njohjen fillestare të një instrumenti kapitali neto që nuk mbahet për shitje, Fondi mund të zgjedhë të paraqesë në mënyrë të pakthyeshme ndryshimet e mëvonshme në vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. Kjo përzgjedhje bëhet për çdo investim individualisht dhe mbulon interesa strategjike që nuk paraqiten plotësisht në mënyrë të konsoliduar. Të gjithë aktivet e tjerë financiare, që nuk plotësojnë kriteret për tu klasifikuar si të matura me koston e amortizuar ose VDNATP, klasifikohen si të matura me vlerën e drejtë, ndryshimet e të cilës njohen në fitim-humbje. Si rrjedhojë, Fondi ka mundësinë që në njohjen fillestare të përcaktojë në mënyrë të pakthyeshme një aktiv financiar, matja e të cilit bëhet me VDNFVH, nëse të vepruarit në këtë mënyrë eliminon ose redukton ndjeshëm një mospërputhje matjeje ose njohjeje, për shembull një mospërputhje kontabël që do të lindte nga matja e aktiveve ose detyrimeve, ose njohja e fitimeve dhe humbjeve në to, në baza të ndryshme. Një aktiv financiar klasifikohet në një nga këto kategori në njohjen e tij fillestare.

#### Vlerësimi i modelit të biznesit

Fondi ka vlerësuar objektivin e modelit të biznesit në të cilin një aktiv financiar mbahet në nivel portofoli, dhe kjo reflekton më së miri mënyrën se si menaxhohet biznesi dhe se si informacioni i përcillet drejtimit.

Në vlerësimin se cili model biznesi është i përshtatshëm, janë shqyrtuar kriteret e mëposhtme:

- Si performanca e modelit të biznesit (dhe aktiveve financiare të këtij modeli) janë vlerësuar dhe raportuar drejt personelit drejtues të njësisë ekonomike;
- Si ndikojnë rreziqet në performancën e modelit të biznesit (dhe aktiveve financiare të mbajtura brenda atij modeli) dhe mënyra e menaxhimit të këtyre rreziqeve;
- Si kompensohen drejtuesit e biznesit, p.sh. nëse kompensimi bazohet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare ose në flukset monetare kontraktuale të mbledhura;
- Frekuenca, vlera dhe koha e realizimit të shitjeve në periudhat e mëparshme, arsyet për shitjet dhe pritshmëria për aktivitetin e ardhshëm të shitjeve; dhe
- Nëse aktiviteti i shitjeve dhe mbledhja e flukseve monetare kontraktuale janë pjesë integrale e modelit të biznesit apo ndodhin në mënyrë të rastësishme (modelet mbajtur deri në maturim dhe mbajtur për shitje)

Aktivitetet financiare që mbahen për tregtim dhe ato që vlerësohen me vlerë të drejtë do të maten me VDNFVH.

#### Analizë e Karakteristikave të Flukseve Monetare Kontraktuale

Pasi Fondi përcakton se modeli i biznesit të një portofoli specifik është mbajtja e aseteve financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale (ose njëkohësisht mbledhja e flukseve monetare kontraktuale dhe shitja e aktiveve financiare), duhet të vlerësojë nëse kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar specifikojnë datat e caktuara të flukseve monetare, të cilat janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit mbi principalin e mbetur. Për këtë qëllim, interesi përcakton vlerën në kohë të parasë, rrezikun e kredisë që lidhet me shumën e principalit të papaguar gjatë një periudhe të caktuar kohore. Rreziqe dhe kosto të tjera themelore të huadhënies, si dhe një marzhin e fitimit. Ky vlerësim do të kryhet për çdo instrument në datën e njohjes fillestare të aktivitetit financiar.

Kur vlerëson nëse flukset monetare kontraktuale janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit, Fondi do të marrë parasysh kushtet kontraktuale të instrumentit. Kjo do të përfshijë vlerësimin nëse aktivi financiar përmban një kusht kontraktual që mund të ndryshojë kohën ose shumën e flukseve të mjeteve monetare kontraktuale në mënyrë që të mos plotësojë këtë kusht.

Fondi do të marrë në konsideratë:

- Parapagimin, kushtet e zgjatjes së kontratës
- Veçoritë e levës financiare
- Nëse një kusht i kontratës është i limituar në aktive ose flukse monetare specifike
- Instrumentet e lidhura me kontratë

Në vitin 2018, BSNK publikoi një amendament për SNRF 9 në lidhje me tiparet e parapagimit me kompensim negativ. Kompensimi negativ lind kur kushtet kontraktuale lejojnë huamarrësin të parapagujë instrumentin para maturimit kontraktual, por shuma e parapagimit mund të jetë më e vogël se shumata e papaguar të principalit dhe interesit. Megjithatë, për t'u kualifikuar për matjen me anë të Kostos së Amortizuar, kompensimi negativ duhet të jetë kompensim i arsyeshëm për përfundimin e parakohshëm të kontratës. Fondi nuk pret një volum të lartë të parapagimeve me kompensim negativ, i cili duhet të matet detyrimisht me VDNFVH.

## 2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### c) Standarde dhe interpretime në publikim akoma jo në fuqi (vazhdim)

#### **Modifikimi i vlerës kohore të parasë dhe testit të vlerësimit**

Vlera në kohë e parasë është elementi i interesit që merr në konsideratë kalimin e kohës (SNRF 9. B4. 1.9A). Nuk merr parasysh rreziqet e tjera (kredisë, likuiditet etj) ose kostot (administrative, etj.) të lidhura me mbajtjen e një aktivi financiar.

Në disa raste, elementi i vlerës në kohë të parasë mund të mos jetë plotësisht i saktë. Një rast i tillë ndodh kur norma e interesit e një aktivi financiar rivendoset periodikisht, por frekuenca e kësaj rivendosjeje nuk përputhet me maturitetin e normës së interesit. Në këtë rast njësitë duhet të vlerësojnë modifikimin, në mënyrë që të përcaktojnë nëse flukset monetare kontraktuale përfaqësojnë akoma pagesa vetëm të interesit dhe principalit, që do të thotë maturiteti i rivendosjes nuk ndryshon ndjeshëm flukset e mjeteve monetare nga një instrument standard i përsosur.

#### **Vlerësimi i ndikimit në klasifikim dhe matje**

SNRF 9 do të ndikojë në klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare të mbajtura të Fondit më 1 Janar 2018 si më poshtë:

Kreditë dhe paradhëniet për fondit dhe klientët, të klasifikuar si hua dhe llogari të arkëtueshme të matura me koston e amortizuar sipas SNK 39, do të maten me koston e amortizuar në përputhje me SNRF 9.

Aktivet financiare të mbajtura deri në maturim, të matura me koston e amortizuar sipas SNK 39, si rregull gjithashtu do të maten me koston e amortizuar në përputhje me SNRF 9.

Instrumentet e borxhit të vlefshëm për shitje, të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet kapitalit sipas SNK 39, si rregull gjithashtu do të maten në VDNATGJ në përputhje me SNRF 9.

#### **Kontabiliteti mbrojtës**

SNRF 9 lejon opsionet e kontabilitetit mbrojtës. Fondi planifikon të vazhdojë të zbatojë dispozitat për kontabilitetin mbrojtës në përputhje me SNK 39, duke marrë parasysh ndryshimet të paraqitura në shënimet shpjeguese sipas SNRF 7.

#### **Zhvlerësimi i përgjithshëm**

Llogaritja e humbjeve të pritura të kredisë kërkon përdorimin e parashikimeve kontabël të cilat, sipas përkufizimit, rrallëherë do të jenë të barabarta me rezultatet aktuale. Drejtimi ushtron gjykim në zbatimin e politikave kontabël të Grupit.

Fondi vlerëson në bazë të parashikimit humbjet e pritura të kredisë të lidhura me aktivet e saj të borxhit të mbartura me koston e amortizuar dhe VDNATGJ, dhe me ekspozimin që rrjedh nga angazhimet e huasë, kontratat e qirasë dhe kontratat e garancisë financiare. Fondi njej provigjon për humbje të tilla në çdo datë raportimi.

#### **Matja e humbjeve të pritshme të kredisë**

Matja e humbjeve të pritura të kredisë pasqyron një vlerë të paanshme dhe me probabilitet të ponderuar që përcaktohet duke vlerësuar një sërë re zultatesh të mundshme, vlerën në kohë të parasë dhe informacionin e arsyeshëm dhe të mbështetur që është në dispozicion pa kosto ose përpjekje të panevojshme në datën e raportimit për ngjarjet e kaluara, aktuale dhe parashikimet e kushteve të ardhshme ekonomike.

Matja e lejueshmerisë për humbjet e pritshme të kredisë për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar dhe vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, është një zonë që kërkon përdorimin e modeleve komplekse dhe supozimeve të rëndësishme në lidhje me kushtet e ardhshme ekonomike dhe sjelljen e kredisë. Vlerësime të rëndësishme:

- Përcaktimi i kritereve për rritje të ndjeshme të rrezikut të kredisë
- Zgjedhja e modeleve dhe supozimeve të përshtatshme për matjen e humbjeve të pritura të kredisë
- Vendosja e numrit dhe peshave relative të skenarëve të ardhshëm për secilin lloj produkti/tregu dhe humbjet e pritura të kredisë të lidhura
- Krijimi i grupeve të aktiveve financiare të ngjashme me qëllim matjen e humbjeve të pritshme të kredisë.

Vlerësimi i ekspozimit të kredisë për qëllime të menaxhimit të rrezikut është kompleks dhe kërkon përdorimin e modeleve. Vlerësimi i rrezikut të kredisë për një portofol të aktiveve përfshin vlerësime të mëtejshme në lidhje me mundësitë e mosshlyerjeve të ndodhura, të raporteve të lidhura me humbjen dhe korrelacioneve të mosshlyerjeve ndërmjet palëve. Fondi mat rrezikun e kredisë duke përdorur probabilitetin e mosshlyerjes së kredive, ekspozimin në mosshlyerje të kredisë dhe humbjet nga mosshlyerja. Kjo është një metodë mbizotëruese e përdorur për qëllimet e

## 2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### c) Standarde dhe interpretime në publikim akoma jo në fuqi (vazhdim)

matjes së humbjeve të pritshme të kredisë sipas SNRF 9.

SNRF 9 përshkruan një model me tre hapa për zhvlerësimin bazuar në ndryshimet në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare. Ky model kërkon që një instrument financiar, i cili nuk është i zhvlerësuar nga kreditë në njohjen fillestare, klasifikohet në Fazën 1 dhe rreziku i tij i kreditit monitorohet vazhdimisht. Nëse është identifikuar një rritje e ndjeshme e rrezikut të kredisë që nga njohja fillestare, instrumenti financiar kalon në Fazën 2, por nuk konsiderohet të jetë i zhvlerësuar nga kredia. Nëse instrumenti financiar është i zhvlerësuar nga kreditimi, instrumenti financiar më pas zhvendoset në Fazën 3.

Për instrumentet financiare në Fazën 1, humbja e pritshme e kredisë matet me një shumë të barabartë me pjesën e humbjeve të pritshme të kredisë që rezultojnë nga ngjarjet e mundshme gjatë 12 muajve të ardhshëm. Instrumentet në Fazat 2 ose 3 kanë humbjet e pritshme të kredive të matura në bazë të humbjeve të pritura të kredisë gjatë gjithë jetëgjatësisë. Sipas SNRF 9, kur matet humbja e pritshme e kredisë është e nevojshme të merret në konsideratë informacioni për të ardhmen. Aktivët financiare të blera ose me origjinë nga kreditë e zhvlerësuar janë aktive financiare të cilat janë të zhvlerësuar nga kredia në njohjen fillestare. Humbja e pritshme e kreditit matet në vazhdimësi të jetës (Faza 3).

#### Rritja e ndjeshme e rrezikut të kredisë

Fondi konsideron që një instrument financiar ka përjetuar një rritje të ndjeshme të rrezikut të kredisë kur një ose më shumë nga kriteret e mëposhtme sasiore, cilësore ose ndaluese të mëposhtme janë plotësuar:

#### Kriteret sasiore

Fondi përdor kriteret sasiore si tregues parësor të rritjes së konsiderueshme të rrezikut të kredisë për të gjitha portofolet materiale.

Për vlerësimin sasiore, Fondi krahason kurbën e probabilitetit të mospagimit për të gjithë jetëgjatësinë me të dhënat e matura, me kurbën e ardhshme të probabilitetit të mos pagimit në datën e njohjes fillestare. Për vlerësimin e kurbës së probabilitetit të mospagimit për të gjithë jetëgjatësinë në datën e njohjes fillestare, bëhen supozime rreth strukturës së saj. Për instrumentet financiare me vlerësim të lartë, supozohet se kurba do të përkeqësohet me kalimin e kohës. Për instrumentet financiare me vlerësim të ulët, supozohet se kurba do të përmirësohet me kalimin e kohës. Shkalla e përmirësimit ose përkeqësimit do të varet nga niveli i vlerësimit fillestar.

Fondi nuk është në dijeni të ndonjë praktike tregu të pranuar përgjithësisht, e cila specifikon një nivel për të cilin një instrument financiar duhet të transferohet në Fazën 2. Nga kjo perspektivë, pritet që rritja e probabilitetit të mospagimit në datën e raportimit, e cila konsiderohet e rëndësishme, do të zhvillohet gjatë një periudhe kohore si rezultat i një procesi përsëritës ndërmjet pjesëmarrësve të tregut dhe mbikëqyrësve.

#### Kriteret cilësore

Fondi përdor kriteret cilësore si një tregues dytësor për rritje të rëndësishme të rrezikut të kredisë për të gjitha portofolet materiale. Transferimi në Fazën 2 zhvillohet kur plotësohen kriteret e mëposhtme.

Për portofolet qeveritare, fondire, të korporatave dhe të financave të projektit, nëse huamarrësi plotëson një ose më shumë nga kriteret e mëposhtme:

- Treguesit e jashtëm të tregut
- Ndryshime në kushtet e kontratës
- Ndryshime në qasjen e drejtimit
- Gjykimi i ekspertëve

Vlerësimi i një rritjeje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë përfshin informacione të ardhshme dhe kryhet në baza tremujore në një nivel marrëveshjeje për të gjithë portofolet jo të tregtueshme të mbajtur nga Fondi.

Për portofolet e tregëtueshme, nëse huamarrësi plotëson një ose më shumë nga kriteret e mëposhtme:

- Lëshime përpara i përket marrëveshjes së kredisë, kur huamarrësi po kalon vështirësi
- Gjykimi i ekspertëve

Vlerësimi i një rritjeje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë përfshin informacion për të ardhmen dhe kryhet në baza mujore në një nivel marrëveshjeje për të gjitha portofolet retail të mbajtura nga Fondi.

## 2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### c) Standarde dhe interpretime në publikim akoma jo në fuqi (vazhdim)

#### Ndalesa

Nëse një huamarrës vonohet më shumë se 30 ditë për pagesat e tij kontraktuale, instrumenti financiar mendohet të ketë patur një rritje të ndjeshme në rrezikun e kredisë dhe në këtë rast, aplikohet një ndalesë. Në disa raste të kufizuara, supozimi se aktivet financiare të cilat janë më shumë se 30 dite vonesa duhet të kalojnë në Fazën 2, hidhet poshtë.

Fondi nuk ka përdorur përjashtimin që vjen nga rreziku i ulët i kredisë për klientët huamarrës; megjithatë, përdor në mënyrë selective përjashtimin që vjen nga rreziku i ulët i kredisë për instrumentat e borxhit.

#### Përcaktimi i mospagimit dhe aktiveve të zhvlerësuara nga kreditimi

Fondi përcakton që një instrument financiar është në mospagim, i cili është plotësisht i linjësuar me përkufizimin e zhvlerësimit nga kreditimi, kur plotëson një ose më shumë nga kriteret e mëposhtme:

- Huamarrësi është më shumë se 90 ditë me vonese për pagesat e tij kontraktuale;
- Nuk është bërë asnjë përpjekje për të hedhur poshtë supozimin se asetet financiare të cilat janë më shumë se 90 ditë me vonese duhet të jenë në Fazën 3.

Huamarrësi ka gjasa për të mos paguar, që tregon se është në vështirësi të konsiderueshme financiare. Këto janë raste kur:

- Huamarrësit i janë mundësuar lëshime për një afat të gjatë për shkak të vështirësive që është duke kaluar ose mund të kalojë
- Huamarrësi është i vdekur
- Huamarrësi është i paaftë të paguajë
- Huamarrësi është në kundërshtim me kushtet financiare të kontratës
- Nuk ka një treg aktiv për aktivin financiar për shkak të vështirësive financiare
- Është e mundshme që huamarrësi të hyjë në falimentim
- Aktivet financiare janë blerë ose origjinojnë me një zbritje të thellë nga cmimi, që pasqyron humbjet e shkaktuara të kredisë.

Kriteret e mësipërme janë zbatuar mbi të gjitha instrumentet financiare të mbajtura nga Fondi dhe janë në përputhje me përkufizimin e mospagimit të përdorur për qëllime të menaxhimit të brëndshëm të rrezikut të kredisë.

#### Shpjegimi i të dhënave, supozimeve dhe teknikave të vlerësimit

Humbja e pritshme e kredisë matet në bazë të një periudhe 12-mujore ose jetëgjatësisë, në varësi të faktit nëse ka ndodhur një rritje e konsiderueshme në rrezikun e kredisë që nga njohja fillestare ose nëse një aktiv konsiderohet si i dëmtuar nga kredia.

Informacioni ekonomik për të ardhmen gjithashtu përfshihet në përcaktimin e probabilitetit të mospagimit 12-mujor dhe të probabilitetit të mospagimit për të gjithë jetëgjatësinë e aktivitetit, ekspozimit në mospagim dhe humbja nga mospagimi. Këto supozime ndryshojnë sipas llojit të produktit. Humbjet e pritshme të kredisë janë prodhimi i probabilitetit të mospagimit, humbja nga mospagimi, ekspozimi në mospagim dhe faktorit skontues (FS).

#### Probabiliteti i mosshlyerjes

Probabiliteti i mosshlyerjes paraqet mundësinë që një huamarrës nuk përmbush detyrimet financiare gjatë 12 muajve të ardhshëm ose gjatë jetës së mbetur të detyrimit. Si rregull, probabiliteti i mosshlyerjes është llogaritur duke përdorur probabilitetin rregullator 12 mujor të mosshlyerjes, pa asnjë marzh konservativizmi. Më pas përdoren metoda të ndryshme statistikore për të gjeneruar një vlerësim se si do të llogaritet profili i mosshlyerjes nga pika e njohjes fillestare e përgjatë gjithë jetës së kredisë ose portofolit të huave.

Në rastet e kufizuara kur disa të dhëna nuk janë në dispozicion, për llogaritjen përdoret grupimi, mesatarja ose krahasimi i të dhënave.

#### Humbja nga mosshlyerja

Humbja nga mosshlyerja, paraqet pritshmërinë që ka Fondi për shkallën e humbjes lidhur me ekspozimin që nuk është paguar në kohë. Kjo humbje varion sipas produktit apo palës së tretë nga e cila rrjedh. Humbja nga mospagimi shprehet si përqindje për njësi ekspozimi në kohën e mospagimit. Ajo llogaritet në bazë 12 mujore ose për të gjithë jetëgjatësinë, ku humbja nga mospagimi 12-mujor është përqindja e humbjes që pritet të pësohet nëse ndodh

## 2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### c) Standarde dhe interpretime në publikim akoma jo në fuqi (vazhdim)

mospagimi në 12 muajt e ardhshëm dhe humbja nga mospagimi gjatë jetës është përqindja e humbjes që pritet të pësohet nëse mospagimi ndodh gjatë jetës së mbetur.

#### **Ekspozimi i mosshlyerjes**

Ekspozimi në mospagim bazohet në shumat që Fondi pret që klientët t'i kenë borxh në kohën e mospagimit, gjatë 12 muajve të ardhshëm ose gjatë jetës së mbetur. Ekspozimi në Mospagim 12-mujor dhe gjatë jetëgjatësisë përcaktohen në bazë të profilit të pagesës së pritshme, e cila ndryshon sipas llojit të produktit. Për produktet e amortizueshme dhe huatë që mundësojnë shlyerjen e njëhershme të principalit në maturim (bullet), llogaritja e ekspozimit në mospagim është bazuar në shlyerjet kontraktuale të huamarrësit gjatë një periudhe 12 mujore ose për të gjithë jetëgjatësinë. Aty ku është e përshtatshme, në llogaritje merren parasysh supozimet e ripagimit/rifinancimit të parakohshëm.

Për produktet rrotulluese (revolving), ekspozimi në mospagim llogaritet duke l shuar shumës së tërhequr një faktor konvertimi të kedisë, i cili lejon tërheqjen e pritshme të kufirit të mbetur deri në kohën e mospagimit. Marzhet rregullatorë të kujdesshme hiqen nga faktori i konvertimit të kedisë. Në rastet e kufizuara kur disa të dhëna nuk janë plotësisht të disponueshme, për llogaritjen përdoret krahasimi i inpueteve.

#### **Faktori aktualizues**

Si rregull, për ekspozime në pasqyrën e pozicionit financiar që nuk janë qera financiare ose instrumenta të blerë ose të origjinuar nga zhvlerësimi i kredisë, norma aktualizuese e përdorur në llogaritjen e humbjes së pritshme të kredisë është norma efektive e interesit ose një përaftrim i saj.

Humbja e pritshme e kredisë është një produkt i Probabilitetit të mosshlyerjes, humbja nga mosshlyerja dhe Ekspozimi i mosshlyerjes, shumëzuar me probabilitetin e mungesës së mospagimit (probabilitetin e pagimit) të një periudhe më para periudhës kohore të konsideruar. Kjo e fundit shprehet nga funksioni i mbijetesës. Kjo llogarit vlerat e ardhshme të humbjeve të pritura të kredisë, të cilat pastaj skontojnë në datën e raportimit dhe më pas mbliohen. Vlerat e llogaritura të humbjeve të pritshme të kredisë peshohen me një skenar të ardhshëm.

Modele të ndryshme janë përdorur për të vlerësuar dispozitat e Fazës 3 të shumave të papaguara të kredisë dhe këto mund të grupohen në kategoritë e mëposhtme:

- Qeveritë, klientët korporata, financimet e projektit, institucionet financiare, qeveritë lokale dhe rajonale, kompanitë e sigurimeve dhe ndërmarrjet e investimeve kolektive - Provigjonet e Fazës 3 llogariten nga menaxherët e ristrukturimit që skontojnë flukset e pritshme të parasë sipas normës së përshtatshme efektive të interesit.
- Kredi me hipotekë për individë – Provigjonet e Fazës 3 krijohen duke llogaritur vlerën e zbritur të realizimit të kolateralit.
- Kreditë e tjera të shitjes me pakicë - Provigjonet e Fazës 3 gjenerohen duke llogaritur vlerësimin më të mirë statistikor të humbjes së pritshme, duke marrë parasysh kostot indirekte.

Nuk është bërë asnjë përpjekje për të hedhur poshtë supozimin se aktivet financiare që janë me më shumë se 90 ditë vonesë duhet të jenë në Fazën 3.

#### **Informacion për të ardhmen**

Vlerësimi i një rritjeje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë dhe llogaritja e humbjeve të pritura të kredisë përfshijnë informacion që shihet nga e ardhmja. Fondi ka kryer analiza historike dhe ka identifikuar variabla kryesorë ekonomike që ndikojnë në rrezikun e kredisë dhe humbjet e pritshme të kredisë për çdo portofol.

Gjykim i ekspertëve zbatohet në këtë proces. Parashikimet e variablave ekonomike (skenari ekonomik bazë) sigurohen nga Raiffeisen Research në baza tremujore dhe japin parashikimin më të mirë për ekonominë gjatë tre viteve të ardhshme. Pas tre vjetësh, për të projektuar variablat ekonomike për jetëgjatësinë e plotë të secilit instrument, përdoret një metodë e kthimit në mesatare, që do të thotë se variablat ekonomike kanë tendencë ose të jenë një normë mesatare afatgjatë ose të kenë një normë mesatare të rritjes afatgjatë deri në maturim. Ndikimi i variablave ekonomike mbi probabilitetin e mospagimit, humbja në mospagim dhe ekspozimi në mospagim përcaktohet duke përdorur regresionin statistikor për të kuptuar ndikimin që ndryshimet në këto variabla kanë pasur historikisht në normat e mospagimit dhe mbi përbërësit e humbjes në mospagim dhe ekspozimit në mospagim.

Përveç skenarit ekonomik bazë, Raiffeisen Invest gjithashtu ofron një skenar me rastin më të mirë dhe një skenar me rastin më të keq, të ponderuara për të siguruar kapërcimin e jo-linearitetit. Fondi ka arritur në konkluzionin se tre skenare ose më pak kapin në mënyrë të përshtatshme jo-linearitetin. Peshat e skenarit përcaktohen nga një kombinim i analizës statistikore dhe gjykimit të ekspertizës së kredisë, duke marrë parasysh gamën e rezultateve të mundshme që secili skenar i zgjedhur përfaqëson.

## 2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### c) Standarde dhe interpretime në publikim akoma jo në fuqi (vazhdim)

Fondi konsideron që këto parashikime përfaqësojnë vlerësimin më të mirë të rezultateve të mundshme dhe mbulojnë çdo jo-linearitet dhe asimetri të mundshme në portofolet e ndryshme të Fondit.

#### Analiza e ndjeshmërisë

Supozimet më të rëndësishme që ndikojnë në lejesën e humbjes së pritshme së kredisë janë si më poshtë:

- Portofolet e korporatave
  - Prodhimi i Brendshëm Bruto
  - Shkalla e papunësisë
  - Norma afatgjatë e obligacioneve qeveritare
  - Norma e inflacionit
- Portofole e tregtueshme
  - Prodhimi i Brendshëm Bruto
  - Shkalla e papunësisë
  - Çmimet e pasurive të paluajtshme

#### Tranzicioni

Ndryshimet në politikat kontabël që rrjedhin nga miratimi i SNRF 9 në përgjithësi do të zbatohen në mënyrë retrospektive, përveç siç përshkruhet më poshtë:

- Fondi do të përfitojë nga përjashtimi duke e lejuar atë të mos rishikojë informacionin krahasues për periudhat e mëparshme në lidhje me ndryshimet në klasifikimin dhe matjen (duke përfshirë zhvlerësim). Diferencat në vlerën kontabël të aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare që rezultojnë nga zbatimi i SNRF 9 njihen në fitimet e pashpërndara që nga 1 janari 2018.
- Vlerësimet e mëposhtme duhet të bëhen në bazë të fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë në datën e aplikimit fillestar:
  - Përcaktimi i modelit të biznesit në të cilin mbahet një aktiv financiar.
  - Emërtimi dhe revokimi i emërtimeve të mëparshme të aktiveve dhe detyrimeve të caktuara financiare të matura në VDNFH

Caktimi i disa investimeve strategjike që nuk mbahen për tregtim si në VDNATGJ.

**SNRF 15 "Të ardhura nga Kontratat me Klientët"** dhe ndryshime të mëtejshme (efektive duke filluar 1 Janar 2018 e në vazhdim),

**SNRF 16 "Qiratë"** (efektive duke filluar 1 Janar 2019 e në vazhdim),

**SNRF 17 "Kontratat e Sigurimit"** (efektiv më ose pas datës 1 Janar 2021),

**Ndryshimet në SNRF 2 "Pagesat bazuar në Aksione"**, - Klasifikimi dhe Matja e transaksioneve të pagesave me bazë aksionet (efektiv më ose pas datës 1 Janar 2018),

**Ndryshimet në SNRF 4 "Kontratat e sigurimit"** - Aplikimi i SNRF 9 "Instrumentat financiarë" me SNRF 4 "Kontratat e sigurimit" (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018, ose kur SNRF 9 "Instrumentat financiarë", është aplikuar për herë të parë),

**Ndryshimet në SNRF 9 "Instrumentat Financiarë"** – Veçoritë e Parapagimit me Kompensim Negativ (efektiv më ose pas datës 1 Janar 2019),

**Ndryshimet në SNRF 10 "Pasqyrat Financiare të Konsoliduara" dhe SNK 28 "Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta"** - Shitja apo Kontributi i aseteve mes një Investitori dhe bashkëpunëtorëve të tij, ose sipërmarrje të përbashkëta dhe ndryshimeve të mëtejshme (data efektive e shtyrë për kohë të pacaktuar derisa projekti kërkimor mbi metodën e kapitalit neto të jetë përfunduar),

**Ndryshimet në SNK 28 "Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta"**- interesa afatgjatë në Pjesëmarrje dhe Ndërmarrje të Përbashkëta (efektiv më ose pas datës 1 Janar 2019),

**Ndryshimet në SNK 40 "Aktivet Materiale Afatgjata të Investuara"** - Transferimet e aktiveve materiale

## 2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### c) Standarde dhe interpretime në publikim akoma jo në fuqi (vazhdim)

afatgjata te investuara (efektive më ose pas 1 janarit 2018),

**Ndryshime në disa standarde "Përmirësimet e SNRF-ve (2014 -2016)"** që rezultojnë nga projekti i përmirësimit vjetor të SNRF-ve (SNRF 1, SNRF 12, SNK 28) kryesisht me qëllim heqjen e mospërputhjeve dhe sqarimin e fjalëve (ndryshimet për SNRF 12 duhet të aplikohen për periudhatvjetore që fillojnë më apo pas datës 1 Janar 2017 dhe ndryshimet për SNK 28 duhet të aplikohen për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 Janar 2018).

**Ndryshimet në standardet e ndryshme "Përmirësimet në SNRF-të (cikli 2015-2017)"** që rezultojnë nga përmirësimi i përvitshëm të projektit të SNRF (SNRF 3, SNRF 11, SNK 12 dhe SNK 28) kryesisht me qëllimin që të shmangin mospërputhjet dhe të qartësojnë formulimin (efektiv në periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2019),

**IFRIC 22 "Transaksionet në monedhë të huaj dhe shqyrtimi i parapagesave"** (efektive për vjetore periudhat që fillojnë më ose pas datës 1 Janar 2018)

**KIRFN 23 "Pasiguria mbi Trajtimin e Tatimit mbi të Ardhurat"** efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).

Fondi ka zgjedhur të mos adoptojë këto standarde, rishqyrtime dhe interpretime përpara datës së tyre efektive. Drejtimi parashikon se adoptimi i këtyre standardeve nuk do të ketë impakt material në pasqyrat financiare të Fondit në periudhën fillestare të zbatimit nga Fondi.

### d) Entiteti i investimit dhe konsolidimi

Fondi ka investitorë të shumtë jo të lidhur dhe mban portofol investimesh të shumta. Fondi është caktuar që të plotësojë përkufizimin e një entiteti investimesh sipas SNRF 10, ndërsa kushtet e mëposhtme ekzistojnë:

- Fondi mbledh asete me qëllim që t'ju sigurojë investitorëve shërbime profesionale të menaxhimit të investimeve.
- Qëllimi i biznesit të Fondit, i cili u është komunikuar direkt investitoreve, është të investojë asetet me qëllim përfitimitin e të ardhurave nga kapitali dhe të ardhurave nga investimet.
- Investimet janë të matura dhe vlerësuar mbi bazën e vlerës së drejtë.

### e) Aktivet dhe detyrimet financiare

#### i Njohja

Aktivt financiare njihen në pasqyrën e pozicionit financiar në ditën kur entiteti bëhet palë kontraktuale në lidhje me një instrument në përputhje me blerjen e rregullt të tij. Një mënyrë e rregullt blerjeje ose shitjeje e një instrumenti financiar njih si datë kontabilizimi të aktivitetit, datën e shlyerjes. Dita e shlyerjes është dita kur aktivi i lëvrohet entitetit. Dita e shlyerjes i referohet a) njohjes së aktivitetit në ditën kur ai merret nga entiteti b) ç'rregjistrimit të aktivitetit dhe njohjes së fitimit/humbjes neto nga shitja në ditën kur ai livrohet/dërgohet nga entiteti. Kur aplikohet dita e shlyerjes, entiteti kontabilizon çdo ndryshim në vlerën e drejtë të aktivitetit gjatë periudhës midis datës së tregtimit dhe datës së shlyerjes. Me fjalë të tjera, ndryshimi në vlerë nuk njihet për aktivitet të mbajtura me kosto ose kosto të amortizuara; por njihet si fitim ose humbje për aktivitet e klasifikuar si aktive financiare të mbajtura me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes; dhe njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave përmbledhëse për aktivitet e vlefshme për shitje.

Detyrimet njihen fillimisht në datën kur entiteti bëhet palë e kontratës.

#### iii Ç'rregjistrimi

Fondi ç'rregjistron një aktiv financiar kur mbarojnë të drejtat kontraktuale të flukseve të parase nga aktivi financiar, ose kur të drejtat për të arkëtuar flukse monetare kontraktuale të aktivitetit financiar janë transferuar në një transaksion me të cilin transferohen kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktiv financiar. Fondi nuk njih një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale janë përmbushur, ndërprerë apo kanë përfunduar.

Fondi merr pjesë në transaksione me anë të të cilave transferon aktive të njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por mban në të gjitha ose kryesisht në të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivitetit të transferuar, ose një pjesë të tyre. Nëse të gjitha ose kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet mbahen, atëherë aktivitet e transferuara nuk çregjistrohen nga pasqyra e pozicionit financiar.

Në transaksionet në të cilat Fondi as nuk mban dhe as nuk transferon rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivitet financiare, aktivi ç'rregjistrohet nëse kontrolli mbi to humbet.

## 2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### e) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

#### iii *Matja e vlerës së drejtë*

Pas njohjes fillestare të gjitha aktivet financiare (përveç atyre të mbajtura deri në maturitet) maten me vlerën e drejtë. Përkufizimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare është përcaktuar duke përdorur teknika të vlerësimit. Metodat e vlerësimit përfshijnë teknikën e vlerës aktuale neto, metodën e flukseve monetare të skontuara dhe krahasimin me instrumente të tjerë të ngjashëm, për të cilat ekzistojnë çmime tregu dhe metoda vlerësimi. Ndryshimet në vlerën e drejtë janë njohur menjëherë në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave.

#### iv *Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit*

Në çdo datë raportimi Fondi vlerëson, nëse ka një evidencë objektive që aktivet financiare, të cilat nuk mbahen me vlerën e drejtë përmes fitim - humbjes, janë zhvlerësuar. Aktivet financiare zhvlerësohen kur evidenca objektive paraqet që një ngjarje që sjell humbje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit dhe që ngjarja që sjell humbje ka ndikim në flukset e ardhshme të parasë së aktivitetit, të cilat mund të maten me besueshmëri.

#### v *Investime të mbajtura deri në maturim*

Investimet e mbajtura deri në maturim janë aktive financiare me pagesa fikse ose të përcaktuara dhe maturitet të fiksuar që Shoqëria ka synimin e qartë dhe aftësinë për të mbajtur deri në maturim, dhe të cilat nuk janë përcaktuar me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes ose në dispozicion për shitje. Investimet e mbajtura deri në maturim mbahen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Çdo shitje ose riklasifikim i shumave të konsiderueshme të investimeve të mbajtura deri në maturim që nuk janë afër maturimit të tyre do të rezultonte në riklasifikimin e të gjithë investimeve të mbajtura deri në maturim si të disponueshme për shitje, dhe do të parandalonte Kompaninë të klasifikonte letrat me vlerë për qëllime investimi si instrumenta të mbajtura deri në maturim për periudhën aktuale dhe gjatë dy viteve financiare pasuese.

#### vi *Investimeve të mbajtura me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes*

Fondi mban disa instrumenta me vlerën e drejtë, me ndryshimet e vlerës së drejtë të njohura menjëherë në fitim ose humbje, siç përshkruhet në politikën kontabël 2 (c) (iii). Një prezantim të detajuar të matjeve të vlerës së drejtë paraqiten në shënimin 6 dhe 7.

### f) Mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre përfshijnë aktive financiare me shkallë likuiditeti të lartë, me maturitet më të vogël se tre muaj, të cilat nuk ndikohen shumë nga ndryshimet në vlerën e drejtë dhe përdoren nga Fondi për administrimin e angazhimeve afatshkurtra. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre mbahen në pasqyrën e pozicionit financiar me kosto të amortizuar.

### g) Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen në fillim në pasqyrën e pozicionit financiar me vlerën e drejtë dhe maten në vazhdim me kosto të amortizuar, duke i zbritur zhvlerësimin.

### h) Llogari të pagueshme dhe të tjera

Llogaritë e pagueshme dhe të tjera janë paraqitur me kosto të amortizuar.

### i) Rënia në vlerë e aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Fondit rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për zhvlerësim. Nëse ka evidenca të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Një humbje nga rënia në vlerë njihet nëse vlera kontabël e një aktiviteti ose e njësisë gjeneruese të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Një njësi gjeneruese e parasë është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse monetare që janë të pavarura nga aktiviteti dhe grupet e tjera. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në fitim ose humbje. Shuma e rikuperueshme e një aktiviteti ose e njësisë gjeneruese të parasë është më e madhe se vlera e tij në përdorim dhe se vlera e drejtë minus koston e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e ardhshme të parasë janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivitetin. Humbjet nga zhvlerësimi të njohura në periudhat e mëparshme vlerësohen në çdo datë raportimi për të parë nëse humbja është zvogëluar apo nuk ekziston. Humbja nga rënia në vlerë rimerret nëse ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga rënia në vlerë anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivitetit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin, në qoftë humbje nga rënia nuk ishte njohur.



## 2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### j) Kuotat e shlyeshme

Fondi emeton kuota te shlyeshme, me kerkese te investitorit. Kuotat klasifikohen si detyrime financiare. Çdo investitor qe ka bere shlyerje te kuotave te tij, mund te ri-vestoje ne Fond nepermjet depozitimit te mjeteve monetare ekuivalente me vleren e kuotave te kerkuara. Kuotat janë të shlyeshme cdo ditë. Ne momentin e kerkeses per shlyerje, kuotat që do te shlyhen mbarten në vleren e shlyerjes si detyrim i pagueshëm në pasqyrën e pozicionit financiar te Fondit.

### k) Vlera neto e asetëve

Vlera neto e asetëve është e barabartë me vlerën totale të aktiveve neto minus detyrimet e Fondit.

### l) Vlera e kuotës së Fondit

Vlera e një kuote të Fondit është e barabartë me vlerën neto të asetëve të pjesëtuar me numrin e kuotave në datën e raportimit. Bazuar në politikën e Fondit, vlera e një kuote në nisjen e Fondit ishte e barabartë me 100 Euro.

### m) Investimet në kuota

Investimet në kuota janë investime në kuota të fondeve të tjera të investimit, të cilët nga ana e tyre kanë një portofol të përqëndruar në obligacione dhe të diversifikuar sipas sektoreve, hapësirës gjeografike etj. Qëllimi i investimit në këtë lloj instrumenti është për të përfituar të ardhura nga rivlerësimi i çmimit të kuotës. Investimi njihet fillimisht me kosto, duke përfshirë kostot e transaksionit, dhe më pas vlerësohet në vlerën e drejtë të përditësuar për të pasqyruar kushtet e tregut në fund të periudhës raportuese. Vlera e drejtë e investimeve është çmimi që do të marret nga shitja e aktivit në një transaksion të rregullt, pa zbritje të kostove të transaksionit.

### n) Të ardhurat nga interesi

Të ardhurat nga interesi përfshijnë hyrjet nga kuponat e obligacioneve dhe interesat nga depozitat maturuara gjatë vitit dhe nga interesat e llogarise rrjedhese. Të ardhurat nga interesi njihen në bazë përlogaritjeje.

### o) Tarifa e shoqërisë administruese

Fondi duhet t'i paguajë Shoqërisë së Administrimitnjë tarifë prej 1.5% në vit (2015: 1.5%) të vlerës së asetëve neto, si shpenzim i cili llogaritet në baza ditore.

### p) Fitimi / humbje të realizuara

Fitim / humbjet e realizuara njihen nga shitja e letrave me vlerë ose kuotave dhe janë llogaritur si diferencë midis çmimit të ofruar dhe vlerës së principalit dhe interesit të maturuar të letrave me vlerë të blera me premium ose zbritje dhe si diferencë e çmimit të blerjes dhe të shitjes për kuotat. Këto dallime njihen në fitim ose humbje kur ndodhin.

### q) Fitimi / humbje të porealizuara

Fitimi / humbja e porealizuar njihet si diferencë midis koston dhe vlerës së drejtë. Kur letrat me vlerë/kuotat shiten fitim / humbja e porealizuar transferohet në fitim/ humbjen për periudhën.

### r) Krahasueshmëria

Të gjitha shumat janë raportuar ose paraqitur me informacione krahasuese.

## 3. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR

### a) Përmbledhje

Aktivitetet e Fondit e ekspozojnë atë ndaj një shumëllojshmërie rreziqesh financiare: rrezikut të tregut (duke përfshirë rrezikun e këmbimit valutor, rrezikun e normës së interesit dhe rreziqe të tjera të çmimeve), rrezikut të kredisë dhe rrezikut të likuiditetit.

Fondi është i ekspozuar edhe ndaj rreziqeve operationale të filla si rreziku i kujdestarisë. Rreziku i kujdestarisë është rreziku i humbjes së letrave me vlerë të mbajtura në kujdestari të shkaktuar nga neglizhenca e kujdestarit. Edhe pse është vendosur një kuadër i përshtatshëm ligjor që eliminon rrezikun e humbjes së vlerës së letrave me vlerë të mbajtura nga kujdestari, në rast

### 3. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM) a) Përmbledhje (vazhdim)

të dështimit të saj, aftësia e Fondit për të transferuar letrat me vlerë mund të dëmtohet përkohësisht. Programi i përgjithshëm i menaxhimit të rrezikut të Fondit kërkon të maksimizojë kthimin që vjen nga niveli i rrezikut për të cilat Fondi është i ekspozuar dhe kërkon për të minimizuar efektet e mundshme negative mbi performancën financiare të Fondit.

#### **Struktura e administrimit të rrezikut**

Në bazë të ligjit nr. 10198, datë 10 dhjetor 2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive" Shoqëria e Administrimit ka përfshirë në strukturën e saj, Njësinë e Menaxhimit të Rrezikut, përgjegjës për administrimin e rrezikut dhe për raportimin në Bordin e Administrimit. Politikat e menaxhimit të rrezikut të Fondit janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet e hasura nga institucioni financiar, për të vendosur kufizime dhe kontrole, dhe për të monitoruar zbatimin e këtyre kontroleve. Politikat e administrimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut, produktet dhe shërbimet e ofruara. Fondi, përmes standardeve dhe procedurave të menaxhimit, synon të zhvillojë një mjedis kontrolli konstruktiv dhe të disiplinuar, në të cilin çdo punonjës do kuptojë rolin dhe detyrimet përkatëse.

#### **(b) Rreziku kreditor**

Rreziku i kreditor lidhet me mundësinë që emetuesi i një instrumenti financiar, pjesë e asetëve të Fondit, të mos jetë në gjendje të shlyejë pjesërisht ose plotësisht të gjitha detyrimet e tij, cka do të kishte një impakt negative mbi vlerën e asetëve të Fondit. Këshilli i Administrimit i Fondit ka deleguar përgjegjësinë për administrimin e rrezikut kreditor Menaxhimit, i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e rrezikut të kredisë të Fondit. Fondi nuk përfshin asnjë kolateral apo përforcues të tjerë të rrezikut të kredisë, e cila mund të reduktojë ekspozimin e Fondit. Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut kreditor më 31 Dhjetor është vlera kontabël e aktiveve financiare të përcaktuara më poshtë:

	<b>31 Dhjetor 2017</b>	<b>31 Dhjetor 2016</b>
Aktivet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes	10,387,789	8,651,237
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	738,862	2,810,559
Kuota në fonde investimi	3,618,106	2,172,958
Llogari të arkëtueshme të tjera	623	241
<b>Totali</b>	<b>14,745,380</b>	<b>13,634,995</b>

Më 31 dhjetor 2017, aktivet e mbajtura nga Fondi nuk janë as me vonesë e as të zhvlerësuar (2016: nuk ka).

#### **c) Rreziku i likuiditetit**

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Fondi mund të mos jetë në gjendje të gjenerojë burime të mjaftueshme të parasë për të shlyer detyrimet e tij në mënyrë të plotë në kohën e duhur ose mund të veprojë kështu vetëm në kushte që janë materialisht të pafavorshme. Fondi mund të investojë në mënyrë periodike në instrumenta financiarë të tregtueshme. Si rezultat, Fondi mund të mos jetë në gjendje të likuidojë shpejtë investimet në këto instrumenta në një shumë të afërt me vlerën e tyre të drejtë për të përmbushur kërkesat për likuiditet, ose të jetë në gjendje të përgjigjet ngjarjeve të veçanta si përkeqësimi i aftësisë kredimarrëse të një emetuesi të vecantë. Fondi ka aftësinë të marrë hua afat-shkurtër për të mundësuar shlyerjen. Nuk ka pasur hua të këtij lloji gjatë vitit.

Në mënyrë që të menaxhojë likuiditetin e përgjithshëm të Fondit, Shoqëria Administruese ka aftësinë të pezullojë tërheqjet nëse kjo konsiderohet të jetë në interesin më të mirë të të gjithë kontribuesve. Në mungesë të detyrimeve të rëndësishme financiare Shoqëria Administruese e monitoron rrezikun e likuiditetit në bazë flukseve monetare të aktualizuara kontraktuale. Tabela e mëposhtme analizon aktivet financiare dhe detyrimet e Fondit në grupimet përkatëse të maturimit bazuar në periudhën e mbetur në pasqyrën e pozicionit financiar deri në datën kontraktuale të maturimit. Shumat në tabelë janë flukset e parasë kontraktuale të aktualizuara më 31 dhjetor 2017 dhe 2016:

### 3. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

#### c) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

<b>31 Dhjetor 2017</b>						
	<b>Deri 1 muaj</b>	<b>1 deri në 3 muaj</b>	<b>3 deri 6 muaj</b>	<b>6 deri 12 muaj</b>	<b>Mbi 1 vit</b>	<b>Totali</b>
<b>Aktivët</b>						
Aktivët financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes	-	-	-	-	10,387,789	<b>10,387,789</b>
Aktivët financiare të mbajtura deri në maturim	-	-	-	-	-	<b>0</b>
Kuota në fonde investimi	-	-	-	-	3,618,106	<b>3,618,106</b>
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	738,862	-	-	-	-	<b>738,862</b>
<b>Totali</b>	<b>738,862</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>14,005,895</b>	<b>14,744,757</b>
<b>Detyrimet</b>						
Detyrime ndaj Shoqërisë së Administrimit	(18,755)	-	-	-	-	<b>(18,755)</b>
Detyrime për kërkesa terheqjeje nga fondi	(11,746)	-	-	-	-	<b>(11,746)</b>
Detyrime të tjera	(1,437)	-	-	-	-	<b>(1,437)</b>
<b>Totali</b>	<b>(31,938)</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>(31,938)</b>
<b>Rreziku i likuiditetit</b>	<b>706,924</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>14,005,895</b>	<b>14,712,819</b>
<b>Akumulimi</b>	<b>706,924</b>	<b>706,924</b>	<b>706,924</b>	<b>706,924</b>	<b>14,712,819</b>	

#### 31 Dhjetor 2016

	<b>Deri 1 muaj</b>	<b>1 deri në 3 muaj</b>	<b>3 deri 6 muaj</b>	<b>6 deri 12 muaj</b>	<b>Mbi 1 vit</b>	<b>Totali</b>
<b>Aktivët</b>						
Aktivët financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes	-	-	-	414,551	8,236,686	<b>8,651,237</b>
Aktivët financiare të mbajtura deri në maturim	-	-	-	-	-	<b>-</b>
Kuota në fonde investimi	-	-	-	-	2,172,958	<b>2,172,958</b>
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	79,307	-	-	-	-	<b>79,307</b>
<b>Totali</b>	<b>79,307</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>414,551</b>	<b>10,409,644</b>	<b>10,903,502</b>
<b>Detyrimet</b>						
Detyrime ndaj Shoqërisë së Administrimit	(17,262)	-	-	-	-	<b>(17,262)</b>
Detyrime për kërkesa terheqjeje nga fondi	(8,860)	-	-	-	-	<b>(8,860)</b>
Detyrime të tjera	(2,438)	-	-	-	-	<b>(2,438)</b>
<b>Totali</b>	<b>(28,560)</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>(28,560)</b>
<b>Rreziku i likuiditetit</b>	<b>107,867</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>414,551</b>	<b>10,409,644</b>	<b>10,932,063</b>
<b>Akumulimi</b>	<b>107,867</b>	<b>107,867</b>	<b>107,867</b>	<b>522,418</b>	<b>10,932,063</b>	

### 3. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

#### d) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimi në çmimet e tregut do të ndikojnë në të ardhurat e Fondit ose në vlerën e instrumenteve financiare. Objektivi i administrimit të rrezikut të tregut është të menaxhojë dhe kontrollojë ekspozimet ndaj riskut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, ndërkohë që optimizon kthimin nga rreziku.

#### **Ekspozimi ndaj rrezikut të monedhës së huaj**

Fondi nuk është i ekspozuar ndaj rrezikut të valutës nëse transaksionet në një monedhë të ndryshme nga monedha baze e Fondit (Euro) mungojnë. Fondi nuk ka hyrë në ndonjë shkëmbim ose transaksion derivativ më 31 Dhjetor 2016. Më 31 Dhjetor 2016 dhe 2015 nuk ka aktive ose pasive financiare të cilat janë të shprehura në monedhë të ndryshme nga monedha bazë e Fondit (Euro)

#### **Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit**

Rreziku kryesor ndaj të cilit portofolet tregtare janë ekspozuar është rreziku i humbjes nga luhatja e flukseve të ardhshme të parasë ose vlerës së drejtë të instrumenteve financiare për shkak të një ndryshimi në normat e interesit të tregut (diferencat mes vlerës aktuale të aktiveve dhe detyrimeve neto). Rreziku i normës së interesit manaxhohet kryesisht nëpërmjet monitorimit të të diferencave të normave të interesit. Administrimi i rrezikut të normave të interesit kundrejt hendekut të limitit të normave të interesit, kompletohet duke monitoruar ndjeshmërinë e aktiveve dhe detyrimeve financiare të Fondit për skenarë të ndryshëm standard dhe jo-standard të normave të interesit. Skenarët standardë të cilët vlerësohen në mënyrë periodike, përfshijnë 100 pikë bazë (pb) rënie ose ngritje paralele në të gjitha kurbat e kthimit. Një analizë e ndjeshmërisë të Fondit në një rritje ose rënie të normave të interesit të tregut (duke supozuar që nuk ka lëvizje asimetrike të kurbove të kthimit si dhe një gjendje të pandryshueshme financiare) është si vijon:

<b>2017</b>		
Normat e interesit	Rënie 100 pb	Rritje 100 pb
Efekti i fitim/ humbjes së vlerësuar (në 000/Lek)	3,539	(3,539)
<b>2016</b>		
Normat e interesit	Rënie 100 pb	Rritje 100 pb
Efekti i fitim/ humbjes së vlerësuar (në 000/Lek)	1,836	(1,836)

## 4. MANAXHIMI I RREZIKUT TË KAPITALIT

Kapitali i Fondit përfaqësohet nga aktivet neto që i atribuohen mbajtësit të kuotave. Shuma e aktivitet neto që i atribuohet mbajtësit të kuotave mund të ndryshojë në mënyrë të konsiderueshme në baza ditore, pasi Fondi i nënshtrohet investimeve dhe tërheqjeve ditore sipas gjykimit të mbajtësit të kuotes. Objektivi i Fondit përta i përket menaxhimit të kapitalit është të ruajë vazhdimësinë e tij me qëllim sigurimin e kthimit për mbajtësin e kuotes, sigurimin e përfitimeve për palët e tjera dhe ruajtjen e një bazë të fortë kapitali për të mbështetur zhvillimin e aktiviteteve të investimeve të Fondit. Për të ruajtur strukturën e kapitalit, politika e Fondit do të performojë si më poshtë:

- Monitorimi i nivelit të hyrjeve dhe tërheqjeve ditore në raport me situatën e likuiditetit duhet të mundesojë likuidimin e kërkesave brenda 7 ditëve nga dita e kërkesës së vlefshme.
- Shlyerja dhe emetimi i kuotave të reja duhet kryer në përputhje me ligjin dhe prospektin e Fondit. Kjo përfshin aftësinë për të kufizuar shlyerjet dhe për të kërkuar një minimum investimi në Fond.

Administratoret e Shoqërisë Administruese monitorojnë kapitalin në bazë të vlerës së aktiveve neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave

## 5. STRATEGJIA E INVESTIMIT

Strategjia e investimeve të aktiveve të Fondit Raiffeisen Invest Euro mbështetet në ligjin nr. 10198 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive" dhe rregulloret e dala në zbatim të tij, si dhe në politikën e brendshme të investimit të Shoqërisë administruese, propozuar nga Komiteti i Investimit dhe miratuar nga Keshilli i Administrimit i Shoqërisë administruese.

### a) Kuadri ligjor

Në lidhje me investimet e aktiveve të Fondit, Shoqëria Administruese Raiffeisen INVEST – Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a. i përmbahet ligjit nr.10198, date 10 Dhjetor 2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive" dhe perspektivës së Fondit.

#### (i) Investimet e lejuara

Sipas rregullores, aktivet e Fondit mund të investohen vetëm në instrumentet e mëposhtëm:

- tituj të transferueshëm dhe instrumente të tregut të parasë, që tregtohen në tregje të rregulluara ose në një bursë titujsh në Republikën e Shqipërisë, në një shtet të Bashkimit Europian apo në çdo shtet tjetër të lejuar nga AMF-ja;
- kuota të fondeve të investimit apo aksione të shoqërive të investimit, të licencuara sipas ligjit nr.10198, datë 10.12.2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", si dhe nga kuota ose aksione të sipërmarrjeve kolektive të investimit, të licencuara në përputhje me standardet e Bashkimit Europian;
- depozita në institucione kreditimi, të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, në një nga shtetet anëtare të BE-së ose në çdo shtet të lejuar nga AMF-ja, të cilat mund të tërhiqen menjëherë ose që kanë afat maturimi jo më shumë se 12 muaj;
- instrumente financiare derivative ;
- instrumente të tjera të tregut të parasë.

Për secilin prej keyre instrumenteve, shoqëria administruese duhet të respektojë kufizimet e investimit të parashikuara në Ligjin nr.10198, datë 10.12.2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", si dhe ato të parashikuara në politikën e brendshme për manaxhimin e rrezikut.

#### (iii) Kufizimet e investimit dhe kufiri i lejuar

Fondi nuk mund të investojë më shumë se 20% të aktiveve të saj në depozita në të njëjtin institucion depozitues.

Fondi nuk mund të investojë më shumë se 5% të aktiveve të saj në tituj dhe instrumente të tregut të parasë të një emetuesi të vetëm. Kufiri 5%, mund të rritet deri në:

- a) 10%. Në këtë rast, vlera totale e titujve ose instrumenteve të tregut të parasë, që mban Fondi te disa emetues, ku për secilin ka investuar mbi 5% të asetëve, nuk duhet të tejkalojë 40 për qind të vlerës totale të asetëve të fondit;
- b) 35% në rastin e titujve dhe të instrumenteve të tregut të parasë, të emetuara ose të garantuara nga qeveria dhe autoritetet vendore të Republikës së Shqipërisë, shteteve të Bashkimit Europian, shteteve të tjera të lejuara nga AMF-ja, ose nga organizma publikë ndërkombëtarë, në të cilët bëjnë pjesë një ose më shumë shtete të Bashkimit Europian;
- c) 100% me miratimin e AMF-së, sipas disa kushteve të percaktuara në Ligj.
- d) 25% në rastin e disa obligacioneve të veçanta, të emetuara nga institucionet kredituese të licencuara, të cilat e kanë selinë e regjistruar në Republikën e Shqipërisë, apo në një shtet të Bashkimit Europian apo të lejuara nga AMF-ja. Kur Fondi investon më shumë se 5% të asetëve në këto lloj obligacionesh të emetuara nga një emetues i vetëm, atëherë vlera totale e këtij investimi nuk tejkalon 80% të vlerës totale të aktiveve të sipërmarrjes kolektive me ofertë publike;

Ekspozimi ndaj rreziqeve të palës tjetër i Fondit në një transaksion me instrumente derivativ në një treg të rregulluar nuk duhet të tejkalojë 10 për qind të asetëve të tij, kur pala tjetër është një institucion i licencuar kreditimi ose 5 për qind të asetëve, në rastet e tjera. Fondi mund të investojë deri në 30 për qind të asetëve të tij në kuota apo aksione të një forme tjetër të sipërmarrjeve të investimeve kolektive. Shoqëria Administruese i manaxhon aktivet e Fondit sipas parimit të sigurisë afatgjatë dhe të një kthimi të përshtatshëm nga investimi, duke ruajtur një raport optimal mes rritjes së kursimeve për investime dhe riskut të marrë përsipër. Objektivat afatgjatë për shpërndarjen e aktiveve të Fondit janë si më poshtë:

## 5. STRATEGJIA E INVESTIMIT (VAZHDIM)

### (a) Kuadri ligjor (vazhdim)

Klasa	Objective
Tituj të emtuar dhe garantuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe autoritetet vendore shqiptare	55%
Tituj të emtuar dhe garantuar nga shtete dhe autoritete të Bashkimit Europian, nga organizma publike nderkombetare ose nga çdo shtet i lejuar nga AMF-ja	10%
Depozita bankare ose çertifikata depozite	5%
Kuota të fondeve të investimit	5%
Tituj të transferueshëm dhe instrumente të tjerë financiarë të borxhit që tregëtohen në tregje të rregulluara ose burse titujsh në Republikën e Shqipërisë, në një shtet të Bashkimit Europian apo në çdo shtet tjetër të lejuar nga AMF-ja	25%
Derivate financiare	0%

Këto objektiva janë orientuese dhe mund të ndryshojnë në varësi të kushteve të tregut dhe politikës së investimit.

### b) Politika e brendshme e investimeve të Shoqërisë së Administrimit

Rreziku në investime ndërmerret vetëm nga anëtarë të Fondit dhe jo nga Shoqëria Administruese. Për të minimizuar këtë rrezik, Shoqëria Administruese ka përfshirë në strukturën e saj organizative, Komitetin e Investimeve, i cili propozon politikat për alokimin e pasurive dhe investimeve dhe një Njësi për Menaxhimin e rrezikut e cila kryen kontrollin sasior dhe cilësor të të gjitha rreziqeve të lidhura me Fondin. Nuk lejohen të gjitha ato investimet, norma e kthimit e të cilave, është nën nivelin e tregut, sepse kjo do të rrezikojë ekuilibrin e lidhjes investime - rrezik.

Pasqyra e strukturës së investimeve më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 paraqitet si më poshtë:

	Vlera në datën e raportimit	Si % të totalit të aktiveve të fondit
Obligacione	10,387,789	70%
Kuota në fonde investimi	3,618,106	25%
Depozita	697,920	5%
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	40,942	0%
Llogari të arkëtueshme të tjera	643	0%
<b>31 Dhjetor 2017</b>	<b>14,745,380</b>	<b>100%</b>

	Vlera në datën e raportimit	Si % të totalit të aktiveve të fondit
Obligacione	8,651,237	63%
Kuota në fonde investimi	2,172,958	16%
Depozita	2,731,252	20%
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	79,307	1%
Llogari të arkëtueshme të tjera	241	0%
<b>31 Dhjetor 2016</b>	<b>13,634,995</b>	<b>100%</b>

## 6. VLERA E DREJTË E AKTIVEVE DHE DETYRIMEVE FINANCIARE

Duke filluar nga 1 janar 2013 Fondi ka adoptuar SNRF 13 në lidhje me dhënien e informacioneve shpjeguese rreth shkallës së besueshmërisë së matjeve të vlerës së drejtë. Kjo kërkon që Fondi të klasifikojë, për qëllime të shpalosjes, matjet e vlerës së drejtë duke përdorur një hierarki të vlerës së drejtë e cila reflekton rëndësinë e të dhënave të përdorura në kryerjen e matjeve.

### *Përcaktimi i vlerës së drejtë*

Përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare të tregtuara në tregje aktive bazohet tek çmimet e kuotuar të tregut ose në çmimet e shitësit. Vlera e drejtë e instrumenteve të tjera financiare përcaktohet përmes teknikave të vlerësimit. Teknikat e vlerësimit përfshijnë teknikën e vlerës aktuale neto, metodën e skontimit të flukseve monetare, krahasimin me instrumente të ngjashme për të cilat ka çmime tregu dhe modelet e vlerësimit.

Fondi e mat vlerën e drejtë duke përdorur Nivelin 2 të hierarkisë së vlerës së drejtë, i cili reflekton rëndësinë e elementeve të përdorur në realizimin e vlerësimit, që shpjegohet si më poshtë:

- **Niveli 2:** Teknikat e vlerësimit të bazuara në elementet e vëzhgueshëm, në mënyrë direkte ose jo direkte (p.sh. që rrjedhin nga çmimet). Kjo kategori përfshin instrumente të vlerësuar nëpërmjet çmimeve të instrumenteve të ngjashëm të kuotuar në tregje aktive; çmimet e kuotuar të instrumenteve të njëjta ose të ngjashme në tregje jo shumë aktive; ose teknika të tjera vlerësimi, ku të gjithë elementet e rëndësishme vëzhgohen në mënyrë direkte ose jo direkte nga të dhënat e tregut.

Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare që tregtohen në tregje aktive bazohet në çmimet e kuotuar të tregut ose në çmimet e kuotuar të shitësit. Për instrumentet financiare që nuk tregtohen në mënyrë të vazhdueshme dhe që nuk kanë transparencë në çmime, vlera e drejtë është më pak objektive dhe kërkon nivele të ndryshme të gjykimit, në varësi të likuiditetit, përqendrimit, pasigurisë së faktorëve të tregut, supozimeve mbi çmimet dhe rreziqeve të tjera që ndikojnë në instrument.

### *Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre*

Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre përfshijnë paratë në arkë, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat me bankat rezidente. Sikurse këto gjendje janë afatshkurtra, vlera e drejtë e tyre është pothuajse e barabartë me vlerën e mbetur.

### *Investimet në letra me vlerë*

Investimet në letra me vlerë përfshijnë bono thesari dhe obligacione të qeverisë shqiptare, si dhe obligacione të qeverive apo korporatave të huaja. Vlera e drejtë e tyre llogaritet duke përdorur modelin e flukseve të skontuara të parave bazuar në normën e brendshme aktuale të kthimit e përshtatshme për maturitetin e mbetur. Investimet në letrat me vlerë janë mbajtur me vlerën e drejtë.

Tabela e mëposhtme analizon në kuadër të hierarkisë së vlerës së drejtë aktivet financiare të Fondit (në bazë të klasës) i matur me vlerën e drejtë më 31 dhjetor 2017 dhe më 31 dhjetor 2016.

Të gjitha matjet e vlerës së drejtë të publikuara janë matje të vlerës së drejtë periodike.

	<b>31 Dhjetor 2017</b>	<b>31 Dhjetor 2016</b>
Aktivitet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes	10,387,789	8,651,237
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	738,862	2,810,559
Kuota në fonde investimi	3,618,106	2,172,958
Llogari të arkëtueshme të tjera	643	241
<b>Totali</b>	<b>14,745,380</b>	<b>13,634,995</b>

Vlerësimet janë përgatitur dhe shqyrtuar në baza mujore nga Menaxheri i rrezikut që raporton dhe i jep rekomandime shoqërisë administruese në bazë mujore, në përputhje me vlerësimet mujore që janë dhënë për investitorët. Menaxheri i rrezikut konsideron përshtatshmërinë e modelit të vlerësimit, të dhënat hyrëse kryesore si dhe rezultatin e vlerësimit duke përdorur metoda të ndryshme të vlerësimit dhe teknika përgjithësisht të njohura si standarde në kuadër të industrisë. Teknika e vlerësimit është zgjedhur dhe kalibruar në blerjen e titujve themelore të portofolit. Në përcaktimin përshtatshmërinë së vazhduar të teknikës së zgjedhur të vlerësimit, Menaxheri i rrezikut mund të kryejë testimin përsëri duke marrë në konsideratë rezultatet aktuale të modeleve të ndryshme dhe se si ata historikisht janë në një linjë me transaksionet aktuale të tregut. Gjithashtu banka kujdestare është përgjegjëse për shqyrtimin e rivlerësimeve përmes një procedure të përditshme konfirmimi

## 7. VLERËSIMET DHE GJYKIMET KRITIKE KONTABËL

Fondi bën vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën dhe faktorët e tjerë, duke përfshirë pritjet e ngjarjeve të ardhshme të cilat besohet të jenë të arsyeshme duke marrë në konsideratë rrethanat.

### Vlera e drejtë e investimeve e pakuotuar në një treg aktiv

Vlerat e drejta të letrave me vlerë që nuk janë të kuotuar në një treg aktiv përcaktohen duke përdorur teknika vlerësimi, kryesisht të ardhurat shumëfishme, flukset e parasë të skontuara dhe transaksioneve të kohëve të fundit të krahasueshme. Modelet e përdorura për të përcaktuar vlerat e drejta janë të vlefshme dhe të rishikohen periodikisht nga Shoqëria Administruese. Inputet në modele me të ardhurat e shumëfishta përfshijnë të dhëna të vëzhgueshme, siç janë shumëfisha të të ardhurave të kompanive të krahasueshme me kompaninë përkatëse të portofolit, dhe të dhëna të pavëzhgueshme, të tilla si të ardhurat e parashikuara për kompaninë portofolit. Në modelet e skontuara të flukseve monetare, inputet jo të vëzhgueshme janë flukset e parasë të projektuara të kompanisë përkatëse portofolit dhe primit të rrezikut për likuiditet dhe rrezikun e kreditit që janë të përfshira në normën e skontimit. Menaxhimi përdor modele për të rregulluar kthimin e kapitalit neto të vëzhguar për të reflektuar strukturën aktuale të financimit të borxhit / kapitalit neto të investimeve të vlerësuar të kapitalit. Modelet janë të kalibruar nga mbrapa- testimit për rezultatet aktuale/ çmimet e daljes të arritura për të siguruar që rezultatet janë të besueshme.

### Monedha funksionale

Shoqëria Administruese konsideron monedhën Lek si valuta që më besnikërisht përfaqëson efektin ekonomik të transaksioneve themelore, ngjarjet dhe kushtet. Leku është monedha në të cilën Fondi mat performancën e tij dhe raporton rezultatet e tij, rrjedhimisht monedha funksionale dhe raportuese. Ndërkohe monedha me të cilën Fondi merr abonimet nga investitorët e tij është Euro si edhe monedha baze e strategjisë së investimit të Fondit. Kjo vendosmëri merr në konsideratë mjedisin konkurrues në të cilin Fondi është në krahasim me fondet tjera të investimeve.

### Statusi i entitetit të investimeve

Në përcaktimin e statusit të Fondit si një entitet investimi në përputhje me SNRF 10, Shoqëria Administruese konsideron faktet e mëposhtëme:

- Fondi ka grumbulluar asete monetare nga investitorët e tij në mënyrë që të rrisë investimet financiare dhe për të ofruar shërbime të menaxhimit të investitorëve në lidhje me këto investime;
- Fondi ka për qëllim të gjenerojë kapitale dhe kthime në të ardhura nga investimet të cilat do të shpërndahen në përputhje me kërkesat e kontribuesit; dhe
- Fondi vlerëson performancën e investimeve mbi bazën e vlerës së drejtë (përveç atyre të mbajtura deri në maturim), në përputhje me politikën e përcaktuar në këto pasqyra financiare. Edhe pse Fondi plotëson të tre kriteret përcaktuese, Shoqëria Administruese e ka vlerësuar gjithashtu qëllimin e biznesit të Fondit, strategjitë e investimit për investimet financiare, natyrën e çdo të ardhure nga investimet dhe modelet e vlerës së drejtë. Shoqëria Administruese bëri këtë vlerësim për të përcaktuar nëse fusha të tjera të gjykitimit do të ekzistojnë në lidhje me karakteristikat tipike të një njësie ekonomike të investimit kundrejt atyre të Fondit.

## 8. TË ARDHURAT NGA INTERESI

Të ardhurat nga interesi përbehen si më poshtë :

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2016
Obligacione të Qeverisë dhe Korporatave	382,394	350,741
Të ardhurat nga interesi i depozitave	(7,062)	(10,256)
Të ardhurat nga interesi i llogarive rrjedhëse dhe të ardhura të tjera	-	-
<b>Totali</b>	<b>375,332</b>	<b>340,485</b>



## 9. NDRYSHIME TË TJERA NË VLERËN E DREJTË TË AKTIVEVE FINANCIARE TË MBAJTURA NË VLERËN E DREJTË NËPËRMJET FITIMIT OSE HUMBJS

Ndryshimet ne vleren e drejte detajohen si me poshte:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Aktive financiare te mbajtura për tregtimin me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes	201,627	333,552
<b>Ndryshimi total në vlerën e drejtë të aktiveve financiare</b>	<b>201,627</b>	<b>333,552</b>
Fitime te realizuara nga investimet	2,466	21,809
Humbje te realizuara nga investimet	(29,230)	(46,720)
Fitime te porealizuara nga investimet	1,077,131	1,400,961
Humbje te porealizuara nga investimet	(875,504)	(1,067,410)
<b>Ndryshimi total në vlerën e drejtë të aktiveve financiare</b>	<b>174,863</b>	<b>308,640</b>

## 10. HUMBJE NGA KURSI I KËMBIMIT

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Fitime të realizuara nga transaksionet e këmbimit valutor	112	3,572
Humbje të realizuara nga transaksionet e këmbimit valutor	(12,318)	(21,830)
Fitime të porealizuara nga transaksionet e këmbimit valutor	2,170,152	2,679,456
Humbje të porealizuara nga transaksionet e këmbimit valutor	(2,309,504)	(2,863,663)
<b>Totali</b>	<b>(151,558)</b>	<b>(202,465)</b>

## 11. AKTIVE FINANCIARE TË MBAJTURA ME VLERË TË DREJTË NËPËRMJET FITIMIT OSE HUMBJES

Aktivt financiarë me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes janë paraqitur si më poshtë:

<b>Afatgjata</b>	<b>31 Dhjetor 2017</b>	<b>31 Dhjetor 2016</b>
Obligacione Qeveritare dhe Korporatash	10,387,789	8,651,237
	<b>10,387,789</b>	<b>8,651,237</b>
<b>Afatshkurtra</b>		
Bono Thesari	-	-
<b>Total</b>	<b>10,387,789</b>	<b>8,651,237</b>

Aktivt financiarë me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes mund të detajohen përsa i përket kategorive si në vijim:

	<b>Vlera Nominale</b>	<b>Primi /(zbritja) e paamortizuar</b>	<b>Interesi i përlogaritur</b>	<b>Vlera e drejtë fitim/ (humbje)</b>	<b>Vlera e tregut</b>
Bono thesari					
Obligacione Qeveritare dhe Korporatash	9,352,900	732,579	118,930	201,627	10,387,789
<b>31 Dhjetor 2017</b>	<b>9,352,900</b>	<b>732,579</b>	<b>118,930</b>	<b>201,627</b>	<b>10,387,789</b>

	<b>Vlera Nominale</b>	<b>Primi /(zbritja) e paamortizuar</b>	<b>Interesi i përlogaritur</b>	<b>Vlera e drejtë fitim/ (humbje)</b>	<b>Vlera e tregut</b>
Bono thesari	-	-	-	-	-
Obligacione Qeveritare dhe Korporatash	7,895,268	333,552	111,235	333,552	8,651,237
<b>31 Dhjetor 2016</b>	<b>7,895,268</b>	<b>333,552</b>	<b>111,235</b>	<b>333,552</b>	<b>8,651,237</b>

Lëvizjet në vlerë nominale të aktiveve financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 janë paraqitur më poshtë:

<b>Bono Thesari</b>	<b>2017</b>	<b>2016</b>
Më 1 janar	-	<b>1,235,520</b>
Blerje gjatë vitit	-	-
Të maturuara gjatë vitit	-	(1,235,520)
<b>Më 31 dhjetor</b>	<b>-</b>	<b>-</b>

<b>Obligacione Qeveritare</b>	<b>31 Dhjetor 2017</b>	<b>31 Dhjetor 2016</b>
Më 1 janar	7,895,268	5,614,752
Blerje gjatë vitit	3,706,978	5,798,656
Të maturuara gjatë vitit	(2,245,387)	(3,275,850)
Fitim/humbje nga rivleresimi valutor	(3,959)	(242,290)
<b>Më 31 dhjetor</b>	<b>9,352,900</b>	<b>7,895,268</b>

## 12. INVESTIME NË KUOTA TË FONDEVE TË TJERA

Investimet në kuota përfshijnë investime në kuota të фондеве të huaja, detajet e të cilave paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Kuota në фондеве të tjera	3,618,106	2,172,958
<b>Totali</b>	<b>3,618,106</b>	<b>2,172,958</b>

Aktivitet financiarë të mbajtura deri në maturim mund të detajohen përsa i përket kategorive si më poshtë:

	Vlera Nominale	Vlerësim pozitiv kapitali nga ndryshimet në vlerën e drejtë	Vlera e tregut
Kuota në фондеве të tjera	3,598,843	19,263	3,618,106
<b>31 Dhjetor 2017</b>	<b>3,598,843</b>	<b>19,263</b>	<b>3,618,106</b>

	Vlera Nominale	Vlerësim pozitiv kapitali nga ndryshimet në vlerën e drejtë	Vlera e tregut
Kuota në фондеве të tjera	2,155,878	17,080	2,172,958
<b>31 Dhjetor 2016</b>	<b>2,155,878</b>	<b>17,080</b>	<b>2,172,958</b>

## 13. MJETE MONETARE DHE EKVIVALENTË TË TYRE

Për qëllime të pasqyrës së flukseve së mjeteve monetare, mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përfshijnë tepricat e mëposhtme me maturim origjinal prej më pak se 90 ditë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Llogaritë rrjeshëse me bankën kujdestare	40,942	79,307
<b>Totali i llogarive rrjedhëse</b>	<b>40,942</b>	<b>79,307</b>
Depozita	697,988	2,731,646
Interesi i përlllogaritur	(68)	(394)
<b>Totali i depozitave</b>	<b>697,920</b>	<b>2,731,252</b>
<b>Totali i mjeteve monetare dhe ekuivalentë të tyre</b>	<b>738,862</b>	<b>2,810,559</b>

## 14. DETYRIME TË TJERA

Detyrimet e tjera përfshijnë tatimin në burim mbi të ardhurat personale të mbajtur nga Shoqëria Administruese në lidhje me përfitimet kapitale nga tërhiqjet e kontributorëve gjatë muajit Dhjetor. Shoqëria Administruese vepron si agjent mbledhës për Fondin, sipas ligjit nr. 8438 "Tatimi mbi të ardhurat" i datës 28.12.1998.

## 15. AKTIVET NETO QË I ATRIBUOHEN MBAJTËSVE TË KUOTAVE

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Kapitali i përkushtuar	13,606,435	10,355,508
Kontributet kapitale kumulative	3,516,704	7,132,028
Pagesa të kapitalit kumulative	(2,638,994)	(4,152,041)
<b>Kontributet kumulative të kapitalit neto</b>	<b>14,484,145</b>	<b>13,335,495</b>
Fitimet e përealizuara neto kumulative	201,627	333,552
Fitimet e realizuara neto kumulative	(26,764)	3,066,854
Shpenzime të tjera neto kumulative	54,435	(3,129,466)
<b>Rritja në aktivet neto që i atribuohet kontribuesve</b>	<b>229,298</b>	<b>270,940</b>
<b>Totali i aktiveve neto që i atribuohet kontribuesve</b>	<b>14,713,442</b>	<b>13,606,435</b>
<b>Numri i njësive të fondit</b>	<b>946,389</b>	<b>883,843</b>
<b>Aktivët për njësi</b>	<b>15,547</b>	<b>15,395</b>

## 16. PALËT E LIDHURA

Palët konsiderohen si të lidhura në qoftë se njëra palë ka aftësinë për të kontrolluar palën tjetër ose të ushtrrojë ndikim të rëndësishëm mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare ose operacionale.

Palët e lidhura të Fondit janë Raiffeisen INVEST - Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a, e cila menaxhon Fondin, banka kujdestare e Fondit dhe Raiffeisen Bank sh.a. si aksionar i vetëm i shoqërisë administruese.

Që nga dhe për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 Fondi ka hyrë në transaksionet dhe balancat e mëposhtme me palët e lidhura me të:

Paraja dhe ekuivalentë të parasë	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Llogari rrjedhëse me Bankën kujdestare	40,942	79,307
<b>Totali</b>	<b>40,942</b>	<b>79,307</b>

Depozita	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Depozita me Raiffeisen Bank dhe Raiffeisen Bank International	697,988	686,400
Interesi i përllogaritur	(68)	(9)
<b>Totali</b>	<b>697,920</b>	<b>686,391</b>

Detyrime ndaj Shoqërisë administruese	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Tarifë e pagueshme ndaj Shoqërisë administruese	18,755	17,262
<b>Totali</b>	<b>18,755</b>	<b>17,262</b>

## 16.PALËT E LIDHURA (VAZHDIM)

<b>Të ardhura</b>	<b>Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2017</b>	<b>Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2016</b>
Të ardhura nga interesat nga depozitat me palët e lidhura të maturuara brenda vitit dhe llogaritë rrjedhëse	(7,062)	-
<b>Totali</b>	<b>(7,062)</b>	<b>-</b>

<b>Shpenzime</b>	<b>Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2017</b>	<b>Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2016</b>
Tarifa e Shoqërisë administruese	214,407	197,089
<b>Totali</b>	<b>214,407</b>	<b>197,089</b>

## 17. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIT

Nuk ka ngjarje pasuese pas datës së raportimit që mund të kërkojnë ose rregullim ose shpalesje në pasqyrat financiare.





FONDI I PENSIONIT VULLNETAR RAIFFEISEN

**FONDI I PENSIONIT VULLNETAR RAFFEISEN**

Raporti i Audituesit të Pavarur  
dhe Pasqyrat Financiare  
për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017



# Përmbajtja

<b>Raporti i Audituesit të Pavarur</b>	130
<b>Pasqyra e fitim humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse</b>	132
<b>Pasqyra e pozicionit financiar</b>	132
<b>Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave</b>	133
<b>Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare</b>	134
1. Hyrje	135
2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël	135
3. Manaxhimi i rrezikut financiar	145
4. Manaxhimi i rrezikut të kapitalit	148
5. Strategjia e investimit	148
6. Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare	150
7. Vlerësimet dhe gjykimet kritike kontabël	151
8. Të ardhura nga interesi	152
9. Ndryshime të tjera neto në vlerën e drejtë	152
10. Aktive financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes	152
11. Aktive financiare të mbajtura deri në maturim	153
12. Paraja dhe ekuivalentë të saj	154
13. Detyrime të tjera	154
14. Aktivet neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave	154
15. Palët e lidhura	154
16. Ngjarje pas datës së raportimit	155

# Raporti i Audituesit të Pavarur

**Deloitte.**

Deloitte Audit Albania sh.p.k.  
Rr. Elbasanit,  
Pallati poshte Fakulteti Gjeologji-  
Miniera  
Tirana, Albania  
Tel: +355 4 45 17 920  
[www.deloitte.al](http://www.deloitte.al)

VAT (NUIS) No: L41709002H

Drejtuar Aksionarëve dhe Drejtimit të Shoqërisë Raiffeisen INVEST – Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a.

## Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Raiffeisen INVEST – Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen ("Fondi"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2017 dhe pasqyrën e fitim humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyra e ndryshimeve të aktiveve neto që i atribuohen mbajtësve të njëjësive dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe nga një përmbledhje e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Fondit më datë 31 dhjetor 2017 si edhe të performancës së tij financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

## Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në paragrafin e emërtuar "Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare" të këtij raporti. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Fondi në përputhje me Kodin e Etikës së Kontabilistëve Profesionistë i vendosur nga Bordi i Kontabilistëve për Standardet Ndërkombëtare të Etikës ("BKSNE") dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si edhe, kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur bazën për opinionin tonë të auditimit.

## Përgjegjësitë e drejtimit dhe palëve të ngarkuara me qeverisjen për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me IFRS-të, si edhe për sistemin e kontrollit të brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Fondit për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënimet shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Fondit, dhe të përdorë parimin kontabël të vijimësisë, përveç rasteve kur drejtimi ka ose për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveçse sa më lart. Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Fondit.

## Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë

anomali materiale, për shkak të mashtrimve apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Gjithashtu, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, hartojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale, si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të sistemeve të kontrolleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të përshtatshme me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e sistemeve të kontrolleve të brendshme të Fondit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Fondit për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vemendjen në raportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërpreje të aftësisë së Fondit për vazhduar në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare prezantojnë transaksionet dhe ngjarjet thelbësore në një mënyrë që arrin prezantimin e drejtë.

Ne komunikojmë me palët e ngarkuara me qeverisjen e Fondit, ku përveç çështjeve të tjera, komunikojmë edhe qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në sistemin e kontrollit të brendshëm që është identifikuar gjatë auditimit tonë.

*Deloitte Audit Albania sh.p.k*  
 Deloitte Audit Albania sh.p.k  
 Rr. Elbasanit, Pallati poshte Fakultetit  
 Gjeologji - Miniera,  
 Tirana, Albania Identification number  
 (NUIS): L41709002H

**DELOITTE AUDIT ALBANIA**  
 Rr. Elbasanit, Pallati poshte Fakultetit Gjeologji Miniera  
 NIPT: L 41709002H TIRANA - ALBANIA

Engagement Partner  
 Statutory Auditor  
 Enida Cara

Tirana, Albania  
 April 3, 2018

## Pasqyra e fitimit humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse më 31 dhjetor 2017

(shumat në Lek)

Të ardhura	Shënime	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2016
Të ardhura nga interesi	8	32,878,380	27,920,393
Të ardhura/humbje neto te realizuara nga investimet në letra me vlerë		(162,364)	1,860,183
<b>Totali i të ardhurave neto</b>		<b>32,716,016</b>	<b>29,780,576</b>
<b>Shpenzime</b>			
Tarifa e Shoqërisë së Administrimit		(6,842,354)	(5,544,711)
<b>Totali i shpenzimeve</b>		<b>(6,842,354)</b>	<b>(5,544,711)</b>
<b>Rritja në aktivet neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave të pensionit nga operacionet</b>	<b>14</b>	<b>25,873,662</b>	<b>24,235,865</b>

Shënimet nga faqja 135 në 155 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare

## Pasqyra e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2017

(shumat në Lek)

	Shënime	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
<b>AKTIVET</b>			
Aktive financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes	10	48,893,635	56,805,464
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim	11	451,218,018	350,425,620
Paraja dhe ekuivalentë të saj	12	9,078,383	9,259,342
<b>TOTALI I AKTIVEVE</b>		<b>509,190,036</b>	<b>416,490,427</b>
<b>DETYRIMET</b>			
Detyrime ndaj Shoqërisë së Administrimit		639,283	520,886
Detyrime për kërkesa tërheqje nga fondi		173,574	2,317,726
Detyrime të tjera	13	1,401,909	1,443,949
<b>TOTALI I DETYRIMEVE</b>		<b>2,214,766</b>	<b>4,282,561</b>
<b>AKTIVET NETO TË FONDIT TË PENSIONIT</b>	<b>14</b>	<b>506,975,270</b>	<b>412,207,865</b>
<b>Numri i kuotave të emetuara të Fondit të Pensionit</b>		<b>310,083</b>	<b>266,897</b>
<b>AKTIVET NETO PËR NJËSI</b>		<b>1,635</b>	<b>1,544</b>

Këto pasqyra financiare janë miratuar më 28 mars 2018 në emër të Fondit nga Këshilli i Administrimit të Raiffeisen INVEST – Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a. dhe u firmosën nga:



Administratore e Përgjithshme  
Edlira KONINI




Zv. Administratore e Përgjithshme  
Alketa EMINI

Shënimet nga faqja 135 në 155 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare

## Pasqyra e ndryshimeve në kapital per aktivet neto që i atribuohen mbajtësve të njërive më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në Lek)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2016
Aktive neto që i atribuohen kontribuesve më 1 janar		<b>412,207,866</b>	324,297,953
Kontribute kapitale		86,093,539	76,473,784
Tërheqje për pagesat e përfitimeve të pensionit dhe tërheqje të parakohshme		(17,199,797)	(12,799,736)
<b>Rritja neto nga transaksionet kapitale</b>		<b>68,893,742</b>	<b>63,674,048</b>
Rritja në aktivet neto që i atribuohen kontribuesve nga operacionet		25,873,662	24,235,865
<b>Aktive neto (të detyrueshme nga)/të atribueshme ndaj kontribuesve</b>	<b>14</b>	<b>506,975,270</b>	<b>412,207,866</b>
<b>NUMRI I KUOTAVE TË PENSIONIT</b>			
Njësi të pensionit të emtuara mbi bazën e kontributeve		53,986	50,790
Njësi të pensionit të tërhequra për shkak të pagesave të përfitimeve të pensionit/shlyerje		(10,800)	(8,505)
<b>RRITJE NË NUMRIN E KUOTAVE TË FONDIT TË PENSIONIT</b>		<b>43,186</b>	<b>42,285</b>

Shënimet nga faqja 135 në 155 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

## Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në Lek)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2016
<b>Rrjedha e mjeteve monetare nga aktiviteti operacional</b>			
<b>Rritja në shumën që i atribuohet kontribuesve</b>		<b>25,873,662</b>	<b>24,235,865</b>
<b>Rregullime për:</b>			
Fitime të porealizuara nga rivlerësimi i letrave me vlerë të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes	9	(4,860)	(2,016,707)
Të ardhura nga interesi		(32,878,380)	(27,920,393)
Tarifa e administrimit		6,842,354	5,544,711
<b>Rrjedha e mjeteve monetare të përdorura në aktivitetet operacionale</b>		<b>(167,224)</b>	<b>(156,524)</b>
Zvogëlim në aktivet financiare me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes		5,714,666	-
Rritja në aktivet financiare të mbajtura deri në maturim		(99,675,615)	(98,856,880)
Rritje në detyrimet ndaj Shoqërisë Administruese		118,399	114,910
(Zvogëlim) / Rritje në detyrimet e tjera		(42,041)	595,551
<b>Rrjedha e mjeteve monetare të përdorura në operacione</b>		<b>(94,051,815)</b>	<b>(98,302,943)</b>
Interesi i arkëtuar		31,701,070	26,233,476
Tarifa e paguar e administrimit		(6,723,956)	(5,429,802)
<b>Rrjedha e mjeteve monetare neto të përdorura në aktivitetet operacionale</b>		<b>(69,074,701)</b>	<b>(77,499,269)</b>
<b>Rrjedha e mjeteve monetare nga aktivitetet financuese</b>			
Kontributet marrë nga kontribuesit		86,093,539	76,473,784
Kontributet të paguara kontribuesve		(17,199,797)	(7,817,400)
<b>Rrjedha e mjeteve monetare neto nga aktivitetet financuese</b>		<b>68,893,742</b>	<b>68,656,384</b>
<b>Zvogëlim në mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre</b>		<b>(180,959)</b>	<b>(8,842,885)</b>
Mjete monetare në fillim të vitit		9,259,342	18,102,227
<b>Mjete monetare në fund të vitit</b>		<b>9,078,383</b>	<b>9,259,342</b>

Shënimet nga faqja 135 në 155 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

# 1. HYRJE

Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen ("Fondi") është një fond pensioni i licensuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ("AMF") bazuar në ligjin nr. 10197 më datë 10 dhjetor 2009 "Për fondet e pensionit vullnetar" dhe bazuar në vendimin nr.107 më datë 18 tetor 2011.

Qëllimi i fondit është të gjenerojë rritje kapitale afatmesme dhe afatgjatë duke ruajtur një raport optimal mes rritjes së kursimeve për pension dhe riskut të marrë përsipër. Ky qëllim synohet të arrihet nëpërmjet një portofoli te përberë kryesisht nga instrumenta financiarë të emtuar dhe garantuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

Aktivitetet investuese të fondit manaxhohen nga Raiffeisen INVEST – Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a. ("Shoqëria Administruese").

Fondi iu ofron investimin në kuota një grupi të gjerë investitorësh të cilët janë individë, nëpërmjet planeve të pensionit individuale ose profesionale.

Mbështetur në Ligjin nr. 10197, datë 10.12.2009, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare miratoi gjithashtu First Investment Bank Albania sh.a. si bankë depozitare e Fondit të Pensionit Vullnetar Raiffeisen ("Depozitari"). Shoqëria Administruese dhe Depozitari mbajnë aktivet, veprimet dhe regjistrimet e veta të ndara nga aktivet, veprimet dhe regjistrimet kontabël të Fondit të Pensionit Vullnetar Raiffeisen.

Këto pasqyra financiare janë autorizuar për publikim nga Bordi i Drejtorëve më 28 mars 2018.

## 2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

Politikat kryesore kontabël të zbatuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë të paraqitura më poshtë. Këto politika janë aplikuar në vazhdimësi në të gjitha vitet e paraqitur, nëse nuk shprehet ndryshe.

### a) Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare të Fondit të Pensionit Vullnetar Raiffeisen janë përgatitur mbi një bazë vijimësie dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Pasqyrat financiare janë përgatitur nën parimin e kostos historike, siç modifikohen nga rivlerësimi i aktiveve financiare dhe pasiveve financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon përdorimin e vlerësimeve kontabël kritike, si dhe; ajo kërkon që Shoqëria Administruese të ushtrojë gjykimin e saj në procesin e zbatimit të politikave kontabël për fondin. Ndryshimet në supozime mund të kenë një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare në periudhën që supozimet kanë ndryshuar. Manaxhimi beson se supozimet e aplikuar janë të përshtatshme dhe se për këtë arsye pasqyrat financiare të Fondit paraqesin gjendjen financiare dhe rezultatet në mënyrë të drejtë. Zonat që përfshijnë një shkallë më të lartë të gjykitimit ose kompleksitetit, apo fushat ku supozimet dhe vlerësimet janë të rëndësishme për pasqyrat financiare janë paraqitur në Shënimin 7.

### b) Standarde dhe interpretime në fuqi për periudhën raportuese

Ndryshimet e mëposhtme të standardeve ekzistuese të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe interpretimet e publikuara nga Komiteti i Interpretimeve të Raportimeve Financiare Ndërkombëtare janë në fuqi për periudhën raportuese:

- **Ndryshime në SNK 7 " Pasqyra e Levizjes së Parasë"-** Iniciativa e informacioneve shpjeguese (efektive per periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 Janar 2017),
- **Ndryshime në SNK 12 "Tatimi mbi të Ardhurat"** – Njohja e aktiveve tatimore të shtyra për humbjet e parealizuara ( efektive per periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 Janar 2017),
- **Ndryshime në SNRF 12 si pasojë e "Përmirësimeve të SNRF-ve ( cikli 2014-2016)"** rezultuar nga projekti i përmirësimit vjetor të SNRF ( SNRF 1, SNRF 2, dhe SNK 28) kryesisht me një pikëpamje per të eliminuar mospërputhjet dhe per të qartësuar formulimin (ndryshimet mbi SNRF 12 do të jenë të aplikueshme per periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 Janar 2017).

## 2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### b) Standarde dhe interpretime në fuqi për periudhën raportuese (vazhdim)

Këto ndryshime në standardet dhe interpretimet ekzistuese nuk kanë ndikuar në politikat kontabël, pozicionin financiar dhe performancën e Fondit.

### c) Standarde dhe interpretime të publikuara por akoma jo në fuqi

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet, përmirësimet dhe interpretimet e mëposhtme ishin publikuar por akoma nuk ishin në fuqi. Asnjë prej tyre nuk pritet të ketë efekt të ndjeshëm në pasqyrat e Fondit.

- **SNRF 9 “Instrumentat financiare” (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2018),**

Fondi parashikon se zbatimi i SNRF 9 në të ardhmen mund të ketë një ndikim në shumën e njohura në aktivet dhe detyrimet financiare. Pritet që SNRF 9 të rrisë nivelin e përgjithshëm të provigjoneve për aktivet dhe detyrime. Parashikimi është i bazuar në një kërkesë për të njohur provigjonet në shumën e parashikuar të kredive të pashlyera.

Fondi do të aplikojë SNRF 9 në 1 Janar 2018, sipas versionit të publikuar në Korrik 2014 dhe do të përshtasë ndryshimet e SNRF 9 në të njëjtën datë.

Më 27 dhjetor 2017, Parlamenti Europian publikoi rregulloren (EU) 2017/2395 mbi kërkesat në tranzicion drejt SNRF 9. Rregullorja mundëson zgjedhjen midis dy metodave të ndryshme përsa i përket njohjes së efektit të implementimit të standartit në kapitalin rregullator:

1. Njohja e efektit të plotë në mënyrë lineare, e shpërndarë në një periudhë 5 vjeçare, ose
2. Njohja e impaktit të plotë në ditën e përshtatjes.

Fondi ka vendosur të aplikojë metodën e dytë.

### Klasifikimi dhe Matja e Përgjithshme

SNRF 9 përmban një përjasje të re për klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare, që reflekton modelin e biznesit sipas të cilit menaxhohen aktivet dhe karakteristikat e fluksit të parasë së tyre.

Fondi do të aplikojë katër kategori për klasifikimin e Aktiveve Financiare:

- Aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar (KA)
- Aktivet financiare të matura me vlerë së drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDNATGJ)
- Aktivet Financiare të detyrueshme për t'u matur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim-humbjes (VDNFH) dhe
- Aktive Financiare të matura me vlerë të drejtë nëpërmjet pasqyrave të fitim-humbjes (VDNFH)

Kategoritë ekzistuese të SNK 39 si: të mbajtura deri në maturim, kredi dhe llogari të arkëtueshme, të vlefshme për shitje do të eliminohen.

Aktivitet Financiare do të maten me koston e amortizuar nëse plotësohen të dy kushtet e mëposhtme:

- Aktivi mbahet sipas një modeli biznesi, objektivi i të cilit është të mbajë aktive financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale
- Kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar shprehin qartë termat kohorë të flukseve monetare, të cilat janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit mbi principalin e mbetur.

Objektivi i një modeli biznesi mund të jetë mbajtja e aktiveve financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale, edhe në rastin kur shitje të aktiveve financiare kanë ndodhur ose priten që të ndodhin.

Një aktiv financiar klasifikohet si i matur me VDNATGJ nëse ai mbahet nëpërmjet një modeli biznesi, objektivi i të cilit është të mbledhë flukse monetare kontraktuale dhe të shesë aktive financiare, kur kushtet kontraktuale të aktiveve financiare specifikojnë datat e caktuara të flukseve monetare, të cilat janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit mbi principalin e mbetur.

Për njohjen fillestare të një instrumenti kapitali neto që nuk mbahet për shitje, Fondi mund të zgjedhë të paraqesë në mënyrë të pakthyeshme ndryshimet e mëvonshme në vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. Kjo përzgjedhje bëhet për çdo investim individualisht dhe mbulon interesa strategjike që nuk paraqiten plotësisht në mënyrë të konsoliduar. Të gjithë aktivet e tjerë financiare, që nuk plotësojnë kriteret për tu klasifikuar si të matura me koston e amortizuar ose VDNATP, klasifikohen si të matura me vlerën e drejtë, ndryshimet e të cilës njihen në fitim-humbje. Si rrjedhojë, Fondi ka mundësinë që në njohjen fillestare të përcaktojë në mënyrë të pakthyeshme një aktiv financiar, matja e të cilit bëhet me VDNFH, nëse të vepruarit në këtë mënyrë eliminon ose redukton ndjeshëm një



## 2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### c) Standarde dhe interpretime të publikuara por akoma jo në fuqi (vazhdim)

mospërputhje matjeje ose njohjeje, për shembull një mospërputhje kontabël që do të lindte nga matja e aktiveve ose detyrimeve, ose njohja e fitimeve dhe humbjeve në to, në baza të ndryshme. Një aktiv financiar klasifikohet në një nga këto kategori në njohjen e tij fillestare.

#### Vlerësimi i modelit të biznesit

Fondi ka vlerësuar objektivin e modelit të biznesit në të cilin një aktiv financiar mbahet në nivel portofoli, dhe kjo reflekton më së miri mënyrën se si menaxhohet biznesi dhe se si informacioni i përcillet drejtimit.

Në vlerësimin se cili model biznesi është i përshtatshëm, janë shqyrtuar kriteret e mëposhtme:

- Si performanca e modelit të biznesit (dhe aktiveve financiare të këtij modeli) janë vlerësuar dhe raportuar drejt personelit drejtues të njësisë ekonomike;
- Si ndikojnë rreziqet në performancën e modelit të biznesit (dhe aktiveve financiare të mbajtura brenda atij modeli) dhe mënyra e menaxhimit të këtyre rreziqeve;
- Si kompensohen drejtuesit e biznesit, p.sh. nëse kompensimi bazohet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare ose në flukset monetare kontraktuale të mbledhura;
- Frekuenca, vlera dhe koha e realizimit të shitjeve në periudhat e mëparshme, arsyet për shitjet dhe pritshmëria për aktivitetin e ardhshëm të shitjeve; dhe
- Nëse aktiviteti i shitjeve dhe mbledhja e flukseve monetare kontraktuale janë pjesë integrale e modelit të biznesit apo ndodhin në mënyrë të rastësishme (modelet mbajtur deri në maturim dhe mbajtur për shitje)

Aktivitetet financiare që mbahen për tregtim dhe ato që vlerësohen me vlerë të drejtë do të maten me VDNFH.

#### Analizë e Karakteristikave të Flukseve Monetare Kontraktuale

Pasi Fondi përcakton se modeli i biznesit të një portofoli specifik është mbajtja e aseteve financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale (ose njëkohësisht mbledhja e flukseve monetare kontraktuale dhe shitja e aktiveve financiare), duhet të vlerësojë nëse kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar specifikojnë datat e caktuara të flukseve monetare, të cilat janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit mbi principalin e mbetur. Për këtë qëllim, interesi përcakton vlerën në kohë të parasë, rrezikun e kredisë që lidhet me shumën e principalit të papaguar gjatë një periudhe të caktuar kohore. Rreziqe dhe kosto të tjera themelore të huadhënies, si dhe një marzhin e fitimit. Ky vlerësim do të kryhet për çdo instrument në datën e njohjes fillestare të aktivitetit financiar.

Kur vlerëson nëse flukset monetare kontraktuale janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit, Fondi do të marrë parasysh kushtet kontraktuale të instrumentit. Kjo do të përfshijë vlerësimin nëse aktivi financiar përmban një kusht kontraktual që mund të ndryshojë kohën ose shumën e flukseve të mjeteve monetare kontraktuale në mënyrë që të mos plotësojë këtë kusht. Fondi do të marrë në konsideratë:

- Parapagimin, kushtet e zgjatjes së kontratës
- Veçoritë e levës financiare
- Nëse një kusht i kontratës është i limituar në aktive ose flukse monetare specifike
- Instrumentet e lidhura me kontratë

Në vitin 2018, BSNK publikoi një amendament për SNRF 9 në lidhje me tiparet e parapagimit me kompensim negativ. Kompensimi negativ lind kur kushtet kontraktuale lejojnë huamarrësin të parapaguajë instrumentin para maturimit kontraktual, por shuma e parapagimit mund të jetë më e vogël se shumata e papaguar të principalit dhe interesit. Megjithatë, për t'u kualifikuar për matjen me anë të Kostos së Amortizuar, kompensimi negativ duhet të jetë kompensim i arsyeshëm për përfundimin e parakohshëm të kontratës. Fondi nuk pret një volum të lartë të parapagimeve me kompensim negativ, i cili duhet të matet detyrimisht me VDNFH.

#### Modifikimi i vlerës kohore të parasë dhe testit të vlerësimit

Vlera në kohë e parasë është elementi i interesit që merr në konsideratë kalimin e kohës (SNRF 9. B4. 1.9A). Nuk merr parasysh rreziqet e tjera (kredisë, likuiditet etj) ose kostot (administrative, etj.) të lidhura me mbajtjen e një aktivi financiar.

Në disa raste, elementi i vlerës në kohë të parasë mund të mos jetë plotësisht i saktë. Një rast i tillë ndodh kur norma e interesit e një aktivi financiar rivendoset periodikisht, por frekuenca e kësaj rivendosjeje nuk përputhet me maturitetin

## 2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### c) Standarde dhe interpretime të publikuara por akoma jo në fuqi (vazhdim)

e normës së interesit. Në këtë rast njësitë duhet të vlerësojnë modifikimin, në mënyrë që të përcaktojnë nëse flukset monetare kontraktuale përfaqësojnë akoma pagesa vetëm të interesit dhe principalit, që do të thotë maturiteti i rivendosjes nuk ndryshon ndjeshëm flukset e mjeteve monetare nga një instrument standard i përsosur.

#### Vlerësimi i ndikimit në klasifikim dhe matje

SNRF 9 do të ndikojë në klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare të mbajtura të Fondit më 1 Janar 2018 si më poshtë:

Kreditë dhe paradhëniet për bankat dhe klientët, të klasifikuar si hua dhe llogari të arkëtueshme të matura me koston e amortizuar sipas SNK 39, do të maten me koston e amortizuar në përputhje me SNRF 9.

Aktivet financiare të mbajtura deri në maturim, të matura me koston e amortizuar sipas SNK 39, si rregull gjithashtu do të maten me koston e amortizuar në përputhje me SNRF 9.

Instrumentet e borxhit të vlefshëm për shitje, të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet kapitalit sipas SNK 39, si rregull gjithashtu do të maten në VDNATGJ në përputhje me SNRF 9.

#### Kontabiliteti mbrojtës

SNRF 9 lejon opsionet e kontabilitetit mbrojtës. Fondi planifikon të vazhdojë të zbatojë dispozitat për kontabilitetin mbrojtës në përputhje me SNK 39, duke marrë parasysh ndryshimet të paraqitura në shënimet shpjeguese sipas SNRF 7.

#### Zhvlerësimi i përgjithshëm

Llogaritja e humbjeve të pritura të kredisë kërkon përdorimin e parashikimeve kontabël të cilat, sipas përkufizimit, rrallëherë do të jenë të barabarta me rezultatet aktuale. Drejtimi ushtron gjykim në zbatimin e politikave kontabël të Kompanisë së Administrimit.

Fondi vlerëson në bazë të parashikimit humbjet e pritura të kredisë të lidhura me aktivet e saj të borxhit të mbartura me koston e amortizuar dhe VDNATGJ, dhe me ekspozimin që rrjedh nga angazhimet e huasë, kontratat e qirasë dhe kontratat e garancisë financiare. Fondi njih provigjon për humbje të tilla në çdo datë raportimi.

#### Matja e humbjeve të pritshme të kredisë

Matja e humbjeve të pritura të kredisë pasqyron një vlerë të paanshme dhe me probabilitet të ponderuar që përcaktohet duke vlerësuar një sërë rezultatesh të mundshme, vlerën në kohë të parasë dhe informacionin e arsyeshëm dhe të mbështetur që është në dispozicion pa kosto ose përpjekje të panevojshme në datën e raportimit për ngjarjet e kaluara, aktuale dhe parashikimet e kushteve të ardhshme ekonomike.

Matja e lejesës për humbjet e pritshme të kredisë për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar dhe vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, është një zonë që kërkon përdorimin e modeleve komplekse dhe supozimeve të rëndësishme në lidhje me kushtet e ardhshme ekonomike dhe sjelljen e kredisë.

Vlerësime të rëndësishme:

- Përcaktimi i kritereve për rritje të ndjeshme të rrezikut të kredisë
- Zgjedhja e modeleve dhe supozimeve të përshtatshme për matjen e humbjeve të pritura të kredisë
- Vendosja e numrit dhe peshave relative të skenarëve të ardhshëm për secilin lloj produkti/tregu dhe humbjet e pritura të kredisë të lidhura
- Krijimi i grupeve të aktiveve financiare të ngjashme me qëllim matjen e humbjeve të pritshme të kredisë.

Vlerësimi i ekspozimit të kredisë për qëllime të menaxhimit të rrezikut është kompleks dhe kërkon përdorimin e modeleve. Vlerësimi i rrezikut të kredisë për një portofol të aktiveve përfshin vlerësime të mëtejshme në lidhje me mundësitë e mosshlyerjeve të ndodhura, të raporteve të lidhura me humbjen dhe korrelacioneve të mosshlyerjeve ndërmjet palëve. Fondi mat rrezikun e kredisë duke përdorur probabilitetin e mosshlyerjes së kredive, ekspozimin në mosshlyerje të kredisë dhe humbjet nga mosshlyerja. Kjo është një metodë mbizotëruese e përdorur për qëllimet e matjes së humbjeve të pritshme të kredisë sipas SNRF 9.

SNRF 9 përshkruan një model me tre hapa për zhvlerësimin bazuar në ndryshimet në cilësinë e kredisë që nga njohja

## 2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### c) Standarde dhe interpretime të publikuara por akoma jo në fuqi (vazhdim)

fillestare. Ky model kërkon që një instrument financiar, i cili nuk është i zhvlerësuar nga kreditë në njohjen fillestare, klasifikohet në Fazën 1 dhe rreziku i tij i kreditit monitorohet vazhdimisht. Nëse është identifikuar një rritje e ndjeshme e rrezikut të kredisë që nga njohja fillestare, instrumenti financiar kalon në Fazën 2, por nuk konsiderohet të jetë i zhvlerësuar nga kredia. Nëse instrumenti financiar është i zhvlerësuar nga kreditimi, instrumenti financiar më pas zhvendoset në Fazën 3.

Për instrumentet financiare në Fazën 1, humbja e pritshme e kredisë matet me një shumë të barabartë me pjesën e humbjeve të pritshme të kredisë që rezultojnë nga ngjarjet e mundshme gjatë 12 muajve të ardhshëm. Instrumentet në Fazat 2 ose 3 kanë humbjet e pritshme të kredive të matura në bazë të humbjeve të pritura të kredisë gjatë gjithë jetëgjatësisë. Sipas SNRF 9, kur matet humbja e pritshme e kredisë është e nevojshme të merret në konsideratë informacioni për të ardhmen. Aktivet financiare të blera ose me origjinë nga kreditë e zhvlerësuar janë aktive financiare të cilat janë të zhvlerësuar nga kredia në njohjen fillestare. Humbja e pritshme e kreditit matet në vazhdimësi të jetës (Faza 3).

#### Rritja e ndjeshme e rrezikut të kredisë

Fondi konsideron që një instrument financiar ka përjetuar një rritje të ndjeshme të rrezikut të kredisë kur një ose më shumë nga kriteret e mëposhtme sasiore, cilësore ose ndaluese të mëposhtme janë plotësuar:

#### Kriteret sasiore

Fondi përdor kriteret sasiore si tregues parësor të rritjes së konsiderueshme të rrezikut të kredisë për të gjitha portofolet materiale.

Për vlerësimin sasiore, Fondi krahason kurbën e probabilitetit të mospagimit për të gjithë jetëgjatësinë me të dhënat e matura, me kurbën e ardhshme të probabilitetit të mos pagimit në datën e njohjes fillestare. Për vlerësimin e kurbës së probabilitetit të mospagimit për të gjithë jetëgjatësinë në datën e njohjes fillestare, bëhen supozime rreth strukturës së saj. Për instrumentet financiare me vlerësim të lartë, supozohet se kurba do të përkeqësohet me kalimin e kohës. Për instrumentet financiare me vlerësim të ulët, supozohet se kurba do të përmirësohet me kalimin e kohës. Shkalla e përmirësimit ose përkeqësimit do të varet nga niveli i vlerësimit fillestar.

Fondi nuk është në dijeni të ndonjë praktike tregu të pranuar përgjithësisht, e cila specifikon një nivel për të cilin një instrument financiar duhet të transferohet në Fazën 2. Nga kjo perspektivë, pritet që rritja e probabilitetit të mospagimit në datën e raportimit, e cila konsiderohet e rëndësishme, do të zhvillohet gjatë një periudhe kohore si rezultat i një procesi përsëritës ndërmjet pjesëmarrësve të tregut dhe mbikëqyrësve.

#### Kriteret cilësore

Banka përdor kriteret cilësore si një tregues dytësor për rritje të rëndësishme të rrezikut të kredisë për të gjitha portofolet materiale. Transferimi në Fazën 2 zhvillohet kur plotësohen kriteret e mëposhtme.

Për portofolet qeveritare, bankare, të korporatave dhe të financave të projektit, nëse huamarrësi plotëson një ose më shumë nga kriteret e mëposhtme:

- Treguesit e jashtëm të tregut
- Ndryshime në kushtet e kontratës
- Ndryshime në qasjen e drejtimit
- Gjykimi i ekspertëve

Vlerësimi i një rritjeje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë përfshin informacione të ardhshme dhe kryhet në baza tremujore në një nivel marrëveshjeje për të gjithë portofolet jo të tregtueshme të mbajtura nga Fondi.

Për portofolet e tregëtueshme, nëse huamarrësi plotëson një ose më shumë nga kriteret e mëposhtme:

- Lëshime përpara i përket marrëveshjes së kredisë, kur huamarrësi po kalon vështirësi
- Gjykimi i ekspertëve

Vlerësimi i një rritjeje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë përfshin informacion për të ardhmen dhe kryhet në baza mujore në një nivel marrëveshjeje për të gjitha portofolet retail të mbajtura nga Fondi.

## 2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### c) Standarde dhe interpretime të publikuara por akoma jo në fuqi (vazhdim)

#### Ndalesa

Nëse një huamarrës vonohet më shumë se 30 ditë për pagesat e tij kontraktuale, instrumenti financiar mendohet të ketë patur një rritje të ndjeshme në rrezikun e kredisë dhe në këtë rast, aplikohet një ndalesë. Në disa raste të kufizuara, supozimi se aktivet financiare të cilat janë më shumë se 30 ditë vonesa duhet të kalojnë në Fazën 2, hidhet poshtë.

Fondi nuk ka përdorur përjashtimin që vjen nga rreziku i ulët i kredisë për klientët huamarrës; megjithatë, përdor në mënyrë selektive përjashtimin që vjen nga rreziku i ulët i kredisë për instrumentat e borxhit.

#### Përcaktimi i mospagimit dhe aktiveve të zhvlerësuara nga kreditimi

Fondi përcakton që një instrument financiar është në mospagim, i cili është plotësisht i linjësuar me përkufizimin e zhvlerësimit nga kreditimi, kur plotëson një ose më shumë nga kriteret e mëposhtme:

Huamarrësi është më shumë se 90 ditë me vonese për pagesat e tij kontraktuale;

Nuk është bërë asnjë përpjekje për të hedhur poshtë supozimin se asetet financiare të cilat janë më shumë se 90 ditë me vonese duhet të jenë në Fazën 3.

Huamarrësi ka gjasa për të mos paguar, që tregon se është në vështirësi të konsiderueshme financiare. Këto janë raste kur:

- Huamarrësit i janë mundësuar lëshime për një afat të gjatë për shkak të vështirësive që është duke kaluar ose mund të kalojë
- Huamarrësi është i vdekur
- Huamarrësi është i paafte të paguajë
- Huamarrësi është në kundërshtim me kushtet financiare të kontratës
- Nuk ka një treg aktiv për aktivin financiar për shkak të vështirësive financiare
- Është e mundshme që huamarrësi të hyjë në falimentim
- Aktivet financiare janë blerë ose origjinojnë me një zbritje të thellë nga cmimi, që pasqyron humbjet e shkaktuara të kredisë.

Kriteret e mësipërme janë zbatuar mbi të gjitha instrumentet financiare të mbajtura nga Fondi dhe janë në përputhje me përkufizimin e mospagimit të përdorur për qëllime të menaxhimit të brendshëm të rrezikut të kredisë.

#### Shpjegimi i të dhënave, supozimeve dhe teknikave të vlerësimit

Humbja e pritshme e kredisë matet në bazë të një periudhe 12-mujore ose jetëgjatësisë, në varësi të faktit nëse ka ndodhur një rritje e konsiderueshme në rrezikun e kredisë që nga njohja fillestare ose nëse një aktiv konsiderohet si i dëmtuar nga kredia.

Informacioni ekonomik për të ardhmen gjithashtu përfshihet në përcaktimin e probabilitetit të mospagimit 12-mujor dhe të probabilitetit të mospagimit për të gjithë jetëgjatësinë e aktivitetit, ekspozimit në mospagim dhe humbja nga mospagimi. Këto supozime ndryshojnë sipas llojit të produktit. Humbjet e pritshme të kredisë janë prodhimi i probabilitetit të mospagimit, humbja nga mospagimi, ekspozimi në mospagim dhe faktorit skontues (FS).

#### Probabiliteti i mosshlyerjes

Probabiliteti i mosshlyerjes paraqet mundësinë që një huamarrës nuk përmbush detyrimet financiare gjatë 12 muajve të ardhshëm ose gjatë jetës së mbetur të detyrimit. Si rregull, probabiliteti i mosshlyerjes është llogaritur duke përdorur probabilitetin rregullator 12 muajor të mosshlyerjes, pa asnjë marzh konservativizmi. Më pas përdoren metoda të ndryshme statistikore për të gjeneruar një vlerësim se si do të llogaritet profili i mosshlyerjes nga pika e njohjes fillestare e përgjatë gjithë jetës së kredisë ose portofolit të huave.

Në rastet e kufizuara kur disa të dhëna nuk janë në dispozicion, për llogaritjen përdoret grupimi, mesatarja ose krahësimi i të dhënave.

## 2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### c) Standarde dhe interpretime të publikuara por akoma jo në fuqi (vazhdim)

#### Humbja nga mosshlyerja

Humbja nga mosshlyerja, paraqet pritshmërinë që ka Fondi për shkallën e humbjes lidhur me ekspozim që nuk është paguar në kohë. Kjo humbje varion sipas produktit apo palës së tretë nga e cila rrjedh. Humbja nga mospagimi shprehet si përqindje për njësi ekspozimi në kohën e mospagimit. Ajo llogaritet në bazë 12 mujore ose për të gjithë jetëgjatësinë, ku humbja nga mospagimi 12-mujor është përqindja e humbjes që pritet të pësohet nëse ndodh mospagimi në 12 muajt e ardhshëm dhe humbja nga mospagimi gjatë jetës është përqindja e humbjes që pritet të pësohet nëse mospagimi ndodh gjatë jetës së mbetur.

#### Ekspozimi i mosshlyerjes

Ekspozimi në mospagim bazohet në shumat që Fondi pret që klientët t'i kenë borxh në kohën e mospagimit, gjatë 12 muajve të ardhshëm ose gjatë jetës së mbetur. Ekspozimi në Mospagim 12-mujor dhe gjatë jetëgjatësisë përcaktohen në bazë të profilit të pagesës së pritshme, e cila ndryshon sipas llojit të produktit.

Për produktet e amortizueshme dhe huatë që mundësojnë shlyerjen e njëhershme të principalit në maturim (bullet), llogaritja e ekspozimit në mospagim është bazuar në shlyerjet kontraktuale të huamarrësit gjatë një periudhe 12 mujore ose për të gjithë jetëgjatësinë. Aty ku është e përshtatshme, në llogaritje merren parasysh supozimet e ripagimit/rifinancimit të parakohshëm.

Për produktet rrotulluese (revolving), ekspozimi në mospagim llogaritet duke i shtuar shumës së tërhequr një faktor konvertimi të kredisë, i cili lejon tërheqjen e pritshme të kufirit të mbetur deri në kohën e mospagimit. Marzhet rregullatorë të kujdesshme hiqen nga faktori i konvertimit të kredisë. Në rastet e kufizuara kur disa të dhëna nuk janë plotësisht të disponueshme, për llogaritjen përdoret krahasimi i inputeve.

#### Faktori aktualizues

Si rregull, për ekspozime në pasqyrën e pozicionit financiar që nuk janë qera financiare ose instrumenta të blerë ose të origjinuar nga zhvlerësimi i kredisë, norma skontuese e përdorur në llogaritjen e humbjes së pritshme të kredisë është norma efektive e interesit ose një përaftrim i saj.

Humbja e pritshme e kredisë është një produkt i Probabilitetit të mosshlyerjes, humbja nga mosshlyerja dhe Ekspozimi i mosshlyerjes, shumëzuar me probabilitetin e mungesës së mospagimit (probabilitetin e pagimit) të një periudhe më para periudhës kohore të konsideruar. Kjo e fundit shprehet nga funksioni i mbijetesës S. Kjo llogarit vlerat e ardhshme të humbjeve të pritura të kredisë, të cilat pastaj skontoohen në datën e raportimit dhe më pas mbledhen. Vlerat e llogaritura të humbjeve të pritshme të kredisë peshohen me një skenar të ardhshëm.

Modele të ndryshme janë përdorur për të vlerësuar dispozitat e Fazës 3 të shumave të papaguara të kredisë dhe këto mund të grupohen në kategoritë e mëposhtme:

- Qeveritë, klientët korporata, financimet e projektit, institucionet financiare, qeveritë lokale dhe rajonale, kompanitë e sigurimeve dhe ndërmarrjet e investimeve kolektive - Provigjonet e Fazës 3 llogariten nga menaxherët e ristrukturimit që skontojnë flukset e pritshme të parasë sipas normës së përshtatshme efektive të interesit.
- Kredi me hipotekë për individë – Provigjonet e Fazës 3 krijohen duke llogaritur vlerën e zbritur të realizimit të kolateralit.
- Kreditë e tjera të shitjes me pakicë - Provigjonet e Fazës 3 gjenerohen duke llogaritur vlerësimin më të mirë statistikor të humbjes së pritshme, duke marrë parasysh kostot indirekte.
- Nuk është bërë asnjë përpjekje për të hedhur poshtë supozimin se aktivet financiare që janë me më shumë se 90 ditë vonesë duhet të jenë në Fazën 3.

#### Informacion për të ardhmen

Vlerësimi i një rritjeje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë dhe llogaritja e humbjeve të pritura të kredisë përfshijnë informacion që sheh nga e ardhmja. Fondi ka kryer analiza historike dhe ka identifikuar variabla kryesorë ekonomike që ndikojnë në rrezikun e kredisë dhe humbjet e pritshme të kredisë për çdo portofol.

Gjykim i ekspertëve zbatohet në këtë proces. Parashikimet e variablave ekonomike (skenari ekonomik bazë) sigurohen nga Raiffeisen Research në baza tremujore dhe japin parashikimin më të mirë për ekonominë gjatë tre viteve të ardhshme. Pas tre vjetësh, për të projektuar variablat ekonomike për jetëgjatësinë e plotë të secilit instrument, përdoret një metodë e kthimit në mesatare, që do të thotë se variablat ekonomike kanë tendencë ose të jenë një normë mesatare afatgjatë ose të kenë një normë mesatare të rritjes afatgjatë deri në maturim.

## 2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### c) Standarde dhe interpretime të publikuara por akoma jo në fuqi (vazhdim)

Ndikimi i variablave ekonomike mbi probabilitetin e mospagimit, humbja në mospagim dhe ekspozimi në mospagim përcaktohet duke përdorur regresionin statistikor për të kuptuar ndikimin që ndryshimet në këto variabla kanë pasur historikisht në normat e mospagimit dhe mbi përbërësit e humbjes në mospagim dhe ekspozimit në mospagim.

Përveç skenarit ekonomik bazë, Raiffeisen Research gjithashtu ofron një skenar me rastin më të mirë dhe një skenar me rastin më të keq, të ponderuara për të siguruar kapërcimin e jo-linearitetit. Fondi ka arritur në konkluzionin se tre skenare ose më pak kapin në mënyrë të përshtatshme jo-linearitetin. Peshat e skenarit përcaktohen nga një kombinim i analizës statistikore dhe gjykimit të ekspertizës së kredisë, duke marrë parasysh gamën e rezultateve të mundshme që secili skenar i zgjedhur përfaqëson.

Fondi konsideron që këto parashikime përfaqësojnë vlerësimin më të mirë të rezultateve të mundshme dhe mbulojnë çdo jo-linearitet dhe asimetri të mundshme në portofolet e ndryshme të Bankës.

#### Analiza e ndjeshmërisë

Supozimet më të rëndësishme që ndikojnë në lejesën e humbjes së pritshme së kredisë janë si më poshtë:

- Portofolet e korporatave
  - o Prodhimi i Brendshëm Bruto
  - o Shkalla e papunësisë
  - o Norma afatgjatë e obligacioneve qeveritare
  - o Norma e inflacionit
- Portofole e tregtueshme
  - o Prodhimi i Brendshëm Bruto
  - o Shkalla e papunësisë
  - o Çmimet e pasurive të paluajtshme

#### Tranzicioni

Ndryshimet në politikat kontabël që rrjedhin nga miratimi i SNRF 9 në përgjithësi do të zbatohen në mënyrë retrospektive, përveç siç përshkruhet më poshtë:

- Fondi do të përfitojë nga përjashtimi duke e lejuar atë të mos rishikojë informacionin krahasues për periudhat e mëparshme në lidhje me ndryshimet në klasifikimin dhe matjen (duke përfshirë zhvlerësim). Diferencat në vlerën kontabël të aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare që rezultojnë nga zbatimi i SNRF 9 njihen në fitimet e pashpërndara që nga 1 janari 2018.

Vlerësimet e mëposhtme duhet të bëhen në bazë të fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë në datën e aplikimit fillestar:

- Përcaktimi i modelit të biznesit në të cilin mbahet një aktiv financiar.
  - Emërtimi dhe revokimi i emërtimeve të mëparshme të aktiveve dhe detyrimeve të caktuara financiare të matura në VDNFH
  - Caktimi i disa investimeve strategjike që nuk mbahen për tregtim si në VDNATGJ.
- **SNRF 15 "Të ardhura nga Kontratat me Klientët"** dhe ndryshime të mëtejshme (efektive duke filluar 1 Janar 2018 e në vazhdim),
  - **SNRF 16 "Qiratë"** (efektive duke filluar 1 Janar 2019 e në vazhdim),
  - **Ndryshime në SNRF 10 "Pasqyrat financiare të konsoliduara" dhe SNK 28 "Investime në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta"**- Shitja apo kontributi i pasurive ndërmjet nje investitori dhe bashkëpunetori të tij ose sipërmarrje të përbashkët (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 Janar 2017),
  - **Ndryshimet në SNK 7 "Pasqyra e Fluksit të Parasë"** - Nisma Për Paraqitje (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janar 2017),

## 2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### c) Standarde dhe interpretime të publikuara por akoma jo në fuqi (vazhdim)

- **Ndryshime në SNK 12 "Tatimet mbi të ardhurat"**, - Njohja e aktiveve tatimore të shtyra për Humbjet e Porealizuara (efektive për vjetore periudhat që fillojnë më ose pas datës 1 Janar 2017)
- **Ndryshime në disa standarde "Përmirësimet e SNRF-ve (2014 -2016)"** që rezultojnë nga projekti i përmirësimit vjetor të SNRF-ve (SNRF 1, SNRF 12, SNK 28) kryesisht me qëllim **heqjen e mospërputhjeve dhe sqarimin e fjalëve (ndryshimet për SNRF 12 duhet të aplikohen** për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 Janar 2017 dhe ndryshimet për SNK 28 duhet të aplikohen për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 Janar 2018).
- **IFRIC 22 "Transaksionet në monedhë të huaj dhe shqyrtimi i parapagesave"** (efektive për vjetore periudhat që fillojnë më ose pas datës 1 Janar 2018)

Fondi ka zgjedhur të mos adoptojë këto standarde, rishqyrtime dhe interpretime përpara datës së tyre efektive. Fondi parashikon se adoptimi i këtyre standarteve nuk do të ketë impakt material në pasqyrat financiare të Fondit në periudhën fillestare të zbatimit nga Fondi.

### d) Entiteti i investimit dhe konsolidimi

Fondi ka investitorë të shumtë jo të lidhur dhe kryen investimeve të shumta. Fondi është caktuar që të plotësojë përkufizimin e një entiteti investimesh sipas SNRF 10, ndërsa kushtet e mëposhtme ekzistojnë:

- Fondi mbledh asetet me qëllim që t'iu sigurojë investitorëve shërbime profesionale të manaxhimit të investimeve.
- Qëllimi i biznesit të Fondit, i cili u është komunikuar direkt investitorëve, është të investojë asetet me qëllim përfitimin e të ardhurave nga kapitali dhe nga investimet.
- Investimet janë të matura dhe vlerësuara mbi bazën e vlerës së drejtë.

### e) Aktivet dhe detyrimet financiare

#### i Njohja

Aktivitetet financiare njihen në pasqyrën e pozicionit financiar në ditën kur entiteti bëhet palë kontraktuale në lidhje me një instrument në përputhje me blerjen e rregullt të tij. Një mënyrë e rregullt blerjeje ose shitjeje e një instrumenti financiar njihet si datë kontabilizimi të aktivitetit, datën e shlyerjes.

Dita e shlyerjes është dita kur aktivi i livrohët entitetit.

Dita e shlyerjes i referohet a) njohjes së aktivitetit në ditën kur ai merret nga entiteti b) çregjistrimit të aktivitetit dhe njohjes së fitimit/humbjes neto nga shitja në ditën kur ai livrohët/dërgohët nga entiteti. Kur aplikohët dita e shlyerjes, entiteti kontabilizon çdo ndryshim në vlerën e drejtë të aktivitetit gjatë periudhës midis datës së tregtimit dhe datës së shlyerjes. Me fjalë të tjera, ndryshimi në vlerë nuk njihet për aktivitetet e mbajtura me kosto ose kosto të amortizuara; njihet si fitim ose humbje për aktivitetet e klasifikuara si aktive financiare të njohura me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes; njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse për aktivitetet e vlefshme për shitje. Detyrimet njihen fillimisht në datën kur entiteti bëhet palë e kontratës.

#### ii Çregjistrimi

Fondi çregjistron një aktiv financiar kur mbarojnë të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga aktivi financiar, ose kur të drejtat për të arkëtuar flukse monetare kontraktuale të aktivitetit financiar janë transferuar në një transaksion me të cilin transferohen kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktiv financiar. Fondi nuk njihet një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale janë përmbushur, ndërprerë apo kanë përfunduar.

Fondi merr pjesë në transaksione me anë të të cilave transferon aktive të njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por mban të gjitha ose kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivitetit të transferuar, ose një pjesë të tyre. Nëse të gjitha ose kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet mbahen, atëherë aktivitetet e transferuara nuk çregjistrohen nga pasqyra e pozicionit financiar.

Në transaksionet në të cilat Fondi as nuk mban dhe as nuk transferon rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivitetet financiare, aktivi çregjistrohet nëse kontrolli mbi to humbet.

#### iii Matja e vlerës së drejtë

Pas njohjes fillestare të gjitha aktivitetet financiare maten me vlerën e drejtë. Përkufizimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare është përcaktuar duke përdorur teknikën e vlerësimit. Metodat e vlerësimit përfshijnë teknikën e vlerës aktuale neto, metodën e flukseve monetare të skontuara dhe krahasimin me instrumente të tjerë të ngjashëm, për të cilët ekzistojnë çmime tregu dhe metoda vlerësimi. Ndryshimet në vlerën e drejtë janë njohur menjëherë në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave.

## 2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### e) Aktivitet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

#### iv Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit

Në çdo datë raportimi Fondi vlerëson, nëse ka një evidencë objektive që aktivet financiare, të cilat nuk mbahen me vlerën e drejtë përmes fitimit - humbjes, janë zhvlerësuar. Aktivet financiare zhvlerësohen kur evidenca objektive paraqet që një ngjarje që sjell humbje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit dhe që ngjarja që sjell humbje ka ndikim në flukset e ardhshme të parasë së aktivitetit, të cilat mund të maten me besueshmëri.

#### v. Investime të mbajtura deri në maturim

Investimet e mbajtura deri në maturim janë aktive financiare me pagesa fikse ose të përcaktuara dhe maturitet të fiksuar që Kompania ka synimin e qartë dhe aftësinë për të mbajtur deri në maturim, dhe të cilat nuk janë përcaktuar me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes ose në dispozicion për shitje. Investimet e mbajtura deri në maturim mbahen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Çdo shitje ose riklasifikim i shumave të konsiderueshme të investimeve të mbajtura deri në maturim që nuk janë afër maturimit të tyre do të rezultonte në riklasifikimin e të gjithë investimeve të mbajtura deri në maturim si të disponueshme për shitje, dhe do të parandalonte Kompaninë të klasifikonte letrat me vlerë për qëllime investimi si instrumenta të mbajtura deri në maturim për periudhën aktuale dhe gjatë dy viteve financiare pasuese.

#### vi. Investimeve të mbajtura me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes

Fondi mban disa instrumenta me vlerën e drejtë, me ndryshimet e vlerës së drejtë të njohura menjëherë në fitim ose humbje, siç përshkruhet në politikën kontabël 2 (c) (iii). Një prezantim të detajuar të matjeve të vlerës së drejtë mund ta gjeni në shënimin 6 dhe 7.

### f) Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre

Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre përfshijnë aktive financiare me shkallë likuiditeti të lartë, me maturitet më të vogël se tre muaj, të cilat nuk ndikohen shumë nga ndryshimet në vlerën e drejtë dhe përdoren nga Fondi për administrimin e angazhimeve afatshkurtra. Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre mbahen në pasqyrën e pozicionit financiar me kosto të amortizuar.

### g) Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen në fillim në pasqyrën e pozicionit financiar me vlerën e drejtë dhe maten në vazhdim me kosto të amortizuar, duke i zbritur zhvlerësimin.

### h) Llogari të pagueshme dhe të tjera

Llogaritë e pagueshme dhe të tjera janë paraqitur me kosto të amortizuar.

### i) Rënia në vlerë e aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Fondit rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për zhvlerësim. Nëse ka evidenca të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Një humbje nga rënia në vlerë njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon vlerën e rikuperueshme. Një njësi gjeneruese e mjeteve monetare është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse monetare që janë të pavarura nga aktivitet dhe grupet e tjera. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në fitim ose humbje. Shuma e rikuperueshme e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është më e madhe se vlera e tij në përdorim dhe se vlera e drejtë minus koston e shitjes.

Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e ardhshme të mjeteve monetare janë skontuar me vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivitetin. Humbjet nga zhvlerësimi të njohura në periudhat e mëparshme vlerësohen në çdo datë raportimi për të parë nëse humbja është zvogëluar apo nuk ekziston. Humbja nga rënia në vlerë rimerret nëse ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga rënia në vlerë anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivitetit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin, në qoftë se humbja nga rënia nuk ishte njohur.

### j) Kuotat e shlyeshme

Fondi emeton kuota të shlyeshme, me kërkesë të investitorit.. Kuotat klasifikohen si detyrime financiare. Çdo investitor që ka bërë shlyerje të kuotave të tij, mund të ri-investojë në Fond nëpërmjet depozitimit të mjeteve monetare ekuivalente me vlerën e kuotave të kërkuara. Kuotat janë të shlyeshme çdo ditë. Në momentin e kërkesës për shlyerje, kuotat që do të shlyhen mbarten në vlerën e shlyerjes si detyrim i pagueshëm në pasqyrën e pozicionit financiar të Fondit. Vlera neto e aktiveve është e barabartë me vlerën totale të aktiveve neto minus detyrimet e Fondit.



## 2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### k) Vlera neto e aktiveve

Vlera neto e aktiveve është e barabartë me vlerën totale të aktiveve neto minus detyrimet e Fondit.

### l) Vlera e kuotës së fondit

Vlera e një kuote të fondit është e barabartë me vlerën neto të aktiveve pjesëtuar me numrin e kuotave në datën e raportimit. Bazuar në politikën e Fondit, vlera e një kuote në nisjen e Fondit ishte e barabartë me 1,000 Lek.

### m) Të ardhurat nga interesi

Të ardhurat nga interesi përfshijnë hyrjet nga kuponat e obligacioneve dhe interesat nga bonot e thesarit si dhe interesat nga depozitat maturuara gjatë vitit dhe interesat e llogarisë rrjedhëse. Të ardhurat nga interesi njihen në bazë përlllogaritjeje.

### n) Tarifa e Shoqërisë Administruese

Fondi duhet t'i paguajë Shoqërisë së Administrimit një tarifë prej 1.5% në vit (2016: 1.5%) të vlerës së aktiveve neto, si shpenzim i cili llogaritet në baza ditore.

### o) Fitimi / humbje te realizuara

Fitim / humbjet e realizuara njihen nga shitja e letrave me vlerë si diferencë midis çmimit të ofruar te shitjes dhe vlerës së titullit në momentin e shitjes dhe nga interesat e letrave me vlerë te maturuara të blera me premium ose skonto. Këto dallime njihen në fitim ose humbje kur ndodhin.

### p) Fitimi / humbje të parealizuara

Fitimi / humbja e parealizuar njihet si diferencë midis kostos dhe vlerës së drejtë. Kur letrat me vlerë shiten fitim / humbja e parealizuar transferohet në fitim/ humbje për periudhën.

### q) Krahasueshmëria

Të gjitha shumat janë raportuar ose paraqitur me informacione krahasuese.

## 3. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR

### a) Përmbledhje

Aktivitetet e Fondit e ekspozojnë atë ndaj një shumëllojshmërie rreziqesh financiare: rrezikut të tregut (duke përfshirë rrezikun e këmbimit valutor, rrezikun e normës së interesit dhe rreziqe të tjera të çmimeve), rrezikut të kredisë dhe rrezikut të likuiditetit të cilat janë shpjeguar me hollësi më poshtë:

#### **Struktura e administrimit të rrezikut**

Në bazë të ligjit nr. 10197, datë 10 dhjetor 2009 "Për fondet e pensionit vullnetar" Shoqëria Administruese ka përfshirë në strukturën e saj, Njësinë e Menaxhimit të Rrezikut, përgjegjës për administrimin e rrezikut dhe për raportimin në Keshillin e Administrimit. Politikat e menaxhimit të rrezikut të Fondit janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet e hasura nga institucioni financiar, për të vendosur kufizime dhe kontrolle, dhe për të monitoruar zbatimin e këtyre kontrolleve. Politikat e administrimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut, produktet dhe shërbimet e ofruara. Fondi, përmes standardeve dhe procedurave të menaxhimit, synon të zhvillojë një mjedis kontrolli konstruktiv dhe të disiplinuar, në të cilin çdo punonjës do kuptojë rolin dhe detyrimet përkatëse.

### b) Rreziku kreditor

Rreziku i kreditor lidhet me mundësinë që emetuesi i një instrumenti financiar, pjesë e aseteve të Fondit, të mos jetë në gjendje të shlyejë pjesërisht ose plotësisht të gjitha detyrimet e tij, çka do të kishte një impakt negativ mbi vlerën e aseteve të Fondit. Këshilli i Administrimit ka deleguar përgjegjësinë për administrimin e rrezikut kreditor Menaxhimit, i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e rrezikut të kredisë të Fondit. Investimet e Fondit janë në bono thesari dhe obligacione të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe për këtë arsye Fondi është i ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë së Qeverisë së Republikës së Shqipërisë. Fondi nuk përfshin asnjë kolateral apo përforsues tjetër të rrezikut të kredisë, te cilët mund të reduktojnë ekspozimin e Fondit.

### 3. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM) a) Përmbledhje (vazhdim)

Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut kreditor më 31 dhjetor është vlera kontabël e aktiveve financiare të përcaktuara më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Aktivet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes	48,893,635	56,805,464
Aktivet financiare të mbajtura deri në maturim	451,218,018	350,425,620
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	9,078,383	9,259,342
<b>Totali</b>	<b>509,190,036</b>	<b>416,490,426</b>

Cilësia e kredisë së letrave me vlerë të investimeve sipas klasifikimit të Standard and Poor janë të detajuara si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Vlerësimi i tanishëm: B + (Shqipëria)	500,111,653	407,231,084
<b>Vlera e mbartur</b>	<b>500,111,653</b>	<b>407,231,084</b>

Më 31 dhjetor 2017, aktivet e mbajtura nga fondi i pensionit nuk janë as me vonesë as të zhvlerësuar (2016: asnjë)

### c) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Fondi mund të mos jetë në gjendje të gjenerojë burime të mjaftueshme të mjeteve monetare për të shlyer detyrimet e tij në mënyrë të plotë në kohën e duhur ose mund të veprojë kështu vetëm në kushte që janë materialisht të pafavorshme.

Në mungesë të detyrimeve të rëndësishme financiare Shoqëria Administruese, e monitoron rrezikun e likuiditetit në bazë të flukseve monetare të aktualizuara kontraktuale. Tabela e mëposhtme analizon aktivet financiare dhe detyrimet e Fondit në grupimet përkatëse të maturimit bazuar në periudhën e mbetur në pasqyrën e pozicionit financiar deri në datën kontraktuale të maturimit. Shumat në tabelë janë flukset e mjeteve monetare të aktualizuara kontraktuale më 31 dhjetor 2017 dhe 2016

31 Dhjetor 2017	Deri 1 muaj	1 deri në 3 muaj	3 deri 6 muaj	6 deri 12 muaj	Mbi 1 vit	Totali
<b>Aktivet</b>						
Aktivet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes	-	-	-	9,566,016	39,327,620	48,893,636
Aktivet financiare të mbajtura deri në maturim	-	-	4,454,737	13,126,508	433,636,773	451,218,018
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	9,078,383	-	-	-	-	9,078,383
<b>Totali</b>	<b>9,078,383</b>	<b>-</b>	<b>4,454,737</b>	<b>22,692,524</b>	<b>472,964,392</b>	<b>509,190,037</b>
<b>Detyrimet</b>						
Detyrime ndaj Shoqërisë së Administrimit	639,285	-	-	-	-	<b>639,285</b>
Detyrime për kërkesa terheqjeje nga fondi	173,574	-	-	-	-	<b>173,574</b>
Detyrime të tjera	1,401,909	-	-	-	-	<b>1,401,909</b>
<b>Totali</b>	<b>2,214,767</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>2,214,767</b>
<b>Rreziku i likuiditetit</b>	<b>6,863,616</b>	<b>-</b>	<b>4,454,737</b>	<b>22,692,524</b>	<b>472,964,392</b>	<b>506,975,269</b>
<b>Akumulimi</b>	<b>6,863,616</b>	<b>6,863,616</b>	<b>11,318,353</b>	<b>34,010,877</b>	<b>506,975,269</b>	

### 3. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

#### c) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

31 Dhjetor 2017	Deri 1 muaj	1 deri në 3 muaj	3 deri 6 muaj	6 deri 12 muaj	Mbi 1 vit	Totali
<b>Aktivet</b>						
Aktivet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes	-	2,824,150	-	-	53,981,314	56,805,464
Aktivet financiare të mbajtura deri në maturim	-	-	1,723,401	10,064,976	338,637,243	350,425,620
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	9,259,342	-	-	-	-	9,259,342
<b>Totali</b>	<b>9,259,342</b>	<b>2,824,150</b>	<b>1,723,401</b>	<b>10,064,976</b>	<b>392,618,557</b>	<b>416,490,427</b>
<b>Detyrimet</b>						
Detyrime ndaj Shoqërisë së Administrimit	520,886	-	-	-	-	520,886
Detyrime për kërkesa terheqjeje nga fondi	2,317,726	-	-	-	-	2,317,726
Detyrime të tjera	1,443,949	-	-	-	-	1,443,949
<b>Totali</b>	<b>4,282,561</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>4,282,561</b>
<b>Rreziku i likuiditetit</b>	<b>4,976,781</b>	<b>2,824,150</b>	<b>1,723,401</b>	<b>10,064,976</b>	<b>392,618,557</b>	<b>412,207,866</b>
<b>Akumulimi</b>	<b>4,976,781</b>	<b>7,800,931</b>	<b>9,524,333</b>	<b>19,589,309</b>	<b>412,207,866</b>	

#### d) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimi në çmimet e tregut do të ndikojnë në të ardhurat e Fondit ose në vlerën e instrumenteve financiare. Objektivi i administrimit të rrezikut të tregut është të menaxhojë dhe kontrollojë ekspozimet ndaj riskut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, ndërkohë që optimizon kthimin nga rreziku.

#### **Ekspozimi ndaj rrezikut të monedhës së huaj**

Fondi nuk është i ekspozuar ndaj rrezikut të valutës nëse transaksionet në monedhë të huaj mungojnë. Fondi nuk ka hyrë në ndonjë shkëmbim ose transaksion derivativ më 31 dhjetor 2017. Më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 nuk ka aktive ose pasive financiare të cilat janë të shprehura në monedhë të huaj.

#### **Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit**

Rreziku kryesor ndaj të cilit portofolet tregtare janë ekspozuar është rreziku i humbjes nga luhatja e flukseve të ardhshme të parasë ose vlerës së drejtë të instrumenteve financiare për shkak të një ndryshimi në normat e interesit të tregut (diferencat mes vlerës aktuale të aktiveve dhe detyrimeve neto). Rreziku i normës së interesit menaxhohet kryesisht nëpërmjet monitorimit të diferencave të normave të interesit. Administrimi i rrezikut të normave të interesit kundrejt hendekut të limitit të normave të interesit, plotësohet duke monitoruar ndjeshmërinë e aktiveve dhe detyrimeve financiare të Fondit për skenarë të ndryshëm standard dhe jo-standard të normave të interesit. Skenarët standardë të cilët vlerësohen në mënyrë periodike, përfshijnë 100 pikë bazë (pb) rënie ose ngritje paralele në të gjitha kurbat e kthimit. Një analizë e ndjeshmërisë së Fondit në një rritje ose rënie të normave të interesit të tregut (duke supozuar që nuk ka lëvizje asimetrike të kurbave të kthimit si dhe një gjendje të pandryshueshme financiare) është si vijon:

<b>2017</b>		
Normat e interesit	Rënie 100 pbs	Rritje 100 pbs
Efekti i fitim/ humbjes së vlerësuar (në 000 lek)	1,314	(1,314)
<b>2016</b>		
Normat e interesit	Rënie 100 pbs	Rritje 100 pbs
Efekti i fitim/ humbjes së vlerësuar (në 000 lek)	1,753	(1,753)

## 4. MANAXHIMI I RREZIKUT TË KAPITALIT

Kapitali i Fondit është i përfaqësuar nga aktivet neto që i atribuohen kontribuesve. Objektivi i Fondit për sa i përket menaxhimit të kapitalit është të ruajë vazhdimësinë e tij në mënyrë që të sigurojë kthim nga investimi për kontribuesit/partnerët dhe përfitime për aktorë të tjerë dhe të mbajë një bazë të fortë kapitali për të mbështetur zhvillimin e aktiviteteve të investimeve. Shoqëria Administruese e monitoron kapitalin në bazë të vlerës së aktiveve neto që i atribuohen kontribuesve.

## 5. STRATEGJIA E INVESTIMIT

Strategjia e investimeve të aktiveve të Fondit të Pensionit Vullnetar Raiffeisen mbështetet në ligjin nr. 10197 "Per Fondet e Pensionit Vullnetar" dhe rregulloret e dala në zbatim të tij, si dhe në politikën e brendshme të investimit të Shoqërisë Administruese, propozuar nga Komiteti i Investimit dhe miratuar nga Keshilli i Administrimit i Shoqërisë Administruese.

### a) Kuadri ligjor

Në lidhje me investimet e aktiveve të Fondit, Shoqëria Administruese Raiffeisen INVEST – Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a. i përmbahet ligjit nr. 10197, datë 10 dhjetor 2009 "Për Fondet e Pensionit Vullnetar", si dhe rregullores "Për aktivet e lejuara, kufizimet dhe kufirin maksimal të investimit të fondit të pensionit", miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare me vendimin e Bordit nr. 1, datë 28 janar 2010 dhe ndryshuar me vendimin e Bordit nr.109, datë 18 tetor 2010.

#### (i) Investimet e lejuara

Sipas rregullores, aktivet e Fondit mund të investohen vetëm në instrumentet e mëposhtëm:

- bono thesari, obligacione dhe letra të tjera me vlerë të emetuara ose të garantuara nga Republika e Shqipërisë;
- bono thesari, obligacione dhe letra të tjera me vlerë të emetuara ose të garantuara nga një shtet anëtar i BE-së ose i OECD-së ose nga bankat qendrore përkatëse;
- bono thesari, obligacione, ose letra të tjera me vlerë të emetuara ose të garantuara nga Banka Qendrore Europiane, Banka Europiane e Investimeve dhe Banka Botërore;
- depozita bankare në banka të licensuara, me afat maturimi jo më shumë se 12 muaj;
- letra borxhi të klasifikuara si BBB ose më lart, sipas Standard & Poor's ose Fitch, Baa3 ose më lart sipas Moody's ose BBB (e ulët) ose më lart sipas DBRS (Dominion Bond Rating Service);
- aksione ose kuota të fondeve të investimit të licensuara në një shtet anëtar të BE-së dhe që kanë si qëllim të vetëm investimin në indekset në vijim: CAC 40, DAX, FTSE 100, S&P 500, Mesatarja Industriale e Dow Jones, Nikkei 225 (Japoneze), Sensex (Indiane), All Ordinaries (Australiane) dhe Indeksi Hang Seng (Hong Kong), ose në obligacione, bono thesari dhe letra të tjera me vlerë të emetuara ose të garantuara nga shtetet anëtare të BE-së.

#### (ii) Kufizimet e investimit dhe kufiri i lejuar

Aktivët e fondit nuk mund të investohen më shumë se:

- 100% në obligacione, bono thesari dhe letra të tjera me vlerë të emetuara ose të garantuara nga Republika e Shqipërisë;
- 20% në depozita bankare në të njëjtën bankë;
- 30% në letra borxhi të klasifikuara si BBB ose më lart, sipas Standard & Poor's ose Fitch, Baa3 ose më lart sipas Moody's, ose BBB (e ulët) ose më lart sipas DBRS (Dominion Bond Rating Service), por jo më shumë se 10 % në një emetues të vetëm;
- 30% në aksione ose në kuota të fondeve të investimit të licensuara në një shtet anëtar të BE-së dhe:
  - o që aktivet e tyre investohen në indekset në vijim: CAC 40, DAX, FTSE 100, S&P 500, Mesatarja Industriale e Dow Jones, Nikkei 225 (Japoneze), Sensex (Indiane), All Ordinaries (Australiane) dhe Indeksi Hang Seng (Hong Kong); ose
  - o që aktivet e tyre investohen në obligacione, bono thesari dhe letra të tjera me vlerë të emetuara ose të garantuara nga shtetet anëtare të BE-së;
- 100% në obligacione, bono thesari ose në letra të tjera me vlerë të emetuara ose të garantuara nga Banka Qendrore Europiane, Banka Europiane e Investimeve dhe Banka Botërore;

## 5. STRATEGJIA E INVESTIMIT (VAZHDIM)

### a) Kuadri ligjor (vazhdim)

- 100% në obligacione, bono thesari dhe letra të tjera me vlerë të emtuara ose të garantuara nga shtetet anëtare të BE-së ose të OECD-se ose nga bankat qendrore përkatëse, por:
  - o jo më shumë se 30% në një emetues të vetëm;
  - o kufiri rritet deri në 100% në një emetues të vetëm, pas miratimit nga AMF, sipas argumenteve të dhëna për një politikë të tillë investimi.

### (iii) Investimet e ndaluara

Shoqëria Administruese duhet t'i përmbahet ligjit për të mos i investuar aktivet e Fondit të Pensionit Vullnetar Raiffeisen në instrumentat e mëposhtëm:

- aksione, obligacione dhe letra të tjera me vlerë, që nuk janë të listuara ose që nuk tregtohen në bursë, në tregun ndërbankar apo në tregje të tjera, të rregulluara nga autoriteti përkatës;
- aktive, që nuk mund të shiten ose transferohen;
- instrumente derivative, përveç rasteve për mbrojtjen nga rreziku i kursit të këmbimit apo nga rreziqe të ngjashme;
- aktive afatgjata materiale, që nuk kuotohen në mënyrë të rregullt në tregje të organizuara dhe për të cilat vlerësimi është i pasigurt, si, antika, punime arti, mjete motorike etj;
- aksione, obligacione dhe letra të tjera me vlerë, të emtuara nga:
  - o çdo aksionar i Shoqërisë Administruese;
  - o depozitari i fondit të pensionit;
  - o çdo person, palë e lidhur me aksionarin e Shoqërisë Administruese dhe me Depozitarin e fondit të pensionit;
  - o kuota të fondeve të investimeve, që administrohen nga vetë Shoqëria Administruese;
  - o letra borxhi të emtuara nga vetë punëdhënësi.

Shoqëria Administruese i manaxhon asetet e Fondit sipas parimit të sigurisë afatgjatë dhe të një kthimi të përshtatshëm nga investimi, duke ruajtur një raport optimal mes rritjes së kursimeve për pension dhe riskut të marrë përsipër. Objektivat afatgjatë për shpërndarjen e aktiveve të Fondit janë si më poshtë:

Klasa	Objektivi
Tituj të emtuar dhe garantuar nga qeveria e Republikës së Shqipërisë	95%
Tituj të emtuar dhe garantuar nga shtete të Bashkimit Europian, OECD-së, Banka Botërore, Banka Qendrore Europiane, Banka Europiane e Investimeve	0%
Depozita bankare dhe cash	5%
Instrumenta borxhi me rating BBB (S&P), Baa3 (Moody's), BBB (DBRS)	0%
Kuota të fondeve të investimit ose indekse aksionesh: CAC 40, DAX, FTSE, S&P 500, Dow Jones, Nikkei 225, Sensex, All Ordinaries and Hang Seng	0%

### b) Politika e brendshme e investimeve të Shoqërisë së Administrimit

Më 31 dhjetor 2017 edhe 31 dhjetor 2016, për të mbrojtur anëtarët e Fondit nga rreziku i kursit të këmbimit dhe duke pasur parasysh se tregu i letrave me vlerë shqiptare është ende në zhvillim dhe mungon një bursë e përshtatshme, portofoli përbëhet nga bono thesari dhe obligacione qeveritare të lëshuara nga Qeveria Shqiptare.

Rreziku në investime ndërmerret vetëm nga anëtarë të Fondit dhe jo nga Shoqëria Administruese. Për të minimizuar këtë rrezik, Shoqëria Administruese ka përfshirë në strukturën e saj organizative Komitetin e Investimeve, i cili miraton

## 5. STRATEGJIA E INVESTIMIT (VAZHDIM)

### a) Kuadri ligjor (vazhdim)

politikat e investimeve, dhe një Njësi për Menaxhimin e rrezikut e cila kryen kontrollin sasior dhe cilësor të të gjitha rreziqeve të lidhura me Fondin. Pasqyra e strukturës së investimeve më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 paraqitet si më poshtë:

	<b>31 Dhjetor 2017</b>	<b>Pjesa ndaj totalit të aktiveve të fondit %</b>
Obligacione Qeveritare	500,111,653	98%
Mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre	9,078,383	2%
<b>TOTALI</b>	<b>509,190,036</b>	<b>100%</b>

	<b>31 Dhjetor 2016</b>	<b>Pjesa ndaj totalit të aktiveve të fondit %</b>
Obligacione Qeveritare	407,231,084	98%
Mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre	9,259,342	2%
<b>TOTALI</b>	<b>416,490,426</b>	<b>100%</b>

## 6. VLERA E DREJTË E AKTIVEVE DHE DETYRIMEVE FINANCIARE

Duke filluar nga 1 janar 2013 Fondi ka adoptuar SNRF 13 në lidhje me dhënien e informacioneve shpjeguese rreth shkallës së besueshmërisë së matjeve të vlerës së drejtë. Kjo kërkon që Fondi të klasifikojë, për qëllime të shpalosjes, matjet e vlerës së drejtë duke përdorur një hierarki të vlerës së drejtë e cila reflekton rëndësinë e të dhënave të përdorura në kryerjen e matjeve.

### *Përcaktimi i vlerës së drejtë*

Përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare të tregtuara në tregje aktive bazohet tek çmimet e kuotuar të tregut ose në çmimet e shitësit. Vlera e drejtë e instrumenteve të tjera financiare përcaktohet përmes teknikave të vlerësimit. Teknikat e vlerësimit përfshijnë teknikën e vlerës aktuale neto, metodën e skontimit të flukseve monetare, krahasimin me instrumente të ngjashme për të cilat ka çmime tregu dhe modelet e vlerësimit.

Fondi e mat vlerën e drejtë duke përdorur Nivelin 2 të hierarkisë së vlerës së drejtë, i cili reflekton rëndësinë e elementëve të përdorur në realizimin e vlerësimit, që shpjegohet si më poshtë:

- **Niveli 2:** Teknikat e vlerësimit të bazuara në elementet e vëzhgueshëm, në mënyrë direkte ose jo direkte (p.sh. që rrjedhin nga çmimet). Kjo kategori përfshin instrumente të vlerësuar nëpërmjet çmimeve të instrumenteve të ngjashëm të kuotuar në tregje aktive; çmimet e kuotuar të instrumenteve të njëjta ose të ngjashme në tregje jo shumë aktive; ose teknika të tjera vlerësimi, ku të gjithë elementet e rëndësishme vëzhgohen në mënyrë direkte ose jo direkte nga të dhënat e tregut.

Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare që tregtohen në tregje aktive bazohet në çmimet e kuotuar të tregut ose në çmimet e kuotuar të shitësit. Për instrumentet financiare që nuk tregtohen në mënyrë të vazhdueshme dhe që nuk kanë transparencë në çmime, vlera e drejtë është më pak objektive dhe kërkon nivele të ndryshme të gjykimit, në varësi të likuiditetit, përqendrimit, pasigurisë së faktorëve të tregut, supozimeve mbi çmimet dhe rreziqeve të tjera që ndikojnë në instrument.

### *Mjete monetare dhe ekuivalente*

Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre përfshijnë paratë në arkë, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat me bankat rezidente. Sikurse këto gjendje janë afatshkurtra, vlera e drejtë e tyre është pothuajse e barabartë me vlerën e mbartur.

### *Investimet në letra me vlerë*

Investimet në letra me vlerë përfshijnë bono thesari dhe obligacione të qeverisë. Vlera e drejtë e tyre llogaritet duke përdorur modelin e flukseve të skontuara të parave bazuar në normën e brendshme aktuale të kthimit e përshtatshme për maturitetin e mbetur. Investimet në letra me vlerë janë mbajtur me vlerën e drejtë. Tabela e mëposhtme analizon në kuadër të hierarkisë së vlerës së drejtë aktivet financiare të Fondit (në bazë të klasës) i matur me vlerën e drejtë më 31 Dhjetor 2017 dhe 31 Dhjetor 2016.

## 6. VLERA E DREJTË E AKTIVEVE DHE DETYRIMEVE FINANCIARE (VAZHDIM)

Të gjitha matjet e vlerës së drejtë të publikuara janë matje te vlerës së drejtë periodike.

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Aktivët financiarë me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes	48,893,635	56,805,464
Aktivët financiarë të mbajtura deri në maturim	451,218,018	350,425,620
Paraja dhe ekuivalentë të saj	9,078,383	9,259,342
<b>Totali</b>	<b>509,190,036</b>	<b>416,490,427</b>

Vlerësimet janë përgatitur dhe shqyrtuar në baza mujore nga vlerësimi i Menaxherit të rrezikut që raporton dhe i jep rekomandime shoqërisë administruese në bazë mujore, në përputhje me vlerësimet mujore që janë dhënë për investitorët. Menaxheri i rrezikut konsideron përshtatshmërinë e modelit të vlerësimit, të dhënat hyrëse kryesore si dhe rezultatin e vlerësimit duke përdorur metoda të ndryshme të vlerësimit dhe teknika përgjithësisht të njohura si standarde në kuadër të industrisë. Teknika e vlerësimit është zgjedhur dhe kalibruar në blerjen e titujve themelore të portofolit. Në përcaktimin e përshtatshmërisë të teknikës së zgjedhur të vlerësimit, Menaxheri i rrezikut mund të kryejë testimin përsëri duke marrë në konsideratë rezultatet aktuale të modeleve të ndryshme dhe se si ata historikisht janë në një linjë me transaksionet aktuale të tregut. Gjithashtu banka kujdestare është përgjegjëse për shqyrtimin e rivlerësimeve përmes një procedure të përditshme konfirmimi.

## 7. VLERËSIMET DHE GJYKIMET KRITIKE KONTABËL

Fondi bën vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën dhe faktorët e tjerë, duke përfshirë pritjet e ngjarjeve të ardhshme të cilat besohet të jenë të arsyeshme duke marrë në konsideratë rrethanat.

### Vlera e drejtë e investimeve e pakuotuar në një treg aktiv

Vlera e drejtë e letrave me vlerë që nuk janë të kuotuar në një treg aktiv përcaktohet duke përdorur teknika vlerësimi, kryesisht të ardhurat shumëfishme, flukset e mjeteve monetare të skontuara dhe transaksionet e kohëve të fundit të krahasueshme.

Modelet e përdorura për të përcaktuar vlerën e drejtë janë të vlefshme dhe rishikohen periodikisht nga Shoqëria Administruese. Inputet në modele me të ardhurat të shumëfishta përfshijnë të dhëna të vëzhgueshme, siç janë shumëfisha të të ardhurave të kompanive të krahasueshme me kompaninë përkatëse të portofolit, dhe të dhëna të pavëzhgueshme, të tilla si të ardhurat e parashikuara për kompaninë e portofolit. Në modelet e skontuara të flukseve monetare, inputet jo të vëzhgueshme janë flukset e mjeteve monetare të projektuara të kompanisë përkatëse të portofolit dhe primit të rrezikut për likuiditet dhe rrezikun e kreditit që janë të përfshira në normën e skontimit. Megjithatë, normat e skontimit të përdorura për vlerësimin e letrave me vlerë të kapitalit përcaktohen në bazë të kthimive kapitale historike për subjektet e tjera që veprojnë në të njëjtën industri për të cilat kthimet e tregut janë dukshme.

Menaxhimi përdor modele për të rregulluar kthimin e kapitalit neto të vëzhguar për të reflektuar strukturën aktuale të financimit të borxhit / kapitalit neto të investimeve të vlerësuara të kapitalit. Modelet janë të kalibruara nga mbrapa-tësimi për rezultatet aktuale/ çmimet e daljes të arritura për të siguruar që rezultatet janë të besueshme.

### Statusi i entitetit të investimeve

Në përcaktimin e statusit të Fondit si një entitet investimi në përputhje me SNRF 10, Shoqëria Administruese konsideron faktet e mëposhtme:

- Fondi ka grumbulluar asetet monetare nga investitorët e tij në mënyrë që të rrisë investimet financiare dhe për të ofruar shërbime të menaxhimit në lidhje me këto investime;
- Fondi ka për qëllim të gjenerojë kapitale dhe kthime në të ardhura nga investimet të cilat do të shpërndahen në përputhje me kërkesat e kontribuesit; dhe

## 7. VLERËSIMET DHE GJYKIMET KRITIKE KONTABËL (VAZHDIM)

- c) Fondi vlerëson performancën e investimeve të letrave me vlere të veta mbi bazën e vlerës së drejtë, në përputhje me politikat e përcaktuara në këto pasqyra financiare. Edhe pse Fondi plotëson të tre kriteret përcaktuese, Shoqëria Administruese e ka vlerësuar gjithashtu qëllimin e biznesit të Fondit, strategjitë e investimit për investimet e letrave me vlere, natyrën e çdo të ardhure nga investimet e letrave me vlere dhe modelet e vlerës së drejtë. Shoqëria Administruese bëri këtë vlerësim për të përcaktuar nëse fusha të tjera të gjykitimit ekzistojnë në lidhje me karakteristikat tipike të një njësie ekonomike të investimit kundrejt atyre të Fondit.

## 8. TË ARDHURA NGA INTERESI

Të ardhurat nga interesi përbehen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Obligacione të Qeverisë	32,878,380	27,920,393
Të ardhurat nga interesi i depozitave	-	-
Të ardhurat nga interesi i llogarive rrjedhëse	-	-
<b>Totali</b>	<b>32,878,380</b>	<b>27,920,393</b>

Të ardhurat nga interesi i depozitave përfaqësojnë interesin e fituar nga depozitat e hapura dhe të maturuara brenda vitit.

## 9. NDRYSHIME TË TJERA NETO NË VLERËN E DREJTË

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2016
Fitime të realizuara nga investimet	96,184	15,740
Humbje të realizuara nga investimet	(263,407)	(172,264)
Fitime të porealizuara nga investimet	2,080,896	5,904,820
Humbje të porealizuara nga investimet	(2,076,035)	(3,888,112)
<b>Ndryshimi total në vlerën e drejtë të aktiveve financiare</b>	<b>1,860,183</b>	<b>1,860,183</b>

## 10. AKTIVE FINANCIARE TË MBAJTURA ME VLERË TË DREJTË NËPËRMJET FITIMIT OSE HUMBJES

Aktivët financiarë me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes janë paraqitur si më poshtë:

*(Amounts in Lek, unless otherwise stated)*

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Obligacione Qeveritare	48,893,635	56,805,464
<b>Totali</b>	<b>48,893,635</b>	<b>56,808,464</b>



	Vlera Nominale	Primi i paamortizuar	Interesi i përlogaritur	Vlera e drejtë fitim/ (humbje)	Vlera e tregut
Obligacione Qeveritare	43,800,000	4,480,995	452,933	159,707	48,893,636
<b>31 Dhjetor 2017</b>	<b>43,800,000</b>	<b>4,480,995</b>	<b>452,933</b>	<b>159,707</b>	<b>48,893,636</b>

	Vlera Nominale	Primi i paamortizuar	Interesi i përlogaritur	Vlera e drejtë fitim/ (humbje)	Vlera e tregut
Obligacione Qeveritare	51,500,000	2,495,659	620,569	2,189,236	56,805,464
<b>31 Dhjetor 2016</b>	<b>51,500,000</b>	<b>2,495,659</b>	<b>620,569</b>	<b>2,189,236</b>	<b>56,805,464</b>

Lëvizjet në vlerë nominale të aktiveve financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes më 31 dhjetor 2017 janë paraqitur më poshtë:

Obligacione Qeveritare	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Më 1 janar	51,500,000	53,700,000
Blerje gjatë vitit	-	-
Të maturuara gjatë vitit	(7,700,000)	(2,200,000)
<b>Më 31 dhjetor</b>	<b>43,800,000</b>	<b>51,500,000</b>

## 11. AKTIVE FINANCIARE TË MBAJTURA DERI NË MATURIM

Afatgjata	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Obligacione Qeveritare	451,218,018	350,425,620
<b>Totali</b>	<b>451,218,018</b>	<b>350,425,620</b>

	Vlera Nominale	Primi i paamortizuar	Interesi i përlogaritur	Vlera neto
Obligacione Qeveritare	439,180,000	2,407,250	9,630,768	451,218,018
<b>31 Dhjetor 2017</b>	<b>439,180,000</b>	<b>2,407,250</b>	<b>9,630,768</b>	<b>451,218,018</b>

	Vlera Nominale	Primi i paamortizuar	Interesi i përlogaritur	Vlera neto
Obligacione Qeveritare	339,080,000	3,188,583	8,157,037	350,425,620
<b>31 Dhjetor 2016</b>	<b>339,080,000</b>	<b>3,188,583</b>	<b>5,858,276</b>	<b>350,425,620</b>

Lëvizjet në vlerë nominale të aktiveve financiare të mbajtura deri në maturim më 31 dhjetor 2017 janë paraqitur më poshtë:

Obligacione Qeveritare	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Më 1 janar	339,080,000	244,780,000
Blerje gjatë vitit	111,600,000	101,600,000
Të maturuara gjatë vitit	(11,500,000)	(7,300,000)
<b>Më 31 Dhjetor</b>	<b>439,180,000</b>	<b>339,080,000</b>

## 12. PARAJA DHE EKVIVALENTË TË SAJ

Për qëllime të pasqyrës së flukseve monetare, mjetet monetare dhe ekuivalentet përfshijnë bilancet e mëposhtme me maturim origjinal prej më pak se 90 ditë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Llogaritë rrjedhëse	9,078,383	9,259,342
<b>Totali</b>	<b>9,078,383</b>	<b>9,259,342</b>

Në datë 31 dhjetor 2017 nuk ka depozita të vendosura (2016: Nuk ka).

## 13. DETYRIME TË TJERA

Të përfshira në detyrimet e tjera është tarifa e penalitetit në vlerën 1,151,424.13 lekë (2016: 883,313 Lek) për t'ju paguar Shoqërisë së Administrimit, për tërheqjen e parakohshme nga fondi i pensioneve. Tarifa e penalitetit llogaritet në përputhje me nenin nr.3 të Rregullores Nr.125 "Mbi penalitetet në lidhje me tërheqjen e parakohshme nga fondet e pensionit" të datës 10 Dhjetor 2010 të lëshuar nga AMF-ja.

## 14. AKTIVET NETO QË I ATRIBUOHEN MBAJTËSVE TË KUOTAVE

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Kapitali që i atribuohet mbajtës të kuotave	412,207,866	324,297,953
Kontributet kumulative	86,093,539	76,473,784
Shlyerje kumulative	(17,199,797)	(12,799,736)
<b>Kontributet kumulative të kapitalit neto</b>	<b>481,101,608</b>	<b>387,972,001</b>
Fitimet e përealizuara neto kumulative	(162,364)	1,860,183
Fitimet e realizuara neto kumulative	32,878,380	27,920,393
Shpenzime të tjera neto kumulative	(6,842,354)	(5,544,711)
<b>Rritja në aktivet neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave të pensionit nga operacionet</b>	<b>25,873,662</b>	<b>24,235,865</b>
<b>Totali i aktiveve neto që i atribuohet kontribuesve</b>	<b>506,975,270</b>	<b>412,207,866</b>
<b>Numri i kuotave të fondit</b>	<b>310,083</b>	<b>266,897</b>
<b>Aktivitet për njësi</b>	<b>1,635</b>	<b>1,544</b>

## 15. PALËT E LIDHURA

Palët konsiderohen si të lidhura në qoftë se njëra palë ka aftësinë për të kontrolluar palën tjetër ose të ushtrijë ndikim të rëndësishëm mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare ose operationale.

Palët e lidhura të Fondit janë Raiffeisen INVEST - Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a, e cila menaxhon Fondin, banka kujdestare e Fondit dhe Raiffeisen Bank sh.a. si aksionar i vetëm i shoqërisë administruese.

Që nga dhe për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2017 dhe 2016 Fondi ka hyrë në transaksionet dhe balancat e

mëposhtme me palët e lidhura me të.

<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë të tÿre</b>	<b>31 Dhjetor 2017</b>	<b>31 Dhjetor 2016</b>
Llogari rrjedhëse me Bankën kujdestare	9,078,383	9,259,342
<b>Totali</b>	<b>9,078,383</b>	<b>9,259,342</b>
<b>Detyrime ndaj Shoqërisë administruese</b>	<b>31 Dhjetor 2017</b>	<b>31 Dhjetor 2016</b>
Tarifë e pagueshme ndaj Shoqërisë administruese	639,285	520,886
Detyrime për kërkesa tërheqje nga fondi	173,574	2,317,726
Tarifë penalizimi për mbarim të parakohshëm të kontratës	1,151,424	883,313
<b>Totali</b>	<b>1,964,283</b>	<b>3,721,926</b>
<b>Të ardhura</b>	<b>31 Dhjetor 2017</b>	<b>31 Dhjetor 2016</b>
Të ardhura nga interesat nga depozitat me Bankën kujdestare të maturuara brenda vitit dhe llogaritë rrjedhëse	-	-
<b>Totali</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Shpenzime</b>	<b>31 Dhjetor 2017</b>	<b>31 Dhjetor 2016</b>
Tarifa e Shoqërisë administruese	6,842,354	5,544,711
<b>Totali</b>	<b>6,842,354</b>	<b>5,544,711</b>

## 16. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT

Nuk ka ngjarje pas datës së raportimit që mund të kërkojnë ose rregullim ose paraqitje shtesë në pasqyrat financiare.

